Gjatë punës njëvjeçare kanë kryer një numër të konsiderueshëm të kontrolleve veterinare. Kanë kontrolluar gjithsej 880 therrje të kafshëve para therrjes, gjatë therrjes dhe pas therrjes, të gjitha këto kafshë pas therrjes janë damkosur dhe pajisur me çertifikata shëndetësore të therrjes. Prej këtyre therrjeve kanë inkasuar $880 \times 5 = 4400$ euro. Inspektorët veterinarë gjatë punës se tyre kanë kryer këto aktivitete:

Kanë konfiskuar dhe asgjësuar gjithsej 1372 kg mushkëri gjedhi.

Kanë konfiskuar dhe asgjësuar mëlçi gjedhi gjithsej 657 kg mëlçi gjedhi të cilat ishin të prekura nga nekroza dhe parazitë të ndryshëm si: Fasciola Hepatica, Dicrocoelioza etj.

Kanë konfiskuar dhe asgjësuar 1245 kg mish gjedhi, mish të bluar, mish pule, qumësht dhe produkte të qumështit.

Kanë hartuar 183 procesverbale të rregullta në terren.

Kanë qenë monitorues të projekteve të inicuar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë për vlerësimin e gjedheve të racës simental të cilat u janë dhënë fermerëve të përzgjedhur të Komunës së Ferizajt. Kanë qenë monitorues të projektit për vaksinim të fondit blegtoral.

Kanë qenë monitorues të projektit për repelimin e gjedheve kunder sëmundjeve virale dhe parazitare.

Kanë inicuar 6 lëndë në Gjykatën Themelore – Divizioni për Kundërvajtje në Ferizaj.

Kanë kontrolluar ambulantat veterinare.

Sektori i Ambientit:

Gjatë periudhës kohore dymbëdhjetë mujore janë inspektuar rreth 90 biznese që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale. Numri më i madh i këtyre bizneseve merren me përgatitje të ushqimeve të shpejta, përgatitje të bukës dhe pjekurinave tjera nga mielli, mishtore, përpunues të drurit (mobileri) etj. Të gjitha këto inspektime janë bërë në bazë të nenit 15 të Udhëzimit Administrativ 17/2015 për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, ku saktësisht precizohet se cilat aktivitete i nënshtrohen LMK-së. Nga këto subjekte afariste është kërkuar që t'i plotësojnë kushtet për pajisje me Leje Mjedisore Komunale. Një numër i këtyre subjekteve afariste janë pajisur me LMK, ndërsa tjerat janë në procedurë të pajisjes me LMK. Një kujdes i veçantë i është kushtuar mbajtjes së qytetit të pastërt. Ka pasur disa takime me K.R.M. "Pastërtia" për bashkëpunimin që duhet ta kemi lidhur me mbajtjen sa më të pastërt të qytetit. Takime po ashtu ka pasur edhe me Drejtorinë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, kompaninë publike "Ambienti" pikërisht për mbarëvajtjen e punëve kolektivisht për një qytet më të pastër.

Janë shqiptuar 256 gjoba mandatore duke filluar nga 20 deri në 100 euro, gjoba këto për hedhje të mbeturinave, vajrave në hapësira të ndaluara, shpërndarje të broshurave (fletushkave) promociionale, ndotje të rrugëve etj., që kanë rënë ndesh me Udhëzimin Administrativ në fuqi 06/2018. Vlera monetare e këtyre gjobave arrin shifrën 23,130.00 €.

Të paguara me -50% nga vlera e gjobës totale janë 6,490 €, ndërsa pa paguar janë 16,640 €.

Të gjitha gjobat e papaguara do të përcillen tek përmbaruesi për ekzekutim të mjeteve monetare.

Po ashtu pas marrjes së ankesës dhe inspektimit të përbashkët me inspektorët e MMPH-së si dhe Njësitin e Krimeve të Rënda Ekonomike nga Policia e Kosovës, është marrë vendim për mbylljen e subjektit afarist "Flija Produkt" SH.P.K., pasi nga Komisioni Komunal për Dhënie të LMK-së i është refuzuar leja e tillë (Leja Mjedisore Komunale), për mosplotësim të kushteve për t'u pajisur me të. Përveç gjobave gjatë inspektimeve tona janë dhënë edhe shumë vërejtje gojore të mos hedhen mbeturina në hapësira në të cilat është e ndaluar hedhja e tyre. Po ashtu përmes një njoftimi të protokoluar i ka njoftuar qytetarët për orarin e hedhjes së mbeturinave në çdo pjesë të qytetit. Ka pranuar 50 ankesa me shkrim të cilave i janë përgjigjur në afat të caktuar kohor por ka ende ankesa të cilave do t'i përgjigjen brenda afatit të paraparë të shqyrtimit të tyre (dy prej tyre).

Ka pranuar po ashtu edhe 45 ankesa gojore nga qytetarët të cilave i jemi përgjigjur menjëherë si dhe efekti ka qenë pozitiv.

Gjithashtu gjatë inspektimit në terren ka bërë 80 procesverbale për konstatim të gjendjes si dhe rekomandime për ecuritë e mëtutjeshme.

Ka bërë mbi 30 ditë (orare të ndryshme e jo ditë të plota) inspektime me Inspektorët Sanitar si dhe të Tregut, lidhur me zbatimin e Ligjit të Ushqimit Nr.03/L-016 Neni 15, si dhe inspektimin e shkollave. Po ashtu ka bërë 18 njoftime/rekomandime me shkrim për eliminim të deponive ilegale. Inspektime 30 ditore së bashku me Inspektorët e MMPH-së, KPMM-së, MBPZHR-së si dhe Njësinë për Hetimin e Krimeve të Rënda lidhur me Planin Operativ “PARANDALIMI DHE NDALIMI I AKTIVITETEVE TË JASHTËLIGJSHME NË SEKTORIN MINERAR”.

Shënimi i Ditës Botërore të Ujit me aktivitete të ndryshme dhe pjesëmarrës të shumtë.

Shënimi i Ditës Botërore të Tokës po ashtu me aktivitete simbolike ku pjesëmarrësit kanë qenë të shumtë në shënimin e kësaj dite.

Pjesëmarrës në sesionet informuese dhe seminarët të organizuara nga OJQ Let's Do It Kosova.

Pjesëmarrje në trajnimin dy-ditor për Ligjin e Përgjithshëm të Procedurave Administrative.

Kemi qenë pjesë e takimeve të organizuara nga GIZ-i gjerman me temë: *PLANI OPERATIV NË KOMUNËN E FERIZAJT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE*.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin inspektorët e mjedisit, GIZ, DSHPE, KIËER, BK Consulting, një grup nga KRM “Pastërtia”.

Spektori Komunal:

Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare, Inspektorët Komunal janë angazhuar në zbatimin dhe implementimin e Rregullorës për Rregullin dhe Shërbimet Komunale. Të gjitha procedurat administrative, procesverbale, aktvendimet si dhe kërkesat për kundërvajtje në gjykatë, janë të bazuara në ligjin për procedurë administrative, Kodin Penal dhe në Rregulloren për Shërbimet Komunale të Komunës së Ferizajt. Zbatimi i kësaj rregullore konsiston në mirëmbajtjen e rregullt të trotuareve, rrugëve, hapësirave publike, parqeve, tregjeve në mënyrë që të evitohet rrezikshmëria e qytetarëve në mirëmbajtjen e infrastruktuës komunale etj.

Angazhimi i inspektorëve komunal ka qenë i orientuar në parandalimin e dukurive negative dhe eliminimin e tyre në hapësirat publike në qytet dhe zonat rurale, si dukuri më e theksuar edhe në këtë periudhë kanë qenë tregtarët ambulant me tezgat lëvizëse të vendosura në sipërfaqe publike, verandat dhe mosrespektimi

i skicave për shfrytëzimin e hapësirave publike, krijimi i deponive të egra në disa pjesë të qytetit, kanalizime të ndryshme, defekte në ujësjellës ejt. Në këtë raport po paraqesim të dhënat në mënyrë kronologjike për zhvillimin e procedurave dhe kontrolleve të ndryshme:

- Ankesa dhe kërkesa të qytetarëve – 108;
- Të përfunduara - 105;
- Në proces e sipër – 3;
- Kontrolle të rregullta – 280;
- Kontrolle vizuele – 102;
- Procesverbale – 135;
- Vendime dhe shkresa zyrtare – 12;
- Kallëzime Penale – 3;
- Gjoha – 7;
- Përgjigje në kërkesa të veçanta – 7;
- Kërkesa për kundërvajtje – 4.

III. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Tregu:

- Kontrollimi i të gjitha subjekteve afariste nga Inspektorët e Tregut në kuadër të autorizimeve ligjore;
- Procedimi i lëndëve për procedurën përmbarimore;
- Monitorimi dhe ndalimi i shitësve të mjeteve piroteknike.

Sanitar:

- Kontrollimi dhe monitorimi për kushte higjieno - sanitare në subjektet ushqimore të Komunës së Ferizajt;
- Inspektime në subjekte afariste të cilat kanë produkte shtazore.

Ndërtimi:

- Monitorimi sistematik i objekteve të pajisura me leje ndërtimi;
- Rrënimi i objekteve pa leje.

-

Veterinar:

- Monitorimi i të gjitha mishtoreve të cilat operojnë në kuadër të Komunës së Ferizajt.

Ambient:

- Monitorimi i deponive ilegale;
- Monitorimi i shitësve ambulant të thëngjillit;
- Njoftimi në vazhdimësi për ruajtjen e ambientit;

Komunal:

- Monitorimi i bulevardit të qytetit;
- Inspektimi në terren në bazë të kërkesave të qytetarëve;
- Monitorimi dhe lirimi i hapësirave publike.

IV. STATISTIKAT

5.1 Punët me palë

Të dhënat janë relative

- Sektori i tregut –250;
- Sektori sanitar – 200;
- Sektori ambientit - 180;
- Sektori komunal – 100;
- Koordinator – 500.

5.2 Lëndët e pranuar, të kryera dhe në procedurë

Sektori i tregut

- Lëndë të kryera – 411;
- Lëndë në procedurë – 2;

- Arkëtim nga gjobat – 16,350.00 €.

Sektori sanitar

- Lëndë të kryera - 297;
- Lëndë në procedurë – 10;
- Arkëtim nga gjobat 10,500.00 euro.

Sektori i ndërtimit

- Lëndë të kryera – 30;
- Lëndë në procedure – 3.

Sektori veterinar

- Realizim nga therrjet – 4400 €.

Sektori ambientit

- Lëndë të kryera – 80;
- Lëndë në procedurë – 4.

Sektori komunal

- Lëndë të kryera – 105;
- Lëndë në procedure – 3.

V. SFIDAT

- Mungesa e veturave për Inspektoratin po mbetet ende një problem i madh, duke pasur parasysh numrin e madh të subjekteve dhe ekonomive në Komunën e Ferizajt;
- Mungesa e mjeteve teknike - teknologjike (aparate fotografike, printer me ngjyrë, aparaturë për matjen e ndotjes akustike) shpesh ka qenë shkaktar i mos efikasiteti në punë;
- Vetëdijisimi i qytetarëve për hedhjen e mbeturinave në vende adekuate dhe në kohë të caktuar.

VI. REKOMANDIMET

- Pajisja me vetura shtesë për Inspektoratin Komunal;
- Aparate fotografike;
- Aparate për matjen e ndotjes;
- Aparate për matjen e zhurmës akustike;
- Rritja e numrit të Inspektorëve;
- Pajisja e inspektorëve me uniformë të punës.

VII. AKTIVITETET PËR VITIN 2020-të

- Implementimi i Udhëzimit Administrativ 17/2015;
- Monitorimi i ndotjes nga djegia e thëngjillit;
- Inspektimi i hapësirave publike;
- Organizimi dhe koordinimi i punëve brenda sektorit;
- Përcjellja e gjendjes në kuadër të sektorit, identifikimi i problemeve dhe vështirësive, si dhe propozimi i masave për menjanimin e tyre;
- Përgatitja e planeve dhe raporteve javore, mujore dhe vjetore të punës;
- Inspektimi i lokaleve afariste sa i përket kushteve sanitare;
- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Inspektim final i objekteve ndërtimore;
- Rrënimi i objekteve pa leje;
- Largimi nga hapësirat publike i shitësve ambulant.



REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ



ZYRA E NJËSISË SË AUDITORIT TË BRENDSHËM

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2019

Raporti i punës është përgatitur nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, i cili përmbledh punët dhe shërbimet e auditimit të brendshëm të kryera gjatë vitit kalendarik 2019.

Raporti pasqyron punën e kryer dhe rezultatet e arritura, krahasuar me objektivat dhe detyrimet e planifikuara vjetore të vitit 2019. Auditimet e brendshme janë të mbështetura dhe të bazuara në ligjin Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike si dhe ligjeve dhe akteve nënligjore të tjera në fuqi.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, për vitin 2018 ka përgatitur Planin Strategjik 2019/2021, si dhe Planin Vjetor 2019, e që planifikimi i auditimit është bazuar në rrezikun dhe orientimin e identifikimit dhe përfshirjes për fushat me rrezik për organizatën buxhetore.

Pasi që nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është përgatitur Plani Strategjik dhe Plani Vjetor për vitin 2019, është përcjellë për miratim tek Kryetari i Komunës dhe tek Kryesuesi i Komitetit dhe gjithashtu është dorëzuar një kopje e miratuar në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm.

Në Planin Strategjik 2019-2021 janë të përfshira të gjitha drejtorit-njësitë buxhetore, duke u bazuar në nivelin e rrezikshmërisë me: rrezik të lartë, rrezik të mesëm dhe rrezik të ulët dhe gjithashtu është hartuar Plani Vjetor në të cilin janë paraparë ditët efektive për çdo auditim.

Për vitin 2019, sipas Planit Vjetor janë paraparë gjithsej gjashtë (6) auditime të brendshme që janë: katër (4) me rrezik të lartë, pesë (2) me rrezik të mesme dhe një (0) me rrezik të ulët.

Për vitin 2019 janë kryer këto auditime:

- Procedurat e menaxhimit të pasurive dhe inventarit-Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
- Grumbullimi i të hyrave vetanake -Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit.
- Procedurat e menaxhimit të resurseve njerëzore në DA-Drejtoria e Arsimit.

- Procedurat e menaxhimit të shpenzimeve për mallra, shërbime, komunalit dhe kapitale-Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
- Procedurat e menaxhimit të pasurive dhe inventarit-Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
- Procedurat e menaxhimit të prokurimit-Zyra e Prokurimit

Niveli i realizimit të Planit Vjetor

Gjatë vitit 2019, zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka arritur t'i kryej gjashtë (6) auditime të brendshme dhe të përmbush planin e planifikuar vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2019.

Gjithashtu, zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës ka kryer dhe një (1) auditim të brendshëm:

- Procedurat e rregullimit të veturës së aksidentuar- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Pra, gjatë vitit 2019, zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka arritur t'i kryej gjithsej shtatë (7) auditime të brendshme dhe t'i hartoj e dorëzoj në drejtoritë e audituara, Kryetarit të Komunës, si dhe Kryesuesit të Komitetit nga një kopje të raporteve finale.

Nga gjithsej shtatë (7) auditimet e kryera për të gjeturat e konstatuara kemi dhënë njëzeteshtatë (27) rekomandime për përmirësim, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit gjatë kryerjeve të detyrave të punës nga ana e zyrtarëve të Komunës.

Për rekomandimet e dhëna, të gjitha drejtoritë janë përgjigjur, duke na përcjellë dhe përgatit planin e veprimit dhe datën përfundimtare të zbatimit të rekomandimeve. Bazuar në planet e veprimit të drejtorive, Njësia e Auditimit të brendshëm ka përgatitur oraret e përcjelljes së implementimit të rekomandimeve të dhëna nga kjo zyrë.

Gjatë përcjelljes së zbatimit të rekomandimeve nga gjithsej njëzeteshtatë (27) rekomandimet e dhëna, kemi konstatuar këtë gjendje lidhur me zbatimin e tyre nga ana e drejtorive:

- Tërësisht të zbatuara - njëmbëdhjetë (11)
- Pjesërisht të zbatuara (në proces) - pesë (5)
- Të pazbatuara njëmbëdhjetë - (11)

Pesë (5) rekomandime mbeten për përcjellje gjatë vitit 2020, sipas planit të veprimit të përgatitur për datën përfundimtare të implementimit.

Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për çdo përcjellje të rekomandimeve ka hartuar raporte dhe ua ka dorëzuar drejtorive të audituara, Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Komitetit.

Zyra e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, për dy (2) gjashtëmujorët e vitit 2019 ka përgatitur raportet përmbledhëse dhe ua ka dorëzuar për njoftim me gjendjen e audituar në Komunën e Ferizajt, Njesisë Qendrore Harmonizuese, Kryetarit të Komunës, si dhe Kryesuesit të Komitetit.



ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2019

Zyra për Integritet Evropian funksionon në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Ferizajt. Kjo zyre ka rol të koordinimit, monitorimit dhe raportimit në institucionet gjegjëse të cilat merren me integritet evropian. Pra, linjat e komunikimit në mënyrë të vazhdueshme i mbajmë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministrinë e Integritetit Evropian (MIE).

Gjatë periudhës dymbëdhjetë mujore, respektivisht Janar - Dhjetor 2019, ne kemi kryer në përpikëri obligimet të cilat i kemi të përcaktuara sipas detyrës zyrtare, pra koordinimin, monitorimin dhe raportimin në institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të cilat merren me integritet evropian.

Kemi bërë raportimin e rregullt periodik në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me Bashkëpunimin Ndërkomunal dhe Komunal Ndërkombëtar. Poashtu kemi kompletuar dokumentacionin dhe dosjet e punëve të kryera. Kemi kryer edhe punë të tjera zyrtare në kuadër të zyrës.

Gjatë periudhës raportuese, Zyra për Integritet Evropian ka bërë raportimin e rregullt në MAPL lidhur me implementimin e Planit Individual të Veprimit për Komunën e Ferizajt, dalur nga Agjenda Evropiane për vitin 2019. Kemi plotësuar pyetësorët e ndryshëm të kërkuara nga MAPL, MIE dhe AKK.

Janë ndërrmarrur të gjitha ato veprime me prioritet për integrimet evropiane, me të cilën synohet të jetë krijimi i një klime të volitshme për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetës së qytetarëve, sundimin e ligjit, mbrojtjen e pronës, lirinë e lëvizjes, shprehjen e mendimit, tolerancën dhe krijimin e mirëbesimit.

Në periudhën njëvjeçare Janar - Dhjetor 2019 kemi mbajtur kontaktet e përditshme dhe dërgimin e informatave të kërkuara qoftë përmes telefonit apo përmes postës elektronike me Departamentin për Koordinim, Zhvillim dhe Integritet Evropian të MAPL-së, Ministrinë për Integritet Evropian dhe Ministrinë e Linjave.

Në të gjitha takimet konsultative apo tryezat e punës, jemi përgjigjur pozitivisht thirrjeve të Ministrive përkatëse, duke dhënë kontributin tonë për çështjet në fjalë.



REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ



ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2019

- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim qëllim parësor gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019 ka patur koordinimin e aktiviteteve me të gjithë faktorët relevant që ndihmojnë në stabilizimin e komuniteteve, procesin e kthimit të qëndrueshëm dhe procesin e riatdhesimit dhe ri-integrimit me qëllim të krijimit të një klime të mirë për zhvillim të komuniteteve, dhe ri-integrimin e tyre.
- Lehtësimin e dialogut ndëretnik dhe ndërtimin e besimit ndërmjet personave të kthyer dhe komunitetit pranues.
- Koordinimin i aktiviteteve me zyrtarët për kthim të qëndrueshëm, zyrtarët për integrim të komuniteteve, me institucionet komunale, ministritë përkatëse si dhe bashkëpunimin e ngushtë me organizatat e tjera lokale dhe ndërkombëtare të angazhuara në fushën e stabilizimit të komuniteteve, kthimit dhe ri-integrimit (shkëmbimi i informatave për personat e zhvendosur dhe personat e kthyer).

Stabilizimi i komuniteteve

Sa i përket komuniteteve rom, ashkanli, egjiptian, serb dhe komuniteteve tjera që jetojnë në Komunën e Ferizajt, familjet me gjendje të rëndë ekonomike janë ndihmuar nga organizata, “Human Appl International” me pako të mishit, ndërsa organizata AT - ja ka përkrahur familjet e kthyera herë pas here me pako ushqimore dhe jo ushqimore.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ka përkrahur rreth 55 familje me dru zjarri. Ministria e Planifikimit Hapësinor ka filluar ndërtimin e shtëpive për disa familje por që ende nuk janë përfunduar ndërsa familjet dhe disa janë ende në proces (Lista e përfitueseve për ndërtimin e këtyre shtëpive nuk është hartuar nga ZKKK – ja).

ZKKK – ja ka ndihmuar në kompletimin e dokumenteve të personat që kanë pasur nevojë dhe janë lajmëruar në ZKKK.

Arsimim

Sa i përket arsimit nuk ka pasur ndonjë problem të theksuar, në koordinimi me Drejtorinë e Arsimit gjatë tërë vitit kanë vazhduar aktivitetet për evidentimi i nxënësve që kanë braktisur shkollimin dhe numri i këtyre nxënësve që kanë braktisur shkollën është zvogëluar dukshëm.

Nga zyrtarët e ZKKK – së janë përkrahur nxënësit e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në kompletimin e dokumenteve për aplikim për bursa. Në fillim të vitit shkollor ka pas rritje të aktiviteteve për evidentimi i nxënësve që kanë mbetur pa u regjistruar në klasën e I dhe klasën e X ku janë përfshirë gati të gjithë nxënësit.

Shëndetësia

Të gjitha rastet për probleme shëndetësore janë trajtuar në koordinim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale. Ka pasur edhe trajnime sa i përket ngritjes së vetëdijësimit shëndetësor nga QKMF – ja dhe organizatat e ndryshme.

Kthimi

- Të kthyerit nga Maqedonia vazhdojnë të mbesin kthimet e asistuara nga UNHCR –i, të cilat janë përkrahur me akomodim njëvjeçar, pako ushqimore dhe jo ushqimore, pakot e orendive shtëpiake, një pagesë mujore dhe projekt për qëndrueshmëri ekonomike. Por pas kësaj asistence këto familje të kthyer vazhdojnë të mbesin pa zgjidhjen e problemit të banimit për shkak të gjendjes jo të mirë ekonomike , në mungesë të pronës. Për 12 familje të kthyer nga Maqedonia që nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit Ministria për Komunitete dhe Kthim ka paguar qiranë.
- Në Komisionin qendror për rishikim për përzgjedhjen e përfituesve potencial për ndihmë të kthimit është aprovuar lista me përfituesit potencial, pas shqyrtimit të kërkesave të parashtruara nga PZHI-ve dhe PZHBV-ve nga Komuna e Ferizajt.
- Grupi Punues Komunal për Kthim gjatë këtij viti mbajtur 4 takime, ku është shqyrtuar dhe hartuar lista (prej 30 familjeve) me personat e kthyer nga Komuna e Ferizajt dhe personat nga komunat tjera e që janë të vendosur për banim në Komunën e Ferizajt. Në listën prej 30 familjeve që janë në proces për rindërtim të shtëpive, 18 familje janë nga Komuna e Ferizajt, 6 nga Komuna e Prishtinës, 3 nga Komuna e Hanit të Elezit, 2 nga Komuna e Vitisë dhe 1 nga Komuna e Kaçanikut.
- Lista është përcjellur tek Ministria për Komunitete dhe Kthim, në këtë listë 3 familje janë që posedojnë pronë dhe kanë mbetur në proces për ndërtim të shtëpive, për shkak të gjendjes jo të mirë

të këtyre familjeve edhe Kryetari i Komunës ju ka drejtuar me një shkresë Ministrisë për komunitete dhe Kthim, organizatës IOM (projektit RRK IV), megjithatë këto tri raste ende janë në proces.

- Familjet e kthyer janë monitoruara nga zyrtarët e ZKKK – së në koordinim me organizatat (UNHCR, CRPK, AT - ja). Të përkrahur nga organizata e UNHCR –it dhe AT - së janë mbajtur edhe aktivitete të ndryshme për të ndihmuar në ri-integrimin e qëndrueshëm për personat e kthyer.
- Organizata e IOM-it – Projekti për Zhvillimin dhe Stabilizimin e Komuniteteve ka përkrahur 2 biznese individuale, të cilat biznese janë funksionale dhe të qëndrueshme

Riatdhesimi dhe Ri-integrimi

- Të riatdhesuar në vitin 2019 janë: 91 persona, prej tyre 43 femra dhe 48 meshkuj. Sipas përkatësisë etnike: Shqiptarë - 45, ashkali – 43, rom - 2, goran – 1
- Kërkesa për përftim nga Fondi për Ri-integrim janë 62: Për rekomandim te Zyra e Punësimit 49 kërkesa ndërsa kërkesa për përfitim nga Fondi për Ri-integrim 13. Të regjistruar në SMR (Sistemi i Menaxhimit të Rasteve) nga ZKKK – ja 73 raste. Kërkesat janë shqyrtuar nga Komisioni Komunal për Ri-integrim. Ndërsa Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ka përgatitur lëndët për KKR – në, Vendimet dhe kompletimin e lëndëve për DRPR – në si dhe ka lëshuar vërtetime si dëshmi riatdhesimi për Zyrën e Punësimit.
- Në koordinim me Zyrtarin e Lartë për Koordinim Rajonal dhe Zyrtarin nga Zyra Rajonale e punësimit janë monitoruar përfituesit e Plan Bizneseve
- Me rregulloren Nr.13/2017 nuk ka më aplikim për Plan Biznese në ZKKK, këto aplikime DRPR – ja i ka bartur tek Ministria e Punës (Zyrat Rajonale të Punësimit).

Për personat e riatdhesuar me gjendje jo të mirë ekonomike janë njoftuar zyrtarisht edhe organizatat AËO, URA2 dhe OFAP, disa familje janë përkrahur nga këto organizata, mirëpo ZKKK - ja nuk posedon të dhëna për ndihmën e ofruar.

- Gjykata Themelore e Ferizajt ka bërë 51 kërkesë në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim për sigurimi i të dhënave për adresat e palëve ndërgjyqëse, të gjitha kërkesave ju kemi përgjigjur me kohë.

Janë mbajtur takime dhe aktivitete të ndryshme, ku qëllimi ka qenë ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të ZKKK – së si dhe ndihma në kthimin, ri-integrimin dhe zhvillimin e komuniteteve.



NJËSIA KOMUNALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2019

Ky raport pasqyron përmbledhjen e punës të Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut për periudhën Janar –DHjetor 2019.

Në raport janë prezantuar aktivitetet që pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara gjatë kësaj periudhe në fushat të cilat i trajton NJDNI.

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Treguesit e suksesit- rezultatet	Afati kohor	Resurset-
Ofrimi i mundësive të barabarta për punësim dhe krijimi i kushteve të përshtatshme për punë për të gjithë	- Monitorimi i rekrutimit në punësim në sektorin publik (pjesëmarrja në intervista)	NJKDNJ	- Rritja e shkallës së zbatimit të legjislacionit vendor dhe ndërkombetarmbi punën dhe punësimin - Ofrimi i mundësive të barabarta për punësim	Kontinuitet	
Ofrimi i shërbimeve më të mira shëndetësore	- Ofrimi i rekomandimeve për rregulloren Komunale për lirim nga pagesa të kategorive të cilat janë të përcaktuara në Ligjin për Shëndetësinë	NJKDNJ	- Krijimi i lehtësirave për shërbime shëndetësore		

Ofrimi i shërbimeve më të mira për qytetarë në Administratën Publike	- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e shërbimeve më të mira për qytetarë		- Ofrimi i shërbimeve dhe krijimi i lehtësirave në marrjen e dokumentave identifikuese për qytetarë -		
Udhezimi Administrativ për heqjen e taksave komunale për regjistrimin e pronës në emer të dy bashkeshortëve	Ofrimi i udhëzimit në shërbim të qytetarëve	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster NJDNJK		Mase afirmative një vite kohore	
Mareveshje bashkepunimit Komune- GIZ	Ofrimi i shërbimeve sociale për qytetarët	Grupi Komunal punës-Caritas Kosova	Identifikimi i personave me nevojë të veçantë dhe hulumtimi për një databazë për këto komunitet	Kontinuitet	
Parandalimi i dukurive negative për të mitur	-	NJKDNJ	- Zbatimi i Rregullores për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë negative Zbatimi i Legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar	Kontinuitet	
Ofrimi i ndihmës juridike për qytetarët		Ombudspersoni dhe NJKDNJ			
- Mbajtja e takimeve dhe tryezave me qytetarë (grupmosha të ndryshme) për të drejtat dhe liritë themelore - Shqyrtimi i ankesave për shkelje eventuale të të drejtave të njeriut	NJDNJK dhe Avokati i popullit	NJKDNJ	- Njohja e qytetarit me të drejtat		
-	-				

Informimi dhe vetëdijësimi i femrave për eliminimin e stigmave që pengojnë avancimin e femrës	Takime me Gratë e zonave rurale dhe me gratë e komunitetit RAE Takimet me Grupin Jo Formal te Grave	NJDNJ	- Përfaqësimi i femrës në jetën institucionale		
Ofrimi i mundësive të barabarta për Grua-Burrë		ZBGJ	Rritja e vetëdijësimit për të drejtën e Gruas dhe ofrimi i mundësive të barabarta		
Parandalimi i stereotipeve dhe paragjyqimeve për Gruan		ZBGJ	-Zbatimi i Kushtetutës, Ligjeve dhe rregullores dhe janë në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të Njeriut, të drejtën e Gruas		
Informimi dhe vetëdijësimi i femrave për eliminimin e stigmave që pengojnë avancimin e femrës e veqmas në Trashigimi	- Organizimi i tryezës “LYP HISE GJEJ SHERR” Film dokumentar për të Drejtën e gruas në Trashigimi	ZBGJ			
		ZBGJ			
Identiteti Gjinor		ZBGJ			
Përkatësia Gjinore		ZBGJ			
Pozita e femrës në familje dhe vendimmarrje		ZBGJ			
Pozita e barabart e vajzës dhe djalit në familje		ZBGJ			
Format e diskriminimit së gruas	Tryezë e rrumbullaket	ZBGJ dhe mekanizmat tjere institucional	Ligji i dhunës në familje dhe ligjet tjera që mbrojnë të drejtën e gruas dhe të drejtat e njeriut		
Dhuna në familje					
Ligji për barazi gjinore					

Vendosja e Rregullorës për Barazi Gjinore në nivelin institucional ndërmejet pushtetet lokale me qytetarët me theks te vecantë të përfaqësimit nga femrat anëtare të Kuvendit komunal , përfaqësuesit e partive politike në nivel legjislativ, , dhe përfaqësuesja e OSCE-se	Zyrtarja për barazi gjinore, në konsultim me pjesëmarrëset – femrat asambleiste ka planifikuar kohëzgjatjen e puntorisë, me karakter pune .		Përfituesit kryesorë janë qytetaret e Komunes sonë.		
Takimet me organizatat Ndërkombëtare UNDP, OSCE, GIZ	Promovimi i të drejtave te grave dhe te vajzave	ZBGJ dhe Grupi i Grave Asambleiste			
		ZBGJ			
		ZBGJ dhe OJQ-të	Rrezoluta 1325, Gratë, Paqja dhe Siguria		
		ZBGJ	Me Grupin e grave, me grupin e burrave dhe me grupin e të rinjëve, Rrezoluta 1325		
Trajnim me qytetarët		Kryesuesja e Kuvendit, ZBGJ			
Organizimi i 8 Marsit dites Nderkombetare te Gruas	Takim me Grate	ZBGJ	Programi për barazi gjinore i komunës së Ferizajt ka vlerë të njëjtë për të gjithë qytetarët. Vizioni është që barazia gjinore të realizohet jo vetëm në segmente të caktuara por si tërësi në gjithë komunën.		
Vendosja e Programit për barazi gjinore			Shfaqja e filmit dokumentar “Këq-paraqitja” (Misrepresentation), debat lidhur me dokumentarin dhe		

SHËNIMI I 16 DITËVE AKTIVE KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE		ZBGJ dhe UNDP OSCE, ZBGJ	gjendjen e paraqitjes së gruas në media edhe në kontekstin tonë. Te drejtat e Njeriut,dhe Ligji per Barazi Gjinore		
Promovimi i të drejtave të komuniteteve	- Organizimi i takimeve të komunitetit pakicë për të drejtat e komuniteteve	NJDNJ	-Integrimi i komuniteteve në jetën institucionale e publike		
Promovimi i të drejtave të fëmijëve	- Organizimi i debateve publike me Drejtues të shkollave, nxënës, qytetarë për të drejtat e fëmijëve	NJDNJ NJDNJ DA	-Identifikimi i gjendjes aktuale për DF - Zbatimi i infrastrukturës ligjore për fëmijë		
Promovimi i të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara	- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësimin e kushteve për PAK-të - Identifikimi dhe sigurimi i të dhënave të fëmijëve me aftësi të kufizuara	NJDNJ	- Infrastruktura e rregulluar për PAK-të - Grumbullimi i të dhënave për fëmijët me AK		



REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2019

Aurora Ramadani
Drejtores e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme

Ferizaj
2020

Hyrje

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme (DAP), është kompetente për ofrimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për administratën komunale dhe për ofrimin e shërbimeve për qytetarë, bazuar në ligjet që janë në fuqi: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji mbi Shërbimin Civil, Ligji për Gjendjen Civile, Statutin e Komunës, udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet.

DAP është:

- Garantuese e funksionimit demokratik të administratës komunale në aspektin e vendimmarrjes;
- E lirisë së shprehjes së mendimit;
- Trajtimit të drejtë të kërkesave e shqetësimeve të qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të caktuara të interesit;
- Zbatimit rigoroz të ligjit në procedurat administrative dhe ekzekutive;
- Rritjes së partneritetit ndërmjet administratës në njërën anë dhe qytetarëve në anën tjetër;

DAP do të vazhdojë t'i ruaj dhe kultivoj marrëdhëniet e mira me komunitetet pakicë, në respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre sipas parimit ligjor dhe qytetar.

Synimet e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme gjatë vitit 2019 kanë qenë:

- Krijimi i një administrate profesionale të përgjegjshme dhe të paanshme në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve, infrastrukturë të avancuar profesionale.
- Ofrimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me punët e legjislativit dhe të ekzekutivit.

DAP është angazhuar për të siguruar dhe garantuar:

- Respektim të ligjit (akteve ligjore, nënligjore dhe normative);
- Llogaridhënie;
- Profesionalizëm;
- Efikasitet;
- Barazi gjinore;
- Transparencë në vendimmarrje dhe procedura ekzekutive;
- Depolitizim të aktiviteteve të administratës;
- Luftë kundër dukurisë së korrupsionit dhe dëmtimit të pasurisë së Komunës;
- Shërbime publike cilësore dhe të shpejta për qytetarin;

-
- Frymë të tolerancës për mendimin ndryshe dhe të bashkëpunimit e bashkëpjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në përmirësimin e shërbimeve të administratës komunale.

Angazhimi i vazhdueshëm i DAP për ndërtimin e një administrate funksionale dhe efikase mbi bazën e respektimit të ligjit

- DAP gjatë vitit 2019 ka zhvilluar një aktivitet të gjithanshëm të bazuar në respektimin e ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, duke qenë në funksion dhe në shërbim të gjithë administratës komunale dhe të qytetarëve të komunës tonë.
- **DAP e organizuar në sektorët e lartshënuar** ka arritur që me përkushtimin më të lartë t'i kryej me sukses të gjitha punët dhe detyrat që i kanë dalë përpara gjatë kësaj periudhe një vjeçare të punës, duke qenë vazhdimisht në shërbim të gjithë administratës komunale dhe të qytetarëve të komunës tonë. Më poshtë po përmendim vetëm disa nga aktivitetet më të rëndësishme të administratës komunale:
- Gjatë këtij viti, DAP ka zhvilluar takime të rregullta me përfaqësues të MAPL-së (Ministritë së Administrimit të Pushtetit Lokal), të MAP-së (Ministritë së Administratës Publike), OSBE-së (Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian), të UNDP-së (United Nations Development Program-Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim), të Bankës Botërore, me përfaqësuesit e shoqërisë civile, me mediat elektronike dhe të shkruara etj. Çdo ditë pune është punuar me palë dhe qytetarë të Komunës sonë;
- Gjatë këtij viti, Sektori i Gjendjes Civile e ka rritur vazhdimisht efikasitetin në punë dhe cilësinë e shërbimeve për qytetarët, duke iu ofruar atyre shërbime të shpejta dhe cilësore. Me gjithë fluksin e madh të qytetarëve që kërkojnë shërbime në këtë sektor janë kryer brenda afatit optimal aty për aty, përveç rasteve kur kërkohet dokumentacion plotësues.
- Kjo është një e arritur e jashtëzakonshme e këtij sektori të DAP.
- Me aplikimin e teknologjive të reja është krijuar një mundësi për administratën komunale që sa më lehtë dhe në mënyrë më efikase të kryhen punët, kurse për qytetarët një mundësi për shërbime më cilësore nëpërmjet aplikimit online për pajisjen me dokumentet nga zyra e gjendjes civile.
- Gjatë këtij viti kemi organizuar dhe mbikëqyrur regjistrimin vjetor të inventarit të gjithë sektorëve të administratës komunale duke përfshirë edhe institucionet arsimore, shëndetësore, bibliotekave si dhe institucioneve të tjera që janë nën menaxhimin e Komunës dhe pas këtij regjistrimi kemi bërë edhe tërheqjen e inventarit të demoluar, duke e grumbulluar në depo, kurse pjesën që kemi konstatuar që mund të përdoret e kemi riaftësuar dhe dhuruar shkollave që kanë pasur nevojë (sipas kërkesave të tyre) .
- Këto veprime janë kryer duke formuar paraprakisht komisionet adekuate siç janë: Komisioni për vlerësim dhe regjistrim të inventarit;

- Janë marrë edhe një varg hapash e masash të tjera për funksionalizimin e mëtejshëm dhe bërjen më efikase të administratës komunale.

Në vazhdim do të paraqesim punën vjetore të sektorëve dhe njësive të DAP

Administrata gjatë vitit 2019

DAP gjatë vitit 2019 ka zhvilluar aktivitetin e vet përmes këtyre njësive organizative:

1. Zyrtari i financave
2. Asistentja Ekzekutive
3. Sektorit të Shërbimeve të Përbashkëta-SSHP;
4. Sektorit të Shërbimeve Juridike, Ligjore dhe Administrative-SSHJLA;
5. Sektorit të Gjendjes Civile;
6. Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut

1. Zyrtari financiar

Është përkujdesur për gjendjen financiare të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, përkatësisht i ka ndërmarrë të gjitha veprimet për kompletimin e lëndëve për pagesën e të gjitha faturave të cilat kanë të bëjnë me harxhimet e rrymës elektrike, ujit, faturat e pastërtisë, faturat për riparimin e mjeteve zyrtare si dhe faturat tjera që janë barrë e drejtorisë përkatëse.

2. Zyrtarja administrative (Asistentja Ekzekutive)

Është përkujdesur për punët administrative në kuadër të drejtorisë, përkatësisht pranon të gjitha kërkesat e drejtorisë për të cilat janë zhvilluar procedura dhe të njëjtat i klasifikon dhe i ruan në arkivin e drejtorisë gjegjëse. Shtyp njoftime dhe shkresa të tjera të DAP, kompletton lëndët dhe bënë sistemimin dhe protokolimin e shkresave të ndryshme, bënë pranimin e kërkesave të studentëve për punë praktike në Komunën e Ferizajt si dhe lëshon vërtetime pas përfundimit të punës praktike, kryen edhe punë tjera të arsyeshme në kuadër të drejtorisë.

3. SEKTORI I SHËRBIMEVE TË PËRBASHKËTA

Në kuadër të Sektorit e Shërbimeve të Përbashkëta hyn si më poshtë:

1. Zyra për shërbim të qytetarëve me tre zyrtarë,
2. Arkivi me dy zyrtarë.
3. Njësia e postës me një zyrtarë,
4. Njësia e shoferëve katër të punësuar
5. Njësia për përkthime me dy zyrtarë,
6. Njësia për mirëmbajtje të objektit me dy të punësuarë,
7. Një Zyrtar për financa dhe një administrativ
8. Zyrtar të logjistikës,
9. Zyrtar për mirëmbajtjen e zërimit dhe rrymës elektrike.

Gjatë kësaj periudhe Sektori i Shërbimeve të Përbashkëta i ka kryer këto shërbime siç vijojnë:

- Është monitoruar mbarëvajtja e punëve dhe personelit në zyrën për shërbime të qytetarëve.
- Është përkujdesur për shpërndarjen e shkresave zyrtare prej zyrtarëve komunal deri te qytetarët në qytet dhe zona rurale, përmes zyrtarit për shpërndarjen e postës.
- Është përkujdesur dhe e ka monitoruar punën e zyrës për përkthimin e shkresave zyrtare prej gjuhës shqipe në gjuhën serbe.
- Në mënyrë permanente është përcjellë puna e shoferëve, angazhimin e tyre për bartjen e zyrtarëve komunal.
- Me një përkujdesje të shtuar ka monitoruar gjendjen teknike të automjeteve zyrtare, evitimin e prishjeve të ndryshme, përcjelljen e mbushjeve me lëndë djegëse, kontrollimin e vajit, antifrizit, pastrimin e automjeteve si dhe shërbime tjera.
- Është përkujdesur për servisimin e automjeteve të reja sipas afateve të parapara me libra të automjeteve.
- Është përkujdesur për kohëzgjatjen e regjistrimit të automjeteve zyrtare dhe kompletimin e dokumentacionit për regjistrim përmes shoferëve.
- Është përgatitur raporti vjetor për secilën veturë që ka të bëjë me evitimin e prishjeve, zëvendësimin e pjesëve dhe vlerën e kushtueshmërisë.
- Përmes zyrtarit për mirëmbajtjen e objektit janë evituar prishjet e ndryshme si të dyerve, përkatësisht ndërrimin e bravave të dyerve, nyjeve sanitare si në objektin e komunës ashtu edhe në objektet ndihmëse (qendrën rinore, sallën e sportit, zyrat e vendit etj).
- Zyrtari financiar është përkujdesur për gjendjen financiare për Drejtorinë e Administratës dhe Personelit, përkatësisht ka ndërmarrë të gjitha veprimet për kompletimin e lëndëve për pagesën e të gjitha faturave të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet e rrymës elektrike, shpenzimet e ujit, faturat e pastërtisë, faturat për riparimin e automjeteve zyrtare, si dhe faturave tjera që kanë qenë barrë e drejtorisë përkatëse.

- Zyrtarja administrative është përkujdesur për punët administrative në kuadër të drejtorisë, përkatësisht ka pranuar të gjitha kërkesat për drejtorinë, për të cilat janë zhvilluar procedura për shqyrtimin e tyre dhe të njëjta t'i klasifikoj për ruajtje në sirtarë.
- Përmes zyrtarit të logjistikës kanë kaluar të gjitha faturat që kanë të bëjnë me shërbimet komunale dhe furnizimin e zyrtarëve me mjetet e punës, inventarë dhe material shpenzues.
- Në kuadër të këtij sektori hyë edhe zyrtari për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik në objektin e Komunës dhe përkujdesjen për mirëmbajtjen e zërimit për sallën e Kuvendit.
- Në kuadër të Sektorit të Shërbimeve të përbashkëta hyn edhe sigurimi i objektit, mirëmbajtja e higjienës për të cilën jemi në kontakt të përhershëm me menaxherët e këtyre operatorëve tender fitues.

Kur është fjala tek menaxhimi i automjeteve zyrtare që kanë qenë jashtë përdorimit dhe inventarit të pa përdorur dhe inventarin e demoluar ua jap një pasqyrë konkrete si më poshtë:

I kemi dislokuar veturat të cilat presin ankandin publik, së bashku me inventarin e teknologjisë informative dhe pjesëve të ndërruara mekanike të veturave zyrtare, **/aty janë dhe pjesët e ndërruara të automjeteve/.**

Raportit ia bashkëngjesim edhe tabelorët përcjellës për periudhën vjetore të 2019

- 1.Shpenzimet e administratës me derivate, si dhe derivate për gjenerator, 38,412.68 €
- 2.Mirëmbajtja dhe regjistrimi i veturave, 1741.65 €
- 3.Shpenzimet e rrymës elektrike, 269,747.35 €
- 4.Shpenzimet e ujit, 5092.03 €
- 5.Shpenzimet për mbeturina, 23394 €
- 6.Shpenzimet e telefonisë fikse, 2089.8 €
- 7.Shpenzimet e telefonisë mobile, 24,192.19 €
- 8.Shpenzimet e lëndëve djegëse, 17823.4 €
- 9.Pastrimi i automjeteve, brenda-jashtë, 5520.79 €
- 10.Pastrimi dhe mirëmbajtja e objektit komunal, 77.235 €
- 11.Sigurimi i objektit komunal, 73,633.06 €

**SHPENZIMET E DERIVATEVE PËR AUTOMJETET DHE GJENERATORIN E
KOMUNËS SË FERIZAJT PËR PERIUDHEN 01 Janar – 31 Dhjetor 2019**

Nr	Targat e Automjetit	Drejtoria	Tipi	KM e fillim muajit Janar	KM e fundit të muajit	KM e kaluara	Shpanzim e Naftë	Mes. Në 100 km.	Mesatarja e parapë
1	05z-43-25	DPKGJ	Kia	56273	58516	2243	218.09	9.7	5,00%
2	05z-34-25	N/kryetarit	Renault	4744	12376	7632	525	6.8	5,00%
3	05z-24-25	Kryesuesja	Kia	81483	88723	7240	524.35	7.2	4.80%
4	05z-19-25	DAP	Kia	161357	173858	12501	1115.04	8.9	5,20%
6	05z-04-25	DI	Kia	107014	111704	4690	574	12.2	5.20%
7	05z-14-25	DU	Hundai	82404	91327	8923	580.01	6.5	4.65%
8	05z-06-25	DSHPE	Kia	85434	93641	8207	592.23	7.2	4.90%
9	05z-15-25	DAP	Honday	125783	143693	17910	1277	7.1	5,10%
10	05z-07-25	DRKS	Kia	99052	103595	4543	283	6.2	4.98%

11	05-12-25	DA	Honday	134549	14349 1	8942	498.01	5.5	5.20%
12	05z-10-25	DZHE	Kia	119931	12866 8	8737	489	5.5	4.98%
14	05z-13-25	DEFB	Honday	134457	14027 2	5815	396	6.8	5.25%
15	05z-20-25	DRKS	Mercedes- Bus	139102	15872 9	19627	2475.4 8	12.6	15.0%
16	05z-32-25	DAP	Mercedes- Ko	249731	26948 4	19753	1663	8.4	9.50%
17	05z-33-25	DBZHR	Xhipp- Toyta	187445	20279 8	15353	2041	13.2	9.80%
18	05z-27-25	Kabineti	Kia,1.6	34250	38918	4668	454	9.7	4,25%
19	05-28-25	DU	Kia,1.6	37490	46904	9414	617.18	6.5	4,31%
20	05z-31-25	Kabineti	Kia,1.6	33312	45137	11825	824.01	6.9	4,22%
21	01-479-NA	Kryetari	Pezho 505	2753	14499	11746	912	7.7	

RAPORTI VJETOR I RIPARIMEVE

	Emri i Automjetit.	Nr. Regjistri mit	Drejtoria të cilës i përkasin	Pajisja me goma dimri	Riparimi teknik
1	Kia	05z-27-25	DSHPE		
2	Kia	05z-28-25	Kabineti		Servisim
3	Kia	05z-04-25	DI	4 copa	Servisim, Rrypat e Motorrit
4	Kia	05z-06-25	DSHPE	4 copa	Bateria
5	Kia	05z-07-25	DRKS		Ndërruesi i Shpejtësisë
6	Hunday	05z-10-25	DZHE	4 copa	Sistemi i Frenimit
7	Hondai	05z-12-25	DA	4 copa	Servisim
8	Hundai 130	05z-13-25	DF	4 copa	Bateria, Ndërruesi i Shpejtësisë
9	Hondai	05z-14-25	DU		Servisim
10	Hondai	05z-15-25	DAP	4 copa	Ndërruesi i Shpejtësisë
11	Tojota-Xhipp	05z-33-25	DBZHR		Servisim
12	Kia	05z-31-25	Kabineti		Servisim
13	Busi-Merc.	05z-20-25	DRKS		Servisim
14	Kombi-Mercedes	05z-32-25	DAP		Servisim /
15	KIA	05z-24-25	Kryesuesja	4 copa	Rregullimi i Boshtit të Përparëm
16	Kia	05z-19-25	DAP	4 copa	Sistemi i Frenimit
17	Kia	05z-43-25	DPKGJ	2 copa	Xhami i Derës

Në tabelën e mëposhtme po japim të dhënat për pranimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, drejtuar organeve të Komunës, sipas njësive organizative.

Nr.	Përshkrimi	Nr. kërkesave	Përqindja
1	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	99,347	65.00
2	Drejtoria e Financave	26,302	17.00
3	Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë	16,075	10.00
4	Zyra e Kryetarit	2,296	1.00
5	Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	1,908	1.00
6	Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit	1,455	0.00
7	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	1,449	0.00
8	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	1,372	0.00
9	Drejtoria e Arsimit	1,353	0.00
10	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	523	0.00
11	Drejtoria e Infrastrukturës	235	0.00
12	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizëm	215	0.00
13	Kuvendi Komunal	38	0.00
		152,568	

Në tabelën e mëposhtme po japim të dhënat për raportin vjetor 2019 sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes nga data 01.01.2019 deri 31.12.2019.

Raporti sipas departamenteve dhe statusit te zgjidhjes

01/01/2019 - 31/12/2019

01/01/2019 - 31/12/2019

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Perfunduar	Totali
D A P	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	272	2,967	7,990	334	11	0	0	28	87,745	99,347
D A	Drejtoria e Arsimit	2	197	278	868	0	1	0	7	0	1,353
D B P	Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	0	4	1,178	716	0	0	0	10	0	1,908
D F	Drejtoria e Financave	0	73	26,054	99	0	0	0	76	0	26,302
D K R S	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	0	259	191	69	0	0	0	4	0	523
DI	Drejtoria e Infrastrukturës	1	0	78	32	0	121	0	3	0	235
D S H M S	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	1	23	1,254	163	2	0	0	6	0	1,449
D S H PE	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	1	29	1,117	220	0	2	0	3	0	1,372
D P	Drejtoria e Pronës,	18	1,030	14,904	19	0	0	0	104	0	16,075

K GJ	Kadastrit dhe Gjeodezisë										
D U M	Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit	4	1,178	256	7	1	3	0	6	0	1,455
D Z H E T	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizëm	0	113	11	89	0	0	0	2	0	215
K K	Kuvendi Komunal	0	38	0	0	0	0	0	0	0	38
Z K	Zyra e Kryetarit	1	1,917	285	73	0	11	0	9	0	2,296
		300	7,828	53,596	2,689	14	138	0	258	87,745	152,568

Në tabelën e mëposhtme po japim të dhënat për pranimin e kërkesave të qytetarëve, drejtuar Departamentit të Administratës Komunale.

Nr.	Përshkrimi	Nr. Kërkesave
1.	Vërtetimi i dokumenteve nga origjinali	3166
2.	Përcjellja e shkresave përmes postës	572
3.	Pranimi i shkresave në mënyrë rekomanduese	741
4.	Pranimi nga Gjykata ,Aktvendime,Aktgjykime etj.	1834
5.	Vulosja e dokumenteve përmes Arkivit	500
Total:		6813

NJËSIA E PËRKTHYESVE

Dokumentet e përkthyer nga Zyra e përkthimeve gjatë periudhës një vjeçare **01 janar – 31 dhjetor 2019** janë si në vijim:

Gjatë kësaj periudhe, kjo zyrë përpiluar shumicën e procesverbaleve nga takimet e KK, KPF dhe Komiteteve të ndryshme si dhe ka përkthyer dhe njëherit ka lekturuar dokumentet si në vijim:

Procesverbale të Kuvendit, të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete të cilët janë Komitete të rregullta, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, ku në total kanë qenë gjithsej **38** procesverbale ose **258** faqe të përkthyer dhe të lekturuara. (dok. e bashkangjitura në raport mbi evidencën e përkthimeve).

Rregullore Komunale - 5 ose **101** faqe të përkthyer.

Lajme për UEB faqe – 296 lajme – 310 faqe të përkthyer.

Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian i Komunës së Ferizajt 2018-2021-45 faqe.

Plani Aksional për Përmbushjen e Transparencës në Komunën e Ferizajt – 15 fq.

Strategjia Komunale për Personat me Aftësi të Kufizuara – 25 fq.

Buxheti 2020-2022 – 25 fq.

Konkurse gjatë kësaj periudhe kemi përkthyer **16** konkurse apo **34** faqe të përkthyer.

Vendime të Kuvendit Komunal, kanë qenë gjithsej **84** vendime ose **98** faqe.

Vendime, Aktvendime, Ankesa, Kërkesa të ndryshme të drejtorive, të Zyrës Ligjore. të Zyrës së Gjendjes Civile etj. Kanë qenë gjithsej **65** apo **278** faqe të përkthyer.

Tendere, Njoftime për Kualifikim dhe Njoftime për Anulim të Zyrës së Prokurimit – kanë qenë 3 dok. ose 32 faqe.

Totali i gjithë këtyre përkthimeve është 1221 faqe të përkthyer dhe të lekturuara nga Zyra e përkthyesve dhe gjithashtu edhe përpilimi i disa procesverbaleve sipas kërkesës dhe përkthimi direkt në takime të ndryshme sipas kërkesës.

SEKTORI I SHËRBIMEVE JURIDIKE, LIGJORE DHE ADMINISTRATIVE

Gjatë vitit 2019, në Sektorin e Shërbimeve Juridike, konkretisht **Zyra për Ndihmë Juridike** ka kryer këto punë si në vijim:

Nr. Rendor	Llojet e Vërtetimit	Totali
1	Vërtetim për Mbështetje Ekonomike	551
2	Vërtetim për Leje Qëndrimi	558
3	Vërtetim për personin me identitet të njëjtë	221
4	Vërtetim për shtesa të fëmijëve	30
5	Kërkesa për transport	30
	Totali	1390

SEKTORI I GJENDJES CIVILE

Statistikat e regjistrimit ne sistemin e gjendjes civile të bërë për periudhë prej 01.01.2019 deri 31.12.2019 të lëshuara dhe regjistrimet e bëra nga Sektori i Gjendjes Civile (SGJC).

Shërbimet e ndryshme të ofruara ndaj qytetarëve nga Sektori i Gjendjes Civile për periudhën një vjeçare për vitin 2019 gjithsej janë 135,167.

Ndërsa nga raporti i E-Kioska që qytetarët vet kanë bërë vetëshërbim në aparate për këtë periudhë janë gjithsej 1845 shërbime të afuara nga E-Kioska nga Sektori i Gjendjes Civile ndaj qytetarëve.

Statistikat e regjistrimit në sistemin e gjendjes civile të bërë për periudhë prej 01.01.2019 deri 31.12.2019 janë:

Lindje të regjistruara gjithsej	2221
1.Të rregullta	1556
-Brenda vendit	1468
-Jashtë vendit	88
Me vonesë.....	665
-Brenda vendit	238
-Jashtë vendit	427
Verifikime -----	3462
1.Me numër personal personal paraprak-----	3452
1.Me gjenerim të numrit personal -----	10
Rishkrimi lindje -----	418
Regjistrim i qytetarëve -----	88
1. Me vendim të komisionit për shtetësi -----	7
1. Me nenin 31-----	75
1. Me dekret të Presidentit -----	6
1. Me vendim 296/2018 -----	0
1. Me nenin 32-----	10

Martesa	1345
1. E rregullt	1138
2. Jashtë vendit	207
Rishkrim martese	1519
1. Brenda vendit	1475
2. Jashtë vendit.....	44
Shkurorëzime.....	245
Anulime teknike.....	2
Në mes të dy qytetarëve të huaj.....	0
Me element të huaj të regjistruara.....	197
1. Bashkëshorti shtetas i huaj	68
1. Bashkëshortja shtetase e huaj	129
 Vdekje.....	 679
1. E rregullt	444
-Brenda vendi	396
-Jashtë vendi.....	48
2. Me vonesë	235
-Brenda vendi	167
-Jashtë vendi	68
Rishkrim vdekje	0
Regjistrim i qytetarit të vdekur.....	373
Me vendim 296/2018.....	0

DOKUMENTET E LËSHUARA NGA SISTEMI I GJENDJES CIVILE

Lloji i dokumenteve:

-Ekstrakt lindje -----	61209
-Certifikatë lindje -----	28666
-Certifikatë martese -----	13322
-Certifikatë vdekje-----	3496
-Certifikatë vendbanimi -----	4728
-Certifikatë bashkësie familjare -----	16153
-Certifikatë gjendje martesore -----	2886
-Certifikatë shtetësie -----	1694
-Vërtetim nga arkivi -----	3013

Totali----- 135167



REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E FINANCAVE

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2019

Sebahate Ajeti Sadiku
Drejtoreshë e Drejtorisë së Financave

Ferizaj, 2020

Drejtoria e Financave mbështetur në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin e Financave Lokale, si dhe në të dhënat e gjeneruara nga Sistemi i Menaxhimit të Financave të Kosovës, hartoi Raportin Vjetor të Punës për vitin fiskal 2019 përfshirë të dy sektorët e këtij programi buxhetor, duke paraqitur të arriturat, sfidat si dhe objektivat afatshkurtëra dhe atë në fushën e:

1. Të hyrave vetanake dhe
2. Shpenzimeve buxhetore

Programi ynë buxhetor në momentin e hartimit të projekt buxhetit për vitin fiskal 2019 përcaktoi në të njejtën kohë edhe objektivat buxhetore si në fushën e të hyrave dhe në atë shpenzimeve buxhetore gjithnjë duke respektuar në këtë rast qarkoret buxhetore të cilat ishin edhe baza e hartimit të planit të të hyrave vetanake si dhe planifikimit buxhetor të shpenzimeve.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit është kompetente për ofrimin e shërbimeve të përgjithshme për bizneset, për qytetarët dhe për partnerët ndërkombëtar. Ajo përkujdeset për ofrimin e shërbimeve dhe mundësive për zhvillim ekonomik dhe turizmit dhe atë përmes:

- Dhënies së pronave të Komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër,
- Krijimit të Zonave Ekonomike
- Krijimit të Zonave Industriale
- Krijimit të Inkubatorëve të Biznesit
- Bashkëpjesëmarrjes në financim me partnerë ndërkombëtar dhe vendor.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të gjithë punën e saj e kryen duke u bazuar në legjislacionin e vendit tonë, Statutin e Komunës, udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit të Komunës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet.

Përmbledhje e aktiviteteve:

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit ka vazhduar me aktivitete të cila kanë ndikim në ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik lokal ku gjatë këtij viti fokus të veçantë ju ka dhënë; funksionalizimit të Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, mbështetjes së bizneseve me grante si dhe bashkëpunimit me donatorë dhe ministritë e linjës, që kanë ndikuar drejtpërdrejt në përkrahjen e bizneseve të vogla e të mesme si dhe mbështetjen e të rinjve ferizajas me trajnime në aftësimin profesional dhe praktik në punë.

Më poshtë është prezantuar në mënyrë kronologjike një përmbledhje e aktiviteteve të realizuara me sukses me sa vijon:

Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë;

Komuna e Ferizajt tanimë ka ndërtuar një Qendër të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, e cila është një arritje e madhe për qytetarët e Ferizajt, e në veçanti për rininë. Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Ferizaj, po inkurajon inovacionin, ndërmarrësinë, zhvillimin e suksesshem të biznesit, hulumtimin dhe zhvillimin, përkrahjen e ideve inovative si dhe realizimin e ekonomisë lokale. Qendra është duke u fokusuar në

inkubim, trajnime, hulumtime dhe zhvillim, monitorim dhe konsulencë, hapësirë të përbashkët të punës, akselator biznesi, takime dhe konferenca, B2B dhe projekte donatorësh.

Mbështetja e bizneseve me grante “Fondi i Punësimit”

Ofrimi i mbështetjes së bizneseve të vogla dhe të meseme, vazhdon të mbetet prioriteti i yni me rëndësi, andaj gjatë këtij viti janë vizituar shumë biznese të Komunës së Ferizajt, për të parë nga afër mbarëvajtjen e procesit të punës, nevojat dhe kërkesat e tyre, drejt realizimit në të bërit biznes dhe mundësinë e të ofruarit ndihmë për zhvillimin e këtyre bizneseve me të gjitha kapacitetet që ne i posedojmë si DZHET, gjatë muajt Maj kemi bërë thirrje për mbështetje me pajisje dhe mjete pune për bizneset prodhuese dhe përpunuese të drurit, metalit, qumështit, letrës etj, ku në bazë të kësaj thirrje kanë përfituar gjithsej 38 biznese që veprimtarinë e tyre që e ushtrojnë në Komunën e Ferizajt. Kjo skemë mbështetjeje synon që të rrit kapacitetet prodhuese tek ndërmarrësit e vegjël ferizajas dhe të rrit shansin për krijimin e vendeve të reja të punës.

Mbështetja e bizneseve artizanale

Në kuadër të mbështetjes së vazhdueshme që po bën qeverisja lokale në Ferizaj ka bërë shpërndarjen e disa mjeteve të punës dhe pajisje për bizneset të cilat merren me veprimtari apo prodhime artizanale. Në kohën kur këto biznese përballen me sfida të tregut dhe janë në shuarje këto mjete janë një ndihmesë e mirë për ekzistencën e tyre për 15 biznese që janë përfitues të kësaj skeme. Në kuadër të këtij projekti janë mbështetur rrobaqepëse për veshje kombëtare, mjete pune për dru gdhendje, mjete pune për farkëtarë, mjete pune për gatime tradicionale e fusha të tjera të kësaj natyre.

Investimet në Parkun e Lirisë

“Parkut të Lirisë” iu shtua edhe këndi i lojërave për fëmijë. Prindërit e gjyshërit që ndajnë kohën për t’u ç’lodhur në fashon më të bukur të gjelbër të Ferizajt, tani kanë mundësinë që të vegjëllve t’i ofrojnë edhe rekreacionin në këndin e sapo ndërtuar të lojërave. Kjo falë një investimi të realizuar nga Komuna e Ferizajt, me qëllim rirregullimin e kësaj zone duke maksimizuar potencialin e mundësitë që ofron ky park.

Më shumë sesa mbështetje, tregon se qeverisja jonë është e përkushtuar që të krijoj ambiente të tilla. Sigurisht se këto hapësira, këto kënde të lojërave begatojnë edhe më shumë këtë hapësirë.

Tualetet publike

Pas investimeve të kryera më parë për të rregulluar këndin e lojërave, ndriçimin dhe infrastrukturën përcjellës po kompletohet edhe me nyjet e domosdoshme higjienike. Bëhet fjalë për projektin e ndërtimit të toaleteve publike në hapësirën e këtij parku, projekti vazhdon edhe në vitin 2020. Me këtë investim, përfundohet cikli i investimeve bazike infrastrukturore, duke shtuar se edhe rruga që çon në këtë aset natyror me vlerë të jashtëzakonshme për ferizajasit, tani më është përfunduar dhe ka kyçje nga rruga kryesore tek parku, çka përfundimisht, krijohet një hapësirë e përshtatshme, lehtë e qasshme dhe rekreative për frekuentuesit e kësaj zone.

Trajnimi i të rinjve

Opportunity Scouting Light – vazhdimësi e projektit të suksesshme nga viti i kaluar. GIZ YES ka vazhduar të mbështesë këtë aktivitet edhe 2019, kryesisht i orientuar për shkollat e mesme profesionale (Shkollën e mesme profesionale teknike, Shkollën e mesme profesionale ekonomike, Qendra e Kompetencës dhe me Shkollën e Mesme Bujqësore), ku përmes këtij aktiviteti të rinjtë për dy javë kanë pasur mundësi të aftësohen dhe krijojnë përvoja të mira profesionale dhe personale duke punuar në kompanitë vizuale në kuadër të “Opportunity Scouting”.

Panairi i Punës

Një aktivitet tjetër i implementuar me sukses është edicioni i dytë i Panirit të Punës i organizuar në bashkëpunim të ngushtë me Organizatën Qeveritare Gjermane GIZ, MPMS ku kanë marrë pjesë 47 biznese të cilat kanë ofruar rreth 400 vende pune dhe praktikë në sektorin e shërbimeve dhe prodhimit, si qendra të thirrjeve, si dhe në sektorët e shitjes me pakicë, sektorin e drurit, teknologjisë dhe media etj. Të cilët shqyrtuan ofertat e punësimit dhe patën rastin të takoheshin dhe të intervistoheshin nga punëdhënësit e mundshëm gjatë panairit.

Grantet nga Ministria e Zhvillimit Rajonal

Gjatë këtij viti është mbajtur një sesion informues për biznese lidhur me programin e zhvillimit rajonal nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, ku nga Komuna e Ferizajt kanë përfituar mbi 20 biznese nga të cilat janë përkrahur nga DZHET në përgatitjen e aplikacioneve për thirrjen për grante “Zhvillimi Rajonal i Balansuar

2019”. Ku si qëllim kryesor ka qenë përkrahja dhe zhvillimi i sektorit privat, me qëllim të krijimit të vendeve të reje të punës.

Konferenca “Ditët e Biznesit të Vogël 2019”

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), në bashkëpunim me Komunën e Ferizajt në kuadër të aktiviteteve “Ditët e Biznesit të Vogël 2019” ka organizuar “Konferencë Informuese për Zhvillimin e Sektorit Privat” ku janë paraqitur dhe diskutuar sfidat e sektorit privat si dhe shërbimet dhe programet zhvillimore që ofrohen nga Qeveria në nivel kombëtar dhe lokal. Ky aktivitet në kuadër të “Ditët e Biznesit të Vogël 2019” ka për qëllim të zhvillojë dialogun publiko - privat i cili, së bashku me fuqizimin e ndërmarrësisë, është më se i domosdoshëm për një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit privat, respektivisht zhvillimit ekonomik.

Udhëzuesi për Biznese

Qëllimi i këtij udhëzuesi është që ta ndihmojë komunitetin e biznesit, investitorët dhe palë të tjera të interesuara për aktivitete të bërit biznes në Komunën e Ferizajt. Bizneset kanë mundësi të gjejnë veten në këtë udhëzues, ngase ofron tërë potencialin ekonomik që e ka Komuna e Ferizajt duke shpjeguar se udhëzuesi detajisht i njofton afaristët për të gjitha procedurat që lidhen me bizneset e tyre. Në udhëzues qartazi përshkruhet mënyra e regjistrimit të biznesit, koha sa zgjatë regjistrimi, tatimet, si mund të lirohen nga tatimi, si mund të lirohen nga investimet e bëra, rimbursimi etj.

Udhëzuesin Turistik për Komunën e Ferizajt

Ky udhëzues do të jetë në shërbim të vizitorëve, sidomos të huaj që do ta vizitojnë qytetin tonë dhe me të cilin do të njoftohen për vendet të cilat ja vlejnë të vizitohen dhe do të kenë informata për qytetin. Janë paraqitur pjesët kryesore turistike të qytetit të cilat paraqesin mundësi të mire dhe në të njëjtën kohë i mundësojnë turistëve njohjen me vendet turistike të qytetit tonë. Aty janë paraqitur monumentet e fenomenet natyrore si Bifurkacioni, Kisha dhe xhamia, Jezerci dhe në përgjithësi qyteti i Ferizajt.

Qendra për Regjistrimin e Bizneseve

Gjatë viti 2019 Qendra Komunale e Regjistrimit të Bizneseve është bërë me platformen e re elektronike me numër unik identifikues të bizneseve ku ka pasur rritje të kërkesave dhe kjo do të vazhdojë edhe vitin 2020 me këtë platformë pronarët që kanë poseduar me shumë se një biznes individual atyre ju është

mundësuar që bizneset tjera t'i shndërrojnë në njësi. Gjatë periudhës Januar – Dhjetor ne QKRB kanë arritur gjithsej 4246 kërkesa dhe këto janë:

1. Regjistrime të reja 712
2. Ndryshime në biznes 739
3. Ç'regjistrime biznesi 100
4. Informata biznesi 181
5. Vërtëtime 7
6. Ndërrime të Çertifikatave 2719

Në qendrën e regjistrimit të biznesit gjatë periudhës 01.01.2019 deri me 31.12.2019 janë regjistruar gjithsej 712 biznese të reja dhe gjatë kësaj periudhe janë gjithsej 1034 punëtorë të rinj.

Qendra për Regjistrimin e Bizneseve (QRB) në Ferizaj gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019 ka kryer aktivitetet e saja (tabela 1) sa i përket kërkesave të qytetarëve për regjistrim të bizneseve dhe komunitetit të biznesit për ndërrim dhe shtim të aktiviteteve biznesore apo edhe shuarje të biznesit. Sa i përket ç'regjistrimit të bizneseve, gjatë kësaj periudhe janë ç'regjistruar gjithsej 100 biznese. Më poshtë gjeni (tabelën 2). ku është prezantuar raporti i vitit paraprak, i cili mund të shërbejë për të bërë krahasimin e situatës sa i përket numrit të bizneseve të regjistruara e të ç'regjistruara, përfshirë veprimtaritë si dhe numrin e punëtorëve.

	Bizneset e Regjistruar		
Emërtimet	Viti 2018	Viti 2019	Dif %
Prodhuese	135	274	102.9%
Tregtare	250	230	8%
Shërbyese	337	107	-68.2%
Ndërtimore	97	101	4.12%
Gjithsej	819	712	-13%
Struktura Gjimore	Viti 2018	Viti 2019	Dif %
Meshkuj	623	957	53.6%
Femra	198	77	-61.1%
Gjithsej	821	1034	25.8%
Sipas llojit të biznesit	Viti 2018	Viti 2019	Dif %
SH.P.K.	423	460	8.74%
B.I.	388	251	-35.3%
SH.A.	6	1	-83.3%
Gjithsej	819	712	-13.0%

	Bizneset e ç'regjistruara		
Emërtimet	Viti 2018	Viti 2019	Dif %
Prodhuese	3	10	233%
Tregtare	99	76	-23.2%
Shërbyese	21	12	-42.8%
Ndërtimore	2	2	0
Gjithesej	125	100	-20%
Struktura Gjimore	Viti 2018	Viti 2019	Dif %
Meshkuj	88	131	48.8%
Femra	37	47	27%
Gjithesej	125	178	42.4%
Sipas llojit të biznesit	Viti 2018	Viti 2019	Dif %
SH.P.K.	14	9	-35.7%
B.I.	109	88	-19.2%
SH.A.	2	3	50%
Gjithesej	125	100	-20%



REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E ARSIMIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2019

Afrim Llabjani
Drejtore i Drejtorisë së Arsimit

Ferizaj, 2020

Drejtoria e Arsimit, përkundër sfidave të mëdha, në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që ka, ka realizuar punë dhe detyra të shumta në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim dhe krijimit të kushteve më të mira në nivelin e arsimit parauniversitar, ku për vitin shkollor 2018/19, ka bërë një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm mbi ecurinë dhe performancën e procesit edukativo-arsimor, duke e analizuar suksesin e nxënësve për rezultatet dhe sukseset e arritura në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, duke krahasuar rezultatet e suksesit me rezultatet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Në funksion të zhvillimit dhe mbështetjes profesionale të institucioneve arsimore Drejtoria e Arsimit ka përcjellur nga afër ecurinë e procesit arsimor, duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale nga zyrtarët e arsimit, duke funksionalizuar dhe fuqizuar aktivet profesionale (seksionet), duke bashkëpunuar me institucionet dhe organizata të ndryshme për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe sigurimin e efikasitetit të procesit të mësimitdhënies dhe mësimitnxënies dhe njëkohësisht në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, ka realizuar aktivitete dhe gara të shumta në lëmi të ndryshme. Në këto gara të organizuara nxënësit tanë treguan shkathtësi dhe kompetencë të lartë në nivel vendi dhe në nivel ndërkombëtar. Po ashtu, janë vlerësuar dhe analizuar rezultatet e testeve të jashtme: Testit të Arritshmërisë dhe Provimit Shtetëror të Maturës.

Duke ditur se vlerësimi është një proces dhe indikator determinues për nxjerrjen e treguesve kryesor, për ngritjen e cilësisë në arsim dhe për krijimin e një sistemi arsimor bashkëkohor në përputhje me kërkesat e shoqërisë së sotme-shoqërisë së dijes, kjo analizë bëhet jo vetëm për të konstatuar gjendjen, por edhe për të përcaktuar objektivat për të ardhmen, që do të reflektojnë pozitivisht në përmirësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve dhe ngritjen e cilësisë së mësimitdhënies në procesin edukativo-arsimor.

Drejtoria e Arsimit po punon në mënyrë të vazhdueshme, për krijimin e kushteve më të mira me qëllim që cilësia dhe rezultatet e suksesit në shkollat tona të shënojnë progres dhe të arrijnë në nivelin dhe standardin e shkollave të përparuara, si: në mësimitdhënie, në mësimitnxënie dhe të një vlerësimi sa më objektiv të arritshmërisë së nxënësve.

Raporti i organizimit të punës së Drejtorisë së Arsimit

Organizmi i punëve në Drejtoria e Arsimit bëhet përmes sektorëve të saj:

- 1. Sektorit të Administratës**
- 2. Sektorit të Financave**
- 3. Sektorit të Arsimit**
- 4. Sektorit të Shërbimit Teknik**

Qëllimi i raportit vjetor është prezantimi i punës njëvjeçare të të gjitha institucioneve edukativo-arsimore, gjegjësisht paraqiten suksesi, rezultatet, të arriturat, por edhe sfidat e vështirësitë që kanë përcjellur shkollat dhe procesin edukativo-arsimor në edukimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe mesëm të lartë në Komunën e Ferizajt, për vitin shkollor 2018-2019.

Drejtoria e Arsimit me kohë i ka planifikuar punët që duhet të kryhen dhe u ka kushtuar kujdes të veçantë, sidomos prioriteteve duke bërë përpjekje për shfrytëzim sa më racional të të gjitha resurseve të brendshme dhe të jashtme në shkollat tona.

Ky raport vjetor, mbështetet në shënimet statistikore që i sjellin shkollat si dhe raportet tekstuale të tyre në të cilat pasqyrohet puna në shkollat e Ferizajt për vitin shkollor 2018/2019, i kemi shfrytëzuar edhe të gjitha informacionet tjera të cilat i kemi siguruar nga burimet që hyjnë në funksion të plotësimit të këtij raporti. Në raport janë përfshirë: rrjeti shkollor, lokali mësimor, nxënësit dhe paralelet, organizimi i mësimi, suksesi i nxënësve, mungesat e nxënësve, orët e mbajtura, aktivitetet jashtëkurrikulare etj. janë përfshirë të gjitha segmentet e punës dhe jetës në institucionet edukativo-arsimore të komunës së Ferizajt.

Materialet bazë për hartimin e raportit:

- Plani vjetor i punës së DA-it për vitin 2019;
- Raporti vjetor i punës së Sektorëve të Arsimit pranë DA-it për vitin 2019;
- Programet vjetore dhe periodike të punës së njësive pranë DA-it:
- Njësia Administratës;
- Njësia e Financave;
- Njësia e Shërbimeve Teknike;
- Informata e Sektorit të Arsimit për përgatitjet teknike, higjenike dhe kadrovike të institucioneve edukativo - arsimore të Komunës së Ferizajt për fillimin e vitit të ri shkollor 2018-2019;
- Planet individuale të punës të zyrtarëve komunal të arsimit për vitin 2019;
- Kalendari për vitin shkollor 2018-2019, me Udhëzim Administrativ nr.18/2019;

- Raportet tekstuale dhe tabelare të shkollave fillore dhe të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë;
- Raportet e organizimit të seminareve me mësimdhënës për zbatimin e KK-së dhe KB për nivelet e arsimit (0,1,2,3);
- Informatat rreth organizimit të Testit të Arritshmërisë për klasët e 9-ta;
- Informatat rreth organizimit të Provimit të Maturës;
- Bashkëpunimi i zyrtarëve komunal të arsimit DA-së me SIA-në, dhe organe tjera relevante.

Drejtoria e Arsimit dhe stafi i saj në bashkëpunim me MASHT-in, drejtoritë e shkollave dhe organet tjera relevante janë angazhuar në krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për punë në shkollat e komunës sonë. Planifikimi me kohë ka mundësuar një fillim të mbarë të procesit edukativo-arsimor.

Drejtoria e Arsimit në përfundim të vitit mësimor, në të gjitha shkollat e komunës sonë, fillon punët në lidhje me përgatitjet e përgjithshme e të nevojshme për vitin e ri shkollor.

Drejtorët e shkollave me kohë kanë marrë udhëzimet e nevojshme për fillimin e punëve në lidhje me përgatitjet të cilat duhet të bëhen sipas dinamikës së paraparë nga Drejtoria e Arsimit

Përgatitjet janë kryer sipas punëve me prioritet :

- Në përfundim të vitit mësimor, ka filluar me përgatitjet e objekteve shkollore si renovime, lysterje, gëlqerosje etj.
- Për të siguruar kuadrin e nevojshëm, Njësia Administrative pranë Drejtorisë sonë, me kohë ka bërë përgatitjen dhe shpalljet e konkurseve;
- Me kohë është bërë edhe planifikimi për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore të cilat gratis i ka siguruar MASHT-i, për nivelin fillor dhe të mesëm të ulët. Këto tekste nën përcjelljen e zyrtarëve arsimor për vitin shkollor 2018-2019 janë shpërndarë nëpër shkolla ashtu siç është paraparë;
- Nga Drejtoria e Arsimit është bërë planifikimi për furnizimin e shkollave me lëndë djegëse dhe material tjetër të nevojshëm shpenzues.
- Gjithashtu me kohë shkollat janë pajisur me dokumentacion pedagogjik si libra amë, ditar të punës, fletore të punës për mësimdhënës e gjëra të tjera të nevojshme;
- Drejtoria e Arsimit, përmes Aktivit të Drejtorëve të shkollave, kujdes të veçantë i ka kushtuar përfshirjes së të gjithë nxënësve në procesin edukativo-mësimor. Një kujdes të shtuar kemi pasur për nxënësit me nevoja të veçanta. Këtë kategori të nxënësve e kemi përfshirë në gjitha nivelet e arsimit, kurse një numër i tyre (për shkak të nevojave më specifike) janë të përfshirë edhe në dy shkolla fillore në „Gjon Serreçi” dhe në „Ahmet Hoxha”. Për këtë kategori të nxënësve të gjitha shpenzimet i bartë Drejtoria e Arsimit, siguron lokalim mësimor dhe transportin e nxënësve në relacionin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas si dhe ka të siguruar kuadrin profesional.

- Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, organizon mësim plotësues me të gjitha shtresat e nxënësve në tri shkolla të qytetit (“Vezir Jashari”, “Tefik Çanga” dhe “Ahmet Hoxha”).

- Drejtoria e Arsimit ka planifikuar buxhetin për ndarjen e bursave për studentët e komunës sonë. Për vitin shkollor 2018-2019 ka ndarë 50 bursa fillestare si dhe ju kanë vazhduar bursat studentëve vijues.

Me qëllim të mbarëvajtjes së procesit edukativo- arsimor dhe në përgjithësi të punëve nëpër shkolla, Drejtoria e Arsimit, i ka kushtuar kujdes të duhur edhe:

- Planifikimit dhe regjistrimit të nxënësve në klasat e parë I-rë në shkollat fillore;
- Planifikimit dhe regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të, në shkollat e arsimit të mesëm të lartë;
- Gjatë vitit shkollor 2019, kemi vazhduar me zbatimin e KK-së dhe KB-ve në të gjitha shkollat e Komunës së Ferizaj në të gjitha nivelet e arsimit përveç shkollave profesionale që ende nuk kanë filluar në zbatimin e KK-së;
- Drejtoria e Arsimit, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe disiplinës, ka realizuar vizitat të rregullta dhe informative nëpër shkolla;
- Sigurisë në shkolla i është kushtuar rëndësi e duhur, është forcuar bashkëpunimi me Policinë, me Këshillin e Prindërve dhe është shtuar kujdestaria e ditës nga nxënësit dhe mësimmdhënësit;
- Gjellbërimit në oborret shkollore i është kushtuar rëndësi e duhur, në këtë drejtim edhe janë shënuar rezultate. Për të krijuar një ambient më të përshtatshëm e atraktiv, nëpër shkollat tona janë formuar grupet e ekologëve të rinj, si edhe janë mbajtur trajnime me këto grupe.

Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe organizimit të aktiviteteve jashtëkurrikulare, si organizimi i kuizeve nga lëndë të ndryshme të diturisë, garave kulturore, sportive.

Objektet dhe hapësira shkollore

Procesi edukativo-arsimor gjatë vitit shkollor 2018-2019 është zhvilluar në 62 institucione edukativo-arsimore: 8 shkolla të mesme, 52 shkolla fillore dhe në 2 çerdhe të fëmijëve. Po ashtu, në kuadër të procesit mësimor janë të përfshirë edhe nxënësit me nevoja të veçanta, të cilët ndjekin mësimin në klasat e bashkangjitura, të cilët gjinden në dy shkolla të qytetit në ”Gjon Serreçi” dhe në shkollën “Ahmet Hoxha”. Sa i përket hapësirës së lokalit shkollor, 52 shkolla punojnë me dy ndërrime, kurse 8 shkolla kanë zhvilluar procesin mësimor në një ndërrim.

RAPORTI I PUNËS PËR SEKTORIN ADMINISTRATIV TË DA-së

Spektori Administrativ në Drejtorinë e Arsimit gjatë periudhës për vitin 2019 ka udhëhequr procedurat administrative dhe ligjore për pranimin e mësimdhënësve dhe punëtorëve tjerë në shkolla për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në kuadër të Komunes së Ferizajt.

Gjatë këtij viti shkollor kemi publikuar gjithsej 21 konkurse. Konkursët janë shpallur me kohë duke i respektuara afatet ligjore, janë shpallur edhe në faqen zyrtare të Komunes si dhe në tabelën e shpalljeve me sa vijon:

- 4 për drejtor dhe zëvendës drejtor të shkollave;
- 2 për sekretar;
- 3 për pastrues;
- 1 për psikolog;
- 10 për mësimdhënës;
- 1 për bursa për studentë.

Gjithsej 21 konkurse

Kemi udhëhequr procedurat e njoftimit të kandidatëve, intervistimit, për pranimin e kandidatëve për plotësimin vendeve të punës, si në zëvendësime, plotësime etj; janë zhvilluar procedurat e pushimeve të lehonisë, pushimeve mjekësore, pushimeve pa pagesë dhe të punëtorëve të pensionuar gjatë kësaj periudhe. Kemi shqyrtuar kërkesa, ankesa, kemi dhënë përgjigje me shkrim sipas shkresave të palëve.

Kemi bërë kompletimin e lëndëve për zyrën ligjore sipas padive të palëve për kompensimin e pagave me rastin e pensionimit, për rastet e punësimit.

NJËSIA E FINANCAVE

Përgatitja për raportimin e borxheve për vitin e mëparshëm në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, investime kapitale dhe subvencione.

Përgatitja për raportimin e pasqyrave financiare për vitin e mëparshëm në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallëra dhe shërbime, komunal, investime kapitale dhe subvencione.

Përgatitja planit të keshit për vitin 2019 në kategoritë ekonomike paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, komunal, investime kapitale.

Shpërndarja e mjeteve në kategoritë e pagave për arsimin fillor të mesëm, sipas shkollave dhe raportimi i tyre për Ministrinë e Financave.

Shpërndarja e mjeteve përmes Free-Balancit për çdo shkollë veç e veç në arsimin fillor të mesëm dhe çerdhen e fëmijëve.

Kemi bërë shpërndarjen e pagave sipas shkollave, pastaj i kemi futur në Free Balance pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, komunalitë për tremujorëshin e parë të vitit 2019.

Kemi bërë përgatitjen e zotimeve për investime kapitale, përgatitjen e disponueshmërisë së mjeteve, kërkesa për zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Përgatitjen e raportit tremujor për kategorinë e pagave, mallrave dhe shërbimeve, komunalive.

Rregullimin e retroaktivit për mësimdhënësit që nuk kanë hyrë me kohë në listën e pagave.

Raporti i borxheve në të gjitha kategoritë ekonomike për Ministrinë e Financave sipas kërkesës së tyre.

Përgatitja e të dhënave për rishikim të buxhetit në të gjitha kategoritë ekonomike në muajin Qershor.

Përgatitja e të gjitha të dhënave për bursat për studentë dhe pagesat e tyre prej subvencioneve.

Futja e të dhënave në BDMS në të gjitha kategoritë ekonomike për çdo shkollë veç e veç;

Përgatitja e investimeve kapitale për ridestitim, sipas programeve të arsimit;

Përgatitja e listave të pagave për zyrën e thesarit;

Raportimin e mjeteve të sindikatës;

Trajnimet e drejtorëve dhe stafit administrativ, sipas nevojave;

Kemi kryer të gjitha punët që na lidhin me prokurimin, planin e prokurimit, kërkesat për prokurim;

Bashkëpunimi dhe harmonizimi i punëve me drejtorët e shkollave;

Raportin e faturave të papaguara për vitin kalendarik 2019;

Pasqyrat financiare 2019;

Borxhe në kategorinë e pagave nuk kemi.

NJËSIA E SHËRBIMEVE TEKNIKE

Drejtoria e Arsimit i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe infrastrukturës shkollore dhe duke parë që shkollat në Komunën e Ferizajt kanë nevojë për renovime dhe përkujdesje, gjatë vitit 2019, ka vazhduar me realizimin e projekteve siç janë në vijim:

Projektet e realizuara për vitin 2019 janë si në vijim :

1. Fillimi i ndërtimit të shkollës në fsh. Zaskok;
2. Vazhdimi i punimeve në Shkollën e Mesme
3. Vazhdimi i punimeve në shkollën Profesionale;
4. Renovime në shkollën e fsh.Koshare – Investim nga Ambasada e Turqisë;
8. Vazhdimi i punimeve në sallën e sportit në fshatin Balaj;
9. Vazhdimi i punimeve në Palestrën e Sporteve në fshatin Greme;
10. Faza e fundit të ndërtimit të sallës së sporteve në fshatin Gaçkë;
11. Faza finale e ndërtimit të shkollës në fsh.Komogllavë;
12. Ndërimi i kulmit të shkollës “Vezir Jashari” dhe vendosja e një pjese të re të rrethojës, me porta dhe dyer hyrëse;
13. Rregullimi i rrethojës në shkollën “Jeronim De Rada”;
14. Renovimi i shkollave përmes Projektit të Eficiencës;
 - 14.1. “Mejdi Xhaferi” Mirosalë
 - 14.2. “Abetarja” Softaj
15. Krijimi i hapësirës gjelbëruese në shkollën “Jeronim De Rada”

SEKTORI I ARSIMIT

Në kuadër të sektorit të arsimit aktivitetin e tyre e zhvillojnë:

Zyrtari për arsimin parafillor dhe fillor

Zyrtari për arsimin e mesëm të ulët, dhe

Zyrtari për arsimin e mesëm të lartë.

Zyrtarët arsimor, i kanë kushtuar kujdes të duhur këtyre punëve:

- Kanë përcjellur dhe mbikëqyrur përgatitjet e gjithmbarshme të shkollave në kuadër të procesit edukativo-arsimor, janë angazhuar që të bëhet përfshirja e nxënësve në shkollimin e rregullt, kemi kontribuar në ngritjen e bashkëpunimit të shkollës me prindër dhe komunitetin në përgjithësi;
- Takimet mujore të Task Focës, të mbajtura në QPS në Ferizaj;
- Takime me OJQ-në VORAE, ECMI, KEC, IPEDU etj;
- Pjesëmarrës në disa trajnime dhe debate, kryesisht lidhur me Fëmijët me Nevoja të Veçanta;
- 46 mësime të TIK-ut, (SHFMU dhe SHML), 8 koordinator të cilësisë (SHML) dhe 8 drejtor të SHML janë trajnuar në fushën e teknologjisë informative. Trajnimi është bërë nga BUSULLA.COM; të gjithë janë certifikuar në 4 module;
- 16 mësime të trajnuar në programin Menaxhimi dhe Udhëheqja;
- Trajnim 4 ditor me mësime të cilat që punojnë me fëmijët me nevoja të veçanta. Janë certifikuar 7 mësime të cilat, kurse 26 mësime të cilat tjerë po marrin trajnimet e duhura në vazhdimësi të projektit lidhur me punën që bëjnë me FNV. Seminari është financuar nga MPJ e Sllovenisë dhe i implementuar nga IPEDU,
- Është bashkëpunuar me Shoqatën e Biologëve, Matematikientëve, Fizikientëve dhe Kulturës sportive për organizimin e garave në lëmitë përkatëse;
- Kemi bërë grumbullimin e formularëve për suksesin e nxënësve për përfundimin e vitit shkollor 2018/2019 të nivelit 1, 2 dhe 3 të arsimit;
- Janë përgatitur tabelat e nevojshme në funksion të një pune analitike sa i përket suksesit të nxënësve për këtë periudhë, për nivelin 1, 2 dhe 3;
- Në muajin gusht kanë pranuar dhe shpërndarë tekstet shkollore në të gjitha shkollat e komunës sonë, si dhe kemi vazhduar edhe me pjesën tjetër të teksteve të ardhura më vonë nga shtëpitë tjera botuese, nga kontaktet që kemi pasur me shkolla mund të konkludojmë se të gjitha shkollat janë furnizuar me libra;
- Është bërë Vlerësimi i Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, përmes Ekipit Vlerësues;

- Zyrtarët arsimor në kuadër të punëve dhe detyrave të tyre të punës për çdo gjysmëvjetor janë marrë me grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore për suksesin e nxënësve, vijueshmërinë, disiplinën etj;
- Zyrtarët arsimor gjatë vitit 2018/2019 kanë bërë vizita në të gjitha shkollat, me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe disiplinës. Gjatë këtyre vizitave është përcjellur respektimi i orarit mësimor, realizimi i planprogrameve, notimi i nxënësve, kontrollimi i dokumentacionit administrativ, pedagogjik, stafit arsimor, teknik si dhe zhvillimi i aktiviteteve tjera kurrikulare dhe jashtëkurrikulare;
- Është bërë planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasat parafillor, klasat e para dhe në klasat e 10-ta;
- Janë dhënë udhëzime lidhur me organizmin e mbajtjes të testit kombëtar për klasat e IX-ta dhe të Testit të Maturës për klasat e XII-ta;
- Zyrtarët arsimor kanë bërë të gjitha përgatitjet për realizimin e testit, si dhe kanë marrë pjesë në mbarëvajtjen e Testit;
- Zyrtarët arsimor, kanë shqyrtuar konkursat e shpallura për pranimin e kuadrit arsimor, udhëheqës, teknik dhe punëtor administrativë, kanë bërë vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve;
- Zyrtarët e arsimit kanë punuar rreth projektit të USAID-it për shkollat e mesme, Gjimnazi “Kuvendi i Arbërit” është përfitues i projektit të programit të USAID-it “After School Support for Teens” (ASSET)-“Përkrahje adoleshentëve pas mësimin të rregullt”. Programi ka ndihmuar shkollën në themelimin e “Qendrës për Karrierë dhe Ndërmarrësi” programi do të ofroj pajisje, trajnimin dhe materialet për renovim, shkolla do të organizoj grupin e vullnetarëve nga ekipi i shkollës dhe nxënësit për të ndihmuar në renovimin e Qendrës për Karrierë dhe Ndërmarrësi;
- Koordinimi dhe përcjellja e të gjitha trajnimeve që realizohen në Qendrën për Ngritjen Profesionale (QNP) në shkollën “Tefik Çanga”, për të gjitha nivelet (0,1,2,3);
- Është hartuar plani i përcjelljes së trajnimeve për zbatim të KK dhe KB (Kurrikulës dhe Kurrikulës Bërthamë);
- Janë hartuar raporte mujore me shkrim lidhur me zbatimin e KKK-së dhe KB-ve në të gjitha shkollat e Komunës së Ferizajt, raportet janë dërguar në MASHT;
- Organizimi i trajnimit profesional për mësimdhënës në fushën e teknologjisë informative nga BUSULLA.COM;
- Shqyrtimi i rasteve për regjistrim në shkollat fillore të mesme të ulëta të cilët janë riatdhesuar;
- Takim në MASHT, Mekanizmat për Parandalim dhe Reagim kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit në nxënësve në arsimin parauniversitar;
- Përcjellja e programit SMIA dhe futja e të dhënave për numrin e nxënësve,

- Përgatitja e listës të mësimdhënsve për trajnim për udhëheqje arsimore;
- Përgatitja e listës dhe organizim e trajnimeve, për mësimdhënësit për trajnimin në fushat e KK,
- Pjesëmarrje në trajnime për zyrtarët Komunal të Arsimit dhe Financave mbi mënyrën e financimit të udhëzimit administrativ, planifikimin financiar (buxheti) si dhe të kërkojnë fonde shtesë nga institucionet qendrore, për formimin e Qendres Mësimore.

Po ashtu, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të stafit arsimor në shkolla përmes zhvillimit profesional, DA në bashkëpunim me MASHT-in dhe organizata të akredituara ka organizuar trajnime, seminare e punëtori në:

- Trajnimin e Stafit Udhëheqës të Shkollave për Menaxhimin e Institucioneve Shkollore;
- Trajnimin e Stafit Arsimor për Indeksën për Gjithëpërfshirje;
- Trajnimin e Stafit për Gjithëpërfshirje;
- Trajnimin e Stafit Arsimor për zbatimin e Kurikulës, nga muaji Prill kanë filluar trajnimet për KK dhe kanë përfunduar në muajin Korrik. Trajnimet janë realizuar në të gjitha fushat e kurrikulës.

Këto të dhëna janë të paraqitura në tabelën vijuese:

Nr	Fusha e Kurrikulës	Seminari Faza I	Seminari Faza II	Seminari Faza III	Seminari Faza IV	Gjithsej të trajnuar	Planifikimi për Gusht-Shtator 2019, seminari Faza V
1	Gjuhë dhe komunikim	25	-	-	-	25	
2	Matematika	14	-	-	-	14	
3	Shkencat e natyrës	17	-	-	-	17	
4	Shoqëria dhe mjedisi	39	-	-	-	39	
5	Artet	-	-	-	-	-	
6	Programi fillor dhe kl. parafillor	58	32	-	-	90	
7	Jeta dhe puna - TIK	-	-	-	-	-	
8	Ed. fizike dhe sportet	-	-	-	-	-	
Gjithsej		153	32	-	-	185	

Nr .	Fusha e Kurrikulës	Seminari Faza V	Planifikimi për tetor 2019 dhe data e mbajtjes së trajnimit
1	Gjuhë dhe komunikim	21	26 - 27 Tetor 2019, 2 - 3 dhe 9 - 10 Nëntor 2019
6	Programi fillor dhe parafillor	9	-
Gjithsej		30	

RAPORT MBI ARSIMIN GJITHËPËRFSHIRËS - 2019

Arsimi gjithëpërfshirës është një dimension i arsimit cilësor bazuar në të drejtat që thekson barazi në qasje dhe pjesëmarrje, dhe i përgjigjet pozitivisht nevojave individuale për nxënie dhe kompetencave të të gjithë fëmijëve.

Arsimi gjithëpërfshirës ka në qendër fëmijun dhe vendos përgjegjësinë e adoptimit të sistemit arsimor në bazë të nevojave të fëmijës. Së bashku me sektorë të tjerë dhe me komunitet më të gjerë, arsimi gjithëpërfshirës funksionon në mënyrë aktive për t'i siguruar çdo fëmije, pavarësisht gjinisë, gjuhës, aftësisë, fesë, kombësisë ose karakteristikave të tjera, mbështetje për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplotë, të mësosh së bashku me shokët dhe shoqet e tij/saj, si dhe të zhvillojë potencialin e tij/saj të plotë. Arsimi gjithëpërfshirës keqkuptohet si koncept që aplikohet vetëm tek fëmijët me nevoja të veçanta, dhe ky fakt pikërisht na vendos pengesa në arritjen e arsimit gjithëpërfshirës.

Në Kosovë, koncepti i edukimit gjithëpërfshirës, është kuptuar në formën më të kufizuar të tij, duke ngecur te sigurimi i qasjes në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe jo si sigurimi i kushteve për pjesëmarrje të plotë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin mësimor / mësimnxënës.

Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me shkollat ka bërë mbledhjen e të dhënave mbi numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore edhe për vitin shkollor 2018/2019 si dhe mbajtjen e databazës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në nivelin komunal.

Si pjesë e vlersimeve të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore është Ekipi Vlersues në nivelin komunal i përbërë nga ekspert të fushave të ndryshme mësues mbështetës, psikolog, punëtorë social, i cili gjatë vitit shkollor 2018/2019 (ka përfunduar 10 raste të vlerësuara).

Ekipi Vlersues përmes trajnimve të ndryshme që kanë ofruar organizata si Save The Children dhe Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar është duke vazhduar në ngritjen e kapaciteteve profesionale në mënyrë të vazhdueshme. Kemi mbajtur takime dhe shkëmbim përvojash me Komunën e Kamenicës duke i dhënë ide dhe mënyrën se si funksionon Ekipi Vlerësues në nivel të Komunës së Ferizajt.

Drejtoria e Arsimit vazhdon përkujdesje për organizimin e transportit të përshtatshëm për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në klasët e bashkangjitura dhe klasë burimore dhe referimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në qendën burimore “Përparimi” për vazhdim të shkollimit të mesëm (2 fëmijë jashtë sistemit arsimor të rregullt, të referuar për marrjen e shërbimeve arsimore).

Vizita edhe mbajtje të sesioneve informuese për shkollat në tema të ndryshme në varësisht nga nevoja e shkollave për prindër, nxënës dhe mësime dhënë (2 ligjërata informuese në shkollat fillore të Komunës së

Ferizajt, në temat : Çrregullimet e Spektrit të Autizmit, Disiplina të fëmijët dhe mënyra e menaxhimit dhe bullizmin).

DA ka mbështetur fuqimisht organizata e ndryshme që kanë për qëllim fuqizimi e arsimit gjithëpërfshirës dhe trajnimin e mësimeve. Në bashkëpunim me Save the Children ka mbajtur dy tryeza të rrumbullakëta me ekspertë të çështjeve të zhvillimit të fëmijëve, për të përpiluar planin që ka synim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për fëmijët në Komunën e Ferizajt.

Hapja e klasës për fëmijët e moshës 3-5 vjeç në shkollën fillore “Naim Frasheri” në Zaskok, për gjithëpërfshirjen e fëmijëve të komuniteti RAE në edukimin e hershëm.

Punësimi i një edukatore për punë me fëmijët e moshës 3-5 vjeç në SHFMU “Naim Frashëri”.

Trajnimi i afërsisht 75 mësimeve në trajnime të ndryshme për të ngritur kapacitetet e mësimeve në përfshirjen e fëmijëve në procesin arsimor.

Përfitimi i trajnimeve dhe granteve të vogla për 5 shkolla në Komunën e Ferizajt: “Tefik Çanga”, “Ahmet Hoxha”, “Jeronim de Rada”, “Jeta e Re”, “Astrit Bytyçi”.

Punësimi i një mësimeve mbështetëse në shkollën “Astrit Bytyçi”.

Hapja e dhomës për vlerësime pedagogjike të fëmijëve me nevoja të veçanta, e cila do të shërbej për Ekipin Vlerësues Komunal, kjo dhomë është e pajisur me mjete të ndryshme didaktike të cilat kanë qenë mjaft të nevojshme për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Pilotimi i KNF- së në dy shkolla (Jeta e Re në Greme, dhe Tefik Çanga në Ferizaj).

DA në bashkëpunim me organizatën “Syri i Vizionit” ka bërë strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve, edhe zhvillimin e aktiviteteve, si krijimi i planit dinamik të aktiviteteve për 2019/2020.

Down Syndrome Kosova - Ka dhënë donacionin e programit *matematikor Numicon* ku është dhënë 5 shkollave, ky program ka vazhduar edhe me aneks tjetër të materialeve për punë me fëmijët me Down Syndrome.

Caritas Switzerland ka pranuar aplikimin nga DA për trajnimin e edukatoreve të grup moshës 5 -6 vjeçare si dhe në pajisjen e disa klasëve me mjete didaktike, ku marrëveshje do të bëhet në vitin 2020.

Instituti për promovimin e edukimit IPEDU - në bashkëpunim me ambasadën sllovene ka bërë trajnimin e 33 mësimeve me tema specifike mbi çrregullimet e ndryshme dhe mënyrën e intervenimit të fëmijët me çrregullime të ndryshme zhvillimore.

Instituti Ed Guard - Ka arritur të përfundoj fazën e parë (identifikimin e fëmijëve të cilët kanë probleme në të pamur) në këto shkolla: “Ahmet Hoxha”, “Ganimete Terbeshi” (dy objekte) dhe “Astrit Bytyçi”.

- Në shkollën “Ahmet Hoxha” janë kontrolluar gjithsej: 1130 nxënës nga këta, janë referuar tek

oftalmologu: 113 nxënës.

- Në Shkollën “Astrit Bytyçi” janë kontrolluar gjithsej: 470 nxënës nga këta, janë referuar tek oftalmologu: 104 nxënës.

- Në shkollën “Ganimete Tërbeshi” janë kontrolluar gjithsej: 420 nxënës nga këta, janë referuar tek oftalmologu: 115 nxënës.

Drejtorja e Arsimit ka bërë ngritjen e kapaciteteve të arsimit gjithëpërfshirës duke trajnuar rreth 174 mësmdhënës, në bashkëpunim me organizata të ndryshme lokale dhe atyre nacionale.

1. NJËSIA E ARSIMIT PARAFILLOR

Në komunën tonë funksionojë dy çerdhe të fëmijëve, Çerdhja “**Ardhmëria Jonë**”, si çerdhe publike, dhe Çerdhja “**Engjujt**” në partneritet publiko-privat.

Në Çerdhen e Fëmijëve “**Ardhmëria Jonë**” gjatë vitit shkollor 2018 /19, janë sistemuar 199 fëmijë të grupuar në 13 grupe.

Institucioni edukativo-arsimor “Ardhmëria Jonë”
Viti shkollor 2018-2019

Grup mosha	Numri i grupeve	Numri i fëmijëve		
		M	F	Gj
06 muaj – 1 vjeç	1	5	5	10
1 vjeç – 2 vjeç	1	6	5	11
2 vjeç – 3 vjeç	4	23	25	48
3 vjeç – 4 vjeç	3	24	23	47
4 vjeç – 5 vjeç	2	19	22	41
5 vjeç – 6 vjeç	2	21	19	40
Gjithsej	13	98	99	197

Institucioni edukativo-arsimor “Engujt”

Viti shkollor 2018-2019

Grup mosha	Numri i grupeve	Numri i fëmijëve		
		M	F	Gjithsej
06 muaj – 1 vjeç	/	/	/	/
1 vjeç – 2 vjeç	1	6	3	9
2 vjeç – 2 vjeç	1	10	12	22
3 vjeç – 4 vjeç	3	24	25	49
4 vjeç – 5 vjeç	3	29	28	57
5 vjeç – 6 vjeç	3	31	30	61
Gjithsej	11	90	98	188

ARSIMI FILLOR (I – V)

Gjatë 2018-2019 në arsimin fillor kl.(I-V) janë regjistruar 8296 nxënës (4225 meshkuj dhe femra 4071), të shpërndarë në 418 paralele. Prej tyre mësimin e kanë vijuar 8238 nxënës (4196 meshkuj dhe 4042 femra).

NUMRI I NXËNËSVE, PARALELEVE DHE SUKSESI

Klasa 1-5	Paralelet	Nxënës të regjistruar			Nxënës që vijnë			SUKSESI POZITIV										SUKSESI NEGATIV		Të pa notuar	
								Shkelqyeshëm		Shumë mirë		Mirë		Mjaftue.		Gjithsej pozitiv		Përcillen			
Gj	418	4225	4071	8296	4196	4042	8238	5064	61	1608	19	1105	13	420	5.1	8197	99	18	0.22	23	0.28

Në fund të vitit shkollor 2018-2019, suksesi i arritur i nxënësve prej klasës I-rë deri në kl.5-të është si vijon:

- Gjithsej pozitiv 8197 ose 99.5 %;
- Gjithsej përcillen me nota negative..... 18 ose 0.22 %.
- Të pa notuar..... 23 ose 0.28 %
- Nota mesatare..... 4.24

Në krahasim me vitin e kaluar shkollor 2017-2018, në këtë vitit shkollor 2018-2019 suksesi i nxënësve është me një përqindje të njëjtë me vitin e kaluar.

Numri i nxënësve të panotuar është 23, krahasuar me vitin e kaluar në këtë vitit shkollor 2018-2019 është më i vogël për 3.

Klasë I - V	Mungesat			O R Ë T		
	A	Pa	Gj	Planifikuar a	Të mbajtura	Të pambajtura
Gjithsej	31850	9204	41054	209762	198844	10918

Orët:

Krahasuar me gjysëmvjetorin e vitit të kaluar, në këtë vit kemi më shumë orë të humbura përshkak të grevës 3 javore në arsim.

Mungesat:

Mesatarja për një nxënës4.98

Krahasuar me vitin e kaluar, në këtë gjysëmvjetor numri i mungesave është më i vogël.

ARSIMI MESËM I ULËT (VI – IX)

Gjatë 2018-2019, në arsimin e mesëm të ulët në klasat (VI-IX) janë regjistruar 7293 nxënës (3784 meshkuj dhe femra 3509), të shpërndarë në 344 paralele. Prej tyre mësimin e kanë vijuar 7220 nxënës (3743 meshkuj dhe 3477 femra).

Kl.6-9	Paralelet	Nxënës të regjistruar			Numri i nxënësve që kanë vijuar			SUKSESI POZITIV										Suksesi negativ		Të pa notuar	
								Shkëlqyeshëm		Sh.umë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		1 -3 nota të dobëta			
								Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%		
Gj	344	3784	3509	7293	3743	3477	7220	2661	36.5	1732	23.8	1819	25.0	798	11.0	7010	97.09	194	2.37	16	0.22

Në fund të vitit shkollor 2018-2019 suksesi i arritur i nxënësve prej klasës VI-IX është si vijon:

- Gjithsej pozitiv 7010 ose 97.09 %
- Gjithsej negativ194 ose 2.70 %
- Të panotuar..... 16 ose 0.22 %
- Nota mesatare..... 3.77

Në krahasim me vitin e kaluar shkollor 2017-2018, në këtë vit shkollor 2018-2019 suksesi i nxënësve është me një përqindje të njëjtë me vitin e kaluar.

Numri i nxënësve të panotuar është 16, krahasuar me vitin e kaluar, është më i vogël për **0.11 %**.

Klasa VI-IX	Mungesat			Gjithsej orë gjatë vitit		
	Të arsyshme	Të paarsyeshme	Gjithsej	Të planifikuara	Të mbajtura	Të pambajtura
Gjithsej	57275	24805	82080	214560	199923	14637

Orët: Krahastuar me gjysëmvetorin e vitit të kaluar, në këtë vit kemi më shumë orë të humbura përshkak të grevës 3 javore në arsim.

Mungesat:

Mesatarja për një nxënës **11.3**

Krahastuar me vitin e kaluar, në këtë vit kemi mesatarën më të madhe për **0.04**

REZULTATET E TESTIT TË ARRITSHMËRISË PËR KLASAT E IX – 2018/2019

Numri	Shkolla	Kodi	Numri i paralele ve	Numri i nxënësve që kanë hyrë në test	Totali			Renditja
					Pikët e arritura	%	Maksimu mi i pikëve	
1	"Gjon Serreçi"	1	10	253	16071	63.52	25300	10
2	"Jeronim De Rada"	2	5	131	8468	64.64	13100	9
3	"Tefik Çanga"	3	5	135	8853	65.58	13500	6
4	"Ahmet Hoxha"	4	5	128	6851	53.52	12800	29
5	"Ganimete Tërbeshi"	5	5	91	4681	51.44	9100	32
6	"Vezir Jashari"	6	3	78	5369	68.83	7800	4
7	"Bilall Shala"	7	2	27	1543	57.15	2700	23
8	"Jeta e Re"	8	2	53	2773	52.32	5300	31
9	"Konstandin Kristoforidhi"	9	2	31	1495	48.23	3100	33
10	"Naim Frashëri"	10	3	54	3087	57.17	5400	22
11	"Dituria"	11	2	47	2237	47.60	4700	35
12	"Besim Rexhepi"	12	3	50	3254	65.08	5000	8
13	"Imri Halili"	13	2	42	2665	63.45	4200	11
14	"Abetarja"	14	2	28	1231	43.96	2800	39
15	"Muharrem Shemsedini"	15	2	54	3368	62.37	5400	14
16	"Visar Dodani"	16	2	27	1836	68.00	2700	5
17	"Dëshmorët e .Kosharës"	17	2	37	2040	55.14	3700	27
18	"Ismail Qemajli"	18	1	28	1977	70.61	2800	3
19	"Liman Rekaj"	19	2	35	1973	56.37	3500	26
20	"Ramadan Rexhepi"	20	1	21	1563	74.43	2100	1
21	"Ali Hadri"	21	2	39	2325	59.62	3900	18
22	"Skënderbeu"	22	1	7	432	61.71	700	16
23	"Halit Ibishi"	23	1	20	1242	62.10	2000	15
24	"Dardania"	24	1	24	1460	60.83	2400	17
25	"Mic Sokoli"	25	1	19	850	44.74	1900	38
26	Tërrn	26	2	29	1685	58.10	2900	20
27	"Pesë Dëshmoret UÇK-së"	27	1	30	1782	59.40	3000	19
28	"Dëshmorët e Lirisë"	28	2	42	2746	65.38	4200	7
29	"Kemajl Hetemi"	29	1	14	796	56.86	1400	24
30	"Dy Dëshmoret"	30	2	34	1829	53.79	3400	28
31	"Mejdi Xhaferi"	31	2	33	1562	47.33	3300	36

32	"Pavarësia"	32	1	19	1405	73.95	1900	2
33	"Astrit Bytyçi"	33	3	65	3600	55.38	6500	25
34	"4 Prilli"	34	1	25	1441	57.64	2500	21
35	"Hajriz Muhadini"	35	1	22	1010	45.91	2200	37
36	"Afrim Abazi"	36	1	28	1763	62.96	2800	13
37	"Rizah Matoshi"	37	1	32	2015	62.97	3200	12
38	"Enver Topalli"	38	1	24	1284	53.50	2400	30
39	"Arsim Rexhepi"	39	1	22	1059	48.14	2200	34
Gjithsej			87	1878	111621	58.44	187800	

Krahasuar me vitin e kaluar, suksesi është më i ulët për 7.19 %

ARSIMI MESËM I LARTË (X – XII)

Gjatë vitit shkollor 2018/19 në arsimin e mesëm të lartë, klasa X – XII janë regjistruar 6637 nxënës nga ta kemi 3265 meshkuj dhe 3372 femra të sistemuar në 244 paralele, prej tyre mësimin e kanë vijuar 6378 nxënës (3084 meshkuj dhe 3294 femra)

KLASA X-XII	Nr. paraleleve	Nr. i nx. të regjistruar			Nr. i nx. që kanë vijuar			SUKSESI POZITIV										Përsëritës		Të panotuar	
								Shkëlqyeshëm		Shumë mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej pozitiv					
		M	F	GJ	M	F	GJ	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Gj	244	3265	3372	6637	3084	3294	6378	1306	19.6	1421	22	1730	26	1784	28	6241	94	137	2.1	259	3.9

Në fund të vitit shkollor 2018-2019 suksesi i arritur i nxënësve prej klasës X – XII është më sa vijon:

- Gjithsej pozitiv 6241 ose 94 %
- Gjithsej negativ 137 ose 2.1 %
- Të panotuar..... 259 ose 3.9 %

Klasa X - XII	Mungesat			Orët		
	Me arsye	Pa arsye	Gjithsej	Të planifikuara	Të mbajtura	Të pambajtura
Gj.	66321	40916	107237	119052	113302	5750

Orët: Kraheluar me gjysëmvetorin e vitit të kaluar, në këtë vit kemi më shumë orë të humbura përshkak të grevës 3 javore në arsim.

Mungesat:

Mesatarja për një nxënës **16 mungesa**

Kraheluar me vitin e kaluar, në këtë vit kemi mesataren më të madhe për **0.04**

PROVIMI I MATURËS

AFATI I QERSHORIT PËR VITIN SHKOLLOR 2018- 2019

Nr	Shkolla	Nr. i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
1	“Kuvendi i Arbërit”	572	545	95.28	27	4.72
2	“Faik Konica”	497	145	29.17	352	70.82
3	“Zenel Hajdini”	91	12	13.18	79	86.81
4	“Pjetër Bogdani”	118	29	24.57	89	75.81
5	“Elena Gjika”	197	185	93.90	12	6.09
6	“Çesk Zadeja”	38	20	52.63	18	47.37
7	“Dr. Shaban Hashani”	411	250	60.82	161	39.17
8	“Qendra e Kompetencës”	143	132	92.30	11	7.69
9	“Aga Xhite”	5	3	60.0	2	40.0

AFATI I GUSHTIT

Nr	Shkolla	Nr. i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
1	“Kuvendi i Arbërit”	48	45	93.75	3	6.25
2	“Faik Konica”	340	147	43.24	193	56.76
3	“Zenel Hajdini”	48	16	33.33	32	66.66
4	“Pjetër Bogdani”	67	27	40.30	40	59.70
5	“Elena Gjika”	14	9	64.29	5	35.71
6	“Çesk Zadeja”	15	13	86.67	2	13.33
7	“Dr. Shaban Hashani”	256	168	65.63	88	34.37
8	“Qendra e Kompetencës”	3	3	100.0	0	0
9	“Aga Xhite”	2	0	0.00	2	100.0

REZULTATET E TESTIT TË MATURES (qershor – gusht)

Të gjitha shkollat e arsimit të mesëm të lartë klasa 10 - 12	Viti 2019				
	Testi I dhe II				
	Nr.i nxënësve	Pozitiv	%	Negativ	%
Gjithsej	2356	1810	76.83	546	23.17

Përmbledhje

Arsimin ferizajas gjatë vitit 2019 e kanë karakterizuar edhe suksese, por edhe sfida. Si rezultat i punës së qeverisjes lokale dhe në veçanti të Drejtorisë së Arsimit, janë realizuar dhe janë në realizim e sipër disa projekte që kanë ndikuar dhe ndikojnë në përmirësimin e sistemit edukativo-arsimor në komunën tonë.

Rezultatet e arritura janë:

1. Në gjimnazin „Kuvendi i Arbërit“ hapëm Qendrën e Karrierës;
 2. Mbështetëm themelimin e dy bibliotekave në shkollat e fshatrave;
 3. Drejtimet e reja profesionale i promovuam përmes fushatës vetëdijësuese në komunitet;
- Fillimi i ndërtimit të shkollës në fsh. Zaskok;
 - Renovime në shkollën e fsh.Koshare – Investim nga Ambasada e Turqisë;
 - Ndërrimi i kulmit të shkollës “Vezir Jashari” dhe vendosja e një pjese të re të rrethojës, me porta dhe dyer hyrëse;
 - Rregullimi i rrethojës në shkollën “Jeronim De Rada”
 - Krijimi i hapësirës gjelbëruese në shkollën “Jeronim De Rada”
 - Renovimi i shkollave përmes Projektit të Efiçencës;
 - ✓ “Mejdi Xhaferi” Mirosalë
 - ✓ “Abetarja” Softaj

Përfundim

Përkundër sfidave dhe peripecive të mëdha në shumë dimensione që është duke u ballafaquar arsimit në Republikën e Kosovës, ku ende nuk po mund të arrijë një standard të dëshiruar që garanton zhvillim, përparim dhe stabilitet të qëndrueshëm.

Drejtoria e Arsimit, pas vlerësimit dhe analizës së përgjithshme mbi rezultatet e arritura nga nxënësit në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë vitit shkollor 2018/2019, si dhe zhvillimeve të përgjithshme të ecurisë së procesit edukativo-arsimor konstaton se edhe këtë vit shkollor ka zhvillime dhe përmirësime të kënaqshme të rezultateve dhe suksesit të nxënësve në komunën e tonë, pra konsiderohet një vit i suksesshëm dhe me rezultate të mira. Kjo vjen si rezultat i masave dhe veprimeve konkrete të ndërmarra nga Drejtoria e Arsimit, në shumë dimensione në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim. Drejtoria komunale po punon në vazhdimësi me të gjithë kapacitetin maksimal, duke bashkëpunuar edhe me institucionet relevante përgjegjëse të arsimit, që në komunën tonë të ndërtohet një infrastrukturë shkollore e nivelit bashkëkohor, duke krijuar kushte optimale që në shkollat tona, të ngritet cilësia në arsim. Prandaj, çdo vërejtje, apo sugjerim konstruktiv do të ishte i mirëseardhur dhe do të ndikonte në begatimin akoma të këtij raporti i cili do të jetë edhe më i plotë dhe në funksion të avancimit të çështjes së arsimit në përgjithësi.



REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2019

Xhemile Murati Shabani
Drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ferizaj, 2020

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është dikaster që funksionon në kuadër të institucioneve të Komunës së Ferizajt, e cila kryen punët dhe detyrat sipas rregullave, dispozitave shtetërore dhe organogramit komunal.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka këta sektorë dhe njësi:

- **Spektori i Kulturës**
- **Spektori i Sportit**
- **Spektori i Rinisë dhe**
- **Spektori i Bibliotekave**

- **Njësia e Kulturës**
- **Galeria**
- **Muzeu**
- **Teatri dhe**
- **Zyra administrative dhe financiare**

Memorandumet e bashkëpunimit të lidhura ndërmjet Ministrinë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Ferizajt.

1. “ Pallati i Kulturës”
2. “Pishina gjysmë-olimpike në Ferizaj”
3. “Kompleksi i Fushave të Tenisit”
4. “Renovimi i Stadiumit të Qytetit”
5. “Renovimi i Kishës katolike”
6. “Terrene sportive në Dubravë, Ferizaj”
7. “Renovimi i Teatrit”
8. “Mulliri i madh, Xhamia në Greme”

Projekte të përfunduara

1. Renovimi i Galerisë së Arteve, Muzeut dhe Arkivit Historik

Projekte të inicuar

1. Renovimi i Bibliotekës “Sadik Tafarshiku”;
2. Njërtimi i fushave të Ping-pongut (Tabelat e Pingpongut)

Infrastruktura ligjore

1. Themelimi i Muzeut të Kujtesës;
2. Statuti i Muzeut të Kujtesës;
3. Ndryshimin dhe Plotësimi i Rregullores për Dhënien e Dekorativave.

Janë përkrahur me subvencione 42 OJQ, kryesisht shoqata kulturore, klube sportive dhe organizata rinore. Gjithashtu janë përkrahur artistë e sportistë të pavarur me vendime individuale.

Librat e financuara për botim në vitin 2019 janë gjithsej 17 (shtatëmbëdhjetë), libra monografik dhe letrar.

SEKTORI I KULTURËS

Ky sektor organizon aktivitetet kulturore të përbashkëta dhe të ndara, me grupet kulturore dhe komunitetin artistik, aktivitetet tjera që kërkohen nga institucionet komunale, si dhe propozime nga faktorë të jashtëm. Këto aktivitetet shtrihen gjatë punës njëvjeçare duke iu përmbajtur planit të punës të përpiluar në fillimvit, e në të shumtën e rasteve duke tejkaluar këtë plan me aktivitetet shtesë.

Ky sektor aktivitetet kulturore i zhvillon kryesisht në **sallën e Teatrit Adriana**, në Galerinë e Arteve, por edhe në ambiente të hapura, si: **Bulevardi i Qytetit, Sheshi i Qytetit, Sheshi Kadare, Palestra e Sporteve, etj.** (Shënim: Në arkivin e Sektorit të Kulturës, mund të gjeni raportin me ilustrime.)

Në raportin në vijim i gjeni aktivitetet e realizuara nga ky sektor, përkatësisht njësitë e saj si dhe aktivitetet nga grupe kulturore që veprojnë në partneritet me këtë sektor.

Janar

Zakonisht muaji Janar konsiderohet si muaj i rishikimeve, analizave, raporteve dhe planeve të punës. Në kuadër të kësaj mbahen takime konsultime lidhur me mundësinë e realizimit të planeve. Pas disa takimeve të konsultimeve, u dizajnuan dhe u shtyp kalendari i aktivitetëve kryesorë DKRS 2019. Gjithsesi gjatë këtij muaji veçojmë disa aktivitetet të mbajtura:

Ekspozitë personale në Tiranë e piktorit ferizajas Arbnor Karaliti.

Kjo ekspozitë është mbajtur me mbështetje të DKRS-së, duke organizuar transportin e një grupi të artistëve ferizajas për në Shqipëri.

“Oda e Librit” – Organizim i përmuajshëm nga Klubi Letrar “De Rada”

Klubi Letrar “De Rada”, viteve të fundit ka bërë traditë të përmuajshme organizimin e aktivitetit letrar “Oda e Librit”, ku praktikohet zakonisht të diskutohet një libër (roman, dramë etj), apo ndonjë autor i veçantë. Ky aktivitet mbahet në vende të ndryshme, si në Galeri, Bibliotekë, etj.

Xhemil Rexhepi – baritoni i njohur botëror që jeton në Milano, vizitoi Ferizajn

Ishte një rast i mirë që Xhemil Rexhepi, ky muzikant i njohur të viziton Ferizajn. Ai veç të tjerash vizitoi Shkollën e Muzikës “Çesk Zadeja”, duke bashkëpunuar me vokalistë të rinj, nxënës, studentë e pedagogë.

SHKURT

Zakonisht në muajin Shkurt, vëmendije të veçantë i kushtohet **manifestimit 17 Shkurtit- Ditës së Pavarësisë së Kosovës**. Paraprakisht formohet një grup punues nga DKRS, në bashkëpunime me grupet relevante kulturore e sportive, që përpilojnë një tabelë me aktivitete:

17 shkurti – Dita e Pavarësisë së Kosovës	
MANIFESTIM NACIONAL - (Aktivitete kulturore e sportive)	
E ENJTE 14 SHKURT	KONCERT PËR FËMIJË Grupi muzikor- Kromatika
E PREMTE 15 SHKURT	SHFAQJE TEATRORE “HANIBALI I NËNTOKËS” Premierë nga Teatri “Adriana”- Ferizaj Teksti: Hristo Boychev/ Regjia: Fatlum Haziri
	TURNIR NË HENDBOLL KH “Kastrioti” (veteranët)
	KONCERT PËR FËMIJË Grupet muzikore për fëmijë
	EKSPOZITË KOLEKTIVE

E SHTUNË 16 SHKURT	GALERIA & SHAF Zef Kolombi/ “Çmimi “Gursel Sylejmani”
	SHFAQJE TEATRORE “HANIBALI I NËNTOKËS” (reprizë)
E DIEL 17 SHKURT	HOMAZHE TE VARREZAT E DËSHMORËVE
	AKADEMI SOLEMNE Pjesë foljore\ Pjesë artistike: Reacital- Grupi i Teatrit “Adriana”- Ferizaj Koncert Festiv - Kori dhe Orkestra e Qytetit
	KONCERT FESTIV Shkolla e Arteve “Çesk Zadeja ”

Nga të gjithë këto aktivitet kushtuar këtij manifestimi, veçojmë:

Ekspozita kolektive e artit pamor me një organizim profesional dhe masiv, ku ndahet edhe çmimi tradicional „Gursel Sylejmani“, si dhe dy koncertet festive nga Shkolla e Arteve “Çesk Zadeja ”dhe „Orkestra e Qytetit“

AKV “Kastriotët” koncert në SHBA - Me ftesë të Universitetit Montclair University nga Nju Xheri, si dhe me iniciativë të Merita Halilit dhe Raif Hysenit, Orkestra AKV “Kastriotët”, me disa solistë, bashkë me orkestrën e këtij Universiteti, dhanë një koncert të përbashkët në Nju Xheri të SHBA-së. Orkestra Montclair University, është e përbërë nga shtetas amerikanë, nën udhëheqjen e maestro Raif Hyseni, të cilët promovojnë dhe kultivojnë muzikën shqipe.

U përrua grupi artistik “Shamikuqet”- Shamikuqet, është grup karakteristik i përbërë vetëm nga vajzat, ku përfshihet vallëzimi, këngët me defa dhe performanca të tjera.

21 mars Dita e Poezisë - Klubi Letrar “De Rada”- Orë Letrare me karakter garues.

30 Vjetori i Demonstratave “Gratë e Balajve”. Me rastin e këtij jubileu, Komuna e Ferizajt organizoi disa aktivitete. Veç homazheve dhe përrimit të pllakës përkujtimore, u organizua edhe Akademi Përkujtimore me pjesë artistike, ku morën pjesë artistë të shumtë, e në mesin e tyre Selami Kolonja e Mirush Kabashi. Poashtu u organizua edhe një koloni artistike, ku pikturat e punuara iu dhuruan grave personalitete të Komunës së Ferizajt.

20 vjet në kujtim të Adrianës.

Me rastin e 20 vjetorit të Adriana Abdullahut, aktore nga Ferizaj, u organizua një manifestim përkujtimor në nderim të saj. Përveç homazheve, u mbajt edhe një mbrëmje përkujtimore në sallën e Teatrit Adriana. U shfaq një dokumentar i punuar nga Sabri Pajaziti e Besim Ugzmajli, si dhe u evokuan kujtime nga kolegët e profesorët: Enver Petrovci, Fadil Hysaj, Armond Morina, Xhevdet Doda e Vjosa Abazi. Në hollin lartë, u ekspozuan gjësendet që kishin mbetur nga Adriana, si djepi, çanta e fëmijërisë etj.

02-06 Prill - Festivali Ndërkombëtar i Filmit- Ferfilm –

Festivali Ndërkombëtar i Filmit Ferfilm-edicioni i 7-të. Gjatë pesë netëve u shfaqen afro 70 filma ndërkombëtar të metrazhit të shkurtër në katër kategori: fiksim, dokumentar, animacion dhe eksperimental. Ndërsa hapja e festivalit u bë me filmin e ri kosovar “Nëntori i Ftohtë”, prodhim i Qendrës Kinematografike të Kosovës . Veç shfaqjes së filmave dhe programit të rregullt, festivali si zakonisht organizoi edhe aktivitete tjera paralele për mysafirët dhe audiencën e gjerë, si: vizita objekteve kulturore; bifurkacioni, muzeu i qytetit, qyteti i Prizrenit, pastaj mbrëmje muzikore, koktej me ushqime tradicionale etj.

17 prill - Mbledhje komemorative për Gafurr Limanin.

Kjo mbledhje u organizua për t’i dhënë lamtumirën e fundit të ndjerit Gafurr Limani, i cili ishte punëtor dhe kolegj i stafit të DKRS-së. I ndjeri ndërroi jetë më 16 Prill.

Mural Fest dhe Brick- ekspozitë me të rinj, me karakter garues.

Në bashkëpunim me “Mural Fest”, 28 punime plot ngjyra, stile të ndryshme e ide origjinale, u ekspozuan në Galerinë e Arteve në Ferizaj. E veçanta e kësaj ekspozite: “Toleranca”- ishte tema që zgjoi kreativitetin e shumë nxënësve të shkollave të mesme të regjionit të Ferizajt. Në aktivitet u shpërblyen më të mirët.

9 maj- Dita e Europës në Ferizaj –

Me një aktivitet simbolik, Sektori i Kulturës, në bashkëpunim me Grupin Rin On, shënuan Ditën e Europës duke prezantuar hartën e Kosovës në zingjirë, si shenjë proteste artistike kundër izolimit dhe proliberalizimit të vizave.

Promovimi i libri “SHËNDETËSIA e Komunës së Ferizajt me rrethinë gjatë shekullit XX” –

Me rastin e jubileut të 40 vjetorit të gjeneratës së parë të mjekëve të diplomuar ferizajas, në një tubim madhështor, Dr. Agim Bytyçi dhe Ramadan Ramadani, promovuan librin voluminoz “SHËNDETËSIA e

Komunës së Ferizajt me rrethinë gjatë shekullit XX”. Promovimi u mbajt në restaurant “Fitorja”, ku morën pjesë qindra njerëz nga të gjitha viset shqiptare dhe diaspora. Përveç mysafirëve të shumtë, e sidomos emra eminentë të mjekësisë shqiptare, nga Turqia erdhi edhe familja e doktorit të parë ferizajas Shaban Sylejmani, i ndjerë. Libri ishte punuar nga dy autorët e lartëpërmendur dhe përkrahur DKRS në aspektin financiar dhe nga DKRS në aspektin organizativ.

Performancë muzikore nga grupi Doën Sindrom Kosova dhe Anglia.

Me një performancë të mrekullueshme nga artistët me Sindrom Doën, mysafirë nga Anglia, bashkë me ata nga Kosova, ishin sonte në Teatrin "Adriana". Kënga "You can dance" i ftoj të gjithë në skenë, vallëtarë e mysafirë të rëndomtë.

1 qershor Dita e Fëmijëve –

Zakonisht Sektori i Kulturës i kushton vëmendje të veçantë 1 Qershorit- Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve duke realizuar aktivitete të larmishme, si: koncerte, ekspozita, defile etj.

Në bashkëpunim me Sektorin e Rinisë, Sektorin e Sportit, dhe në përkrahje nga GIZ, dita e fëmijëve u shënuar me disa aktivitete: Filmi artistik i shkurtër: "Rruga" nga Besim Ugzmajli; Debat "Të drejtat e Fëmijëve"; Defile i përbashkët, sportistë e artistë të vegjël, Koncert për fëmijë; Koloni artistike me të fëmijë në Dubravë; Në defilenë e përbashkët morën pjesë qindra fëmijë të grupeve kulturore dhe sportive, të cilët pas arritjes të sheshi i komunës, filluan me demonstrimet e tyre në fushat përkatëse të kulturës e sportit.

Në këtë manifestim prezantuan edhe Policia e Kosovës, FSK, KFOR-i Shëndetësia, Brigada Zjarrfikësve, të cilët me instrukecionet e tyre e bënë më kreative manifestimin për fëmijë.

DITËT E KULTURËS – Ferizaj 2019

Sektori i Kulturës, tradicionalisht gjatë muajit Qershor realizon manifestimin kulturor **“Ditët e Kulturës-Ferizaj 2019”**. Zakonisht manifestimi mbahet gjatë periudhës 02 -12 qershor, mirëpo të shumtën e rasteve ka lëvizje datash, me qëllim të përshtatjes së agjendave tjera, festave, orientimet e artistëve etj. Manifestimi i sivjetëm u zgjerua në dy tabela:

DITËT E KULTURËS- Tabela I

E mërkurë 5 Qershor	EKSPozITË KOLEKTIVE Galeria e Arteve & SHAF “Zef Kolombi”
	SHFAQJE TEATRORE “Koprraci” nga Molier - Teatri “Adriana”- Ferizaj
E Enjte 6 Qershor	GARAT E RECITATORËVE Aktivitet artistik me shkollat fillore dhe të mesme Organizator: Klubi Letrar “De Rada” & Teatria “Adriana”
E premte 7 Qershor	“Festival i këngës për fëmijë” “FËMIJËT E GËZUAR” Golden Stars 2019
	ROCK KONCERT Prezantim i albumit “Exodus” nga Isak Maloku dhe Rock Ginis
E shtunë 8 Qershor	KONCERT MUZIKOR - Dita e Shkollës së Arteve “Çesk Zadeja”
E hënë 10 Qershor	“ORA E ASTRITIT” - AKTIVITET LETRAR Organizator: Klubi Letrar “De Rada”
	SOLO KONCERT - Xhemil Rexhepi - bariton
E martë 11 Qershor	EKSPozITË VIZUELE ME EKSPONATE TË MUZEUT Zyra për Trashëgimi e Muze
	FERFOREST Festival Festivali Ndërkombëtar i kampingut
E mërkurë 12 Qershor	DITA E ÇLIRIMIT Homazhe te Varrezat e Dëshmorëve
	AKADEMI SOLEMNE - Pjesë foljore/ Pjesë artistike Kori dhe Orkestra e Qytetit

GALA KONCERT FILHARMONIA E SHQPËRISË

Organizator: NSH Klarino

DITA	AKTIVITETI DITËT E KULTURËS- Tabela II
E diel 15 Qershor	Koncert muzikor “FESTIVALI I MUZIKËS PËR FËMIJË “A MOL”
E mërkurë, 19 Qershor	Koncert muzikor “MEKSIKA FESTON DITËN E ÇLIRIMIT” Ansambli nga Meksika dhe AKV “Kastriotët”
E Diel 22 Qershor	Festivali Ndërkombëtar i Valleve për Fëmijë FERFOLK
E Enjte 27 Qershor	Vizitë e monumenteve historike i grupit “PEACE CORPS” NGA SHBA
E Premte 28 qershor	Prezantim i Festivalit të Animacionit ANIBAR në Ferizaj
E shtunë 29 Qershor	Manifestim tradicional “DITA E PLISIT”
E diel 30 Qershor	KINEMAJA SOLARE (Në bashkëpunim me DokuFest)
E Enjte 4 Korrik	KONCERT FESTIV 4 KORRIKU DITA E PAVARËSISË SË SHBA-së Ansambli MONTCLAIR UNIVERSITY dhe AKV “Kastriotët” Mysafir special: Merita Halili dhe Raif Hyseni

Nga kjo tabelë veçojmë:

Koncerti kushtuar 12 qershorit - Ditës së Çlirimit, ku prezantoi Filharmonia e Shqipërisë me këngëtarë të njohur të estradës shqiptare: Kastriot Tusha, Selami Kolonja, Liridon Sadriu, Besa Llugiqi e Fatmira Breçani, poashtu Asnambli “Shota” dhe ansambli nga Ferizaj “Kastriotët”.

Aktivitet Letrar “Ora e Astritit”- që mbledhi shumë poetë nga trojet shqiptare, me mysafir special Xhevdet Bajra;

Koncert solistik me baritonin Xhemil Rexhepi, me prejardhje nga Ferizaj, por që jeton e vepron në Milano të Italisë, bashkë me Sugiko Chinen, pianiste nga Japonia. Poashtu mbrëmjen e madhështoi prezantimi i inetepreruesve ferizajas: Arta Prekadini- violinë, e cila kishte ardhur nga SHBA.

Ferforest Festival- Një aktivitet masiv me përmasa të mëdha ishte edhe Ferforest Festival që u mbajt në fshatin Nerodime, ku prezantuan artistë të njohur vendorë e ndërkombëtarë.

Pastaj **Koncert muzikor “MEKSIKA FESTON DITËN E ÇLIRIMIT”** - Ansambli nga Meksika "Arte folklor Mexico" i përbërë më shumë se 50 artistë, prezantuan me një performancë të bukur muzikore në sheshin e qytetit të Ferizajt, i cili ishte i mbushur përplotë.

Festivali Ndërkombëtar i Valleve për Fëmijë - FERFOLK – i cili sivjet në Ferizaj u formua nga grupi i valleve “Shamikuqet”, si një festival i ri muzikor, konkretisht i valleve për fëmijë. Në edicionin e I-rë, u prezantuan grupe nga Kosova, Maqedonia, Turqia dhe Bosnja. Zakonisht “Ditët e Kulturës”, zgjojnë kërshërinë e dashmirëve të kulturës dhe qytetarëve të tjerë.

Qershor-Mbledhje komemorative për shkrimtarin Ramadan Asllani

Me rastin e ndarjes nga jeta të shkrimtarit dhe gazetarit të njohur ferizajas Ramadan Asllani, në sallën e Teatrit “Adriana”- Ferizaj, u organizua një mbledhje komemorative.

Prezantim i Festivalit të Animacionit ANIBAR në Ferizaj- Festivali Ndërkombëtar i Animacionit “Anibar” nga Peja, në pragë të edicionit të radhës, në programin e tyre, kishin një prezantim edhe në Ferizaj. Një ekip nga ky festival prezantoi para një audience ferizajase, programin dhe disa prej filmave që do të prezantohen në edicionin e vitit 2019. Sektori i Kulturës, në bashkëpunim me disa artistë ferizajas u përkujdes në mbarëvajtje të këtij eventit.

Manifestim tradicional “DITA E PLISIT”

Në fshatin Jezerc, u mbajt manifestimi tradicional “Dita e Plisit”, aktivitet i cili mbahet në vende të ndryshme të Kosovës, konkretisht në trevat ku ende ruhet kjo tradita e plisit. Organizator të festivalit ishte Ismet Lala- Krasniqi, ndërsa nikoqir i manifestimit Nazmi Hajdari nga fshati Jezerc. Në manifestim prezantuan shumë mysafirë nga treva të ndryshme shqiptare. DKRS u përkujdes në mbarëvajtje të këtij manifestimi.

KINEMAJA SOLARE - nga DokuFest

Një ekip nga Festivali DokuFest prezantoi me një projekt specifik në sheshin e qytetit të Ferizajt, konkretisht, me kinemanë solare, një teknologji inovative. Përfaqësues të DKRS-së u përkujdesën në mbarëvatjen e këtij aktiviteti.

Koncert festiv -4 Korriku- Dita e Pavarësisë së SHBA-së - Në vigjilje përvjetorit të pavarësisë së SHBA-së, me ftesë të AKV “Kastriotët” në Ferizaj qëndroi katër netë **Ansambli MONTCLAIR UNIVERSITY nga SHBA**. Ky ansambël i përbërë nga artistë amerikanë e që kultivojnë dhe interpretojnë muzikën popullore shqipe, është themeluar nga prof Raif Hyseni dhe Lisa De Lorenzo, drejtoreshë e këtij universiteti.

Gjatë katër netëve, veç vizitave vendeve kulturore, ky ansambël dha koncert në Prishtinë, Shkup dhe Ferizaj. Në Ferizaj, bashkë edhe me ansamblin “Kastriotët”, u dha një koncert madhështor në sheshin e qytetit. Mysafire speciale në koncert ishte këngëtarja e njohur shqiptare Merita Halili. Mysafirët gjatë katër ditëve i shoqëroi një ekip i Sektorit të Kulturës.

Ceremonia e hapjes “Mural Fest” (10-17 Korrik)

Në një atmosferë festive u mbajt ceremonia e hapjes së Festivalit të Muraleve- “Mural Fest”, edicioni i 4-të. Festivali zgjati tetë netë, ku përveç punimit të muraleve, u realizuan edhe aktivitete tjera artistike e organizative, si: 3D, ekspozitë, koloni artistike, mbrëmje poetike, ekspozitë e fotografisë, si dhe aktivitete të tjera përcjellëse; after party, ekskurzione, koncert në shesh etj. Mural Fest po zë një vend të rëndësishëm në manifestimet kulturore ferizajase. duke sjellur murale dhe risi në festival. DKRS këtij manifestimi i kushton rëndësi të veçantë, veç atyre financiare edhe në përkujdesje organizative dhe logjistike.

Mbrëmje poetike me Shpëtim Selmanin, organizuar nga Mural Fest.

Ekspozitë e fotografisë “99-19” nga Hazir Reka - Kjo ekspozitë e fotografisë ishte retrospektivë e fotografive të realizuara gjatë viteve të 90-ta nga fotografi i njohur Hazir Reka, të cilat u reprodukuan në pëlhurë nga artistët e rinj ferizajas të SHA “Çesk Zadeja”- Ferizaj.

Diskutim publik “Pallati i Kulturës” - Komuna e Ferizajt ka inicuar një projekt kapital për ndërtimin e një objekti të ri kulturor „Pallati i Kulturës“. Në kuadër të kësaj u mbajt një diskutim publik me ekipin që ka fituar projektin dhe komunitetin artistik. Muajve në vijim pritet që të konkretizohet ky projekt.

Zbulimi i shtatores së dëshmorit Nazmi Ukësmajli – Veç pjesës foljore, u dha edhe një aktivitet kulturor me këngë e poezi, prezantuan edhe AKV “Kastriotët”, etj.

Muzat e Jezercit”- Aktivitet letrar “ Ky aktivitet tradicional letrar tre ditor, u organizua nga Klubi Letrar “De Rada”, dhe u mbështet nga DKRS. Aktiviteti u mbajt në fshatin Jezerc, ku u realizua mbrëmje poetike, promovim libri, diskutime, mbrëmje muzikore etj.

«**Ditët e Diasporës**» - është manifestim i veçantë me shumë aktivitete kulturore që iu dedikohen bashkëatdhetarëve tanë që gjenden për pushime në vendlindje. Zakonisht DKRS përpilon një tabelë të aktiviteteve kushtuar këtij manifestimi.

DITËT E DIASPORËS 2019 27 korrik- 07 gusht	
26 Korrik	KONCERT PËR FËMIJË (Hapja e manifestimit)
27 Korrik	KOLONI ARTISTIKE DHE EKSPOZITË PËR MËRGIMTARË Organizon: Galeria e Arteve/ SHAF Zef Kolombi
	Ekspozitë e arkitekturës- organizator Fakulteti i Arkitekturës i UBT-
28 Korrik	“TINGUJT E ZEMRËS” - (Aktivitet kulturo-artistik në Mirosalë)
	HIKING - Shoqëria Bjeshkatore Alpiniste “Lybeteni”
29 Korrik	TURNIR NË FUTBOLL TË VOGËL
30 Korrik	EKSPOZITË E EKSPONATEVE Prezantim Muzeu i Qytetit - Forma vizuele
31 Korrik	ROCK KONCERT – Veli Sahiti – Trix
01 Gusht	TURNIR NË VOLEJBOLL - Aktivitet sportiv për mërgimtarë
02 Gusht	PANAIRI I LIBRIT (02-04 gusht) Organizator: Klubi Letrar “De Rada”- Ferizaj
	SHFAQJE TEATRORE “Kur Hana del” Teatri “Adriana”- Ferizaj
3 Gusht	MBRËMJE FILMI - "Streha pas reve"- sjellur nga PriFest
E hënë 5 Gusht	PANAIR ME PRODUKTE USHQIMORE DHE ARTIZANALE (05-07 Gusht) Drejtoria e Bujqësisë

Prej gjitha këtyre aktiviteteve të këtij manifestimi, do të veçonim:

Koncert Veli Sahiti- Trix, një koncert madhështor që u mbajt në sheshin kryesor të qytetit të Ferizajt. Koncertin e përcollën qindra mysafirë nga mërgata dhe dashamirë të tjerë të grupit Trix.

«**Panairi i Librit**» një aktivitet i ri në Ferizaj, i cili zgjoi kërshërinë e shumë dashamirëve të librit dhe qytetarëve të rëndomtë.

Në shërbim të mërgimtarëve, u mbajtën edhe aktivitete tjera të shumta, si:

Darka e Gurbetqarit" – koncert i organizuar nga këngëtari ferizajas Labinot Tahiri. Ky aktivitet u përkrah nga disa biznese ferizajase, ndërsa në aspektin organizativ nga DKRS-Ferizaj.

Festa e Miqësisë- Tani dy viteve të fundit Komuna e Ferizajt ka zhvilluar bashkëpunim të mirë me kompaninë Conex, që realizon aktivitet për mërgimtarë e quajtur "Festa e Miqësisë". Ky manifestim në Ferizaj qëndroi tre netë duke sjellur koncert madhështor me emra të njohur të estradës shqiptare, si: Redon Makashi, Elton Deda etj.

Mbledhje komemorative për Hafir Bislimin

Me rastin e vdekjes së parakohshme të artistit dhe gazetarit ferizajas Hafir Bislimi, Drejtoria e Kulturës organizoi mbledhje komemorative, ku përveç familjarëve, morën pjesë artistë dhe kolegë të Hafirit. Kujtojmë se Hafir Bislimi ishte emër i njohur i skenës teatrale dhe filmike në Ferizaj e më gjërë.

Promovimi librit "Një jetë për atdhe" nga Musa Emini - Në sallën e Teatrit "Adriana" u bë promovimi i librit të autorit Musa Emini me titull: "Një jetë për atdhe". Musa Emini njihet si humanist në Ferizaj, gjatë viteve të 90-ta, që kishte hapur shtëpinë për organet shtetërore paralele të Kosovës në atë kohë. Gjithë kujtimet, ai i kishte mbledhur në këtë libër. Veç pjesës foljore, u dha edhe një program artistik nga Okteti i Qytetit- Ferizaj.

Akademi përkujtimore për Ramadan Hazirin - Me rastin e një vjetorit të ndarjes nga jeta të intelektualit dhe shkrimtarit Ramadan Haziri, Klubi i Intelektualëve të Ferizajt, organizuan një akademi përkujtimore në nderim të tij.

Kori i Qytetit në Ohër - Nën udhëheqjen e dirigjentes Lindita Isufi, prezantoi me një program special në festivalin e koreve në Ohër të Maqedonisë.

28 shtatori- Dita e Dëshmorëve në Komunën e Ferizajt. Zakonisht Komuna e Ferizajt, konkretisht Drejtoria e Kulturës, në bashkëpunim me shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së organizojnë manifestimin Dita e Dëshmorëve. Përveç homazheve, pjesës foljore, organizatorët përgatisin edhe pjesë të tjera artistike.

Ecje në Jezerc - Poashtu në kuadër të manifestimit “Dita e Dëshmorëve” SHBA Lybeteni, organizoi ecje në Jezerc. Ky aktivitet ishte në bashkëpunim me DKRS-në.

Mural Fest “Our planet our future” - Realizoi ligjërata me të rinj.

“Njeriu në Fokus” ekspozitë e fotografisë nga Hazir Reka

Fotografi i njohur kosovar Hazir Reka, realizoi një ekspozitë ndërkombëtare me fotografi të ndryshme nga vende të ndryshme të botës, të cilat kishin temën: “Njeriu në Fokus”. Ekspozita u hap në Stacionin e Trenit në Ferizaj, një hapësirë thuajse e braktisur, por shumë pamje estetike në përshtatje me ekspozitën. Ekspozita mbeti e hapur nga 8 deri më 12 tetor.

Hapja solemne e Festivalit të muzikës për fëmijë A-MOL - Ky festival për herë të parë e ndërroi formatin e organizimit, duke u bërë festival ndërkombëtar. Sivjet prezantuan mysafirë nga Kroacia, Sllovenia, Rumania, Shqipëria etj. Fituese e festivalit ishte Anisa Shabani.

Ferfilm në Herne- Gjermani - Një pjesë e ekipit të Festivalit FerFilm, ishte mysafirë special në Festivalin ICFF në Herne të Gjermanisë. Kujtojmë se një ekip i këtij festivali patën prezantuar një program special në Ferizaj.

25 tetor – Akademi përkujtimore kushtuar tre dëshmorëve

Në organizim të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe në mbështetje të DKRS-së, me rastin e 20 vjetorit të rënies së tre dëshmorëve: Naim Beka-Sokoli, Agim Matoshi dhe Avni Shehu, u organizua një akademi përkujtimore. Veç pjesës foljore, me një pjesë artistike prezantuan: Okteti i Qytetit të Ferizajt dhe këngëtari Milaim Mezini.

30 tetor – Festivali i muzikës për Fëmijë – “Sidorela Fest”

Festivali i Muzikës për Fëmijë “Sidorela Fest” zakonisht mbahet në fund të muajit tetor të vitit kalendarik. Ky festival organizohet nga Artistic Center, por që ka vëmendjen edhe DKRS-së- Ferizaj. Vlera Kastrati fituesja e vendit të parë në kategorinë Live.

Promovimi i librit “Mulla Hamit Guta” në Jezerc - Në organizim të autorit Isak Guta, Shoqatës “Jezerci” dhe në mbështetje të DKRS-së, u bë promovimi i librit “Mulla Hamit Guta” të autorit Isak Guta

(i biri i Hamit Gutës). Hamit Guta ishte personalitet kombëtar dhe fetar, për të cilin folën panelistë të ftuar për këtë promovim.

Film artistik “Martesa” - Me kërkesë të grupit të rinjve, në Teatrin Adriana Ferizaj, u shfaq filmi artistik “Martesa”, prodhim i Qendrës Kinematografike të Kosovës. Kujtojmë se ky film ka fituar shumë çmime ndërkombëtare në Europë dhe vende të tjera atlantike.

Filloi Audicioni “Kosovarja Këndon”

Pas aplikimit të kandidateve për pjesëmarrje, filloi audicioni i festivalit “Kosovarja Këndon”. Selektimin e kandidateve dhe fillimin e përgatitjeve të këngëve (përzgjedhjet, aranzhimet etj) u përkujdes orkestra e AKV “Kastriotët” në udhëheqjen artistike të Fitim Bytyqit. Pas disa ditëve prova, u përpilua lista përfundimtare dhe përgatitjet e fundit për festival.

27 nëntor- Aktivitet kulturor-humanitar Shkolla e Arteve “Çeska Zadeja”

Me rastin e ndodhjes së tragjedisë në Shqipëri, shumë aktivitete kulturore u shtynë për më vonë, ndërsa u mbajtën disa aktivitete tjera kulturore me karakter humanitar. I tillë ishte aktiviteti i organizuar nga Shkolla e Arteve “Çesk Zadeja” që performoi me disa pika muzikore dhe me një ekspozitë të vogël. Mjetet që u mbledhën, iu dërguan të mbijetuarve në Durrës.

Festivali i këngës popullore “Kosovarja Këndon”

Zakonisht Festivali “Kosovarja Këndon” mbahet në fund të muajit nëntor, respektivisht në datën e flamurit më 28 nëntor, por edhe “Kosovarja...” ishte shtyer për shkak të tragjedisë në Shqipëri. Festivali “Kosovarja Këndon” zakonisht realizohet nga AKV “Kastriotët”, respektivisht nga orkestra popullore e këtij ansambli, ndërsa në aspektin logjistik e organizativ përkujdeset Sektori i Kulturës- DKRS. Sivjet u realizua edicioni i 47 me radhë. Vendi i parë - Alma Haxhiu. Festivalin e përcolli orkestra e AKV "Kastriotët" nën udhëheqjen artistike të Fitim Bytyqit, i cili i kreu edhe aranzhimet. Kryetari i bordit të AKV "Kastriotët", Astrit Mustafa, në fund të mbremjes nderoi me plaketë tre personalitete që kontribuan në ruajtjen dhe kultivimin e muzikës popullore shqipe. Plaketa u ndanë për: Fahri Beqiri – kompozitor; Zeqirja Ballata – kompozitor dhe Fetië Tërstenën - këngëtare.

Takim mortor me rastin e vdekjes së Nazire Krajës

Me rastin e ndarjes nga jeta të aktivistes, pedagoges dhe intelektualet znj. Nazire Kraja, Komuna e Ferizajt organizoi nderim mortor për të ndjerën.

Shfaqje teatrale për të rinj "Home" nga OJQ BRAN

Organizata jovqeveriare "BRAN" e cila merret ekskluzivisht në përkrahje dhe emancipim të komunitetit rom, ashkalinj dhe egjiptas, organizoi një program kulturo-artistik për të rinj. U dha një shfaqje teatrale, si dhe disa pika muzikore.

Program kulturo-artistik për fundvit- Artisti i Vitit

Zakonisht Sektori i Kulturës në një prej mbrëmjeve të fundvitit, organizon një program kulturo-artistik në përfundim të aktiviteteve vjetore, ku publikohen aktivitetet kulturore të realizuara gjatë vitit kalendarik, ndahen mirënjohje e falënderime për të gjitha grupet kulturore që kanë bashkëpunuar gjatë vitit. Kjo natë poashtu konsiderohet shumë e veçantë për shkak se shpallet edhe artisti i vitit. Me një pjesë artistike në këtë program prezantoi Shkolla e Arteve "Çesk Zadeja", ndërsa komisioni për shpalljen e artistit të vitit, pasi shpалosi të nominuarit, publikoi emrin fitues i cili ishte: Agon Qosa- skulptor.

Mbrëmje filmike me Besim Ugzmajlin

Me iniciativën e regjisorit Besim Ugzmajli, u shfaqen katër filmat e tij artistik të shkurtër: "Erë", "The Eaters", "Rruga", dhe "Më fal". Kujtojmë se secili nga këta filma janë shfaqur në shumë festivale prestigjioze ndërkombëtare dhe shpeshherë janë shpërblyer me çmime të rëndësishme. Salla ishte përmbushur plotë me mysafirë e dashamirë të filmit nga Ferizaj e Kosova. Kjo mbrëmje filmike u shoqërua edhe me një ndenjë muzikore, ku performoi rock grupi ferizajas Bystander.

GALERIA E ARTEVE

Galeria e Arteve është institucion qeveritar i kulturës në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Ferizajt. Që nga themelimi i saj (dalja në objektin e ri 2011) kjo galeri është funksionale në vazhdimësi, duke vepruar në kuadër të DKRS-së.

Galeria e Arteve zhvillon aktivitet e kulturore që kanë të bëjnë me artet pamore, duke promovuar vlerat artistike, artistëve të rinj, drejtimeve të reja artistike të artit bashkëkohorë si dhe ngritja e interesimit të qytetarëve mbi artin. Roli i Galerisë është ekspozimi, promovimi, ruajtja dhe konservimi i veprave artistike.

Këtu nuk janë të përfshira të gjitha aktivitetet që janë të zhvilluara në hapësirat e Galerisë së Arteve (grupe kulturore, rinore artistike etj).

Ekspozita tradicionale 17 shkurti-Dita e Pavarësisë, Çmimi "Gursel Sylejmani"

Në çdo përvjetor të Pavarësisë, Galeria e Arteve dhe SHAF “Zef Kolombi” tradicionalisht organizojnë ekspozitën kolektive, ku ndahet çmimi “Gursel Sylejmani”, përkrahur nga DKRS. Morën pjesë 60 autorë nga Kosova, Maqedonia e Shqipëria; Fitues: **Fehmi Hoxha-FEHO**

8 Mars – Ekspozita u organizua nga SHAF “Zef Kolombi” me përkrahje nga DKRS, ku tradicionalisht organizohet për nder të 8 marsit- Ditës së Gruas.

Ekspozita individuale e artistit vizual Dardan Murseli - “Ku janë farat”

Prezantimi i 23 punimeve gjatë të studimeve dhe prezantim i vlerave artistike (art konceptual);

SHAF “Zef Kolombi”- Ferizaj - Zgjedhi kryesinë e re

Më 16 mars u mbajt kuvendi zgjedhor i Shoqatës së Artistëve Figurativ “Zef Kolombi”. Mbledhjen e hapi Pranvera Sylejmani, kryetare e deritanishme e shoqatës. Takimi u përmbyll me fjalën e kryetarit të ri të shoqatës Ilmi Sadiku, me dëshirën dhe vullnetin për suksese të reja.

Ekspozitë kolektive e përbashkët me artistët nga Ferizaj, Shtërpca dhe Klllokoti.

Kjo ekspozitë u zhvillua më 30 mars Novobërd (Artanë). Ky aktivitet u organizua mes Sektorit të Rinisë/Qendrës Rinisë, Galerisë së Arteve dhe Misionit të OSCE.

Ekspozitë nga studentët e UBT-së. Ekspozita e studentëve të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor (UBT) në Ferizaj.

Festivali Ndërkombëtar i Karikaturës nga SHK “HiTHi” Shoqata e Karikaturistëve ‘HiTHi’-Ferizaj
Për Festivalin Ndërkombëtar të Karikaturës, Ferizaj 2019 - Edicioni i Parë që u hap më 10 maj 2019 në ora 19,00 në Galerinë e Arteve në Ferizaj, u paraqitën punime të artistëve nga afro 80 vende të botës.

Koloni Artistike me fëmijë e të rinj në Dubravë

Ekspozitë kolektive tradicionale “Ditët e Kulturës”

Në Galerinë e Arteve në Ferizaj u hap ekspozita tradicionale “Ditët e Kulturës”, e cila ka një historik të gjatë të organizimit. Ekspozita u organizua nga SHAF “Zef Kolombi” dhe Galeria e Arteve – Ferizaj, e përkrahur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Ferizaj. Prezantuan me punime 30 autorë nga Ferizaj; Vizitorë: 800-1000” Fituesi i çmimit ishte Jetullah Sylejmani. Në këtë edicion të kësaj ekspozitë u nda mirënjohje për artistin Emin Hasani.

Aktivitet humanitar në fushën e artit figurativ

Aktivitet i përbashkët mes Sektorit të Rinisë dhe Galerisë së Arteve, dhe punën e mrekullueshme të të rinjve të talentuar në fushën e artit figurativ. Të rinjtë të talentuar në fushën e artit figurativ të bashkangjiten tek Biblioteka e Qytetit "Sadik Tafarshiku" në koloninë një ditore e cila është me karakter humanitar.

“Ditët e Mërgatës” 2019 – Kolonia artistike – Kjo koloni u mbajt me artistë të vendit dhe mërgata. Organizimin e bëri Galeria e Arteve në bashkëpunim me SHAF "Zef Kolombi", në përkrahje nga DKRS-Ferizaj. Morën pjesë 20 autorë nga Ferizaj, Prishtina, Gjlani, Vitia, Bujanoci, Kumanova, Tetova, Franca etj.

Ekspozita një javore – E organizuar nga CEL në projektin “Ngjyra ngjyra”.

“Superheronjtë” - Aktivitete edhe nga organizata Rin-on

Ekspozita kolektive e nxënëve të gjimnazit- skulptura urbane, e përkrahu Galeria e Arteve.

Bienali i Vizatimit – Edicioni i IV-të

Në Galerinë e Arteve u hap ekspozita e Bienalit të Vizatimit, organizuar nga: Galeria e Arteve & Shoqatën e Artistëve Figurativ “Zef Kolombi”. Pjesëmarrës me punime ishin artistët nga Maqedonia dhe Shqipëria, si dhe nga Greqia e Gjermania. Kurator ishte Jetullah Sylejmani. Juria profesionale zgjodhi punimin më të mirë të artistit Vehbi Murati.

Vizitat në Galeri

Zakonisht përveç vizitorëve në ceremonitë e hapjeve të ekspozitave, Galeria e Arteve pranon vizitorë të ndryshëm edhe gjatë ditëve tjera të vitit. Kryesisht janë bërë të rëndomtë grupet e organizuara nga shkollat e ndryshme nga parashkollor, shkollat e mesme deri te Universiteti i Ferizajt, pastaj shoqata, organizata, grupe, kulturore dhe lëmvive tjera, individë të ndryshëm etj.

Të gjithë ata që vijnë të vizitojnë Muzeun e Qytetit, si zakonisht vizitojnë edhe galerinë, repsektivisht njërin prej ekspozitave që është aktuale.

Këtë vit ishte një numër rekord i vizitorëve, duke e marrë parasysh edhe në bazë të ngjarjeve të organizuara nga Galeria e Arteve dhe nga Qendra e Kulturës dhe jashtë saj.

Galeria e Arteve, si hapësirë e përshtatshme është shfrytëzuar edhe për shumë aktivitete tjera, letrare muzikore dhe forma tjera artistike, që kanë ardhur si organizime të pavarura ose jo të organizuara nga Galeria.

ZYRA PËR TRASHËGIMI E MUZE

Muzeu është institucion i cili e ruan, promovon dhe prezanton trashëgiminë kulturore të trevës së Ferizajt, Që nga viti 2011, kur Muzeu i Qytetit filloi të funksionoj zyrtarisht në hapësirën e re, ka grumbulluar qindra eksponate që janë dhuruar nga qytetarët e Ferizajt.

Tani Muzeu i Qytetit vizitohet nga qindra e mijëra vizitorë gjatë gjithë vitit, duke filluar nga nxënës të shkollat fillore e mesme, studentë, universitarë, ndërkombëtarë, qytetarë të rëndomtë etj. Gjatë vitit kjo zyre, bashkë me Sektorin e Kulturës, promovojnë një fushatë sensibilizuese nëpërmes rrjeteve sociale, takimeve, aktiviteteve dhe organizimeve të ndryshme.

Njësia për Trashëgimi e Muze, iu kushton rëndësi të veçantë dy datëve të rëndësishme të kësaj natyre, duke i shënuar me aktivitete specifike, të cilat janë:

18 Prilli- Dita Botërore e Trashëgimisë; dhe

18 Maji – Dita Ndërkombëtare e Muzeve

Poashtu kjo njësi kontribon me aktivitetet e saja edhe në manifestime të ndryshme që organizon drejtoria, si: Ditët e Kulturës, Dita e Çlirimit, Ditët e Diapsorës, etj.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Muzeve **18 maj**, u mbajt një ligjëratë për trashëgiminë kulturore të trevës së Ferizajt me nxënësit e Gjimnazit "Kuvendi i Arbërit". Dy ditë më vonë është mbajtur një takim konsultativ në Gjakovë, me temën "Roli i Muzeve Lokal të Kosovës". ku prezentuan përfaqësues të muzeve regjionale.

Gjatë këtij viti, kjo njësi ka organizuar aktivitete promovuese e sensibilizuese, si: takime pune, vizita studimore, ka pritur shumë vizitorë vendor e ndërkombëtarë, etj.

Vizita studimore: Vizitë në fshatrat Jezerc dhe Nerodime; Prezantimi dhe gjendja e Trashëgimisë kulturore të mullinjve në trevën e Nerodimes; Evidentim të monumenteve dhe lokaliteteve; Vizitë në Zaskok në lokalitetin e njohur "Varret e Rimit" etj.

Vizitorë:

Grupi i Korpusit të Paqes SHBA (Peace Corps Team);

Artistë ndërkombëtarë, pjesëmarrës në Festivalin "FerFilm";

Bashkëatdhetarë nga Franca

Nxënësit e SHFMU fshatit Prelez i Jerlive,

Nxënësit e SHFMU "Mejdi Xhaferi" prej fshatit Mirosalë,

Nxënësit e SHFMU "4 Prilli "prej fshatit Zllatar,

Nxënësit e e SHFMU "Bilall Shala" prej fshatit Loshkobare,

Nxënësit e SHFMU "Dëshmorët e Kombit" nga fshati Koshare.

nxënësve të paralelës 10/3 e gjimnazit "Kuvendi i Arbrit" Ferizaj.

Nxënësit e SHFMU "Halit Ibishi" nga fshati Cërnmillë.

Nxënësit e ciklit të ulët të SHFMU "Dy Dëshmorët" nga fshati Talinovc i Muhaxhirëve.

Nxënësit e e SHFMU "Visar Dodani" nga fshati Varosh.

Nxënësit e e ciklit ulët të SHFMU "Ahmet Hoxha"

Nxënësit e ciklit parashkollor të SHFMU "Rizah Matoshi" nga Ferizaj;

Nxënësit dhe personeli i SHFMU "Konstandin Kristoforidhi" - Nerodime.

Vizitë nga fëmijët e kopshtit "Ardhmëria" nga Ferizaj;

Nxënësit e SHFMU "Dëshmorët e Lirisë" nga fshati Manastirc.

Nxënësit e paraleleve të klasave të dhjeta të gjimnazit "Kuvendi i Arbrit" - Ferizaj

Kollexhi privat "Agaxhite" Ferizaj.

Përfaqësues të Ambasadës Amerikane,

Bashkëatdhetarë që jetojnë dhe punojnë në Zvicër

Përfaqësuesit e MKRS-së vizitë Muzeut të Qytetit, vende turistike, trashëgimisë kulturore etj.

Dhurim i eksponatave:

Eksponate të dhuruara nga fshati Rahovicë

Eksponate arkeologjike nga Fshati Jezerc me karakter etnologjik dhe me vlera hstorike;

Artefakteve e dhuruesve në fondin etnologjik

Dhurimi eksponatëve nga fshatrat Pleshine dhe Dremjak.

Prezantim në media:

Prezantim i vlerave arkeologjike në fshatit Varosh;

Trashëgimia kulturore e fshatit Komogllavë;

Prezantimi i Trashëgimisë Kulturore dhe Muzeut në programin e mëngjesit në RTK;

107 vjetori i pushtimit serb të Ferizajt,

Trashëgimia Kulturore e fshatit Zaskok, përshkrim lokalitetit Tuma- Gur i cili tregon për një trashëgimi të pasur arkeologjike që posedon treva e Ferizajt;

Prezantimi i një pjesë të historisë kombëtare: “Rrethanat historike deri te fillimi Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912 dhe fillimi i Luftës së Parë Ballkanike”

Prezantimi i Trashëgimisë Kulturore të Ferizajt- Fshati Jezerc në RTK;
Kisha e Nikadinit në periudhën paleokristiane në territorin e Dardanisë dhe

Trashëgimia kulturore dhe arkeologjike e të fshatit Greme.

Ekspozita:

- *Ekspozitë me fotografi* – Me rastin e 7 marsit - Ditës së Mësuesit, në bashkëpunim me Bibliotekën e Qytetit, si prezantim i zanafillës së arsimit shqip në Komunën e Ferizajt;
- *Ekspozitë me fotografi* - 20 vjetori- Dita e Çlirimit, fotografi dhe dokumente që ndërlidheshin me ngjarjet historike të luftës së Kosovës, vitet 1998-99, foto të ushtarëve të UÇK-së, demët materiale të bëra nga shteti serb, foto nga aleatët e NATO-s.
- Ekspozitë me fotografi prezantim i trashëgimisë kulturore në fotografi. Ekspozita u mbajt ë kuadër të manifestimit “Ditë e Diasporës” në Bulevardin e Qytetit para Bibliotekës.

Pas renovimit të fundit të muzeut, u bë e mundur që të krijohet një hapësirë më adekuate për aranzhimin e ekspozateve dhe prezantimit të vlerave tona historike.

Zyra për Trashëgimi e Muze, vazhdon të luaj një rol shumë të rëndësishëm në prezantim të trashëgimisë sonë dhe vlerave tona kombëtare e turistike.

TEATRI I QYTETIT

Teatri Profesional “Adriana Abdullahu” në bashkëpunim të mirë me strukturat komunale, gjegjësisht D.K.R.S-në dhe Këshillin Drejtues të Teatrit, arriti që t’i realizoj pesë (5) premiera teatrore si dhe organizoj “Festivalin Mbarëkombëtar të Teatrove”- Edicionin e 49-të.

I. Premierat:

1. Shfaqja” Hanibali i nëntokës”Hristo Boytchev, regjia: Fatlum Haziri
2. Shfaqja” Kopraci” Molieri, regji: Elmaze Nura
3. Shfaqja “UN Inspektori” David Farr, regjia: Erson Zymberi
4. Shfaqja “ Nata e Gretës” Ingmar Villqist, regjia: Ben Apolloni
5. Shfaqja “Derisa vdekja nuk na ndanë” Nina Horvat, regjia: Fatos Berisha

II. Repertori i shfaqjeve në këtë periudhë:

44 repriza të shfaqjeve, ku përfshihen edhe shfaqjet mysafire

5 shfaqje janë anuluar

7 shfaqje në edicionin e 49 të Festivalit

Gjithsej: 51 shfaqje

III. Pjesëmarrja në Festivale e Teatrit “Adriana”

1. Shfaqja “Kur hana del” në Festivalin mbarëkombëtar “Talia e Flakës “-Gjilan
2. Shfaqja “Kopraci” në Festivalin mbarëkombëtar në Dibër-Maqedoni e Veriut
3. Shfaqja “Kopraci” në Festivalin e Teatrit Bashkëkohor në Kajro-Egjipt
- 4.
5. Shfaqja “UN Inspektori” në Festivalin e komedisë “Ditët e komedisë” –Preshevë
6. Shfaqja “UN Inspektori” në Festivalin e Teatrove në Ferizaj-Edicioni 49
7. Shfaqja “UN Inspektori” në Festivalin ndërkombëtar “Shou Case “në Prishtinë
8. Shfaqja “Kopraci” në Festivalin revial në Viti

Prezantimi i teatrit në nivel ndërkombëtar:

4. Shfaqja “Verteri” Gëte, në Teatrin e Ludvigsahfenit –Gjermani
5. Shfaqja “Koprraci” në Kajro-Egjipt

IV. Çmimet e fituara nga Festalet:

- ✓ Shfaqja “Kopraci”, shfaqja më e votuar online e huaja në Festivalin ndërkombëtar të Teatrit Bashkëkohor dhe eksperimental në Kajro-Egjipt
- ✓ Shfaqja “Kopraci”, regjia më e mirë në Festivalin mbarëkombëtar në Dibër
- ✓ Shfaqja “UN Inspektori”, Aktori më i mirë në Festivalin e Komedisë në Preshevë
- ✓ Shfaqja “UN Inspektori”, Aktorja dytësore më e mirë në Festivalin e Komedisë në Preshevë
- ✓ Shfaqja “UN Inspektori”, shfaqja më e mirë në Festivalin e teatrove në Ferizaj
- ✓ Shfaqja “UN Inspektori”, roli më i mirë episodik në Festivalin e teatrove në Ferizaj
- ✓

V. Shfaqjet mysafire: 16 shfaqje mysafire, duke përfshirë edhe Festivalin

VI. Shikueshmëria e shfaqjeve: Numri i përafërt pasi që ka pasur të ftuar gjatë premierave dhe gjatë Festivalit, mirëpo mendohet se shikueshmëria e shfaqjeve në total ka qenë afro **5016** shikues.

VII. Festivali i Teatrove Edicioni 49

Programi i Festivalit:

1. Teatri “Hadi Shehu”–Gjakovë, me shfaqjen “Shumë zhurmë për asgjë” Shakespeare, regjia: Zana Hoxha
2. Teatri Tetovës “Një letër e humbur” J.L. Karaxhale, regjia: Kushtrim Bekteshi
3. Teatri “Migjeni”–Shkodër, me shfaqjen “Zona e Pritjes” M. Vujçiç, regjia: Fatos Berisha
4. Teatri “Adriana”-Ferizaj, me shfaqjen “UN Inspektori” David Farr, regjia: Erson Zymberi
5. Teatri Qytetit të Gjilanit, me shfaqjen “Erdh Godoja” D. Cruson, regjia: Shkelzen Berisha
6. Teatri i Podujeves & Instituti për vetëdijesimin bashkëkohor, me shfaqjen “Ditë Vere” Mrozhek, regjia: Naser Shatrolli
7. ArtPolis-Prishtinë, me shfaqjen “Kanuni i Gruas”, regjia: Arlinda Morina

Shpërblimet e Festivalit:

1. Shfaqja më e mirë “UN Inspektori “Teatri “Adriana” dhe “Zona e pritjes” Teatri “Migjeni”-Shkodër
2. Regjia më e mirë –Kushtrim Bekteshi me shfaqjen “Një letër e humbur”
3. Aktori më i mirë (Çmimi Ismail Rama), Arsim Fazliu –Teatri i Tetovës
4. Aktorja më e mirë (Çmimi Adriana), Vjollcë Bekteshi-Teatri i Tetovës
5. Roli dytësor më i mirë (F), Vlora Pylla-Teatri “Hadi Shehu” -Gjakovë
6. Roli dytësor më i mirë (M), Simon Shkreli-Teatri “Migjeni”-Shkodër
7. Roli më i mirë episodik, Urata Shabani-Teatri “Adriana”-Ferizaj
8. Skenografia më e mirë, Betrim Zeqiri-Teatri i Tetovës
9. Kostumografia më e mirë, Alma Krasniqi-Teatri “Hadi Shehu” -Gjakovë
10. Shpërblimi i Gazetarëve (Çmimi Hafir Bislimi), Shfaqja “Erdh Godoja”-Teatri i Gjilanit

Shkurtimisht për programet tjera në Teatër

Programe të tjera të mbajtura në sallën e teatrit janë afro 100, me një shikueshmerri prej afro **15.700** shikuesve. Orët jashtë orarit të rregull janë: 529, duke mos i llogaritur orët e provave të shfaqjeve jashtë orarit.

I. Buxheti dhe raporti i shpenzimeve

(Shih te Raporti i zgjeruar i DKRS-së 2019 dhe tek Raporti i Drejtorisë së Financave)

Vërejtje: Duam të rikujtojmë se në raportin e Sektorit të Kulturës (kultura, galeria, muzeu dhe teatri) nuk janë përfshirë edhe shumë aktivitete kulturore e rinore të pavaruara që janë organizuar në objektet institucionale apo hapësirat tjera.

Raporti përmban aktivitetet më të rëndësishme të organizuar nga Sektori i Kulturës- DKRS- Ferizaj. Poashtu në raport nuk janë të përfshira edhe punët dhe aktivitetet e rëndomta që mbahen në këtë Sektor (provat, takimet, mbledhjet, vizitat etj). Një version i këtij raporti gjendet në arkivin e DKRS-s, me një format më të zgjeruar dhe ilustruar me fotografi të aktivitetëve.

SEKTORI I RINISË

Në fillimvit janë shpërndarë certifikatat (mirënjohje) për vullnetarët dhe aktivistat e Sektorit të Rinisë në një ceremoni të organizuar në hapësirat e sallës Kuvendit të Komunës për kontributin e tyre vullnetare gjatë vitit 2018 në fushën e shërbimeve sociale, edukim jo-formal, aktivizëm rinor dhe pjesëmarrje aktive të të rinjve në jetën publike.

Pastaj janë hapur format e aplikimit për trajnimet në fushën e aftësive të buta për Komunitet: Shtërpçë, Kaçanik, Viti në kuadër të projektit “One for All” mbështetur nga Qeveria Gjermane-GIZ programi Yes (Rinia, Punësimi dhe Aftësimi Profesional) ndërsa përfshirja e Komunave të lartcekura ka ardhur si rezultat i një pune dhe angazhimi mes Sektorit të Rinisë, programit Yes-GIZ dhe komunave: Gjakovë, Mitrovicë, Vushtrri ku programi në fjalë ka pasur shtrirje që nga fillimet si projekt pilot.

Promovimi i projektit “One for All”

Faza e dytë e shtrirjes së projektit ishte promovimi në Shkollave të Mesme të Larta në Komunitet Ferizaj, Shtërpçë, Viti, Kaçanik për mes Zyrave të Punësimit, Qendrave Rinore, Këshillave të Veprimit Rinor Lokal, Sektorit të Rinisë dhe Drejtorive të Kulturës, Rinisë dhe Sportit në komunitet e lartcekura shoqërisë civile dhe organizatave të cilat e mbulojnë aftësinë e kufizuar në Komunitet ku projekti ka pasur shtrirje.

Janë shpërndarë mbi 100 broshura dhe formës së sponzorizimit në faqen e facebook-ut të Sektorit të Rinisë dhe paraqitjeve mediale në mediat lokale dhe nacionale. Pastaj është hapur konkursi për praktikant/e ka qenë i hapur më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe pas përfundimit komisioni në përbërje të tre antarëve, një zyrtar nga Zyra e Punësimit, një përfaqësuesi të shoqërisë civile dhe një përfaqësuesi nga projekti “One for All” ka zgjedhur praktikant/e në kohëzgjatje prej gjashtë muaj.

Trajnimi në fushën e gastronomisë (kuzhinë) -Komuna Ferizaj

Në koordinim edhe me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Zyrën Regjionale të Punësimit në Ferizaj, Qendrën e Aftësimit Profesional kemi hapur aplikacionin për trajnimin e fushës së gastronomisë ku nga ky trajnim kanë përfituar 30 (tridhjetë) pjesëmarrës punëkërkues nga Komunitet: Ferizaj, Viti, Kaçanik dhe Komuna e Shtërpçës. Trajnimi ka zgjatur tre muaj dhe në fund pjesëmarrësit janë pajisur me çertifikata të Aftësimit Profesional të cilat çertifikata njihen edhe në vendet e Europës.

Trajnimi në fushën e IT- Komuna Ferizaj

Trajnimi në fushën e IT ka zgjatur për 5 (pesë) ditë me radhë dhe është zhvilluar në kabinetin e Shkollës së Mesme të Lartë të Kompetencës, në të cilën trajnimet janë zhvilluar me modulet nga programet e fundit në fushën e teknologjisë dhe infomacionit.

Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin gjithsej 16 (gjashtëmbdhjetë) të rinj student nga Universitetet Publike dhe Private dhe nga Shkollat Profesionale, ndërsa me përfundimin e trajnimit këta të rinj u çertifikuan.

Trajnimi në fushën e fotografisë -Komuna e Ferizajt

Pas mbylljes së aplikacionit i cili ka qëndruar i hapur më shumë se 15 (pesëmbdhjetë) ditë i hapur në faqen zyrtare të Sektorit të Rinisë/Qendra e Rinisë, komisioni vlerësues në përbërje të një zyrtari nga zyra e punësimit, trajneri dhe përfaqësuesit të shoqërisë civile, ka përzgjedhur gjithsej 16 (gjashtëmbdhjetë) të rinj të grupmoshës 15-24 vjeç.

Trajnimi u zhvilluar nga ana e regjisorit të njohur ferizajas z. Besim Ugzmajli dhe pas përfundimit u ndan çertifikata me modulet e zhvilluara.

Promovimi i Panairit Regjional të Punës 2019 - Ferizaj

Nga ana e vullnetarëve dhe aktivistëve të Sektorit të Rinisë janë shpërndarë në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe gjithsej 100 postera dhe 150 broshura në hapësirat e institucioneve në Komunën e Ferizajt, Kaçanik, Shtërpçë, Hani Elezit, Shtime dhe në hapësirat ku frekuentohen nga ana e të rinjve dhe punëkërkesve.

Trajnimet në fushën e aftësive të buta- Komuna Ferizaj

Me qëllim të aftësimit të të rinjve nga shkollat e mesme dhe punëkërkesve nga komunat e Regjionit të Ferizajt janë zhvilluar trajnime në fushën e aftësive të buta (soft skills) në modulën e CV-së dhe letrës motivuese me qëllim ngritjen e aftësive të këtyre të rinjve dhe përgatitjen për Panairin e Punës.

Trajnimet në fushën e aftësive të buta janë zhvilluar në Komunën e Ferizajt në hapësirat e Univeritetit të Shkencave të Aplikuara, në Qendrën e Karrierës dhe në Qendrën Sociale Edukative “CARITAS KOSOVA”, Dubravë-Ferizaj ku përfitues ishin 100 (njëqind) të rinj pjesëmarrës. Pastaj ka vazhduar në Komunën e Shtimes, Hanit të Elezit etj.

Organizimi i klasës fillestare për mësimin e gjuhës angleze

Në bashkëpunim me njësitin e LMT-së KFOR-i Amerikan Kampi Bondstill për më shumë se 10 (dhjetë) vite vazhdojmë të organizojmë klasën fillestare për mësimin e gjuhës angleze me qëllim ngritjen e njohurive dhe praktikimit të gjuhës për nxënësit e shkollave të Mesme të Ulëta dhe të Larta të Komunës së Ferizajt dhe nga ky organizim i klasës jo-formale vazhdojnë të përfitojnë një numër i madh i nxënësve.

Trajnimi në fushën e aftësive të buta (Soft Skilles)- Komuna Ferizaj

Pas hapjes së aplikacionit për aplikim për pjesëmarrje në trajnimin e shkathësive të buta për të rinjtë e grup moshave 15-35 vjeç komisioni vlerësues ka përzgjedhur sipas kriterëve 25(njëzet e pesë) të rinj nga grupet e të rinjëve që nuk kanë pas qasje në trajnimet e mëhershme dhe grupet e të rinjve nga zonat e thella nga Komuna e Ferizajt. Trajnim në fushën e aftësive të buta ka zgjatur gjithsej 5 (pesë) ditë ndërsa pas përfundimit të trajnimit të rinjve u janë ndarë çertifikata me përshkrimin e moduleve të zhvilluar nga ana e trajnerit.

Panairi i karrieres ofertës dhe kërkesës

Në bashkëpunim me bizneset dhe Qendrën e Aftësimit Profesional në Ferizaj kemi organizuar Panairin e Karrierës, ofertës dhe kërkesës me qëllim promovimin e punës dhe aktivitetit të pjesëmarrësve të trajnimit në fushën e gastronomisë, pas përfundimit të aktivitetit mbi 7 (shtatë) pjesëmarrës të çertifikuar ju propozuan oferta pune nga bizneset e fushës së gastronomisë (kuzhinë).

Java e KFOR-it

Për 5 (pesë) ditë me radhë janë zhvilluar aktivitete rinore, kulturore dhe sportive, ora letrare në bashkëpunim me njësitin e LMT-së KFOR-i amerikan dhe me pjesëmarrjen e një numri të madh të të rinjve nga shkollat e mesme të ulëta dhe të larta.

Ecje në natyrë-HIKING.

Në bashkëpunim me personat profesional (guidat) që e duan dhe njohin natyrën nga Komuna e Hanit të Elezit kemi organizuar ecjen në natyrë (hiking) tek maja dhe Liqeni i Konjushës në lartësi mbidetare 2422m me pjesëmarrjen e mbi 60 (gjashtëdhjetë) të rinjëve dhe të rejave, ushtarëve amerikan dhe anëtarë të shoqatave nga Komunitat e Regjionit të Kosovës. Natyrisht pjesë e ecjes ishte edhe stafi mjekësor nga institucioni i Mjekësisë Familjare dhe stafi mjekësor i KFOR-it amerikan njësitin LMT-së.

Realizimi i projektit “Promovimi dhe informimi i të rinjve për aktivitetet joformale”

Me mbështetjen e Organizatës IOM janë realizuar aktivitete në 5 (pesë) Shkollat e Mesme të Ulëta të Komunës tonë, ndërsa shkollat e përfshira janë Shkolla e Mesme e Ulët “Jeta e Re” fshati Greme, Shkolla

e Mesme e Ulët “Skënderbeu” fshati Jezerc, Shkolla e Mesme e Ulët “Bilall Shala” fshati Lloshkobare, Shkolla e Mesme e Ulët “Ahmet Hoxha” Ferizaj, dhe Shkolla e Mesme e Ulët “Jeronim De Rada” Ferizaj. Përfshirja e këtyre shkollave përmes aktiviteteve joformale kishte për qëllim nxitjen e të rinjve dhe nxënësve për pjesëmarrje në aktivitete rinore në kuadër të Sektorit të Rinisë.

Hapja e konkursit për trajner/e në fushën e IT-së dhe Ndërmarrësi

Me qëllim organizimin e trajnimit në fushën e IT-së dhe Ndërmarrësi të mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Organizata DVV-Internacional implementuar nga Sektori i Rinisë është hapur konkursi për përzgjedhjen e trajnerit apo trajneres me qëllim realizimin e trajnimit dhe zhvillimin e moduleve.

SEKTORI I SPORTIT

Në raportin vjetor, fillimisht po japim gjeneralet e klubeve sportive të vitit 2019, ku janë të përfshirë **51 klube sportive** dhe **4 shoqata sportive**, të organizuar deri diku mirë në zhvillimin e sportit në Komunën e Ferizajt. Aktivitetin e vet e zhvillojnë në një hapsirë sportive prej **43,421 m²**.

Në të gjitha klubet sportive janë të përfshira në të dy gjinitë me të gjitha grupmoshat duke u përfshirë nga grupmosha U7 deri tek seniorët, çka do të thotë se në komunën tonë kemi diku rreth **3,150 sportistë aktiv** dhe diku rreth **6,500 sportistë** rekreativ. Tek sportistët rekreativ janë të përfshirë edhe sportistët e garave shkollore dhe grupimet e sportit të futbollit, çiklizmit, alpinizmit, motoristët, notuesit, atletët dhe shumë grupe të tjera që zhvillojnë sportin rekreativ.

Të gjitha këto shënime janë shumë të përafërta me zhvillimin e aktiviteteve, po sikur klubet sportive të jenë më të përpikta në administratën sportive të klubeve gjegjëse, atëherë ne do të nxerrim numri shumë të saktë të të gjitha aktiviteteve sportive për Komunën e Ferizajt. Në tabelën e mëposhtme kemi të shënuar çdo klub veç e veç dhe të gjitha aktivitetet që ka zhvilluar për vitin 2019.

KLUBET SPORTIVE DHE AKTIVITETET E TYRE

KH “Kastrioti” M (seniorët)

Ka zhvilluar 321 orë stërvitje ekonomike, duke përfshirë lojë kampionale, miqësore, për kupë, stërvitje, etj. Është ekip në superligë, i organizuar mjaft mirë me gjitha grupë moshat, i rreshtuar në krye të tabelës dhe kampion i stinorit, si dhe dy ndeshje të fituara në garat e Kupës së Europës.

KH “Kastrioti” F (senioret) - Ka zhvilluar 293 orë stërvitje ekonomike, është në superligë në mesin e tabelës, i organizuar mjaft mirë me gjitha kategoritë dhe pjesëmarrës në garat europiane.

KH “Ferizaj” F (senioret)- Ka zhvilluar 192 orë stërvitje ekonomike, ka hyrë në superligë. është i organizuar mjaft mirë me të gjitha kategoritë, i rreshtuar në krye të tabelës.

KBas. “Kastrioti” (M) - Është aktiv por dobët. gjendet në mesin e tabelës.

KBas. “Kastrioti” (F) Ka zhvilluar 192 orë stërvitje ekonomike, është në superligë, në krye të tabelës, i organizuar mjaft mirë me të gjitha kategoritë.

KV “Kastrioti” F - Ka zhvilluar 120 orë stërvitje ekonomike, është në superligë. Aktualisht gjendet në krye të tabelës dhe është fitues i disa kupave ballkanike në Beachvolley.

KV “Lybeteni” M - Ka zhvilluar 108 orë stërvitje ekonomike, është në superligë. Është kampion i ligës dhe fitues i Kupës së Kosovës, Kupës Gjithëkombëtare, Kupës “Adem Jashari” si dhe pjesëmarrës në garat ndërkombëtare.

KV “Ferizaj” M (seniorët) -Ka zhvilluar 108 orë stërvitje ekonomike, është në superligë, kampion i ligës së parë dhe në krye të tabelës.

KVF “Ferizaj” Ka zhvilluar 94 orë stërvitje ekonomike, në superligë në mesin e tabelës.

K.Box. “Kastrioti” M (seniorët)-Ka zhvilluar 312 orë, fitues i disa medaljeve dhe kupave në garat kampionale të Kosovës dhe turne të jashtëm.

KXh “Kastrioti” MF - Ka zhvilluar 134 orë stërvitje ekonomike është klub i sukseshëm me grupmosha të reja, ka sjellur medalje dhe është pjesëmarrës në disa gara ndërkombëtare.

KM “Kastrioti” MF - Nuk është aktiv, por pritet që këtë vit të rifilloj.

KQ “Kastrioti” MF - Kampion i vitit, fitues i shumë medaljeve e kupave në Kosovë dhe jashtë.

SHPKF dhe Sportit Shkollor- fitues i shumë kupave e medaljeve gara shkollore- Kosovë.

KPP “Ahmet Hoxha” MF (veteranët) -Ka zhvilluar 124 orë kampionale. Është në superligë në vendin e tretë të tabelës, fitues i disa medaljeve dhe kupave kombëtare e ndërkombëtare.

K Kik Box.”Ferizaj” M (seniorët) Ka zhvilluar 202 orë, është i sukseshëm dhe fitues i disa medaljeve.

K Kik Box.”Kastrioti” M (seniorët) Ka zhvilluar 202 orë, fitues i disa medaljeve.

KF “Ferizaj” M (seniorët) Ka zhvilluar 172 orë ekonomike. Është në superligë, në fund të tabelës, por i organizuar mjaft mirë me të gjitha grupëmoshat e reja.

KF “Tefik Çanga” M (seniorët)- Ka zhvilluar 82 orë, Liga e dytë, i rreshtuar në fund të tabelës.

KF “Vizioni “ F (seniorët) Ka zhvilluar 108 orë stërvitje ekonomike etj. Në superligë. i organizuar mjaft mirë dhe pjesëmarrës i shumë turneve.

KF “ÇELIKU“ M (seniorët) Ka zhvilluar 37 orë ekonomike është në Ligën e dytë me suksese të mesme. Në stinorin pranveror ishte në mes të tabelës, kurse në stinorin vjeshtor është pasiv.

KF “Kastrioti“ M (seniorët) Ka zhvilluar 74 orë. Liga e dytë, i organizuar mjaft mirë.

KF “Dinamo” (kadetët, fatosat, pioner) Ka zhvilluar 22 orë.

KF Ardhmeria” (kadetët, pioner) Ka zhvilluar 74 orë.

KF “Varoshi” futsal - Ka zhvilluar 74 orë.

KF “Ferizaj ” (Veteranët) Ka zhvilluar 15 orë.

KN “Kastrioti” (seniorët) Ka zhvilluar 156 orë. Në superligë, është i organizuar mjaft mirë, me tituj dhe pjesëmarrje në shumë gara kombëtare.

KN “Ferizaj” - Ka zhvilluar 106 orë. Në superligë, i organizuar mjaft mirë, me tituj dhe pjesëmarrje në shumë gara kombëtare.

K Gj. “Ferizaj” - I organizuar mjaft mirë , fitues i shumë medaljeve në vend edhe pjesëmarrës në turne ndërkombëtare.

Klubet e Karates KK “Kastrioti”, KK “Sharri” dhe KK “Fituesi”

Të gjitha të organizuara mjaft mirë, me pjesëmarrje në garat kombëtare e ndërkombëtare.

Duke sjellur shumë kupa dhe medalje, Ferizaj për karate mbetet favorit në Kosovë.

K. Aer. “Kastrioti” MF - I mirë organizuar në garat regjionale e republikane, fitues i disa medaljeve.

Shoqatat e Bjeshkatarisë “Sharri-Lybeten” dhe Peshkatarëve “Lepenci”

Dy shoqata që janë të organizuara shumë mirë dhe kanë sjellë shumë medalje e kupa nga të gjitha grupmoshat, por veçohen bjeshkatarët të cilët kanë suksese kulmore në vend e jashtë vendit.

K Bodybuildingut. “Kastrioti” dhe “Roni” - Kanë rezultate të mira si në Kosovë ashtu edhe jashtë Kosovës.

TURNIRE DHE AKTIVITETE TË LIRA SPORTIVE

Turnir në voleyboll për “Ditët e Diasporës”

Panairi i klubeve sportive në Komunën e Ferizajt

Turnir i Streetballit në Sheshin e Qytetit
Stërvitje Kombëtarja e Kosovës në volejboll U-17 femrat 36 orë

Futsal -Shoqata e Pedagogëve gara shkollore

Lojë miqësore - KH Kastrioti (veteranët)

Aktivitete sportive: basketboll e volejboll - Java e KFOR-it

Ushtrime valltaret Shamikuqet

Gara në volejboll- Policia e Kosovës

Vrapim në krosin e organizuar për Ditën Olimpikë

Aktivitete nga grupi i të rinjve Act Noë- lojëra e dhurata për fëmijë

Kampionati ballkanik në volejboll

Stërvitje Kombëtarja e Kosovës U-18 volejboll me 3 orë

Turnir i institucioneve në volejboll - Kupa “Ismet Ramadani” -23 tetor

Gara në basketboll- organizuar nga Sporti Shkollor

Turnir mbarëkombëtar në futsal – Morën pjesë 32 ekipe nga Kosova e Maqedonia e Veriut. Gjatë 14 ditëve janë zhvilluar 65 ndeshje, më 30 dhjetor është zhvilluar finalja e këtij turniri.

Loja kualifikuese ndërkombëtare: **Kv Luboteni – Kv Maliye Milli Piyango Ankara** -11 dhjetor

Gjysëmfinalja dhe finalja për femra dhe meshkuj në volejboll e organizuar nga FVK-14 dhjetor.

AKTIVITETE TË TJERA ME KARAKTER PUNE:

Spektori i Sportit bashkë me stafin e tij, gjatë gjithë vitit është në shërbim të klubeve dhe shoqatave sportive, duke filluar nga mirëmbajtja dhe përgatitja palestrës dhe stadiumit në gatishmëri për stërvitjeve e garave kampionale, dhe përcjellja e tyre ku ishte e nevojshme; pastaj përpilimi i orarit të stërvitjeve, kujdesi gjatë garave.

Spektori i Sportit poashtu bën përkujdesje teknike në organizime të tjera që planifikon DKRS, sidomos në manifestimet kulturore “Ditët e Kulturës”, “Ditët e Diasporës”, koncertet masive në palestër dhe në sheshin e qytetit, pastaj tubime të ndryshme të natyrave të tjera politike, humanitare, fetare etj. Poashtu ky sektor bashkangjitet edhe në aktivitete të përbashkëta që organizon Spektori i Rinisë dhe ai i Kulturës, në turnire të përbashkëta apo manifestime të tjera.

SEKTORI I BIBLIOTEKAVE

Gjatë vitit 2019 në sektorin për fëmijë u anëtarësuan 1,623 lexues me 18,917 libra të lexuara. Në sektorin për të rritur u anëtarësuan 1,467 lexues me 9,422 libra të lexuara.

Gjithsej: 3,090 lexues \ Gjithsej libra të lexuara: 28,339

Në sektorin e pasurimit dhe të përpunimit janë pranuar 1,900 ekzemplarë, tituj të blerë 803 me 1,458 ekzemplarë, tituj të dhuruar 266 me 443 ekzemplarë të dhuruar.

Gjithsej: 886 tituj \ Gjithsej ekzemplarë: 1,439

Në sallën e leximit kanë frekuentuar 15,533 lexues kurse në sallën e informatikës 2,509 lexues.

Në degën e fshatit Neredime: janë anëtarësuar: 298 lexues me 1,108 libra të lexuara.

Në degën e fshatit Komogllavë janë anëtarësuar: 268 lexues me 806 libra të lexuara.

Në degën e fshatit Talinoc i Muhaxherëve janë anëtarësuar 192 lexues me 1,292 libra të lexuara.

Në degën e fshatit Dardani janë anëtarësuar 165 lexues me 514 libra të lexuara.

Libra të lexuara: Gjithsejt: 923 lexues / Libra të lexuara: 3,720

Vlenë të ceket se Biblioteka nuk i ka marr gazetat ditore që nga fundi i vitit 2017.

MKRS-ja këtë vit ka përkrahur bibliotekën tonë me dy projekte: "Pasurimi i fondit librar" si dhe "Ligjërata dhe aktivitete një javore për fëmijët e komuniteteve minoritare"

Aktivitetet të lira

Edhe Biblioteka e Ferizajt pjesë e projektit "Qytetari digjital" i financuar nga Instituti për Zhvillimin dhe Inovacionin e Rinisë me qendër në Zagreb në bashkëpunim me fondacionin "BONEVET" në Prishtinë. Për këtë projekt u trajnuan punëtorët Hyrije Rexhepi dhe Avni Sadiku.

Drejtori i Bibliotekës Kombëtare "Pjetër Bogdani" Fazli Gajraku, e vizitoi bibliotekën dhe u njoftua për së afërmi me punën profesionale që bëhet në Bibliotekë.

Me përkrahjen e Ministrisë së Kulturës, biblioteka hapi konkursin letrar për poezi kushtuar Gjergj Kastriotit Skënderbeu. Fitues i çmimit "Robert Elsie" – ishte shifra: "Gegënishtja" autorja Zade Kuqi.

Më 17 shkurt- Ditën e Pavarësisë në bashkëpunim me shkollën "Elena Gjika" anëtarësuaam pa pagesë në bibliotekë njëmbëdhjetë nxënës. Ata i dhuruan bibliotekës nga një flamur të Kosovës.

Ekspozitë - 7 marsi Ditën e Mësuesit organizoi Biblioteka dhe Muzeu (shih te Raporti i Muzeut).

Në ditën e poezisë 21 mars, ekspozuam librat me poezi të autorëve ferizajas. Në ekspozitë u ekspozuan librat e 65 autorëve ferizajas me 157 tituj.

Në bashkëpunim me Qendrën Multimedia bëmë promovimin e librit "Dimri i gjatë i vitit 1945 Tivari" të autorës italiane Anna di Lellio me bashkëautor Dardan Luta. Ky libër me histori të dhimbshme, zgjoi interesim te të pranishmit.

Bashkëqytetari Bajram Maloku ia dhuroi bibliotekës këto libra me vlerë: "Albumi dyzetvjeçar në Amerikë 1906-1946 i hirësisë tij Peshkop Fan S. Noli"- Boston Massachusetts, 1948, "Don Kishoti i Mançes" I, III, IV, V- Miguel de Cervantes Saavedra- Boston, Mass, 1932, "Zonja Ingra e Ostroiti" Henrik Ibsen; e shqipëruar nga Fan S. Noli, Bruxelles, 1926, "Tragjedia e Othello's Arapit të Venetikut", Boston, Mass 1916

Anëtarët e qendrës "Handikos" vizituan bibliotekën dhe diskutuan për librin dhe bibliotekën.

Në kuadër të "Java e Bibliotekës në Kosovë", u organizua ligjërata me temën: " Roli i leximit në edukimin estetik të fëmijët". Po ashtu kolektivi i bibliotekës morri pjesë në hapjen e javës në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani" dhe në aktivitetin e bibliotekës "Latif Berisha" në Mitrovicë. Aktiviteti është përkrahur nga Ministria e Kulturës.

Në Ditën Botërore të Librit u promovua libri "Një shqiptar në CIA" të autorit Bashmir Xhemaj. Për shumë aspekte të librit si për atë publicistikës dokumentare të tij, për vlerat historike dhe ndriçimit të rrethanave të luftës së ftohtë, folën: publicisti Afrim Demiri dhe ambasadori Ylber Hysa, kurse promovimin e moderoi Bekim Kupina.

Bashkëpunimin me Shkollën e mesme teknike "Pjetër Bogdani" dhe huazuam pajisjet "Boson" dhe "Microbit", donacion nga Kroacia dhe BONEVET në Prishtinë, të fituara nga projekti "Qytetari digjital"; Përzgjedhja e librave në Panairin e Librit në Prishtinë, për projektin dyvjeçar, pasurimi i fondit librar etj.

ARKIVI HISTORIK

Arkivi Historik përfshinë territorin e Komunës së Ferizajt me rrethinë dhe vepron si njësi në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Gjatë vitit 2019, kjo njësi ka vazhduar punët e mbetura nga viti paraprak, duke i grumbulluar, evidentuar dhe vendosur nëpër rafte dokumentacionin arkivor. Dokumentacioni arkivor që gjendet në arkiv është përpunuar detajisht dhe profesionalisht dhe është vendosur në vendin adekuat sipas numrit dhe llojit të lëndës.

Gjatë vitit 2019 në Arkivin Historik kemi pasur gjithsejt 96 qytetarë që i kemi shërbyer në mënyrën më të mirë të mundshme, duke i respektuar kornizat ligjore, duke ju shërbyer me material arkivor dhe dokumentacione personale që ata kanë kërkuar nga ne.

Gjatë këtij viti kemi bërë ndarjen e materialit arkivor në drejtoritë përkatëse, sipas shenjave dhe numrit të lëndës, gjithashtu ne jemi në pritje të formimit të komisionit nga Drejtoria e Administratës, pasi që edhe me ligj i takon kësaj drejtorie të formoj një ekip profesional nga sektorët e drejtorive të KKF-së.

Edhe pse në vitin 2015 dhe në 2018 është formuar komisioni për asgjësimin e lëndëve, deri më tani nuk është marrë asnjë veprim për asgjësimin e këtyre lëndëve. Mendojmë që me asgjësimin e këtyre lëndëve të cilat janë për asgjësim, krijojmë një hapësirë më të madhe për sistematizimin e lëndëve tjera, të cilat duhen të vendosen në një vend më të mirë. Momentalisht Arkivi Historik është jashtëzakonisht i ngarkuar me lëndë që ka skaduar afati i ruajtjes dhe duhet të asgjësohen pa humbur kohë.

Gjatë vitit 2019 në kryerjen e punës në Arkivin Historik, jemi përcaktuar sipas kësaj veprimtarie:

Ndarja dhe përcaktimi i dokumentacionit arkivor dhe lëndës arkivore;

Klasifikimi i lëndës arkivore në fonde;

Formimi dhe kompletimi i dosjeve në fonde;

Sistematizimi i lëndës arkivore në fonde;

Mbrojtja teknike;

Në **tremujorin e parë** të vitit 2019 (Janar, Shkurt, Mars)

Ndarja dhe klasifikimi i materialit arkivor në drejtoritë përkatëse si dhe mbrojtja teknike.

Në **tremujorin e dytë** të vitit 2019 (Prill, Maj, Qershor) kompletimi i dosjeve:

1. Përpunimi i fondit procesverbale për kundërvajtje gjyqësore të vitit 1985/86
2. Përpunim i fondit vendime për armëmbajtje dhe dënime në të holla 1947-1960

Në **tremujorin e tretë** të vitit 2019 (Korrik, Gusht, Shtator):

1. Përpunim i fondit Drejtoria për Ekonomi e Financa plani për zhvillimin e bujqësisë dhe pylltarisë 1964, 65, 66, 67, 68 e 69.
2. Përpunim i fondit Këshilli Popullor i vendit Kosinë 1948
Në tremujorin e katërt të vitit 2019 (Tetor, Nëntor, Dhjetor)
 1. Përpunim i fondit Pasaportet e YU (Jugosllavisë)
 2. Përpunim i fondit dëmet e shkaktuara nga okupatori serb të vitit 1998 – 1999

PËRFUNDIM

Një version i këtij raporti, me një format më të zgjeruar dhe ilustrim me fotografi, për referenca të mëtutjeshme gjendet në arkivat e DKRS-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2019

Bekim Ademi
Drejt看 i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Ferizaj, 2020

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë vitit 2019 bazë për përcaktimin e objektivave, respektivisht të planit të punës, ka pasur ngritjen e mirëqenies shëndetësore dhe sociale të qytetarëve tanë, veçmas prioritet i ynë ka qenë tek përcaktimi i objektivave ngritja e disiplinës në punë, llogaridhënia, transparenca dhe ngritja e besueshmërisë së qytetarit ndaj institucioneve në kuadër të Kujdesit Parësor Shëndetësor si dhe institucioneve të Qendrës për Punë Sociale dhe Shtëpisë me Bazë në Komunitet, çdo herë duke u mbështetur në infrastrukturën ligjore në fuqi.

Sektori i Shëndetësisë

DSHMS pas një analize të përgjithshme të punëve dhe të aktiviteteve në kuadër të sektorit të shëndetësisë me theks të veçantë në QKMF gjatë vitit paraprak 2018 kemi vlerësuar se domosdoshmërisht duhet konsultuar me strukturat udhëheqëse të QKMF-së, këshillin drejtues dhe këshillin profesional si dhe njësitë tjera në kuadër të QKMF-së që janë porta kryesore për pacientin në kuadër të kujdesit parësor shëndetësor.

Synimi yni kryesor është ngritja e standardeve teknike, infrastrukturore në rrjetin institucional të QKMF-së duke vlerësuar me prioritet institucionet shëndetësore në pjesët rurale, me qëllim që qytetarëve t'u mundësohet marrja e shërbimeve shëndetësore sa më afër tyre.

Objektivat e Sektorit të Shëndetësisë për vitin 2019

- Ngritja e disiplinës dhe përgjegjësisë në punë (permanente).
- Ushtrimi i vazhdueshëm i kontrollit të brendshëm që do të reflektoj në ngritjen e nivelit të shërbimeve shëndetësore dhe llogaridhënies.
- Angazhimi për realizimin e Kontratës Publike Kornizë në mes Komunës së Ferizajt dhe “Caritas Kosova” për rritjen e stafit shëndetësor për ofrimin të shërbimeve shëndetësore në kuadër të Kujdesit Parësor Shëndetësor.
- Implementimi i projekteve kapitale për vitin 2019.
- Ngritja e aktiviteteve në kuadër të ofrimit të shërbimeve shëndetësore
- Sensibilizimi për specializime në Mjekësi Familjare si kuadro deficitare për Kujdesin Parësor Shëndetësor.
- Avancimi profesional specifik për mjekët familjar ekzistues.
- Ngritja e aktiviteteve të Njesisë së Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor.
- Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore.
- Mbajtja e takimeve të rregullta zyrtare me karakter pune mes DSHMS-së, QKMF-së, QPS-së dhe Shtëpisë me Bazë në Komunitet.
- Promovimi i shëndetit të gruas, fëmijës dhe grupeve vullnerabile.
- Edukimi i stafit për trajtimin e diabetit dhe shputës diabetike.

- Angazhimi në përfitimin e donacioneve për projekte dhe investime kapitale nga organizatat ndërkombëtare, qofshin ato qeveritare apo jo qeveritare, dhe rritja e bashkëpunimit me OJQ-të vendore.

Sfidat e Sektorit të Shëndetësisë

- Furnizimi i pamjaftueshëm me barna nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.
- Moslejimi i rritjes së numrit të personelit shëndetësor nga niveli qendror karshi nevojave të domosdoshme me rastin e hapjes së institucioneve të reja shëndetësore ngase numri i rregullt i 308 punëtorëve është i pamjaftueshëm në ofrim të shërbimeve shëndetësore në kujdesin parësor shëndetësor, që nuk është në përputhje me numrin e banorëve.
- Marrja e mjeteve financiare nga ana e përmbaruesit për obligimet kontraktuese nga ish qeverisja komunale.
- Mos aprovimi i ligjit për sigurime shëndetësore.
- **Ngritja e disiplinës dhe përgjegjësisë në punë dhe ushtrimi i vazhdueshëm i kontrollit të brendshëm**

Ushtrimi i kontrollit të brendshëm është objektiv i yni që ka për qëllim ngritjen e përgjegjësisë, disiplinës në punë dhe llogaridhënies. Gjatë ushtrimit të këtij kontrolli asnjëherë nuk kemi qenë tolerant ndaj të papërgjegjshmëve dhe kemi kërkuar nga menaxhmenti i QKMF-së që çdoherë të ndërmerren veprime ndaj kujdo qoftë që nuk respekton orarin dhe disiplinën në punë.

Po ashtu ne kemi bërë pajisjen e QKMF-së dhe QMF-ve tjera me apartaturën e hyrjeve – daljeve, kjo me qëllim të rritjes së përgjegjësisë dhe disiplinës në punë.

- **Angazhimi për realizimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit në mes Komunës së Ferizajt dhe “Caritas Kosova”**

Sektori i Shëndetësisë ka vlerësuar si të domosdoshme vazhdimin e Marrëveshjes me “Caritas Kosova” me qëllim të rritjes së personelit shëndetësor karshi nevojave të domosdoshme në kujdesin parësor shëndetësor, ngase numri i përgjithshëm i punëtorëve 308 është në shpërputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në proporcion me numrin e përgjithshëm të banorëve të Komunës sonë. Gjithashtu, rritja e rrjetit të institucioneve shëndetësore veçanërisht në zonat rurale ka rritur domosdoshmërinë për një numër të konsiderueshëm të punëtorëve shëndetësor, rreth kësaj shtate ne kemi ushtruar edhe kërkesat tona në nivelin qendror për të na lejuar rritjen e numrit të rregullt të punëtorëve shëndetësorë por një gjë e tillë nuk na është lejuar.

Andaj në bashkëpunim me kreun komunal respektivisht me Kryetarin e Komunës z. Agim Aliu kemi pa të arsyeshme nevojën për publikimin –tenderimin për marrje të shërbimeve sociale, shëndetësore, shtëpiake

dhe ambulantore në QKMF, ku me datën 22.08.2019 është lidhur Kontrata Publike Kornizë në mes Komunës së Ferizajt dhe “Caritas Kosova”.

▪ Implementimi i projekteve kapitale për vitin 2019

Sektori i Shëndetësisë me kohë ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale pranë zyrës së prokurimit, megjithatë jemi përballur me sfida që kanë pamundësuar realizimin e objektivave tona ngase një pjesë e mjeteve financiare janë marrë nga ana e përmbaruesit nga një menaxhim jo i mirë nga ish qeverisja komunale.

Gjatë këtij viti angazhim i yni i veçantë ka qenë në realizimin e objektivave që do të mundësonin avancimin e shërbimeve shëndetësore dhe vlerësojmë se kemi disa të arritura të rëndësishme që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte rrisin performancën në kujdesin parësor shëndetësor.

Projektet e implementuara gjatë këtij viti:

-Vendosja e sistemit informativ shëndetësor në QKMF dhe QMF në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, sistem inovativ në kujdesin parësor shëndetësor, ku mundëson krijimin e databazës së pacientëve dhe vendosja e kartelave për pacientë.

-Vendosja e aparaturës digjitale të hyrje-daljeve për personelin shëndetësor me çka po tentojmë të ngrisim disiplinën dhe përgjegjësinë në punë.

- 05.12.2019 kemi bërë promovimin e Qendrës Mjekësore në fshatin Neredime që i kontribon ngritjes së kujdesit parësor shëndetësor në ofrim të shërbimeve shëndetësore sa më afër qytetarëve. Projekti në fjalë është realizuar në bashkëfinancim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ku kostoja e objektit në fjalë është 133.103,33 €. Në këtë qendër gravitojnë banorët e fshatrave Neredime, Balaj, Manastirc, Jezerc.

Ne po ashtu kemi pajisur personelin shëndetësor me mjete të punës me çka kemi bërë letësimin e punës së tyre.

- Angazhimi ynë ka qenë edhe në hapjen e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Dardani dhe në përgjithësi janë kryer punët nga ana e kontraktuesit dhe është e gatshme për funksion, por meqë objekti i AMF-së së vjetër është shumë afër dhe pamundëson qasjen e hyrjes të personelit shëndetësor dhe të pacientëve veçanërisht të personave me nevoja të veçanta, ku është mëse i domosdoshëm ndërtimi i pjerrinës, kemi vlerësuar që paraprakisht të bëhet rrënimi i këtij objekti dhe të zhvillohet procedurat e tenderimit për rregullimin e hapësirës së oborrit. Angazhimi ynë do të jetë në funksionalizimin sa më të shpejtë të kësaj qendre.

▪ Ngritja e aktiviteteve në kuadër të ofrimit të shërbimeve shëndetësore

DSHMS si prioritet ka rritjen e cilësisë të shërbimeve shëndetësore kundrejt qytetarëve tanë, konsiderojmë se niveli i knaqshmërisë së qytetarëve është i mirë dhe çdoherë i kushtojmë vëmendje çdo ankese të palëve që cenojnë nivelin e shërbimit.

- **Sensibilizimi për specializime në Mjekësi Familjare si kuadro deficitare për Kujdesin Parësor Shëndetësor**

Në bazë të hulumtimeve dhe në konsultim me menaxhmentin e QKMF-së vlerëson si domosdoshmëri rritjen e numrit të mjekëve familjar duke marrë për bazë numrit e përgjithshëm të banorëve të komunës sonë dhe me prioritet do t'i trajtojmë Specializimet e Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe kjo çështje konsiderojmë se do të trajtohet edhe në nivel të Minsitrisë së Shëndetësisë duke vlerësuar se çështja e specialistëve të mjekësisë familjare është një çështje që tejkalon angazhimet e qeverisë lokale dhe duhet të jetë një ndërlidhje në mes institucioneve lokale me ato qendrore, duke u bazuar në faktin se ky është një problem nacional dhe kjo çështje është trajtuar edhe në takimet e rregullta që kemi pasur me Asociacionin e Drejtorëve të Shëndetësisë ku vërehet një jogatishmëri për specializime në kuadër të mjekësisë familjare, ku duhet të gjenden forma dhe mënyra për motivim të kuadrit në këtë drejtim.

- **Avancimi profesional specifik për mjekët familjar ekzistues**

Ngritja profesionale kadrovike çdoherë ka qenë dhe do të jetë prioritet i yni, është një kriter esencial që ndikon në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Në bazë të raporteve që kemi nga Qendra Trajnuese e Mjekësisë Familjare gjatë vitit 2019 në përputhje me planin dhe programin e edukimit specialistik në mënyrë të vazhdueshme bëhen trajnime në ngritjen profesionale shëndetësore ku janë zhvilluar shumë aktivitete – punëtori me mjek familjar, mjek të përgjithshëm si dhe infermierë që punojnë në kuadër të QKMF-së Ferizaj.

Gjatë këtij viti vlen të theksohet angazhimi i trajnerëve zviceran në bashkëpunim me trajnerët tanë, ku është bërë ngritja profesionale e kuadrit shëndetësor duke bartur përvojën e tyre, përvojë kjo e standardeve të larta tek personeli shëndetësor.

- **Ngritja e aktiviteteve të Njesisë së Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor**

Njësia e Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor ka zhvilluar shumë aktivitete promovuese edukative për përmirësimin e shëndetit të popullatës ku janë mbajtur shumë ligjerata nëpër shkolla. DSHMS-ja ka mbështetur çdo aktivitet të njesisë së edukimit dhe promovimit shëndetësor duke vlerësuar se edukimi është një masë preventive dhe edukative që janë në interes të qytetarit.

- **Furnizimi me pajisje mjekësore dhe pajisje të tjera**

Furnizimi me pajisje mjekësore dhe pajisje tjera është bërë në bazë të kërkesave nga njësiti kryesore pranë QKMF-së.

- **Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore**

Renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shëndetësore është në kontinuitet dhe çdo herë intervenimet bëhen sipas nevojës ku paraprakisht bëhet një vlerësim i infrastrukturës së objekteve shëndetësore nga ana e ekspertëve profesional, veçanërisht është intervenuar në QKMF dhe në Qendrën e Shërbimit Primar me qëllim që punëtorëve t'u krijohen kushtet më të mira për punë.

- **Mbajtja e takimeve të rregullta zyrtare me karakter pune mes DSHMS-së, QKMF-së, QPS-së dhe Shtëpisë me Bazë në Komunitet**

Mbajtja e takimeve të rregullta zyrtare me karakter pune mes DSHMS, QKMF dhe SHBK me ngecje mendore ka për qëllim njohjen e më për së afërmi me zhvillimet dhe aktivitetet si dhe me sfidat me të cilat ballafaqohen për të gjetur forma dhe mënyra të rrugëzgjdhjes.

- **Promovimi i shëndetit të gruas, fëmijës dhe grupeve vullnerabile**

Në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësore Familjare funksionon Qendra për Shëndetin e Gruas dhe Fëmijës që është në mbështetje për gratë që nga fillimi i shtatëzanisë deri pas lindjes që është një hap i rëndësishëm progresiv për shëndetin e nënës.

Ky shërbim ka një rëndësi të veçantë në parandalimin e sëmundjeve të ndryshme si dhe në identifikimin e hershëm të sëmundjeve.

- **Edukimi i stafit për trajtimin e diabetit dhe shputës diabetike**

Shërbimi për trajtimin e diabetit është shërbim që funksionon në kuadër të QMF-së II, si shërbim preventiv dhe shërues në kuadër të KPSH-së.

Ky shërbim tani ka formuar grupet vetmbështetëse me prindërit e fëmijëve me diabet që ka për qëllim edukimin e pacientëve dhe mbështetjen nga grupi. Me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së këtij shërbimi stafi i trajnuar bart përvojat e mira tek stafi i ri shëndetësor për ruajtje të kontinuitetit të këtij shërbimi tejet të rëndësishëm.

- **Angazhim në përfitimin e donacioneve për projekte dhe investime kapitale nga organizatat ndërkombëtare, qofshin ato qeveritare apo jo qeveritare, dhe rritja e bashkëpunimit me OJQ-të vendore**

Ne si Drejtori jemi angazhuar në gjetje e mbështetjeve në realizim të objektivave tona duke u nisur nga fakti se me një buxhet të limituar nuk është e mundur të realizohen objektivat, por falë një bashkëpunimi me mekanizmat qeveritar dhe OJQ-të kemi arritur të jemi përfitues dhe mbështetës me projekte shumë të rëndësishme, ku jemi përfitues të:

- Një autoambulance e tipit VË T5 Transporte me vit të prodhimit 2015 nga donatori zviceran me ndërmjetësimin e bashkëatdhetarit tonë z. Sami Bajrami i cili është për t'u falënderuar ngase në vazhdimësi ka ndikuar në ndërmjetësim për arritjen e donacioneve për Qendrën e Mjekësisë Familjare.

- Një autoambulancë me të gjitha pajisjet përcjellëse nga Ministria e Shëndetësisë me shumë 42.788,00€ , ku është bërë edhe trajnimi i personelit shëndetësor.

Marrja e këtyre dy autoambulancave është e një rëndësie të veçantë sepse ofron shërbime më të mira shëndetësore ngase edhe gjatë transportit mundësohen shërbimet e nevojshme ngase janë të pajisura me mjete të standarteve të larta.

- DSHMS-ja në bazë të kërkesës së parashtruar Ministrisë së Shëndetësisë jemi mbështetur me pajisje mjekësore shumë të domosdoshme në vlerë prej 27.586 €

Ne me datë 30.12.2019 jemi përfitues të një autoambulance në vlerë prej 42.788.00€, donacion nga Ministria e Shëndetësisë.

- Me rastin e hapjes së Qendrës së Mjekësisë Familjare në Neredime, nga donatorja dr. Sanije Vladi është dhuruar një karrige stomatologjike e cila tani mundëson ofrimin e shërbimeve stomatologjike për banorët e këtij lokaliteti.

Gjatë vitit 2019 DSHMS respektivisht në Sektorin e Shëndetësisë, angazhim permanent ishte që politikat shëndetësore t'i zhvilloj konform infrastrukturës ligjore në fuqi që rregullon sferën e kujdesit parësor shëndetësor duke qenë të përkushtuar në ndërmarrjen e veprimeve për një funksionalizim të mirëfilltë të QKMF-së, QMF-ve AMF-ve, me të vetmin qëllim që qytetarëve tanë t'u ofrohen shërbime sa më dinjitoze dhe cilësore.

Përkushtimi ynë është i fokusuar në parimin e disiplinës në punë, përgjegjësisë, llogaridhënies, transparencës, për një avancim të cilësisë së shërbimeve dhe rritjen e besueshmërisë së qytetarit ndaj institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor.

Jemi të vetëdijsëm se edhe përkundër përkushtimeve tona mbetet ende për tu bërë dhe angazhimi jonë do të jetë i përhershëm edhe përkundër që shpeshherë po përballemi me sfida jo të tejkalueshme si furnizimi jo i mjaftueshëm me barna esenciale nga Ministria e Shëndetësisë dhe jemi angazhuar të gjejmë

alternativa tjera që nga të hyrat nga participimi të furnizohemi me barna esenciale që sado pak t'i mbështesim qytetarët tanë.

Një sfidë e vazhueshme është mungesa e ligjit mbi sigurime shëndetësore që pamundëson një sistem të mirëfilltë shëndetësor.

DSHMS është transparente për punë dhe aktivitete që zhvillon kundrejt hierarkisë institucionale lokale dhe qendrore si dhe ndaj qytetarëve. Pasqyrim i transparencës është se në vazhdim të këtij raporti do të bashkëngjeshim raportin njëvjeçar në tërësi të QKMF-së, QPS-së dhe SHBK.

Objektivat për vitin 2020

DSHMS-ja ka bërë përcaktimin e objektivave që vlerëson që janë të rëndësishme në arritshmërinë e ofrimit të standarteve të avansuara në Kujdesin Parësor Shëndetësor.

- Funksionalizimi i QMF-së Dardani

Angazhimi ynë gjatë vitit 2019 ka qenë edhe në hapjen e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Dardani dhe në përgjithësi janë kryer punët nga ana e kontraktuesit dhe është e gatshme për funksion, por meqë objekti i AMF-së së vjetër është shumë afër dhe pamundëson qasjen e hyrjes të personelit shëndetësor dhe të pacientëve veçanërisht të personave me nevoja të veçanta, ku është mëse i domosdoshëm ndërtimi i pjerrinës, kemi proceduar me procedurën e tenderimit për rrënimin dhe rregullimin e hapësirës së oborrit, dhe do të angazhohemi që të bëhet njëkohësisht edhe rregullimi i oborrit dhe më pas të bëhet përrurimi i QMF-së.

Sa i përket investimeve kapitale planifikojmë ndërtimin e dy qendrave mjekësore:

- Një në fshatin Softaj
- Një në rrugën “Kadri Zeka” – Ferizaj.
- Rregullimin e oborreve të QMF-ve.
- Mirëmbajtja e institucioneve shëndetësore.
- Vendosjen e kamerave në të gjitha institucioneve brenda qytetit (kjo me qëllim të rritjes së sigurisë dhe përgjegjësisë në punë).
- Ngritjen kadrovike të personelit shëndetësor.
- Vazhdimi i projektit me njësinë e edukimit për kontrollin e vazhdueshëm nëpër shkolla.
- Ndërtimin e Shtëpisë së Pensionistëve.
- Mbështetje e vazhdueshme e OJQ-ve të cilat merren me kategoritë e cënueshme.

DSHMS në përcaktimin e një objektivave të veçantë është mbështetja e fëmijëve me diabet që t’u sigurohen reagencat, insulinë, trakat për matje, si dhe të sigurohet matja tremujore, ngase nga të dhënat që posedojmë kjo kategori ka pasur vështirësi në sigurimin e barnave esenciale për trajtimin diabetik dhe shumica prej tyre janë të pamundshëm që me buxhet vetanak t’i sigurojnë, andaj ne do të angazhohemi që kjo kategori të trajtohet dinjitetshëm duke marrë parasysh faktin se trajtimi i kësaj sëmundje është në vazhdimësi.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE FERIZAJ

HYRJE

Personeli i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare e filloi vitin 2019 me angazhimet e nevojshme në përmbushjen obligimeve dhe detyrave të punës. Që në ditët e para të këtij viti puna filloi me ritmin e zakonshëm nëpër të gjitha QMF – të dhe AMF – të.

Pas nënshkrimit të Akt-emërimit dhe të pranimit të detyrës më 08.03.2019 Drejtoresha ka marrë përgjegjësitë për të siguruar udhëheqjen e punës në QKMF në pajtim me dispozitat e Statutit dhe akteve tjera normative. Ka vazhduar përkushtimi ndaj organizimit të punës dhe eliminimit të ngecjeve eventuale, që është preokupim i vazhdueshëm i stafit menaxhues dhe hap imediat drejt përmbushjes së rekomandimeve të paracaktuara për këtë vit, të cilat janë:

1. Menaxhimi i burimeve njerëzore;
2. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe performancës në punë në Kujdesin Primar Shëndetësor (KPSH);
3. Monitorimi i vazhdueshëm i standardeve bazike në KPSH;
4. Koordinimi i punëve në Edukimin dhe Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional (ZHVP);
5. Kujdesi për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien në punë të të gjithë të punësuarve
6. Angazhimi i vazhdueshëm në plotësimin e standardeve teknike dhe ngritja e performancës në punë në Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF) të komunës sonë.

Aktivitetet dhe takimet:

- Trajnimi treditor prej 11 deri 13 mars 2019, për modulën e gjashtë për Menaxhimin Shëndetësor "Monitorimi dhe Evaluimi", ku është analizuar projekt-hulumtimi "Studimi mbi cilësinë e kujdesit shëndetësor " të ndërmarrë nga ana e AQH-së me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë. Mbledhja e të dhënave në terren nga ekipet monitoruese në QKMF dhe në tre QMF-të e qytetit tonë, u bë nga 10 Shtatori deri më 5 Tetor 2018. Të gjeturat që janë evidentuar janë edhe rekomandime nga MSH që duhet të përmirësohen deri në fund të vitit 2020 kur do të bëhet prapë vlerësimi i gjendjes. Në bazë të këtyre rekomandimeve janë hartuar edhe kërkesat që kanë kosto buxhetore drejtuar Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ndërsa për përmirësimin e gjetjeve që nuk kanë kosto është autorizuar koordinatori dhe cilësisë së punës në bashkëpunim me stafin tjetër menaxherial.

Pas trajnimit janë mbajtur edhe tre takime të grupeve punuese për hartimin e Planit të Veprimit nga stafi menaxherial i QKMF-së dhe DSHMS –së. Në Planin e Veprimit janë paraqitur nevojat për përmirësimin e

gjendjes së infrastrukturës, edukimin profesional të stafit e komunitetit si dhe për furnizimin me pajisje mjekësore. Për ato nevoja që mund të realizohen në bazë të mundësive buxhetore kanë filluar menjëherë të merren masat adekuate, ndërsa për ato që nuk mund të realizohen, por që janë të nevojshme kemi kërkuar nga MSH që të na i sigurojë si donacion.

- **Shënimi i Ditës së Infermierisë** - Më 12 maj, me një manifestim modest u shënua Dita Botërore e Infermierisë në Qendrën Trajnuese, ku përveç infermierëve të QKMF-së, të pranishëm ishin edhe Drejtori i DSHMS-së, zyrtarë të DSHMS-së, mjekë e infermierë nga kujdesi primar dhe sekondar. Përveç fjalëve përshëndetëse, në takim u prezantuan pesë punime nga infermierët. Ndërsa në fund të takimit, në shenjë falënderimi dhe vlerësimi për punën dhe kontributin e dhënë, u ndanë mirënjohje për infermierët me përvojë shumëvjeçare në QKMF.

- **Takimi me "Save the children"** - Më 25 Prill, koordinatorja e organizatës "Save the Children" vizitoi menaxhmentin e QKMF -së me ç'rast u bisedua rreth marrëveshjes së mëhershme të Partneritetit mes kësaj organizate dhe DSHMS-së, lidhur me aktivitetet e Grupit për Edukim Shëndetësor që lidhen me periudhën e fëmijërisë së hershme. Ky bashkëpunim ky që u përkrah dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

- **Vizita nga përfaqësuesi i Kolegjit Mbretëror Anglez** - QKMF më 16 maj u vizitua nga Ekspertiza e Kolegjit Mbretëror të Britanisë së Madhe, MRCGP-UK, e kryesuar nga Profesor Johnny Lion-Maris / Dekan i Asociacionit GP. Kjo vizitë kishte për qëllim njohjen për së afërmi me Implementimin e Edukimit Specialistik në QTMF - Ferizaj, nivelin e implementimit të konceptit të Mjekësisë Familjare, si dhe mbështetjen e procesit të specializimit, pasi programi është i akredituar nga ky kolegji.

- **Hulumtim nga MSH, UNICEF dhe OBSH** - Prej datës 17.06.2019 është bërë një hulumtim në QKMF- Ferizaj, si projekt në kujdesin parësor para dhe pas lindjes. Ky projekt, i mbështetur nga Ministria e Shëndetësisë, UNICEF-i dhe OBSH, ka zgjatur 3 ditë në Kujdesin Primar Shëndetësor ku është observuar puna e mjekut dhe infermiereve rreth kujdesit për nëna dhe fëmijë, deri në moshën 12 muajshe.

Gjithashtu, janë bërë edhe intervista me nëna rreth kujdesit të ofruar në KPSH. Në ditën e katërt është bërë observimi i punës në administratë. Në bazë të këtij hulumtimi do të vlerësohet gjendja, dhe në bazë të rekomandimeve eventuale do të vlerësohet se në të ardhmen a ka nevojë trajnimi i stafit apo jo.

- **Dita Botërore e Dhurimit të Gjakut** - Mjekë dhe infermierë të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj, në krye me drejtoreshën, iu bashkuan aksionit për dhurimin e gjakut, që u zhvillua nëpër të gjitha qendrat e Kosovës për nder të 14 Qershorit, Ditës Botërore të Dhurimit të Gjakut.

- Më 03.07.2019 nga komisioni i përbërë prej dy punëtorëve të QKMF-së dhe një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, u bë liferimi, montimi dhe trajnimi i stafit për spektrofotometër i ndarë nga MSH me vlerë 9.900 €, kurse me datën 04.07.2019 për aparat të ultrazërit me sondë me vlerë prej 9.700 € dhe defibrilatorit për adult me vlerë 3.942 €.

- Në bazë të inicimit dhe kërkesës së Drejtorit të DSHMS-së në praninë e anëtarëve të komisionit të zgjedhur të QKMF-së, u bë auditimi i brendshëm në shërbimin e laboratorit në QKMF, ku sipas komisionit nuk ka pasur diçka të veçantë.

- Është organizuar komisioni mjekësor ku janë shqyrtuar raportet e pushimeve mjekësore. Në bazë të vlerësimit të komisionit, pushimet mjekësore kanë qenë të arsyeshme.

- Në bazë të ftesës nga Kryetari i AMFK-së për pjesëmarrje në Konferencë të profesionistëve shëndetësor që është mbajtur më 13 dhe 14 Shtator., me ç'rast 11 mjekëve, shumica mjekë të rinj, u është bërë kuotizmi me qëllim të sensibilizimit të tyre për t'u orientuar në specializim në Mjekësinë Familjare.

Është bërë edhe shqyrtimi i raporteve të komisionit mbikëqyrës të QKMF-së i cili përbëhet prej disa komisioneve tre anëtarësh e që i përbëjnë anëtarët e Këshillit Drejtues dhe shefave të njësive, komisione këto që inspektojnë edhe monitorojnë punën në QKMF, QMF dhe SHEP, duke u bazuar në disa kritere të rëndësishme që duhet të respektohen.

Gjatë **vitet 2019** është punuar intensivisht nëpër të gjitha njësitë dhe janë arritur rezultate të kënaqshme. Numri i përgjithshëm i shërbimeve mjekësore dhe infermierike në QKMF gjatë kësaj periudhe

është **933 230**, nga të cilat **265 768** janë vizita mjekësore, **622 590** shërbime infermierike e të tjera dhe **44 872** janë shërbime stomatologjike.

TRUPAT PROFESIONALE TË QKMF – së

KËSHILLI DREJTUES DHE ZYRA E DREJTORIT

Këshilli Drejtues si organi më i lartë i udhëheqjes së QKMF – së, gjatë **vitet 2019** ka mbajtur 25 mbledhje, për të cilat janë mbajtur rregullisht procesverbalet, që pastaj janë aprovuar dhe protokolluar. Në këto mbledhje u shqyrtuan çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me mbarrëvajtjen e procesit të punës në QKMF:

- Nga kryeshefi është raportuar për diskutimet nga mbledhjet e Këshilli Profesional, ndër to edhe vijueshmëria në punë.
- Janë ristrukturuar komisionet e parapara me statut, të nevojshme për mbarrëvajtjen e punës si: komisioni për pushime mjekësore, komisioni disiplinor dhe komisioni për ankesa. Nga këto komisione, angazhimi ka filluar së pari nga komisioni për ankesa, që ka shqyrtuar ankesën e përfaqësuesve të Asociacionit të Mjekëve Familjarë të Ferizajt, për kujdestarinë në QMF 2, për çka kanë kërkuar kompensim. Pas analizës së fakteve dhe mbledhjes së orëve të punës, komisioni duke u mbështetur në statutin dhe rregulloret e punës për QKMF, ka marrë vendim se me kujdestarinë e natës në QMF 2 mjekët kanë plotësuar orët e punës që parashihen me kontratë të punës. Në rastet që orët janë tejkaluar, është bërë kompensimi adekuat.
- Është bërë iniciimi i procedurave për plotësimin e nevojave për resurse humane.
- Iniciimi i procedurës për reagensë laboratorik.

- Është diskutuar për pajisjet mjekësore të ndara nga Ministria e Shëndetësisë për QKMF, në bazë të kërkesave që janë bërë më herët dhe bëhet fjalë për pajisjet në vazhdim:
 1. Defibrilator automatik për adult - në vlerë prej 3 290 €
 2. Sterilizator (me ajër të thatë) - në vlerë prej 1 156 € - e pranuar më 26.06.2019
 3. Ultrazë me sondë - në vlerë prej 9 700 €
 4. Spektrofotometër automatik - në vlerë prej 9 900 €
 5. EKG- 3 kanalëshe - në vlerë prej 740 € - e pranuar më 18.06.2019
 6. Aparat hematologjik me kapilarë - në vlerë prej 2 800 € - i pranuar më 24.06.2019

Këto pajisje në vlerë prej **27 586** eurosh janë pranuar nga komisioni dhe është bërë trajnimi i stafit për përdorimin e tyre nga përfaqësuesit e kompanive furnizuese.

DONACIONET

Gjithashtu, për QKMF-në, gjatë kësaj periudhe u ofruan edhe donacione të ndryshme. Nga *America Prenatal Vitamina* përmes OJQ - *Aksioni për Nëna dhe Fëmijë*, të cilat janë pranuar më datën 28.05.2019. Donacioni përmban 15 kutia me vitamina prenatal për gra shtatzëna, të cilat janë dërguar në QMF 2, në klasën për nëna dhe nëpër dhomat e KAN - it (Kujdesit Antenatal) nëpër QMF.

Më 17.04.2019 është sjellë një donacion me uniforma për stafin e Shërbimit Emergjent Primar, nga Toni Company, me ndërmjetësimin e drejtorit të IPKO-s. Ky donacion përfshin: 27 jakne për staf dhe 33 uniforma (pantallona dhe bluza).

Anesteziologu zviceran Martin Hoffer me bashkëshorten e tij Susanne, që vitin e kaluar kanë sjellë donacion dy autoambulanca dhe pajisje të tjera, përmes bashkëatdhetarit Sami Bajrami, në fillim të muajit Qershor kanë mbajtur trajnim për personelin e Shërbimit Emergjent Primar. Krahas trajnimit tregues ata kanë sjellë donacion pajisje mjekësore:

- Rregullator i O₂ (2000) - 2 copa
- Maska speciale për O₂ (2000, Cpap) - 8 copa
- Maska të thjeshta - 7 copa
- Tuba endotrakeal - 19 copa
- Tuba laringeal - 20 copa
- Tampona për hundë - 4 copa
- Ambu - 4 copa
- Maska Ambu - 9 copa
- Set për laringoskop - 2 copa
- Kompresa për infuzion - 1 copë
- Rripa merimangë për barelë - 1 copë
- Jelek imobilizues - 1 copë
- Qafore - 8 copa

Këto pajisje janë pranuar nga komisioni i formuar nga tre infermierë të Shërbimit Emergjent Primar.

Më 30.12.2019 kemi pranuar donacion nga Ministria e Shëndetësisë një autoambulancë me vlerë 42.788 euro.

TË TJERA

Vlen të përmendet se më 25.05.2019 në QMF 2 ekipi i ekologjisë ka bërë dezinfektimin e hapësirave të punës në kartotekë, laborator, dhomat numër 8, 4, 3, 2 dhe deratizimi në kartotekë dhe dhomën numër 8.

KËSHILLI PROFESIONAL DHE ZYRA E KRYESHEFIT TË DEPARTAMENTIT TË

MJEKËSISË FAMILJARE

Këshilli Profesional gjatë **vitet 2019** ka mbajtur 8 takime, në të cilat ka raportuar secili përgjegjës për njësinë e vet dhe janë diskutuar çështje të ndryshme. Detyrat dhe aktivitetet e Këshilli Profesional janë të lidhura ngushtë me obligimet e Zyrës së kryeshefit të DMF, prandaj edhe do t'i paraqesim në një vend, ato që janë më domethënëse për këtë periudhë:

- Hartimi dhe prezantimi i plani të punës për vitin 2019.
- Organizimi dhe koordinimi i punës në bashkëpunim me shefat e QMF – ve.
- Diskutim rreth plotësimit të drejtë dhe me kohë të raporteve të punës për vizita dhe shërbime mjekësore.
- Masat për respektimin e orarit të punës.
- Analiza lidhur me funksionimin e ordinancave stomatologjike nëpër QMF në fshatra dhe nëpër shkolla.
- Identifikimi i nevojave të institucionit për staf mjekësor.
- Përpilimi i orareve për kujdestari të natës, të dielave dhe festave.
- Caktimi i ekipeve mjekësore për përcjelljen e aktiviteteve sportive lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Sistemimi i mjekëve të rinj nëpër njësi, për përfundimin e praktikës profesionale që parashihet nga Ministria e Shëndetësisë.
- Vizitat mbikëqyrëse nëpër njësitë e QKMF-së.
- Sistematizimi i vendeve të punës.
- Takimet dhe kontaktet e vazhdueshme me shefat e njësive lidhur me çështjet institucionale.

Nga pikat e lartpërmendura është me rëndësi të paraqitet më gjerësisht çështjet në vazhdim:

Plani i punës për vitin 2019 - Kryeshefi i Departamentit të Mjekësisë qysh në fillim të këtij viti ka hartuar një plan të punës dhe një gjë të tillë e ka kërkuar edhe nga shefat e njësive. Në këtë plan është kërkuar që të përfshihet edhe menaxhimi i pushimeve vjetore të këtij viti, por edhe pjesës së mbetur të pushimeve të vitit të kaluar.

Zbatimi i udhërrëfyesve - Nga Këshilli Profesional janë kërkuar pajisjet e nevojshme për zbatimin e udhërrëfyesve për trajtimin e hipertensionit, astmës dhe diabetit. Kjo nënkupton që secili mjek duhet të ketë pulsoksimetër. Për udhërrëfyesin e astmës nevojiten pikflometrat dhe bocat e oksigjenit, për udhërrëfyesin e diabetit duhen glukometër, shirita, barna, ndërsa për udhërrëfyesin e trajtimit të hipertensionit duhen tensionmetra. Gjithashtu, barnatoret duhet të jenë të pajisura me barnat e nevojshme. Këto konsiderohen të jenë sfidat e këtij viti, krahas atyre me të cilat jemi përballur vitin e kaluar, ndërsa këtë vit jemi pajisur me mjete pune.

Ordinancat stomatologjike nëpër shkolla dhe AMF - Nga pikat e lartpërmendura është me rëndësi të paraqitet më gjerësisht çështja e ordinancave stomatologjike nëpër AMF në fshatra dhe atyre nëpër shkolla. Lidhur me këtë kemi kërkuar nga përgjegjësit e Sektorit të Stomatologjisë që të mbajnë takimin e Kolegjit Profesional dhe të dalin me një përfundim.

Sipas mendimeve të dhëna në Kolegjin Profesional, funksionalizimi dhe menaxhimi i ordinancave stomatologjike nëpër shkolla është ngarkesë e pa përballueshme për këtë sektor. Zgjidhje më e mirë, sipas tyre, do të ishte që Drejtoria e Arsimit të merret me këtë çështje, ata duhet të pranojnë stomatologë për këto ordianca, ndërsa furnizimi me material të bëhet nga Sektori i Stomatologjisë, gjegjësisht QKMF. Në mendimin e Kolegjit Profesional të Stomatologjisë theksohet se prezenca e stomatologut në shkollë është shumë e rëndësishme, sepse aty bëhet parandalimi i sëmundjeve të gojës e dhëmbit, mirëpo mundësitë aktuale të Sektorit të Stomatologjisë janë të kufizuara që të ofrojë më tepër në këtë drejtim. Vitet e fundit vazhdimisht është zgjeruar infrastruktura, janë shtuar njësitë dhe objektet, ndërsa numri i kuadrove ka mbetur i njëjtë që sa kohë. Sa i përket ordinancave stomatologjike nëpër fshatra përgjegjësit e stomatologjisë janë zotuar se mund të rregullojnë një plan që nëpër AMF ku ka ordianca stomatologjike të dërgohet stomatologu një apo dy herë në javë. Në AMF në Miroslë karrigia stomatologjike është jofunksionale, karrigia stomatologjike që është dhuruar për ordinancën në fshatin Sojevë ka qenë vetëm çështje publiciteti, ajo asnjëherë që nga çasti i dhurimit, nuk ka qenë funksionale dhe as që mund të rregullohet. Është e shkatërruar plotësisht.

Zyra e Kryeinfermieres

Shërbimi infermioror është një nga shërbimet më të mëdha si me numër të personelit, ashtu edhe me numrin e shërbimeve që ofron. Përveç detyrave menaxheriale, për të cilat i përgjigjet drejtorit dhe kryeshefit të QKMF-së, kjo zyrë përballlet edhe me shumë sfida.

Gjatë vitit 2019 janë lëshuar rreth 167 vendime për sistemim në praktikë dhe janë dhënë rreth 120 vërtetime që e kanë përfunduar stazhin. Sipas marrëveshjes me Universitetin jo publik UBT për kryerjen e praktikave, janë pranuar zyrtarisht rreth 120 studentë- në fazën e parë dhe rreth 50 në fazën e dytë. Po ashtu

të gjithë studentët e Komunës tonë që studiojnë në UP - "Hasan Prishtina" dhe studentët e Kolegjit jo publik "QEAP Heimerer". Të gjithë nxënësit e Shkollës së Kompetencës në Ferizaj. Po ashtu janë pranuar të gjithë nxënësit e shkollës së mesme "Elena Gjika" dhe e gjithë kjo ka ndikuar dukshëm në mbarëvajtjen e punës.

Vlen të theksohet se gjatë muajve të verës (Qershor – Korrik - Gusht) shënohet rritje e konsiderueshme e numrit të pacientëve, për shkak të ardhjes së bashkatdhetarëve, ndërkohë është edhe perioda kur shfrytëzohen pushimet vjetore nga personeli. Kjo përcillet me ngarkesë dhe angazhim të shtuar për tërë personelin. Me fillimin e implementimit të sistemit të ri informativ shëndetësor, të digjitalizuar, stafi i infermierisë e ka kryer trajnimin dhe është aftësuar shumë shpejt për këtë sistem. Puna është duke vazhduar për t'u implementuar sa më mirë programi.

Po ashtu shërbimi për vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë ka arritur që të shënojë prapë sukses në nivel të Kosovës. Sukses tjetër kemi edhe shërbimin e formimit të dhomave "Aksioni për nëna dhe fëmijë". Edhe shërbimi i vaksinimit ka arritur ta përmbush me sukses planifikimin vjetor.

Gjatë kësaj periudhe sfidë ka qenë edhe mungesa e mjeteve higjienike, kjo për shkak se disa hapësira dhe sektorë të QKMF-së i përfshin sektori privat. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional për të gjithë infermierët dhe profesionistët tjerë shëndetësor ka vazhduar me sukses. Janë zhvilluar edhe trajnime në nivel nacional si nga ana e Ministrisë e po ashtu edhe në nivel lokal. Në muajin Maj është mbajtur konferenca e parë në nivel të Kosovës, organizuar nga Oda e Infermierëve të Kosovës, kjo është mbajtur në Ferizaj falë përfaqësuesve tanë (QKMF-Spital) që janë në OIK. Dhe po ashtu janë zhvilluar ligjërata për edukim dhe promovim shëndetësor në komunitet Shërbimin 24 orësh në SHEP dhe QMF 2 puna e natës, vazhdojnë duke punuar për të plotësuar nevojat e pacientëve. E gjithë puna jonë qëndron në raportin e përgjithshëm.

KOMITETI PËR NGRITJEN E CILËSISË SË SHËRBIMEVE

Zyra për sigurimin e cilësisë në punë

Duke u bazuar në strategjinë e përmirësimit të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore 2012-2016, si dhe në doracakun e vlerësimit të standardeve të cilësisë së shërbimeve shëndetësore, paraprkisht nga koordinatori për sigurimin e cilësisë në punë, është bërë plani për programin institucional me qëllim të plotësimit të objektivave të strategjisë dhe objektivave institucionale për përmirësimin dhe monitorimin e sigurimit të cilësisë në punë për vitin 2019.

Takimet

- Më 26.02.2019 me ftesë nga kryeinspektori shëndetësor është zhvilluar, “Zbatimi i rekomandimeve të Inspektoratit Shëndetësor” me qëllim të vlerësimit të plotësisë të rekomandimeve të paraqitura
-
-

nga vizitat e Inspektoratit Shëndetësor në lidhje me standardet bazike të cilësisë në kujdes shëndetësor, pas informatave të shpërndara në takimin e kaluar të mbajtur më 14.12.2018.


- Gjatë muajit Mars është zhvilluar takimi në kuadër të Projektit Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor (AQH).
- Gjatë muajit Prill vazhduan edhe me dy punëtori rreth zhvillimit të Planit të Veprimit në kuadër të Projektit Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor (AQH), organizuar nga Ministria e Shëndetësisë.
- Në javën e fundit të Majit përfundoi cikli i punëtorive me modulën “Monitorimi dhe Vlerësimi” i Planit të Veprimit, kuadër të Projektit Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor (AQH), organizuar nga Ministria e Shëndetësisë
- Takime në vazhdimësi me Drejtoren e QKMF-së dhe përgjegjësin e IT të QKMF-së, me çështje diskutimi dhe informimi rreth sfidave dhe kufizimeve në zbatimin e regjistrimit të pacientëve në SISH digjital dhe mundësitë e respektimit të plotësisë të drejtë të të dhënave profesionale për pacientë.

Aktivitetet

- Në koordinim me zyrtarët e depozitës së farmacistëve, në respektim të plotësisë të indikatorëve vlerësues për sigurimin e cilësisë në punë, është arritur përpilimi i listës rreth furnizimit me barna nga lista esenciale dhe komerciale dhe shpërndarja e listës në të gjitha institucionet shëndetësore të QKMF-së.

- Në respektim të Procedurave Standarde Operative/ PSO mbi shpenzimin e insulinave në KPSH është zhvilluar monitorimi i pikës së farmacistëve në QKMF në respektimin dhe zbatimin e hapave procedural dhe nën-hapave në respektim të UA01/2010, konkretisht receta DM0107 dhe raporti nga konsulta UA02/2010, me ç'rast edhe janë dhënë rekomandimet për zbatim të suksesshëm.

- Analiza e parametrave statistikor të auditit klinik për shkallën e referimeve nga Kujdesi Parësor Shëndetësor në Kujdesin Dytësor dhe Tretësor për periudhë njëvjeçare 2018. Rezultatet e auditit tregojnë referimin në nivelet tjera të sistemit shëndetësor brenda standardit të paraparë, në shkallë prej 14.73% , që nënkupton nivelin e referimit të rasteve.



Grafikoni 1: Shkalla e përgjithshme e referimeve në nivelet tjera shëndetësore

Aktivitetet

- Në përmbushje të aktiviteteve të propozuara nga punëtorët e AQH-së, gjatë muajit Maj, janë realizuar vizitat monitoruese në vlerësimin e praktikimit të masave të drejta në parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve tek shërbimet e kujdesit shëndetësor në Qendrat e Mjekësisë Familjare.

Gjatë vizitës u vlerësuan këta parametra:

- Disponueshmëria me ujë të rrjedhshëm (nga rubineti) në institucion;
- Furnizimi me paisjet e nevojshme në zbatim të parimeve të higjienës (dorëza, maska, letër për tharjen e duarve, qese për grumbullimin e mbeturinave, shportat me kapak).
- Furnizimi me preparate për higjienën e duarve (sapun të lëngshëm, preparate me bazë alkooli për dezinfektim të duarve).
- Testimi i njohurive të personelit rreth momenteve për higjienën e duarve.
- Prania e protokollit rreth teknikës së higjienës së duarve.

Menaxherëve, me qëllim të promovimit dhe përmirësimit të higjienës së duarve iu ofruam protokollet e hartuara në përmbledhjen globale të titulluar “Udhëzimet për higjienën e duarve në kujdesin shëndetësor “të OBSH-së, me udhëzimet e nevojshme rreth:

- Teknikës së higjienës së duarve me sapun dhe ujë
- Teknikës së higjienës së duarve me përbërës alkoolik

- 5 momentet tuaja për higjienën e duarve – sqarim se kur duhet të zbatojnë higjienën e duarve

Po ashtu, përmbledhje e raporteve nga të gjeturat, plotësimet dhe rekomandimet për vazhdimësi të ruajtjes dhe respektimit të praktikave profesionale iu dërguan Drejtores së QKMF-së dhe menaxherëve të qendrave.

- Aktivitetet e planifikuara nga Zyra e Cilësisë vazhduan gjatë Qershorit në vlerësimin e gjendjes në përmbushje të standardeve bazike në sigurimin e cilësisë në punë në AMF Mirash, AMF Softaj dhe AMF Talinoc.

Vlerësimi u realizua në bashkëpunim me përgjegjësit e institucioneve, inspektimi u realizua përmes instrumentit matës me indikatorët e propozuar dhe të vlerësuar edhe nga ana e Inspektoratit Shëndetësor, gjithsej 25 indikatorë më të nevojshëm dhe bazik në sigurimin e cilësisë në punë. Në fund të vizitave, përmbledhjet nga vlerësimi me të gjeturat, mangësitë dhe rekomandimet e nevojshme karshi përmbushjes së standardeve të cilësisë janë dërguar Drejtoreshës së QKMF-së dhe menaxherit të institucioneve.

I. DEPARTAMENTI I MJEKËSISË FAMILJARE

Departamenti i Mjekësisë Familjare, me shtrirjen e aktivitetit nëpër Qendrat e Mjekësisë Familjare në të gjitha nivelet, ka vazhduar angazhimet drejt realizimit të objektivave të veta mbi shëndetin, për të gjithë banorët e komunës sonë, aktivitete këto që bëhen duke respektuar gjithnjë politikat lokale për shëndetësi të referuara nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (Sektori i Shëndetësisë) dhe Ministria e Shëndetësisë, të bazuara në ligjet dhe rregulloret administrative në fuqi.

Departamenti i Mjekësisë Familjare gjatë **këtij viti**, funksionimin e vet e ka përqendruar në kryerjen e këtyre shërbimeve:

1. Shërbimet konsultative nga mjeku familjar dhe i përgjithshëm;
2. Shërbimet konsultative nga specialistët e profileve të tjera (fiziatri, radiologu, psikiatri, psikologu, dermatologu, oftalmologu);
3. Shërbime infermierike;
4. Shërbimet preventive (edukimi, vaksinimi, KAN-i, vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë, Qendra informuese për shëndetin e gruas);
5. Shërbimet emergjente;
6. Kujdesi shtëpiak;
7. Kujdesi shëndetësor për nënën dhe fëmijën;
8. Shërbime diagnostike (EKG, ECHO, shërbimet laboratorike, shërbimet rëntgenologjike);

Raporti në vazhdim jep një pasqyrë të detajuar të punës dhe angazhimeve të personelit shëndetësor në Departamentin e Mjekësisë Familjare.

1. SHËRBIMET MJEKËSORE

Shërbimet mjekësore kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë mes mjekëve dhe infermierëve, krahas përgjegjësisë dhe shkallës së lartë të përgatitjes profesionale. Gjatë punës dhe aktivitetit të përditshëm të mjekëve dhe infermierëve bëhen përpjekje të vazhdueshme për të ofruar shërbime shëndetësore me cilësi të lartë për të gjithë qytetarët e komunës sonë dhe më gjerë.

Numri i shërbimeve dhe mbarëvajtja – Rezultatet e punës për **vitin 2019**, në Departamentin e Mjekësisë Familjare të QKMF – së, mund të radhiten sipas qendrave, me sa vijon:

- **Në QKMF** - janë ofruar **239 031** shërbime shëndetësore, prej tyre **58 644** janë vizita mjekësore kurse **180 387** shërbime infermierike.
- **Në QMF I** - janë kryer **117 820** shërbime shëndetësore, prej tyre **31 067** janë vizita mjekësore, kurse **86 753** shërbime infermierike.
- **QMF II** - janë kryer **219 445** shërbime shëndetësore, prej tyre **57 059** janë vizita mjekësore kurse **127 158** janë shërbime infermierike dhe të tjera.
- **QMF IV** - janë kryer **84 130** shërbime shëndetësore, prej tyre **24 057** janë vizita mjekësore kurse **56 929** shërbime infermierike.
- **QMF III Greme** - janë kryer **23 594** shërbime shëndetësore, prej tyre **6 033** janë vizita mjekësore kurse **15 195** shërbime infermierike.
- **QMF V Komogllavë** - janë kryer **9 338** shërbime shëndetësore, prej tyre **2 872** janë vizita mjekësore kurse **6 466** shërbime infermierike.
- **QMF VI Pleshinë** – janë kryer **6 891** shërbime shëndetësore, prej tyre **3 784** vizita mjekësore dhe **3 107** shërbime infermierike.
- **AMF – të** – janë kryer **30 984** shërbime shëndetësore, prej tyre **10 199** vizita mjekësore kurse **20 785** shërbime infermierike.
- **KUJDESTARIA E NATËS** – si njësi që funksionon në kuadër të Shërbimit Emergjent Primar dhe QMF II, ka kryer **76 734** shërbime shëndetësore, nga të cilat **43 868** vizita mjekësore kurse **32 866** shërbime infermierike. Prej tyre **51 666** shërbime janë kryer në QKMF (SHEP) dhe **25 068** shërbime në QMF 2.
- **KUJDESTARIA E TË DIELAVE** – ka kryer gjithsejtë **31 037** shërbime, nga të cilat **15 052** vizita mjekësore dhe **15 985** shërbime infermierike. Prej tyre **19 698** shërbime janë ofruar në QKMF (SHEP) dhe **11 339** në QMF.

Tabela 1, Numri i shërbimeve sipas qendrave

Qendra	Numri i vizitave mjekësore	Numri i shërbimeve infermierike	Numri i përgjithshëm shërbimeve
QKMF	58 644	180 387	239 031
QMF 1	31 067	86 753	117 820
QMF 2	57 059	127 158	219 445
QMF 4	24 057	56 929	84 130
QMF Greme	6 033	15 195	23 594
QMF Komogllavë	2 872	6 466	9 338
QMF Pleshinë	3 784	3 107	6 891
AMF - të	10 199	20 785	30 984
Kujdestaria e natës	43 868	32 866	76 734
Kujdestaria e të dielave	15 052	15 985	31 037

1.1. LABORATORI

Personeli i laboratorëve në pesë qendrat ka ofruar shërbime të vazhdueshme, përkundër numrit tejet të madh të pacientëve dhe vështirësive në furnizim me reagensë. Në këta laboratorë janë kryer shumica e analizave të nevojshme për diagnostifikim, numri i përgjithshëm i të cilave gjatë **këtij nëntëmuajori** arrin në **125 087** analiza, prej të cilave **109 113** janë analiza gjaku dhe **15 974** analiza urine.

Tabela 2. Shërbimet e ofruara në laboratorët e qendrave

Laboratorët në qendra	Analiza urine	Analiza gjaku	Gjithsej
QKMF	8 607	78 412	87 019
QMF 1	1 153	6 768	7 921
QMF 2	5 318	19 360	24 678
QMF 4	418	2 726	3 144
QMF Greme	359	2007	2 366
Totali	15 974	109 113	125 087

Me shtimin e numrit të personelit në laboratorin e QKMF - së, që nga fillimi i Qershorit shërbimet janë ofruar në dy ndërrime, nga ora 7⁰⁰ deri në 19⁰⁰ (prej të hënës deri të premten) dhe nga 7⁰⁰ deri 14⁰⁰ të shtuneve.

Gjatë kësaj *periudhe njëvjeçare* laboratori është pajisur me aparaturë të re nga Ministria e Shëndetësisë. Bëhet fjalë për aparatin hematologjik me kapilarë, aparat ky i sofistikuar, që ofron shërbime më të lehta dhe më të shpejta për pacientët dhe personelin.

1.2.KABINETI I RADIOLOGJISË

Në kuadër të QKMF-së në Ferizaj, funksionon Kabineti i Radiologjisë që përbëhet nga:

1. Kabineti i RTG-së në Dispanzerin Aantituberkular
2. Kabineti i RTG-së digjital në Emergjencën Primare
3. Kabineti i RTG-së dental
4. Kabineti i Mamografisë
5. Kabineti i radiologut në DAT -ultrazëri dhe leximi i filmave
6. Kabineti i radiologut në Shërbimin Emergjent Primar -ultrazëri dhe leximi i filmave

Gjatë vitit **2019** në këtë njësi janë kryer këto shërbime:

Tabela 3.

Shërbimet	Numri i shërbimeve	Numri i pacientëve
Vizita specialistike radiologjike	4 884	4 884
Radiografia të extremiteteve	9 902	12 906
Radiografi të mushkërive	3 004	
Echo e abdomenit	344	344
Echo e gjinjve	848	848
Echo e qafës	63	63
Echo	521	521
Echo e gjëndrës tiroide	25	25
Radiografi e dhëmbit	1 365	1 334
Radiografi e gjinjve	3 457	763
Mamografi lexim	451	
Gjithsej	24 864	21 688

Nevojat dhe kërkesat aktuale për këtë njësi janë:

1. Eliminimi i defektit të RTG- së në DAT-servisimi
2. Furnizimi me qumësht si mjet shtesë për mbrojtje nga rrezatimi
3. Renovimi –lyerja e hapësirave të cilat nuk janë freskuar prej vitit 2012
4. Klimatizimi i kabinetit në RTG-Digjital (dritarja dhe klima)
5. Klimatizimi i kabinetit të Radiologes në DAT

Në njësinë e Kabinetit të Radiologjisë me 4 rëntgen dhe 2 Kabinete të Radiologëve punojnë: 2 radiologe dhe 10 infermierë, të gjithë me përgatitje profesionale dhe Certifikatë të Teknikut të Rëntgenit, numër ky që është optimal për funksionimin e këtyre kabineteve me rëndësi të madhe diagnostifikuese. Natyra e punës me rreze jonizuese që njëkohësisht është edhe e rrezikshme, kërkon që stafi të jetë i kompletuar sepse është e pamundur që një teknik të punojë i vetëm në një kabinet dhe t'i plotësojë kërkesat e mjekëve dhe pacientëve që kërkojnë këtë shërbim shtesë për diagnostifikim. Vlen të theksohet se furnizimi me filma për RTG-DAT nga Depoja Qendrore në bazë të planifikimit është i mirë.

1.3.DISPANZERI I SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE

Në DAT gjatë vitit 2019 janë përpunuar 308 anëtarë të familjeve dhe prej tyre janë zbuluar 4 anëtarë me ILBT. Si raste të dyshuara (supozuara) për TB janë ekzaminuar bakteriologjikisht 385 pacientë dhe janë punuar 704 baciloskopi, prej të cilave 16 pacientë kanë rezultuar pozitiv.

Tabela 4.

Shërbimet	Numri
Vizita specialitike	1 842
Edukim shëndetësor	1 527
Përpunim i kontaktit	388
Raste të reja me TB	62
Baciloskopi	894
Laborator (Se)	41
PPD	462
Vizita shtëpiake	103
Inhalime	58
Testi i HIV-it	12
Matja e peshës trupore	68

Në këtë periudhë janë regjistruar gjithsej 31 raste të reja me tuberkuloz, prej tyre 23 janë me tuberkuloz pulmonar dhe 8 me tuberkuloz ekstrapulmonar, ndërsa dy prej tyre janë raste recidive.

Tabela 5.

Raste të reja	Numri
Pulmonare	45
Extrapulmonare	17
Totali	31

Tabela 6.

Pulmonare	Numri
Pozitive	29
Negative	16
Recidive	2

Kohët e fundit personeli i DAT-it ka ndërmarrë iniciativën e zbulimit aktiv të rasteve me TB (identifikimi i rasteve të dyshimta me TB) në rajonin Ferizaj-Kaçanik-Shtime. Është duke u punuar te të gjithë pacientët e mjekuar më herët, nga viti 2000 e këndej. Këta pacientë dhe anëtarët e tyre që janë të dyshimtë, ftohen për vizita specialistike.

Tabela 9.

Raporti nga zbulimi aktiv i rasteve		Numri
Numri total i të intervistuarve me pyetësor		2967
Të referuar për ekzaminim të mëtejshëm në DSM		402
Rastet e referuara në DSM - Të ekzaminuar klinikisht		385
Rastet e referuara në DSM - Të ekzaminuar me Mantoux		71
Rastet e referuara në DSM - Të ekzaminuar me RTG		309
Rastet e referuara në DSM - Të ekzaminuar bakteriologjikisht		152
Rastet e konfirmuara me TB	Bakteriologjikisht të konfirmuara	8
	Klinikisht të diagnostifikuar	
Rastet e diagnostikuara me infeksion latent të TB (ILBT)		2

2. SHËRBIMET PREVENTIVE

Në shërbimet preventive, që nënkuptojnë promovimin e shëndetit në komunitet, bëjnë pjesë dy njësi të QKMF – së:

- a) Edukimi shëndetësor dhe
- b) Vaksinimi.

Të dyja këto njësi ofrojnë shërbime nëpër shkolla dhe në komunitet dhe organizojnë punën nëpërmjet ekipeve përkatëse.

2.1. Edukimi shëndetësor

Gjatë **këtij viti** Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor, koordinatori i tij, kanë zhvilluar një varg aktivitete, me subjekte të ndryshme, me qëllim të bashkëpunimit dhe realizimit të projekteve të parapara vjetore. Janë zhvilluar shumë takime me përfaqësues të strukturave dhe institucioneve të ndryshme si: zyrtarët e DSHMS-së, udhëheqësen e rrjetit të grave nga Komuniteti RAE, përfaqësues nga organizata “Aleanca e grave për Integrim”, përfaqësues nga IKSHP dhe KESH, përfaqësuesit e HANDIKOS-it, përfaqësuesen e organizatës "Save dhe children" etj. Gjithashtu, janë organizuar aktivitete të shumta për shënimin e Ditëve Ndërkombëtare të Shëndetit, por edhe ligjërata e projekte edukative shëndetësore në shkolla dhe komunitet.

- Në HANDIKOS, më 24 Janar në kuadër të projektit “Shërbimet e kujdesit ditor të bazuara në komunitet te personat me aftësi të kufizuara”, Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor i QKMF – së në Ferizaj, filloi këtë aktivitet për vitin 2019. Aktivitetet e këtij projekti, kanë për qëllim vetëdijesimin e grupit përfitues (personat me nevoja të veçanta) për higjienën trupore. Mjekët kanë bërë ekzaminimin fizik të personave përfitues (ekzaminimin e kokës dhe trupit për pedikulozë dhe skabies, si dhe ekzaminime tjera), edukimin dhe këshillimin për higjienën trupore, trajtimin e personave të detektuar me këto problematika, si dhe edukimin dhe këshillimin e familjarëve e stafit që merret me personat përfitues. Personeli mbikëqyrës i HANDIKOS-it krijoi një ambient të përshtatshëm për realizimin e këtij aktiviteti, ku janë ekzaminuar 21 persona.

- Ky projekt ka vazhduar edhe më 26 shkurt 2019, në HANDIKOS, ku Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor i QKMF – së në Ferizaj, mbajti ligjëratën “Mbrojtja e ambientit”, në të cilën ishin prezent rreth 25 persona përfitues. Më 28 mars 2019, Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor realizoi vizita shëndetësore të këtyre përfituesve dhe mbajti ligjëratën “Infeksioni i traktit urinar - Si ta

parandalojmë?” Ndërsa më 24.04.2019, Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor realizoi vizita të përfituesve në lidhje me shëndetin e tyre dhe ligjëratën "Alergjitë".

- Për nder të 24 marsit “Ditës Botërore të Tuberkulozit” Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor filloi aktivitetin në SHMU” Jeronim De Rada”, me moton “Është KOHA – Fund

Tuberkulozit” ku u mbajt ligjërata për vetëdijesimin e të rinjve për këtë sëmundje, me theks të veçantë të mënyra e transmetimit, këshillimi, parandalimi dhe format e mjekimit. Gjatë aktivitetit u shpërndanë fletëpalosje për informimin e nxënësve rreth kësaj sëmundjeje, si dhe rolit të secilit prej tyre në detektimin më të hershëm në rrethin ku jetojnë të personave që shfaqin simptoma, në mënyrë që nga profesionistët shëndetësor të merren hapa të hershëm në eradikimin e kësaj sëmundjeje. Po ashtu së bashku me përfaqësuesit e IRSHP, me nxënësit e kësaj shkolle u realizua defilimi nëpër qendër të qytetit, ku u shpërndanë fletëpalosje për vetëdijesimin e qytetarëve për sëmundjen e tuberkulozit.

- Më 11.04.2019, Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor në kuadër të Projektit “Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë për kujdesin dhe zhvillimin gjatë fëmijërisë së hershme në Kosovë” në SHFMU në fshatin Zaskok, mbajti ligjëratën "Sëmundjet lëkurore në fëmijërinë e hershme". Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin nëna të fëmijëve 3 – 6 vjeç, fëmijë parashkollorë dhe edukatore.

- Më 26 prill - për nder të Javës Evropiane të Vaksinit, Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor në kuadër të QKMF –së dhe QRSHP –së/Ferizaj, ndërmoi një aktivitet në Qendrën Socio – Edukative /Caritas, në fshatin Dubravë me komunitetin RAE. Së pari u mbajt një takim pune mes përfaqësuesve të tri institucioneve: Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Institutit Rajonal të Shëndetit Publik dhe Qendrës Socio-Edukative në Dubravë. Pas këtij takimi, u zhvilluan edhe takime grupore të komunitetit RAE me qëllim të vetëdijesimit të popullatës për rolin që ka vaksinimi i rregullt dhe me kohë i fëmijëve të tyre.

- Më 10.05.2019, në SHFMU në fshatin Zaskok, Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor, në kuadër të Projektit “Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë për kujdesin dhe zhvillimin gjatë fëmijërisë së hershme në Kosovë” mbajti ligjëratën: "Të ushqyerit me qumësht gjiri". Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin nëna të fëmijëve 3 – 6 vjeç, fëmijë parashkollorë dhe edukatore.

- Për nder të 17 Majit “Ditës Botërore të Hipertensionit”, Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor në kuadër të QKMF - Ferizaj, në bashkëpunim me IRSHP - Ferizaj, organizoi aktivitete të shumta me moton “Kontrollohu te Mjeku Familjar – Kujdesu për Shëndetin Tënd”. Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor kryesisht është fokusuar në vetëdijesimin e popullatës për parandalim të Hipertensionit Arterial, në veçanti për: faktorët e rrezikut, të ushqyerit e shëndetshëm dhe aktivitetin fizik. Është bërë mbledhja e të dhënave nga Qendrat e Mjekësisë Familjare në Ferizaj (QKMF, QMF 1, QMF2, QMF4), përmes anketimit të pacientëve të rastit që gravitojnë në këto qendra, matjes së shtypjes së gjakut, matjen e peshës dhe gjatësisë, përcaktimi indeksit të masës trupore (IMT). Këto evidenca shkencore do të përpunohen ndërkohë dhe Grupi për Promovim dhe Edukim do të dalë me rekomandime, me qëllim të ndikimit në politikat shëndetësore rreth depistimit të presionit të gjakut. Në këtë aktivitetet u janë dhënë këshilla pacientëve për hipertensionin kryesisht të fokusuar në ushqim të shëndetshëm, aktivitetet fizike

-

dhe faktorët e rrezikut. Përveç këshillave gjatë aktiviteteve janë shpërndarë edhe fletëpalosje. "Muaji i Matjes së Presionit Arterial” është një fushatë globale ndërgjegjësimi e udhëhequr nga Shoqata Ndërkombëtare e Hipertensionit, e cila përfaqëson shkencëtarët, klinikistët, ofruesit e kujdesit shëndetësor nga e gjithë bota, të cilët kanë interes të përbashkët në fushën e kërkimit për hipertensionin arterial. Kjo fushatë ka në qendër të vëmendjes rritjen e aksesit ndaj depistimit të presionit arterial si mënyra potencialisht më efektive për të ulur efektet e dëmshme të hipertensionit në shëndet.

- Më 23.05.2019 - Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor në kuadër të QKMF-së Ferizaj, filloi projektin për realizimin e vizitave sistematike me qëllim të vlerësimit të parametrave të rritjes, zhvillimit, defekteve të boshtit kurrizor, higjienës dhe patologjive tjera, si dhe vizitat sistematike për shëndet oral në shkollat fillore të Komunës së Ferizajt. Në këtë projekt do të përfshihen nxënësit e grup moshave 6 vjet dhe 10 vjet (klasa e parë dhe e pestë). Projekti filloi në SHMU “Pesë Dëshmorët e UÇK – së” në fshatin Pleshinë. Vizitat sistematike janë hapi i parë drejt identifikimit dhe ndryshimit të gjendjeve patologjike, meqë një nga arsyt pse kemi një ngecje të tillë në arritjen e një performance të mirë shëndetësore, është pikërisht mosparaqitja me kohë tek mjeku. Me këtë vlerësim, vizita dhe këshillim, synohet që përmes paraqitjes së përvojave të vendeve të zhvilluara, të konkretizohen praktikatat e mira në rininë tonë. Grup përfitues i drejtpërdrejt i këtij projekti janë nxënësit në radhë të parë, për të cilët synohet mirëqenia dhe jeta e shëndetshme.

- Për nder të 31 Majit - Ditës Botërore kundër Duhanit, anëtarët e Grupit për Promovim dhe Edukim Shëndetësor në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj, bashkë me Institutin Rajonal të Shëndetit Publik në Ferizaj, realizuan një varg aktivitete për promovimin, ndërgjegjësimin, ngritjen e njohurive dhe motivimin e të rinjve kundër konsumimit të duhanit. U mbajtën ligjërata në SHFMU “Jeronim De Rada”, “Ganimete Tërbeshi”, “Ahmet Hoxha”, “Besim Rexhepi” - në fshatin Komogllavë, si dhe “Gjon Serreçi” me të gjithë nxënësit e klasave të VIII-ta.

- Për pesë ditë me radhë, më 21, 23, 28, 29 dhe 30 Maj në kuadër të projektit “Shërbime të kujdesit ditor me bazë në komunitet, për personat me aftësi të kufizuara” - janë mbajtur aktivitete ndërgjegjëse me qëllim ngritjen e vetëdijes së komunitetit për çështjen e aftësisë së kufizuar përmes mbajtjes së ligjëratave dhe aktiviteteve në pesë shkolla të mesme, në: Qendrën e Kompetencës, Gjimnazin “Kuvendi Arbërit”, Gjimnazin “Dr. Shaban Hashani”, Shkollën e Mesme Ekonomike “Faik Konica” dhe Shkollën e Mesme Teknike “Pjetër Bogdani”.

- 30 Shtator - Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor në kuadër të QKMF- Ferizaj, sot shënoi “Ditën botërore të zemrës”, me moton “Një premtim ... për zemrën time, për zemrën tënde, për të gjithë zemrat tona”, në mënyrë që të kuptohet se çka duhet ndërmarrë për të reduktuar faktorët e rrezikut dhe për të pasur një zemër të shëndoshë. Fushata e sivjetme do të organizohet me moton: “Zotohu për një zemër të shëndoshë. Zotohu se do të ushqehesh shëndetshëm.” Aktivitetet për këtë ditë dhe me këtë moto zhvillohen në mbarë botën, me qëllim që të nxisin ndryshime të vogla për një zemër të shëndoshë. Në katër Qendrat e Mjekësisë Familjare në Ferizaj u zhvilluan aktivitete si: matja e tensionit arterial për pacientët e rastit që gravituan në këto qendra, saturimi i oksigjenit dhe pulsi, si dhe janë dhënë këshilla për pacientët. Gjithashtu janë shpërndarë broshura që janë ofruar nga IRSHP – Ferizaj.

Më dt .08, 15,19,20,21. 11.2019 Në kuadër të muajit “Nëntori-muaji i vetëdijësimit kundër substancave narkotike”. Grupi për Promovim dhe Edukim Shëndetësor ofroi bashkëpunim Qendrës Këshilluese “Këshillimi” për realizimin e ligjeratave vetëdisuese për këtë dukuri, me nxënësit e Shkollave të mesme të Komunës sonë.

[14 Nëntor 2019](#) · Për nder të “Ditës Botërore të Diabetit” Grupi I PESH –it, me moton “Vepro sot, ndrysho të ardhmen” në QKMF, QMF 1, dhe QMF4 anëtarët e këtij grupi bënë matjen e glikemisë te

pacientët e rastit, ofruan këshilla se si të parandalohet diabeti, shpërndan lifleta me qëllim të informimit sa më të drejtë të pacientëve dhe komunitetit në përgjithësi. Ndërsa në QMF 2 është organizuar dreka tradicionale diabetike.

21 Nëntor 2019 · Me moton "Sporti dhe Shëndeti" - Sektori i Rinisë dhe Këshilli Organizativ në bashkëpunim me Grupin për Promovim dhe Edukim Shëndetësor në kuadër të Mjekësisë Familjare organizuan ligjëratë të "Shtëpia e bamirësisë". Para të rinjve të qytetit u mbajt ligjëratat me qëllim të promovimit dhe informimit rreth rolit të sportit në kujdesin ndaj shëndetit.

- Të arriturat nga aktivitetet e realizuara nga Grupi i Promovimit dhe Edukimit Shëndetësorë për vitin 2019, janë të fokusuara konkretisht në këto 3 shtylla:

- I. Ligjerata
- II. Seanca këshilluese
- III. Vizita sistematike

*Këto të dhëna janë të paraqitura në tabela dhe grafikonet e mëposhtme

I	LIGJËRATAT	Nr. i ligjëratave	Nr. i pjesëmarrësve	
1	Parandalimi i kancerit të qafës së mitrës	4	80	Femra
2	Parandalimi i kancerit të gjirit	4	80	femra
3	Të ushqyerit me qumësht gjiri	4	80	femra
4	Shëndeti oral dhe parandalimi i kariesit	1 1 2 1 gjiths	30 20 160 25 235	Nxenes (kl 1) Parashkollore Nënat e fëmijëve 0-6 vj, edukatorë, parashkollorë HANDIKOS (përfutuesit)
5	Kujdesi për higjenën e ambientit natyra për ujin	1 2	90 55	Nxenes(kl. 11) Nxënës(kl.10 dhe 11)
6	HTA	4	260	komunitet
7	ZEMRA	4	200	komunitet
8	ADOLESHENCA	5	150	Kl.IX
9	DUHANI	15	450	Nxenesit e kl.VIII
10	DROGAT	15	450	Nxenesit e kl.VIII
11	Parandalimi I komplikimeve te diabetit	4	115	komunitet
12	Parandalimi I TB	3	120	nxenes
13	Problemet lëkurore në fëmijërinë e hershme	1	30	Nëna të fëmijëve 0-6 vj.(Save the children)
14	Të ushqyerit me qumësht gjiri	1	35	Nëna të fëmijëve 0-6 vj.(Save the children)
15	Edukimi	1	25	HANDIKOS
16	Shendeti oral	1	25	(përfutuesit)

17	Alergjite	1	25	
18	Ndihmae parë	1	25	
19	Të ushqyerit e shëndetshëm	1	25	
20	Higjena e trupit	1	25	
21	Infeksionet e traktit urinar	1	25	
22	Nritja e vetëdijes së komuniteteit për çasjen ndaj personave me aftësi të kufizuar	5	250	nxënës t e shkollave të mesme
23	Roli I vaksinimit	1	20	Gra të komunitetit RAE

II . SEANCAT KËSHILLUESE	EDUKIMI DHE KËSHILLIMI GJATË KËTYRE VIZITAVE Temat e përfshira	GJITHSEJ v. 2019
GJATË VIZITAVE PËR NËNA DHE FËMIJË	Të ushqyerit me qumësht gjiri Vetë-kontrolli i gjirit Planifikim familjar	2824
GJATË VIZITAVE TEK PERSONAT ME TB	Edukim dhe këshillim për anëtarët e ngushtë dhe familjen e gjerë rrethë TB .	4315
GJITHSEJT		7139

III. VIZITAT SISTEMATIKE	GJITHSEJ
Vizitat sistematike ne 6 shkolla fillore , kl – 1 dhe kl- 5 (janë të paraqitura në hulumtim – specifikat)	225
Shëndeti oral dhe parandalimi i kariesit :	235
Nxënës (kl.I)	30
Parashkollorë	20
Nënat e fëmijëve 0 – 6 vj.,educatorë, parashkollorë	160
HANDIKOS (përfituesit)	25
GJITHSEJ	460

Realizimi i vizitave sistematike të përgjithshme dhe vizitat sistematike për shëndet oral në shkollat fillore të Komunës së Ferizajt.

Për të evituar rrugën e gjatë që kërkon procesi i shërimit, duhet bërë përpjekje në drejtim të mbrojtjes së shëndetit, si zgjidhje më efikase drejt mirëqenies së plotë. Për të arritur nivel më të lartë të shëndetit të popullatës, duhet të bëhet edukimi shëndetësor i saj dhe vizita sistematike.

Udhezimi administrativ (Shëndetësi) Nr.08/2017 Neni 4 pika 2.2 (citat: Mbrojtja parandaluese nëpërmjet programeve të promovimit të shëndetit dhe vizitave sistematike të fëmijëve dhe të rinjve në shkollat fillore, të mesme dhe të larta në territorin e Komunës)

- Projekti ka filluar në muajin PRILL dhe do të jetë në vazhdimësi 2019 – 2021, kur nxënësit e shkollave përkatëse janë në proces të rregullt shkollor.
- Sa i përket resurseve materiale janë të nevojshme:
 - Peshore, Metër për matjen e gjatësisë, Dorëza, shpatulla’
 - **Formular për vlerësimin e gjendjes shëndetësore (forma 1 dhe 2).....etj.**
- **Fokus i hulumtimit-** nxënësit
 - grup moshat 6 **vjet** si dhe **10 vjet (kl. 1 dhe 5)**
- **Aktivitetet -** Janë përfunduar- **6 shkolla** fillore të komunës së Ferizajt

Data	SHKOLLA FILLORE	VENDI QYTET/FSHAT	KL . I –rë			KL. V –të		
			M	F	GJ	M	F	GJ
23.05.2019	“Pesë Dëshmorët e UÇK –së”	Pleshinë	11	9	20	10	5	15(+1m)=16
22.10.2019	“Pavarësia”	Balaj	4	8	12	8	10	18
29.10.2019	“Kemajl Hetemi”	Rahovicë	6	3	9	6	5	11
05.11.2019	“Dardania”	Rakaj	8	12	20 (+1m)=21	13	8	21
19.12.2019	“Riza Matoshi”	Nikadin	10	13	23 (+2m)=25	11	10	21 (+1m)=22
03.12.2019	“Enver Topalli”	Omuraj	20	8	28 (+2m)=30	17	10	27 (+1m)=28


Ku janë përfshirë **225** nxënës .

KL. – I – rë			KL. – V – të			KL I & V		
M	F	GJ.	M	F	GJ.	M	F	GJ.
59	53	112	65	48	113	124	101	225


FORMULARI PËRMBLEDHËS			Nxënësit KL. I - rë				Nxënësit KL.V – të			
VIZITAT SISTEMATIKE (6 SHKOLLA)			M	F	Gj.	%	M	F	Gj.	%
SYTË	TË PAMURIT	PA NDRYSHIME	57	51	108	93%	64	44	108	96%
		ME NDRYSHIME	0	0	0		1	3	4	3%
		ME SYZE /	2	2	4	7%	0	1	1	1%
VESHI	NDËGJIMI	PA NDRYSHIME	59	53	112	100%	65	48	113	100%
		ME NDRYSHIME	0	0	0		0	0	0	
SISTEMI RESPIRATOR	PA NDRYSHIME		43	41	84	75%	58	45	103	91%
	SR I sipërm	RINIT	0	0	0		0	0	0	
		TONSILLIT KRONIK	16	12	28	25%	5	3	8	7%
		GJËNDRRAAT E AJURA	0	0	0		2	0	2	2%
	SR I poshtëm	MUSHKERITE	0	0	0		0	0	0	
ZEMRA	PAVEQORI		59	53	112	100%	65	48	113	100%
	ME NDRYSHIME		0	0	0		0	0	0	
ABDOMENI	PAVEQORI		59	53	112	100%	65	48	113	100%
	ME NDRYSHIME		0	0	0		0	0	0	
TË META NË TË FOLUR			2	0	2	2%	0	3	3	3%
KONSTATIME TJERA PATOLOGJIKE			0	0	0		0	0	0	

FORMULARI PËRMBLEDHËS		Nxënësit e KL.I – rë				Nxënësit e KL.V- të			
VIZITAT /STOMATOLOGJI (6 SHKOLLA)		M	F	Gj.	%	M	F	Gj.	%
K1- Karies fillestar		28	17	45	40%	39	35	74	65%
K2- Karies i mesëm		46	39	85	76%	40	28	68	60%
K3- Karies i thellë		42	27	69	62%	43	19	62	55%
Kp.- Pulpit		0	0	0		4	1	5	4%
Kg.- Gangrene		0	0	0		3	0	3	3%
RR- Rrënjë e dhëmbit		26	21	47	42%	19	10	29	26%
E- Dhëmbi i hequr		0	0	0		0	0	0	
M- Dhëmbi mungon		0	0	0		0	0	0	
P – Dhëmbi i pllombuar		4	5	9	8%	11	18	29	26%
Ks- Karies sekondar		0	0	0		0	0	0	
Kc – Karies cirkular		0	0	0		0	0	0	
MP- Mbushje e përkohshme		0	0	0		0	0	0	
D- Dhëmbi në dalje		0	0	0		0	0	0	
Fr- Dhëmbi i frakturuar		6	0	6	5%	0	0	0	
H- Hipoplazion		2	7	9	8%	1	1	2	2%
Higjiena e gojës dhe e dhëmbëve	E MIRË	37	44	81	72%	45	38	83	73%
	JO E MIRË	22	9	31	28%	20	10	30	26%
Gjendja e mukozës orale dhe gjingjivës	E MIRË	59	52	111	99%	65	38	113	100%
	JO E MIRË	0	1	1	1%	0	0	0	
Rast ortodontik		2	3	5	4%	10	8	18	16%
Prezenca e furunculit		8	3	11	10%	2	5	7	6%
PA NDRYSHIME		0	0	0		2	2	4	4%


IMT (Indeksi i masës trupore)




HIGJIENA




Qëndrimi trupor




Boshti kurrizor




Të pamurit




Sistemi respirator



Vizitat stomatologjike/ Kl I –rë ; % e patologjive më të shpeshta të gjetura në 6 shkollat



Vizitat stomatologjike/ Kl V –të ; % e patologjive më të shpeshta të gjetura në 6 shkollat



Rekomandimi gjatë takimit përmbyllës për vizitata e bëra / për Drejtorët e këtyre shkollave:

Janë pajisur drejtorët e shkollave me dokumentacionin për nxënësit e ekzaminuar në shkollat e tyre , gjegjësisht nxënësit e kl. I-rë dhe V-të, dhe u informuan se si do i informojnë prindërit e këtyre nxënësve për rezultatet nga ekzaminimet e bëra dhe si ata do ju qasen personelit shëndetësor. Poashtu drejtorët u informuan se si duhet ta ruajnë privatësinë e secilit nxënës mbi shëndetin e tyre.

1.2. Shërbimi i vaksinimit

Gjatë **vitit 2019** Shërbimi i Vaksinimit në QKMF ka vazhduar të jetë mjaft i suksesshëm. Në të gjitha QMF-të dhe AMF-të, janë dhënë gjithsej **38 118** vaksina, prej të cilave **3 719** vaksina janë dhënë nëpër shkolla, te nxënësit e klasave të gjashta dhe maurantët. Përqindja e vaksinimit në raport me numrin e popullatës është **97 %**. Pas pensionimit të përgjegjëses së Shërbimit të Vaksinimit, në vend të saj është emëruar Dr. Drita Nazifi - Emini, specialiste e Mjekësisë Familjare.

Tabela 10. Vaksinimi sipas qendrave

<i>Qendra</i>	<i>Vaksinat nëpër njësi</i>	<i>Vaksinat në shkolla</i>	<i>Totali</i>
QKMF	21 058	5 905	26 963
QMF 1	2 256		
QMF 2	4 295		
QMF 4	1 667		
QMF Greme	972		
AMF - të	1 965		
Totali	38 118	5 905	

Tabela 11.

<i>Grupmoshat</i>	<i>Numri i vaksinave</i>
Klasa e parë	1 757
Klasa e gjashtë	1 918
Maurantët	2 230
Totali	5 905

2.3 Qendra Informuese për Shëndetin e Gruas

Në Qendrën Informuese për Shëndetin e Gruas në QMF 2, gjatë **këtij viti**, janë ofruar **261** shërbime dhe trajnime individuale dhe grupore, për gra shtatzëna dhe familjet e tyre.

2.4 Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë

Shërbimi i Vizitave Shtëpiake për Nëna dhe Fëmijë gjatë **këtij viti**, ka ofruar **2748** vizita që janë tejet të rëndësishme për ruajtjen e shëndetit të nënave dhe fëmijëve, ushqyeshmërinë e fëmijëve dhe parandalimin e sëmundjeve të ndryshme apo identifikimin e hershëm të tyre.

Tabela 12. Vizitat shtëpiake për nëna dhe fëmijë

<i>Qendra</i>	<i>Numri i vizitave</i>
<i>QKMF</i>	<i>946</i>
<i>QMF 1</i>	<i>457</i>
<i>QMF 2</i>	<i>804</i>
<i>QMF 4</i>	<i>329</i>
<i>AMF</i>	<i>232</i>
<i>Totali</i>	<i>2 748</i>

Sipas numrit të vizitave gjatë këtij viti, jemi ranguar të parët në Kosovë.

3. SHËRBIMET EMERGJENTE

Shërbimi emergjent si njësi në kuadër të QKMF-së, gjatë **këtij viti** ka intervenuar në **2426** raste emergjente, mirëpo përveç rasteve emergjente aty janë ofruar edhe **20 076** shërbime të tjera. Shërbimet emergjente në terren dhe shërbimet e tjera janë paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 13. Numri i shërbimeve emergjente mjekësore në bazë të entiteteve emergjente:

Shërbimet emergjente	Numri i rasteve
Emergjencat internistike	585
Emergjencat infektive	3
Emergjencat kirurgjike	42
Emergjencat ortopedike	99
Emergjencat pediatrike	3
Emergjencat gjinekologjike	5
Emergjenca toksikologjike	32
Emergjencat neurologjike	91
Emergjencat psikiatrike	140
Emergjencat geriatrike	219
Trauma në komunikacion	236
Dhimbje akute	384
Trauma në punë	19
Trauma në familje	19
Trauma me armë zjarri	3
Trauma me armë të ftohta	16
Vetëvrasje me armë	2
Tentim vetëvrasje me armë kimike	3
Sëmundje malinje	241
Verifikim i vdekjes	274
GJITHSEJ	2 426

Pacientët tek të cilët intervenohet jo gjithherë vazhdojnë trajtimin në QKMF, një numër i tyre dërgohen edhe nëpër institucionet e tjera brenda ose jashtë qytetit, varësisht nga gjendja e tyre shëndetësore dhe mjekimi që duhet t'u ofrohet. Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat lidhur me vazhdimin e mëtejshëm të trajtimit të tyre.

Table 14. Trajtimi i pacientëve pas ndihmës emergjente

Të trajtuar në:	
QKMF	97
Shtëpi	1 164
Aksident komunikacioni	209
Të transportuar në:	
Spital – Ferizaj	456
QKUK	47

Tabela në vijim paraqet shërbimet e tjera që ofrohen në objektin e SHEP.

Tabela 15. Shërbimet e tjera në SHEP

Shërbimet e tjera	Numri
Vizita mjekësore	2 184
EKG	369
Therrje intramuskulare	669
Therrje intravenoze	0
Infuzione	10 272
Lidhtore	312
Riqna	29
Kateterizime	60
Matja e glikemisë	160
Inhalime	236
Reanimime	266
Interpretim i RTG - së	1 363
ECHO e gjirit	848
ECHO të tjera	88
Mamografi lexim	451
Shërbimet në terren	2 426
Totali	20 076

4. KUJDESI SHTËPIAK

Në kuadër të kujdesit shtëpiak si njësi që funksionon në katër QMF – të, realizohen **vizitat shtëpiake** me një staf të përgatitur mirë që tregon suksese në përmbushjen e obligimeve të punës, përkundër faktit që kjo punë bëhet nëpër shtëpitë e pacientëve të cilët janë në gjendje shumë të rëndë dhe të palëvizshëm. Gjatë **vitit 2019**, janë kryer gjithsejtë **4 587** vizita shtëpiake dhe kjo tregon se organizimi i kësaj njësie është shumë i suksesshëm dhe i nevojshëm.

Tabela 16. Raporti i Shërbimit të Kujdesit Shtëpiak

Kujdesi shtëpiak në	Numri i shërbimeve
QKMF	1 359
QMF I	953
QMF II	1 350
QMF IV	895
DAT-i	103
Të tjera	17
GJITHSEJ	4 587

5. KUJDESI SHËNDETËSOR ANTENATAL (KAN)

Kujdesi shëndetësor antenatal realizohet në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare, ku gjenden dhomat për Kujdesin antenatal (KAN) të cilat udhëhiqen nga infermieret e trajnuara për këtë qëllim, që bashkë me mjekun, përcjellin tek pacientet periudhën e shtatzënisë dhe lehonisë. Raporti i këtij shërbimi për **vitin 2019** është **6 000** vizita.

Tabela 17. Raporti i Shërbimit të Kujdesit Antenatal

Kujdesi Antenatal	Numri i shërbimeve
QKMF	2 462
QMF I	77
QMF II	2 781
QMF IV	297
GJITHSEJ	6000

6. AMBULANCAT E MJEKËSISË FAMILJARE

Në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare funksionojnë 10 Ambulanca të Mjekësisë Familjare në fshatrat: Mirash, Softaj, Mirosalë, Dardani, Varosh, Gaçkë, Nerodime, Jezerc, Llojza dhe Talinovc, ndërsa në Greme, Komogllavë dhe Pleshinë funksionojnë QMF 3, QMF 5 dhe QMF 6. Gjatë **këtij viti** në të gjitha AMF – të nëpër fshatra, numri i përgjithshëm i shërbimeve është **30 984**, prej të cilave **10 199 janë** vizita mjekësore dhe **20 785** shërbime infermierike.

NJËSIA E FARMACISË

Njësia e farmacisë gjatë **vitet 2019** ka vazhduar punën e saj në distribuimin dhe disperzimin e barnave dhe materialit medicinal. Depoja qendrore pranë QKMF - së furnizohet nga: Ministria e Shëndetësisë - Divizioni i Farmacisë, operatori ekonomik dhe donacionet.

AKTIVITETET (distribuim dhe disperzim i barnave dhe materialit medicinal):

Distribuim i kënaqshëm është arritur në këto pika furnizuese

Barnatorja pranë QKMF -së; Barnatorja pranë QMF 1; Barnatorja pranë QMF 2; Barnatorja pranë QMF 4; Kryeinferimeri pranë QMF; Kryeinfermieri pranë QMF 1; Kryeinfermieri pranë QMF 2; Kryeinfermieri pranë QMF 3; Kryeinfermieri pranë QMF 4; Laboratori QKMF; Laboratori QMF 1; Laboratori QMF 2; Laboratori QMF 3; Laboratori QMF 4; Kujdestaria e natës –I-II-III; Shërbimi emergjent; Rëntgeni; Stomatologjia; AMF- Neredime, Llojza, Dubravë, Softaj, Dardani, Gaçkë, Varosh, Mirosalë, Jezerc

Tabela 18. Shërbimet e farmacisë

<i>Qendra</i>	<i>Shërbime të farmacisë</i>
<i>QKMF</i>	<i>15 561</i>
<i>QMF 1</i>	<i>3 282</i>
<i>QMF 2</i>	<i>6 571</i>
<i>QMF 4</i>	<i>2 258</i>
<i>AMF</i>	<i>636</i>
<i>Totali</i>	<i>28 308</i>

Buxheti i planifikuar i Ministrisë së Shëndetësisë për Barna, material harxhues mjekësor dhe diagnostik

I. Pasqyra e përgjithshme e furnizimit e përkthyer në vlerë monetare

Tabela 19.

Muaji	Buxheti
Janar	24,458.316
Shkurt	23,626.478
Mars	22,516.6770
Prill	21,980.4215
Maj	22,331.415
Qershor	20,771.459
Korrik	22,332.382
Gusht	19,814.541
Shtator	19,506.260
Tetor	19,581.231
Nëntor	17,204.08
Dhjetor	23,347.865
Totali	257471.125

Realizimi i furnizimit për vitin 2019 përkthyer në përqindje.

Tabela 20.

II.	Buxheti	Te shpenzuara	Të mbetura	Realizimi
	për vitin 2019			Përqindja
	344,000.00	257471.125	86528.875	74.846%

Kategoria e insulinëmarrësve

Shfrytëzuesi më i madh i buxhetit vjetor të dedikuar për QKMF - Ferizaj nga MSH janë kategoria e insulinëmarrësve në një përqindje prej afro 55.8 %. tabela me poshtë:

Tabela 21.

III	Buxheti për vitin 2019	Të shpenzuara /insulina	Realizimi /Përqindja
	344,000.00	191948.51	55.8%

QENDRA TRAJNUESE E MJEKËSISË FAMILJARE

AKTIVITETET NË QTMF:

Në Qendrën Trajnuese të Mjekësisë Familjare gjatë **vitit 2019** janë zhvilluar aktivitetet e rregullta sipas planit.

- Aktivitetet e Mentorëve Klinikë në QTMF/Ferizaj janë të parapara nga programi i edukimit specialistik, por edhe nga punët në QKMF, apo nga postet të cilat i zotërojnë. Nga aktivitetet e shumta të tyre po veçojmë:

- Ligjëratat qendrore në QZHMF – Prishtinë;
- Ushtrimet klinike në QTMF – Ferizaj;
- Monitorimi në përgjegjësinë e mentorit klinik të ushtrimeve klinike në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt;
- Puna me pacientë;
- Aktivitetet në kuadër të QKMF si: ZHVP, Edukim në komunitet, këshilla profesionale dhe takime profesionale në QKMF dhe QZHMF;

- f) Aktivitetet e zhvilluara gjatë ushtrimeve klinike në QTMF që janë të parapara me programin specialistik në MF si: Vlerësimi në mes dhe në fund të modulit, plotësimi dhe vlerësimi i fletores së punës, vlerësimi i tandem konsultimit, vlerësimi i prezantimit të rastit, vlerësimi i videoincizimit, vlerësimi i auditit, vlerësimi i shkathtësive klinike varësisht nga moduli përkatës, puna grupore për ushtrime klinike në harmoni me ligjëratat e mbajtura në QZHMF-Prishtinë.

QZHMF-Prishtinë

- g) Prezantimi aktiv i mentorëve klinik në pilot projektin akreditues të programit të MF nga RCGP;
- h) Marrja pjesë aktive në avancimin e programit të mjekësisë familjare në QZHMF, Prishtinë në grupin AKT dhe CSA;
- i) Trajnimet e ndryshme në kuadër të trajnimeve në QTMF dhe QZHMF.
- j) ZHVP dhe aktivitetet e saja të parapara në programin e hartuar qysh në fillim të vitit 2018, kjo periudhë ka qenë e ngarkuar me aktivitete dhe detyra të tjera në kuadër të programit të ESP, por me një punë kompetente ka arritur t'i përmbush detyrat që janë të parapara në ESP dhe aktivitetet tjera. Aktivitetet e ZHVP në **vitin 2019** janë përmbushur në përgjithësi edhe pse në mungesë të një fondi nga KK-Ferizaj për këto aktivitete, falë punës së palodhshme të stafit të QTMF e në veçanti personit zyrtar të ZHVP, ka arritur kriterin e dëshiruar të ZHVP me ligjëratat e mbajtura në QTMF nga ekspertet tanë dhe të jashtëm për fushat e caktuara që janë relevante në KPSH.

AKTIVITETI NË KPSH / IMPLEMENTIMI I STRATEGJISË NË KPSH:

- Trajnimet në QTMF dhe QZHMF të mjekëve dhe infermierëve në fusha të caktuara si SST, PF e shumë të tjera,
- Pjesëmarrja aktive në këshilla dhe takime të avancuara, me qëllim të implementimit të konceptit të Mjekësisë Familjare në KPSH.

TË ARRITURAT:

- E arritura më e madhe në këtë periudhë është pranimi i tre mentorëve klinikë të QTMF-së si anëtarë të rregullt në Kolegjin Mbretëror Britanik (Royal College of General Practitioners).
- Realizimi me kohë i përmbushjes së të gjitha obligimeve që dalin për ESP me kohë për një gjeneratë të specializantëve në QTMF.

ZHVP

Gjatë 12 muajve të vitit 2019 nga zyra e ZHVP-ës janë zhvilluar aktivitete të cilat kanë për qëllim ngritjen profesionale të mjekëve familjar dhe mjekëve të përgjithshëm. Aktivitetet paraprakisht janë akredituar nga Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional pranë OMK me ç'rast secili pjesëmarrës i merr 2 pikë kredituese kurse ligjëruesit 3 pikë kredituese. Këto pikë mundësojnë licencimin dhe rilicencimin e punëtorëve shëndetësor. Sa i përket natyrës së aktiviteteve janë zhvilluar ligjërata, punëtori, trajnime me metodologji interaktive ku pjesëmarrësit e aktiviteteve kanë qenë në qendër.

Ky vit është karakterizuar edhe me aktivitete dhe bashkëpunim të madh me agjensione, organizata të ndryshme si dhe me profesionistë jashtë vendit në mënyrë që t'u ofrojmë profesionistëve tanë sa më shumë mundësi për ngritje profesionale dhe mundësi të përfitimit të pikëve për licencim dhe rilicencim. Zyra e ZHVP ka qenë si zyre ndërlidhëse mes QKMF dhe agjensioneve, organizatave dhe profesionistëve jashtë vendit.

QTMF-ZHVP si qendër regjionale gjithashtu ka kontribuar për edhe komunat si Kaçaniku, Shtërpca, Shtimja dhe Vitia në ngritje profesionale. Vlen të përmendet bashkëpunimi me organizatat:

- PRAK-Shoqata për të Drejta të Pacientit me ç'rast gjatë vitit janë organizuar 3 trajnime të gjitha të akredituara nga OMK
- AMFK-Asociacioni i Mjekëve Familjar-janë organizuar 3 ligjërata-
- UNFPA-është mbështetur Auditi Klinik-Planifikimi Familjar
- UNICEF-Trajnimet për vizita në shtëpi
- AMC-Trajnimet për shëndetin e nënës dhe fëmijës
- QS-Ligjërues nga QS kanë kontribuar në ngritjen profesionale të stafit të QKMF
- PEN-trajnim 3 ditor për prindërim
- Instituti Kosovar për Menaxhim dhe MSH-trajnim 5 javor-Gusht-Shtator 2019 me ç'rast janë trajnuar 166 punëtorë shëndetësor të komunës tonë prej tyre 23 mjekë dhe 143 infermierë.
- Ekipi zviceran-dr. Martin Hofer –anesteziolog dhe Suzana Hofer trajnere për paramedic
- Dr. Arsim Azemi-internist.

Ligjëratat, trajnimet dhe punëtoritë gjatë muajve

- Infeksionet e traktit respirator të fëmijët-dr. Hysen Demelezi pediatër
- Diabeti dhe komplikimet-dr. Fatbardh Ramadani internist
- Të drejtat e pacientit-PRAK

- Infeksionet virale-dr.Teuta Kryeziu-mjeke familjare
- Interpretimi i analizave laboratorike-dr. Blerim Gashi-biokimist
- Udhërrëfyshi klinik-Diabetes Melitus-dr. Drita Lumi-mjeke familjare
- Infeksionet e traktit urinar-dr. Shemsije Selmani , mjeke familjare
- Astma-Dr. Nuhi Baftiu-pulmolog
- Stresi post traumatik-z. Gyltene Dërguti-psikologe
- Gastritis acuta-dr. Afrim Rexhepi
- Gjendjet emergjente në Kujdesin Parësor-Dr.Martin Hofer, Ms.Suzana Hofer
- Përfshirja e burrave dhe grave në barazi gjinore-Dr.Afrim Rexhepi, dr. Drita Lumi, Dr. Ylber Murati
- Shëndeti publik- dr. Ilir Begolli –QKUK-
- Gjendjet urgjente-dr. Basri Lenjani-specialist I emergjencës-QKUK
- Sindroma akute koronare-dr. Ahmet Hoxha
- Auditi klinik-Planifikimi Familjar-dr. Drita Lumi, Dr. Ylber Murati

Njësia e SISH-it

Në muajin Shkurt, nga Ministria e Shëndetësisë ka filluar të implementohet projekti i Sistemit Informativ të Digjitalizuar, projekt ky i financuar nga Banka Botërore. Fillimisht është bërë shpërndarja e rrjetit kabllor të internetit në të gjitha QMF-të dhe AMF-të, e më pas është bërë furnizimi me kompjuterë i të gjitha QMF-ve, ndërsa nëpër AMF nuk janë dërguar ende kompjuterët. Pas vendosjes së pajisjeve, ka filluar edhe trajnimi i personelit të QKMF-së. Implementimi i SISH-it digjital është bërë nëpër të gjitha QMF-të në qytet dhe nëpër fshatra.

II. SEKTORI I STOMATOLOGJISË

Sektori i Stomatologjisë që funksionon në kuadër të QKMF – së në Ferizaj organizon punën në tri shtylla kryesore:

1. Shërbimet stomatologjike primare
2. Shërbimet stomatologjike sekondare dhe
3. Laboratori dentar

Shtylla e parë ku hyjnë shërbimet stomatologjike primare, shtrihet përveç QKMF – së edhe në: QMF I, QMF II, QMF III, QMF IV, QMF V, QMF VI dhe AMF në Mirash, ndërsa dy shtyllat e tjera funksionojnë vetëm në QKMF.

Gjatë muajve të parë të këtij viti Sektori i Stomatologjisë është përballur me mungesën e personelit, në veçanti për AMF-të, por edhe nëpër QMF nuk ka qenë numri adekuat. Ndërkohë ky problem është tejkaluar, përkohësisht, me pranimin e punëtorëve të rinj, stomatologë dhe infermierë.

Gjatë **viti 2019** furnizimi me material shpenzues ka qenë relativisht i mirë.

Sistemi i punës në Sektorin e Stomatologjisë është i rregulluar në atë mënyrë që pacienti që paraqitet për herë të parë evidentohet si vizitë stomatologjike, ndërsa seancat e tjera evidentohen sipas shërbimeve që kryhen te pacienti.

Gjatë **viti 2019** në Sektorin e Stomatologjisë janë kryer shërbimet e paraqitura në tabelën vijuese:

Tabela 23, Raporti i Sektorit të Stomatologjisë

Llojet e shërbimeve	Me pagesë	Pa pagesë	Totali
Vizita specialistike	169	2248	2417
Vizita stomatologjike	2255	9773	12028
Nxjerrje me anestezion	2072	3835	5907
Nxjerrje pa anestezion	81	3442	3523
Aplikim i barit me anestezion	77	149	226
Drenazhë	363	4324	4687
Aplikim i barit	1204	6057	7261
Ekstirpim vital me mbushje	34	159	193
Ekstirpim mortal	291	951	1242
Mbushje e kanalit	283	851	1134
Amalgam pllombë	684	752	1436
Helio pllombë	1513	1418	2931
Largimi i shtresave të buta	23	72	95
Pastrimi i dhëmbëve	78	187	265
Përpunimi i xhepit paradontal	2	14	16
Incizioni	29	232	261
Alveoliti	10	55	65

Ndalja e gjakderdhjes	7	30	37
Kiretazha	45	164	209
Rindërtimi me vidë	1	6	7
Proteza parciale	38	2	40
Proteza totale	209	0	209
Kurora por.	35	0	35
Cemetim i urës dhe kurorës	4	7	11
Reparatura	178	16	194
Korektura e protezës	2	317	319
Ribazimi i protezës	12	18	30
Vendosja e dhëmbit në protezë	54	1	55
Gingivektomia	0	3	3
Amputimi i rrënjës	8	16	24
Frenoktomia	0	11	11
Florizimi	0	25	25
Vulosja e fisurave	0	65	65
Totali	9794	35279	45073

Ndërsa, numri i shërbimeve të ofruara në secilën njësi të Sektorit të Stomatologjisë është paraqitur në tabelat e mëposhtme.

Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat e mësipërme të njësive në mënyrë të përmblëdhur

Tabela 33.

Qendra	Numri i pacientëve	Numri i shërbimeve	Të hyrat
QKMF	16194	19730	15634.5 €
QMF 1	3182	3506	1479 €
QMF 2	6261	8726	5374.5 €
QMF 3 (Greme)	1182	1406	844.5 €
QMF 4	5677	5926	2515 €
QMF 5 (Komogllavë)	608	608	389 €
QMF 6 (Pleshinë)	460	659	354.5 €
Kujdestaria	3333	4311	1713.5 €
Totali	36897	44872	28304.5 €

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmblëdhur rezultatet e të gjitha shërbimeve mjekësore, infermierike dhe të tjera të ofruara në të gjitha qendrat dhe njësitë gjatë **vitit 2019**

Tabela 32. Rezultatet e të gjitha shërbimeve të ofruara gjatë vitit 2019

QKMF FERIZAJ		RAPORTI I PËRGJITHSHËM		VITI 2019
REKAPITULIM I VIZITAVE MJEKËSORE, INFERMIERIKE STOMATOLOGJIKE DHE TË TJERA, GJATË PERIUDHËS JANAR-DHJETOR 2019				GJITHSEJ
M J E K	VIZITA	Vizita nga MF dhe MP	254318	265 768
	MJEKËSORE	Vizita SPECIALISTIKE	11450	
	SHËRBIMI EMERGJENT PRIMAR		2426	622 590
		THERRJE I.M.	100011	

Ë S I A F A M I L J A R E	SH Ë R B I M E T I N F E R M I E R I K E	DHE TË T J E R A	THERRJE I.V.		2729
			INFUZIONE		36765
			LIDHTORE		24266
			TRIAZHIME		105084
			INHALIME		1476
			VIZITA SHTËPIAKE		4565
			FIZIOTERAPI		3679
			KËSHILLA		108929
			KATETERIZIM		854
			LABORATO RI	ANALIZA URINE	15974
				ANALIZA GJAKU	109113
			KAN		6000
			ECHO		462
			EKG		5609
			MATJA E GLIKEMISË		2348
			VAKSINA		38118
			RTG		12906
			MAMOGRAFIA		3457
			SHËRBIMI PODIATRIK		610
			PSIKOLOGU		1429
			PPD		462
			SHËRBIME ANTITUBERKULARE		2352
			VIZITA SHTËPIAKE PËR NËNA DHE FËMIJË		2748
			KËSHILLA PËR GRA SHTATZËNA		261
			GRUPET VETPËRKRAHËSE		467
			SHPËRLARJA E VESHIT		405

		CERTEFIKATA MJEKËSORE	212	
		SHËRBIME NË FARMACI	28308	
		OKSIGJENOTERAPIA	234	
		SHPËRLARJA E SYRIT	161	
		DEBRIDMAN I THOIT	170	
		SHËRBIME STOMATOLOGJIKE		44 872
G J I T H S E J S H Ë R B I M E N Ë Q K M F				933 230

SEKTORI I MIRËQENIES SOCIALE

Sektori i Mirëqenies Sociale në kuadër të DSHMS-së ofron shërbime sociale për qytetarët në nevojë, për shërbimet profesionale sipas infrastrukturës ligjore dhe standardeve për shërbime sociale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, respektivisht Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Të gjitha kategoritë në nevojë për shërbime sociale trajtohen nga institucionet profesionale relevante, Qendra për Punë Sociale ku ofrohen Shërbime Sociale dhe Skema e Asistencës Sociale - ndihma ekonomike për familjet dhe personat që janë në nevojë socio-ekonomike.

Përveç përkrahjes institucionale qytetarët përfitojnë shërbime dhe ndihma materiale edhe nga shoqatat e ndryshme të licencuara për shërbime sociale dhe nga donatorët vullnetmirë të cilët në koordinim me DSHMS-në përkrahin familjet skamnore të identifikuar nga zyrtarët kompetent (profesionistët e Qendrës për Punë Sociale).

Për personat me ngecje në zhvillim mendor përkujdesemi me staf profesional të DSHMS-së në Shtëpinë me Bazë në Komunitet ku për momentin në strehim rezidencial qëndrojnë 10 persona të cilët strehohen nga komisioni i DSHMS-së pasi që nga Gjykata Themelore u është marrë zotësia e veprimit me propozimin e QPS-ve në nivel rajonal.

Bashkëpunime shumë të frytshme kemi me OJQ-të lokale e vendore si PEMA, HANDIKOS, HendiFer, OFAP, “Shpresa dhe shtëpia” por edhe me organizata ndërkombëtare si me GIZ-in gjerman, me OSBE-në, me “Save the Children”, Relief Islamik, KFOR-i Amerikan etj.

Nga niveli qendror respektivisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me Komunën e Ferizajt është mundësuar financimi i projektit për ndërtimin e 35 shtëpive për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian i cili projekt është ende në proces dhe pritet të përfundoj gjatë këtij viti.

Edhe pse me shumë sfida dhe obligime marramendëse nga viti i kaluar ne po u përgjigjemi kërkesave dhe nevojave të qytetarëve duke u ofruar shërbime sociale dhe përkrahje materiale.

Në periudhën Janar – Dhjetor kemi shpërndarë ndihma nga subvencionet

DSHMS-ja për vitin 2019 ka pasur në dispozicion mjete si kategori e subvencioneve gjithsej 60,000.00 € për përkrahje të rasteve më të rënda me shuma simbolike përballë nevojave dhe kostove për trajtime të kategorive të ndryshme ekonomiko-sociale.

Në bazë të kërkesave të palëve për shërim, për kushte të rënda ekonomike sociale për pagesën e qirasë si dhe thirrje publike ku janë ndihmuar OJQ-të për projektet e tyre. Nga subvencionet janë përkrahur gjithësej **129 raste**, për të cilat si ndihmë e njëhershme momentale janë ndarë gjithsej **60,000.00€**.

Gjatë kësaj periudhe për shkak të obligimeve që ka pasur Komuna gjatë vitit 2017, përmbaruesi i ka marrë nga kategoria mallra dhe shërbime në vlerë prej **20,103.05 €**,

Raport financiar i DSHMS-së nga subvencionet

Lloji i përkrahjes	Nr. i rasteve	Shuma
Mjete për shërim	110	44,085.00 €
Mjete për pagesën e qirasë	3	1,800.00 €
OJQ	11	14,115.00 €
Gjithësej :		60,000.00 €

Në vazhdim bashkëngjesim Raportin Vjetor 2019, të Qendrës për Punë Sociale dhe Shtëpisë së Komunitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara Mendore.

RAPORT PUNE I QENDRËS PËR PUNË SOCIALE

Sektori i Shërbimeve Sociale

Raporti i punës i shërbimeve sociale për periudhën Janar-Dhjetor 2019

Kategoritë mbrojtëse	Rastet e vjetra	Rastet e reja	Gjithsej
Delikuenca e të miturve	44	55	99
Fëmijët me sjellje asociale	34	33	67
Fëmijë e keqtrajtuar	24	4	28

Fëmijet e braktisur të posalindur	10	5	15
Fëm.pa perk.pr.të strehuar tek të afërmit me pagesë	0	40	40
Fëmij me aft.të kufizuara	97	21	118
Kujdestaria ndaj fëmijve	46	5	51
Kërkesa për adoptim	12	5	17
Dhuna në familje	12	10	22
Viktima të trafikimit	0	0	0
Çrregullimet bashkëshortore	35	33	68
Familje strehuse	5	0	5
Mbroj.e personave të moshuar	4	1	5
Klient tjerë	97	813	910
Puna e rrezikshme	44	4	48
Përdoruesit e substancave narkotike	5	1	6
Përdoruesit e alkoolit	0	0	0
Martesa e të miturve	1	0	1
Gjithsej:	470	1030	1500

I. SEKTORI I SHËRBIMIT TË SAS-IT

Zyrtarët e S.A.S në kuadër të Qendrës për Punë Sociale, u kanë ofruar shërbime të nevojshme qytetarëve në nevojë në harmoni të plotë me ligjet e aplikueshme.

Nëpunësit e S.N.S-së të Qendrës për Punë Sociale në Ferizaj kanë pranuar të gjitha kërkesat e asistencës sociale në harmoni të plotë me Ligjin 2003/15.

Në periudhën **Janar - Qershor - Shtator - Dhjetor - 2019** numri i aplikantëve që kanë aplikuar **për herë të parë është, kurse në konsultim e sipër jemi me familjet tjera.**

Muaji	Aprovuar	Refuzuar	Shqyrtim	Gjithsej
Janar	9	1	1	11
Shkurt	9	1	5	15

Mars	6	5	0	11
Prill	7	0	0	7
Maj	9	0	0	9
Qershor	5	0	0	5
Korrik	7	1	0	8
Gusht	2	1	5	8
Shtator	13	1	6	20
Tetor	16	1	3	20
Nëntor	18	1	0	19
Dhjetor	6	1	0	7
Totali	107	13	28	140

Nga lista e pagesave për mos riaplikim largohen një numër i konsiderueshëm i familjeve të cilët nuk vazhdojnë me ndihmë sociale me kohë .

Muaji	Numri i familjeve
Janar	10
Shkurt	7
Mars	5
Prill	3
Maj	9
Qershor	11
Korrik	7
Gusht	5
Shtator	7
Tetor	7
Nëntor	4
Dhjetor	5
Totali	80

NUMRI I FAMILJEVE QË JANË VERIFIKUAR DHE RIVERIFIKUAR

Muaji	Aprovuar	Refuzuar	Totali
Janar	150	20	170
Shkurt	138	22	160
Mars	151	12	163
Prill	145	15	160
Maj	121	13	134
Qershor	94	19	113
Korrik	83	9	98
Gusht	84	4	95
Shtator	85	6	97
Tetor	89	12	101
Nëntor	143	13	156
Dhjetor	121	10	131
Totali	1404	174	1578

Gjatë riverikimit Nëpunësit e **S.N.S**-së kanë refuzuar - **174** - familje që nuk i plotësojnë kriteret sipas **Ligjit të SAS-it.2003/15**.

Prej familjeve që kemi riverifikuar janë aprovuar - **1404** - kërkesa të asistencës sociale.

Nëpunësit e **SNS-së** mesatarisht për çdo muaj kanë realizuar përafërsisht - **173** - riaplikime, këtu hyjnë edhe lëndët e vjetra dhe të reja.

Gjatë periudhës **Janar - Qershor - Shtator - Dhjetor: janë** dërguar - **333** - lëndë në komision mjekësor - **308** - kërkesa janë aprovuar nga komisioni mjekësor, kurse - **0** - kërkesa janë kthyer për kompletim te dokumentacionit mjekësor.

Nga komisioni mjekësor janë refuzuar - **25** - lëndë.

Numri i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit e ndihmave sociale për periudhën: **Janar - Qeshor - Shtator - Dhjetor: janë** - **25** - ankesa .

Nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (shkalla e dytë) janë refuzuar - **19** - ankesë, ndërsa nga **DNS -ja** janë aprovuar - **2** - ankesa, në shqyrtim janë - **4** - ankesa.

Lëndë që presin prej gjykatës kontestin gjyqësor – kemi 2 – lëndë, kurse lëndë që janë shqyrtuar negative - 0 - apo pozitivisht nga ana e gjykatës nuk kemi.

Janë lëshuar - 203 - vërtetime për familjet që janë dhe nuk janë shfrytëzues të asistencës sociale ,në këto vërtetime përfshihen: ndihmë momentale (urgjente),vërtetim për përfitimin e shtetësisë,bursës,mujores së udhëtimit banimit dhe shërbimeve tjera që mundësohen nga SNS-ja.

Palët të cilët kanë kërkuar ndihma të menjëhershme nga DPSF – DNS-ja kërkesa janë - 8 - të aprovuara janë - 4 , kurse kërkesa negative janë - 4 - në shqyrtim nuk ka - 0-.

QPS po ashtu ka shpërndarë ndihma me artikuj ushqimor dhe higjenik në bashkëpunim me donatorë të ndryshëm.

RAPORTI VJETOR I SHPËRNDARJES SË NDIHMAVE SOCIALE

SIPAS KATEGORIVE

Muaji	Kateg - I -	Kateg - II -	Nr. i familjeve	Nr.i anëtarëve	Totali
Janar	553	418	971	4087	105.520.00 €
Shkurt	542	414	956	4031	103.660.50 €
Mars	544	417	961	4054	104.490.00 €
Prill	549	407	956	4018	104.567.50 €
Maj	544	409	953	4004	103.520.00 €
Qershor	548	401	949	3978	103.052.00 €
Korrik	546	405	951	3997	103.340.00 €
Gusht	542	394	936	3939	101.662.50 €
Shtator	546		941	3950	102.367.50 €
Tetor	544	395	948	3969	103.205.00 €
Nëntor	537	404	946	3949	102.035.00 €
Dhjetor	535	409	941	3921	101.995.00 €
Totali		406			1.239.415.00 €

Familjet shfrytëzuese të asistencës sociale të zëna nga ATK - ja, të cilat punojnë në firma të ndryshme dhe kanë përfituar ndihmën sociale pa bazë ligjore.

Muaji	Kateg -I-	Kateg -II -	Totali
Janar	1	1	2
Shkurt	1	2	3
Mars	0	1	3
Prill	1	1	3
Maj	4	8	3
Qershor	1	0	3
Korrik	4	0	3
Gusht	5	1	3
Shtator	0	0	5
Tetor	0	2	1
Nëntor	0	0	5
Dhjetor	0	0	14
Totali			

**SHTËPIA E KOMUNITETIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA MENDOR-
FERIZAJ**

RAPORT PUNE PËR PERIUDHËN 01/01/2019-31/12/2019

- *Gjendja shëndetësore e rezidentëve*
- *Furnizimi me ushqim, barna, material higjienik, ujë, rrymë etj*
- *Aktivitetet me rezidentë*
- *Vizitat e QPS-ve dhe familjarëve*
- *Sfidat dhe pengesat në punë*

Gjendja shëndetësore e rezidentëve

Në vitin që lamë pas për kundër disa problemeve tjera, për fat të mirë gjendja shëndetësore e rezidentëve ka qenë e mirë. Gjatë muajit Mars dhe fillim të muajit Prill zakonisht në periudhën e kalimit nga sezona e dimrit në sezonën e pranverës disa nga rezidentët shfaqin një lloj agresiviteti të përballushëm ndaj stafit dhe ndaj rezidentëve tjerë madje duke dëmtuar edhe inventar apo gjësende në momentin e caktuar që kanë para vetes, por falë angazhimit të stafit punonjës me masa preventive lehtë e kaluam këtë periudhë.

Në muajin Shkurt dhe Mars të gjithë rezidentët janë dërguar tek dentisti për kontroll dhe konsultime apo eventualisht edhe intervenime tek rezidentët që kanë pasur nevojë.

Ndërsa në Maj/2019 dhe Dhjetor /2019 të gjithë rezidentëve u janë kryer analizat kryesore në QKMF.

Nga rezultatet e nxjerrura pas analizave del se shumica prej rezidentëve kanë gjendje stabile dhe se nuk kanë ndryshim në shëndetin e tyre me përjashtim të rezidentit B.K. që ka një infeksion në pjesën e pasme të veshit e që pas kontrollave tani është duke përdorur terapi për mjekim.

Furnizimi me ushqim, material higjienik, barëra, ujë, rrymë, derivate etj.

Sa i përket furnizimit me ushqim dhe material higjienik duhet cekur se në fillim të viti 2019 kemi pasur probleme, por këto probleme janë rregulluar nga Qershori.

Sa i përket shërbimeve tjera komunale si rrymë dhe ujë në vitin 2019 nuk kemi pasur probleme.

Për ngrohjen e institucionit tonë në vitin 2019 kemi shfrytëzuar kalldajën me naftë pasi që furnizimi me pelet ishte i pamundur nga kompania e cila ka qenë e kontraktuar nga Zyra e Prokurimit në Ferizaj. Furnizimi ka qenë i rregullt dhe me shumë korrektësi nga ana e operatorit për furnizim me derivate për ngrohje.

Aktivitetet e stafit me rezidentë

Në Sh.e kom.në Ferizaj asnjëherë nuk kanë munguar aktivitete të ndryshme me rezident por në muajt e fillim vitit kryesisht angazhohen në vizatime ,lojëra me letra ,vallëzim etj.ndërsa gjatë sezonës së pranverës rezidentët në mënyrë vullnetare angazhohen edhe në mirëmbajtjen e kopshtit dhe pemëve që kemi në oborrin e institucionit tonë.

Gjatë ditëve të verës stafi punonjës ka organizuar disa herë dalje me rezidentë edhe në Parkun e Lirisë tek pishat e po ashtu edhe rreth lumit të Nerodimes duke ju përgaditur edhe ushqime tradicionale.

Vizitat e QPS-ve dhe familjarëve të rezidentëve

Sa i përket vizitave nga ana e QPS-ve duhet cekur se në shkurt dhe për festën e F. Bajramit zyrtarë nga QPS e Malishevës kanë marrë dhe e kanë dërguar në familje rezidenten me inicialet I.T pasi që me kërkesë të familjes e kishim dërguar në fillim të muajit Shkurt/2019 e cila ka qëndruar disa ditë në familjen e saj në Dragobil të Malishevës.

Kurse për festën e F. Bajramit e kanë marrë dhe e kanë kthyer zyrtarët e QPS nga Malisheva.

Vizita në familje kanë realizuar edhe J. B, F. D, B. K të cilët janë marrë nga familjarët apo të afërmit e tyre dhe po ashtu janë kthyer nga vet ata. Pas këtyre vizitave të gjithë janë ndarë të kënaqur dhe të relaksuar për disa ditë me radhë.

Sfidat dhe pengesat në punë

Një nga sfidat kryesore edhe në vitin 2019 ka qenë shpenzimi i buxhetit i paraparë për nevojat e rezidentëve në Shtëpinë e Komunitetit në Ferizaj nga ana e përmbaruesve privat për obligime krejt tjera.

Lidhur me këtë problem kemi diskutuar edhe në fund të Janarit /2019 në një takim të mbajtur në DMS në Prishtinë ku pas dorëzimit të raportit financiar është tërhequr vërejtja se këto mjete janë Grant Qeveritar i dedikuar decidivisht për nevojat e rezidentëve në Sh. e Kom. në Ferizaj. Megjithatë edhe vitin që lamë pas nga përmbaruesit privat janë marr mjete nga kodi ynë buxhetor kryesisht nga linja mallra dhe shërbime e që na kanë krijuar probleme për kryerjen e obligimeve ndaj furnitorëve tanë.

Po ashtu problem tjetër ka qenë edhe mos lejimi i zëvendësimit të punëtorëve që shkojnë në pushim të lehonisë edhe pse ne kemi kërkuar disa herë. Për institucionin tonë, nëntë muaj pa një infermiere do të thotë mungesë e madhe.



REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E PRONËS, GJEODEZISË DHE KADASTRIT

RAPORT I PUNËS PËR VITIN 2019

Sabri Murseli
Drejtore i Drejtorisë së Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrit

Ferizaj, 2020

Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë e Komunës së Ferizajt;

Është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjen, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ për tokën dhe pronën e Komunës së Ferizajt.

Në kuadër të kësaj kjo drejtori është e ndarë në tre sektor: Sektori i Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Më poshtë i gjeni të dhënat lidhur me lëndët e pranuar dhe të administruara nga tre sektorët e Drejtorisë.

Sektori i Kadastrit është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjen, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ për tokën dhe pronën e Komunës së Ferizajt.

1 *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga sektori juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër.*

1.1 Në sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:

- Kërkesa për Çertifikata të Pronësisë dhe Kopje të Planit janë pranuar gjithsej 6774 kërkesa, të miratuara janë 6740, të refuzuara gjithsej 34 kërkesa.
- Kërkesa për Regjistrim i Hipotekave janë pranuar 207 nga të cilat janë miratuar 207, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Ç'regjistrim i Hipotekave janë pranuar 176 kërkesa, nga të cilat janë miratuar 207, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Regjistrim i Trashëgimeve janë pranuar 320 kërkesa, nga të cilat janë miratuar 320, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Regjistrimi i Shitblerjeve janë pranuar 1408 kërkesa nga të cilat janë miratuar 1382, të refuzuara 26 kërkesa.
- Kërkesa për Regjistrim i Faljeve janë pranuar 624 kërkesa nga të cilat janë miratuar 624, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Regjistrim i këmbimeve dhe ndarjeve fziqe janë pranuar 72 kërkesa nga të cilat janë miratuar 72, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Regjistrim i barrave tatimore janë pranuar 50 nga të cilat janë miratuar 43 kërkesa, ndërsa janë refuzuar 7 kërkesa.
- Kërkesa për Ç'regjistrim i barrave tatimore janë pranuar 19 kërkesa, nga të cilat janë miratuar 17 kërkesa kurse 2 të tilla janë të refuzuara.
- Kërkesë Regjistrim i Masave Siguruese kemi pranuar 50 kërkesa, janë përfunduar 50, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesë për Ç'regjistrim i Masave Siguruese kemi pasur gjithsej 27 kërkesa, janë përfunduar 27, ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesë për Vërtetime për Nevoja Personale i kemi pasur gjithsej 1726 kërkesa, janë përfunduar 1726 kërkesa ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.

- ***STATISTIKAT-Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për sektorin tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e***

pranuara, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

Kërkesat e pranuar në Sektorin e Kadastrit gjatë vitit 2019	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë
Çertifikata të Pronësisë dhe Kopje të Planit	6774	6740	34	/
Regjistrim i Hipotekave	207	207	/	/
Ç'regjistrim i Hipotekave	176	176	/	/
Regjistrim i Trashëgimeve	320	320	/	/
Regjistrimi i Shitblerjeve	1408	1382	26	/
Regjistrim i Faljeve	624	624	/	/
Regjistrim i këmbëve dhe ndarjeve fziqe	72	72	/	/
Regjistrim i barrave tatimore	50	43	7	/
Ç'regjistrim i barrave tatimore	19	17	2	/
Regjistrim i Masave Siguruese	50	50	/	/
Ç'regjistrim i Masave Siguruese	27	27	/	/
Vërtetime për Nevoja Personale	1726	1726	/	/
Totali	11453	11384	69	/

Totali i kërkesave / lëndëve të pranuar në Sektorin e RDPP-së, gjatë viti ka qenë 11453 kërkesa, të përfunduara janë 11384 kërkesa dhe janë refuzuar 69 kërkesa për arsye të ndryshme.

SEKTORI I GJEODEZISË është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjen, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ për token dhe pronën e Komunës së Ferizajt.

- **AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga sektori juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër.**

1.1 Në sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:

- Kërkesa për Identifikime janë pranuar gjithsej 5 kërkesa, të miratuara janë 5 ndërsa nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Modifikime janë pranuar 4 nga të cilat janë miratuar 3, ndërsa është refuzuar 1 kërkesë.
- Kërkesa për Kërkesa për bashkim të parcelave janë pranuar 265 kërkesa, nga të cilat janë miratuar 260, ndërsa janë refuzuar 5 kërkesa.
- Kërkesa për Njoftime për Ngastrën janë pranuar 3 kërkesa, nga të cilat janë miratuar 3, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Kërkesa për identifikimin dhe regjistrimin e njësive banesore janë pranuar 3 kërkesa nga të cilat janë miratuar 3, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri janë pranuar 9 kërkesa nga të cilat janë miratuar 9, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Kërkesa për ndërrim kulture janë pranuar 19 kërkesa nga të cilat janë miratuar 18, ndërsa është refuzuar 1 kërkesë.
- Kërkesa për Përmirësime të numrave të Parcelës janë pranuar 3 kërkesa nga të cilat janë miratuar 3 kërkesa, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Përmirësim i sipërfaqës është pranuar 1 kërkesë, nga e cila janë miratuar 1 kërkesë, nuk është refuzuar asnjë.
- Kërkesa për Regjistrime të copëtimit kemi pranuar 836 kërkesa, janë miratuar 830, ndërsa janë refuzuar 6 kërkesa.
- Kërkesë për Riregjistrim të copëtimit kemi pasur gjithësej 138 kërkesa, janë miratuar 136, ndërsa janë refuzuar 6 kërkesa.
- Kërkesa për Rregullim i kufirit janë pranuar 12 kërkesa nga të cilat janë miratuar 12 kërkesa, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Sqarime është pranuar 1 kërkesë nga e cila është miratuar 1 kërkesë, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Produkte janë pranuar 1027 kërkesa nga të cilat janë miratuar 1021 kërkesa, ndërsa janë refuzuar 6 kërkesa.
- Kërkesa për Bashkimi të njësisë banesore janë pranuar 2 kërkesa nga të cilat janë miratuar 2 kërkesa, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për ndarje të njësisë banesore janë pranuar 3 kërkesa nga të cilat janë miratuar 3 kërkesa, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Identifikimi të njësisë banesore janë pranuar 1 kërkesë nga e cila është miratuar 1 kërkesë, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Përmirësim të katit banesor janë pranuar 1 kërkesë nga e cila është miratuar 1 kërkesë, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Përmirësimi të numrit të banesës janë pranuar 3 kërkesë nga e cila është miratuar 3 kërkesa, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Regjistrimi të Lokaleve janë pranuar 1 kërkesë nga e cila është miratuar 1 kërkesë, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Regjistrimi të njësisë banesore janë pranuar 37 kërkesa nga të cilat janë miratuar 37 kërkesa, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.
- Kërkesa për Identifikimi të njësisë banesore janë pranuar 1 kërkesë nga e cila është miratuar 1 kërkesë, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.

Kërkesa për Regjistrim të Objektivit janë pranuar 3 kërkesa nga e cila është miratuar 3 kërkesa, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.

Kërkesa për Copëtime janë pranuar 8 kërkesa nga të cilat janë miratuar 8 kërkesa, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.

Kërkesa për Rregullim të pjesës grafike janë pranuar 1 kërkesë nga e cila është miratuar 1 kërkesë, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.

Kërkesa për Rregullim të megjës janë pranuar 4 kërkesa nga e cila është miratuar 3 kërkesa, ndërsa është refuzuar 1 kërkesë.

Kërkesa për Korrigjim të sipërfaqes është pranuar 1 kërkesë nga e cila është miratuar 1 kërkesë, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.

Kërkesë për Historiat është pranuar 1 kërkesë nga e cila është miratuar 1 kërkesë, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.

Kërkesa për Kopje të Planit janë pranuar 2930 kërkesa nga e cila janë miratuar 2930 kërkesa, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.

Kërkesa për Kopje të Planit Zyrtare janë pranuar 472 kërkesa nga e cila janë miratuar 472 kërkesa, nuk është refuzuar asnjë kërkesë.

Totali i kërkesave / lëndëve të pranuar në Sektorin e Gjeodezisë, gjatë vitit 2019 ka qenë 5794 kërkesa, të përfunduara janë 5772 kërkesa, në procedurë nuk ka asnjë kërkesë dhe janë refuzuar 22 kërkesa për arsye të ndryshme.

- **STATISTIKAT-Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për sektorin tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtorja juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.**

Sektori i Pronës merret me menaxhimin e pronave komunale, ku përfshihet mbajtja e shënimeve për tërë tokën dhe objektet, të cilat i posedon apo i shfrytëzon Komuna, me zhvillimin e procedurës së shpronësimit, këmbimit të tokës në pronësi të Komunës me tokën e personave privat të planifikuar për interes publik, si

Kërkesat e pranuar në sektorin e Gjeodezisë gjatë vitit 2019	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedure	Mjetet e grumbulluara €
Identifikime	5	5	/	/	
Modifikime	4	3	1	/	
Kërkesa për bashkim të parcelave	265	260	5	/	
Njoftime për Ngastrën	3	3	/	/	

Kërkesa për identifikimin dhe regjistrimin e njësive banesore	3	3	/	/	
Kërkesa për përcaktim dhe rirregullim kufiri	9	9	/	/	
Kërkesa për ndërrim kulture	19	18	1	/	
Përmirësime të numrave të Parcelës	3	3			
Përmirësim i sipërfaqës	1	1	/	/	
Regjistrim i copëtimit	836	830	6	/	
Riregjistrim i copëtimit	138	136	2	/	
Rregullim i kufirit	12	12	/	/	
Sqarime	1	1	/	/	
Produkte	1027	1021	6	/	
Bashkimi i njësisë banesore	2	2	/	/	
Copëtimi i njësisë banesore	3	3	/	/	
Identifikimi i njësisë banesore	1	1	/	/	
Përmirësimi i katit banesor	1	1	/	/	
Përmirësimi i numrit të banesës	3	3	/	/	
Regjistrimi i Lokaleve	1	1	/	/	
Regjistrimi i njësisë banesore	37	37	/	/	
Regjistrim i Objektit	3	3	/	/	
Copëtime	8	8	/	/	
Rregullim i pjesës grafike	1	1	/	/	

Rregullim i megjës	4	3	1	/	
Kërkesë për Korrigjim	1	1	/	/	
Kërkesë për Historiat	1	1	/	/	
Kopje të Planit	2930	2930	/	/	
Kopje të Planit Zyrtare	472	472	/	/	
TOTALI	5794	5772	22	/	

dhe me trajtimin dhe zhvillimin e procedurave administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës.

1. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga sektori juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër.

1.1 Në sektorin e Pronës janë pranuar kërkesat në vijim:

- Në lëmin e uzurpimeve janë pranuar gjithësej 171 kërkesa të përfunduara janë 142, në procedurë 29 kërkesa.
- Në lëmin e destinimeve janë pranuar 161 kërkesa, janë përfunduar 150, në procedurë janë 11 kërkesa.
- lëmin e shpronësimeve janë pranuar 35 kërkesa, të përfunduara 29, në procedurë janë 6 kërkesa.

STATISTIKAT-Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për sektorin tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

Kërkesat e pranuar në sektorin e Pronës gjatë vitit 2019	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të miratuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara-shpenzuara €
Uzurpime	171	161		29	
Destinime dhe përgjigje në kërkesa	161	150		11	
Shpronësime	35	29		6	
Totali	367	340		46	

· Në lëmin e Uzurpimeve bëjnë pjesë: inqizimet gjeodezike dhe caktimet e kufijeve të Rrugëve, Lumenjëve, Objekteve Shkollore, Objektëve Shëndetësore, Zyrave të Gjendjes Civile etj, të gjitha ato të cilat janë të poshtshënuara.

- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 21-0 Zk. Nekodim
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 459-0 Zk. Talinoc I Jerlive
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 328-7 Zk. Greme
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 1584-2 Zk. Greme
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 386-1 Zk. Lloshkobare
- Inqizimi i ngastres kadastrale 950 Zk. Nikadin
- Caktimi i pikave te rruges 49611 Zk. Ferizaj
- Inqizimi i ngastrave kadastrale 20831 dhe 3161 Zk. Pleshinë
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 266-0,2149-0 Zk. Mirosalë
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 1053-1 Zk. Dardani
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 398-0,401-0 Zk. Talinoc i Muhaxherve
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 1148-2 Zk. Dardani
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 1326-1 Zk. Ferizaj
- Inqizimi i ng.kad. 496-4 Zk. Talinoc i Jerlive
- Inqizimi i ng.kad. 153-0 Zk. Lloshkobare.
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 810-1,809-2 Zk. Talinoc i Muhaxherve
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 923-4 Zk. Jezerc
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 3575-12 Zk. Jezerc
- Inqizimi i ngastres kadastrale me numer 62-0 Zk. Nekodim
- Inqizimi i ngastres kadastrale me numer 795-0 Zk. Gaçkë
- Inqizimi i ngastres kadastrale 591-0 Zk. Varosh
- Caktimi i Pikave te rruges në fshatin P. Jerlive në ng.kad. 1782117811
- Caktimi i pikave te rruges ne fshatin Zaskok në ng.kad. 5491, 5492, 5480,5500, 549.
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 21-0 Zk. Nekodim
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 459-0 Zk. Talinoc I Jerlive
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 328-7 Zk. Greme
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 1584-2 Zk. Greme
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 386-1 Zk. Lloshkobare
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 266-0,2149-0 Zk. Mirosalë
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 1053-1 Zk. Dardani
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 398-0,401-0 Zk. Talinoc i Muhaxherve
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 1148-2 Zk. Dardani
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 1326-1 Zk. Ferizaj
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 810-1,809-2 Zk. Talinoc i Muhaxherve
- Caktimi i pikave te rruges ne ngastren kadastrale 2485 Zk. Ferizaj.
- Caktimi i pikave te rruges ne ngastren kadastrale 3820 Zk. Prelez I Muhaxh.
- Caktimi i pikave te Qerdhes së fëmijeve ne ng.kad. 21541, 21551 Zk. Greme.
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 1053-1 Zk. Dardani
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 840-0 Zk. Zllatar
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 314-0, 545-0 Zk. Papaz
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 552-0, 455-0 Zk. Pleshinë
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 1137-0 , 1044-0 Zk. Tërrn
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 942-0, 227-0, 1083- 0 Zk. Talinoc I Muhaxherëve
- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 556-7 Zk. Bibaj
- Inqizimi i ngastres kadastrale 178-12, 178-11 dhe 178-10 Zk. Zaskok

- Inqizimi i ngastrave kadastrale me numer 248-0, 246-2, 246-3, 247-0, 249-0 Zk. Fshati i Vjetër,
- Caktimi i pikave te rruges ne Ferizaj në ng.kad. 4411, 4375, 13772
- Caktimi i pikave te rrugës në fshatin Talinoc i Muhaxhereve në ng.kad. 10020
- Caktimi i pikave te rrugës në fshatin Talinoc i Jerlive në ng.kad. 4590
- Caktimi I pikave ne fshatin Greme ne ng.kad.2942-0 Zk. Greme
- Caktimi I pikave ne fshatin Gaçkë ne ng.kad.1502-1 Zk. Gaçke
- Inqizimi i ngastres kadastrale 4276, 42610, 4276, 4854, 48534263, 4273 Zk. Gërlisë.
- Inqizimi i ngastres kadastrale 25231 Zk. Ferizaj.
- Inqizimi i ngastres kadastrale 176-2 dhe 176-2 Zk.Zaskok
- Inqizimi i ngastres kadastrale 11919 Zk. Ferizaj.
- Inqizimi i ngastres kadastrale 9833 Zk. Ferizaj.
- Caktimi i pikave te rruges ne fshatin Jezercë ne ng.kad. 35512 dhe 34840 Zk. Jezerc
- Caktimi i pikave të lumit në ng.kad. 1285-0 ne Zk.Zaskok.
- Caktimi i pikave të rrugës ng.kad. 1723-0 Zk Nerodime
- Caktimi i pikave të rrugës ng.kad. 901-0 Zk. Nikadin
- Caktimi i pikave të rrugës ng.kad.290-0Zk. Dremjak
- Caktimi i pikave në ng.kad nr376-0 Zk. Sojeve
- Inqizimi i ngastres kadastrale 10-0,9-0,11-2,12-9 Zk.Zaskok
- Caktimi i pikave në ng.kad nr 168-0 Zk. Llashkobare
- Caktimi i pikave per projektin e Kek-tu Zk. Greme
- Caktim I pikave per rruges Varosh Gerlic
- Caktimi I pikave ne fshatin Greme ne ng.kad.2942-0 Zk. Greme
- Caktimi I pikave ne fshatin Gaçkë ne ng.kad.1502-1 Zk. Gaçke
- Inqizimi i ngastres kadastrale 168-1,167-9,167-1 dhe 166-0 Zk.Zaskok
- Caktimi i pikave ne fshatin Nikadin në ng.kad.3740
- Inqizimi i ngastres kadastrale 171-3, 171-4, 171-5 dhe 171-6 Zk.Zaskok
- Inqizimi i ngastres kadastrale 950 Zk. Nikadin
- Caktimi i pikave te rruges 49611 Zk. Ferizaj
- Inqizimi i ngastres kadastrale 173-13, 173-12, 173-2, 173-3,173-4 dhe 173-5 Zk.Zaskok
- Inqizimi i ngastres kadastrale 388-8,388-9 dhe 460-9 Zk.Ferizaj
- Inqizimi i ngastres kadastrale 185-3, 186-6,186-7,195-1 dhe 194-0 Zk.Nekodim
- Inqizimi i ngastres kadastrale 177-0, 175-2,175-1,174-1,169-1,169-6, 169-3 dhe 169-4 Zk.Zaskok
- Inqizimi i ngastres kadastrale 1194-3, 1194-1,1194-1 dhe 186-5 Zk. Ferizaj
- Inqizimi i ngastres kadastrale 455-0 dhe 552-1 Zk. Pleshinë
- Inqizimi i ngastres kadastrale 526-1 dhe 526-3 Zk. Muhoc
- Inqizimi i ngastres kadastrale 148-3,149-2,149-3,149-4 Zk.Zaskok
- Inqizimi i ngastres kadastrale 4090 Zk. Surqinë.
- Inqizimi i ngastrave kadastrale 21551, 21541, 21520 Zk. Greme.
- Inqizimi i ngastres kadastrale 630 Zk. Manastircë.
- Inqizimi i ngastres kadastrale 8540 Zk. Koshare.
- Caktimi i pikave te rruges ne ngastrat kadastrale 2040 dhe 2050 Zk. Cërnillë.
- Caktimi i pikave te rruges ne Ferizaj në ng.kad. 4411, 4375, 13772
- Caktimi i pikave te rrugës në fshatin Talinoc i Muhaxhereve në ng.kad. 10020
- Caktimi i pikave te rrugës në fshatin Talinoc i Jerlive në ng.kad. 4590
- Caktimi i pikave te rrugës në fshatin Komogllavë në ng.kad.35770, 14680, 15050
- Caktimi i pikave ne rruges fshatin Softaj në ng.kad. 6931
- 11790
- Caktimi i pikave ne fshatin Greme në ng.kad.32380
- Caktimi i pikave ne fshatin Neredime e Eperme në ng.kad.17360

- Caktimi i pikave ne fshatin Nikadin në ng.kad.3740
- Inqizimi i ngastrës kadastrale 92 Bablak
- Caktimi i pikave te rruges në fshatin Dremjak 733-0 Zk. Dremjak.
- Caktimi i pikave te rruges në Ferizaj ne rrugen “Imri Halili” deri te pishina “Matoshi”
- Inqizimi i rruges në Ferizaj ne ng.kad. te rruges 1211-3
- Inqizimi ne Fshatin e Vjetër në ng.kad.295-0
- Inqizimi i rrugës ne lagjen “Sherret” ne ng.kad, 845-0 Zk. Ferizaj
- Caktimi i pikave te rruges në Ferizaj rr. “Marije Kraja ng.kad. 288-6,288-7.
- Caktimi i pikave te rruges në Ferizaj ne rr. Reçakut”ng.kad. 2525-0.
- Caktimi i pikave ne rruges fshatin Mirosalë 2148-0
- Caktimi i pikave te rruges 496-11 Zk. Ferizaj
- Inqizimi i objektit ne ng.kad. 2509-0 Zk. Ferizaj
- Caktimi i pikave ne rruges fshatin Mirosalë 2148-0
- Caktimi i pikave te rruges 496-11 Zk. Ferizaj
- Caktimi i pikave ne Ferizaj ne ng.kad.1377-2
- Caktimi i pikave ne Ferizaj në ng.kad.459-0
- Ferizaj Inqizimi i sheshit të qytetit.
- Ferizaj inqizimi i rrugës “Saranda”
- Caktimi i pikave te rrugës fsh.”Manastircë.
- Caktimi i pikave ne fshatin Papaz dhe Softa
- Inqizimi i ng.kad. 2548-0 Zk. Komogllavë.
- Inqizimi i ng.kad.2748-0 Zk. Ferizaj.
- -Caktimi i pikave te rruges ne ng.kad. 382-0 Zk. P. i Muhaxhereve
- Caktimi i pikave te rruges ne ng.kad. 2807-0 Zk. Ferizaj
- Caktimi i pikave te rruges ne ng.kad. 687-0 Zk. Ferizaj
- Caktimi i pikave te rruges ne ng.kad. 773-0 Zk. Burnik
- Caktimi i pikave te rruges ne ng.kad. 708-0 Zk. Ferizaj
- Caktimi i pikave të rrugës në ng.kad. 533-0 Zk. Jezerc
- Caktimi i pikave në Ferizaj në ng.kad. 2832-0 Zk. Ferizaj.
- Caktimi i pikave të rrugës në ng.kad. 1329-0 Zk. Zllatar.
- Inqizimi i ngastres kadastrale 1085-1 Zk. Ferizaj
- Inqizimi i ngastres kadastrale 549-19 Zk. Bibaj
- Inqizimi i ngastres kadastrale 31-0, 51-2, 32-0 125-2 dhe 210-0 Zk. Nerodime e Eperme
- Inqizimi i ngastres kadastrale 955-5 Zk. Nekodim
- Inqizimi i ngastres kadastrale 853-3 Zk. Talinoc I Jerlive
- Inqizimi i ngastres kadastrale 1584-2 dhe 3286-7 Zk. Greme
- Inqizimi i ngastres kadastrale 3162-0 Zk. Ferizaj
- Inqizimi i ngastres kadastrale 795-0 Zk Gaqke
- Inqizimi i ngastres kadastrale 1010-5 dhe 1214-2 Zk. Prelez I Jerlive
- Inqizimi i ngastres kadastrale 291-1, 295-7 dhe 750-3 Zk.Muhoc
- Inqizimi i ngastres kadastrale 731-1 Zk Nekodim
- Inqizimi i ngastres kadastrale 117-4 Zk. Fshati I Vjeter
- Inqizimi i ngastres kadastrale 794-17 dhe 907-13 Zk.Jezerc
- Inqizimi i ngastres kadastrale 480-1 Zk. Cernillë
- Inqizimi i ngastres kadastrale 640-2 Zk. Nekodin
- Inqizimi i ngastres kadastrale 800-0 dhe 803-0 Zk Zllatar
- Inqizimi i ngastres kadastrale 470-1 dhe 471-7 Zk. Talinoc I Jerlive
- Inqizimi i ngastres kadastrale 3179-0 Zk. Ferizaj
- Inqizimi i ngastres kadastrale 8266-0 Zk. Ferizaj

- Inqizimi i ngastres kadastrale Zk. Jezerc
- Inqizimi i ngastres kadastrale 240-0 Zk.Cernillë
- Inqizimi i ngastres kadastrale 923-4 Zk.Jezerc

Në lëmin e destinimeve: bëjnë pjesë propozim-vendimet për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm, propozim- vendimet për këmbimin e pronave komunale me pronat private, propozim-vendimet për destinimin e pronave komunale, propozim-vendimet për dhënien në shfrytëzim etj.

- Kërkesat drejtuar Ministrisë së Financave- Departamentit të Tatimit në Pronë-ZVPP-së për parcelat të cilat janë në fazën e vlerësimit të tokave si në lëmin e shpronësimit ashtu edhe në lëmin e këmbimit të pronave, përgjegjëjet në kërkesa të ushtruar nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit për parcelat të cilat janë në fazën e likuidimit, kërkesat të cilat kanë ushtruar qytetarët për ri-regjistrimin e parcelave, kërkesat e qytetarëve për faljen e paluajtshmerive të tyre për rrugë, varreza, etj, kërkesat brenda Sektoreve drejtuar kadastrit dhe gjeodezisë për zbatim të vendimeve në RDPP, çertifikata të pronës, produkte, kërkesë për coptime etj.

Propozim - vendime për Kuvendin e Komunës së Ferizajt gjithsej 21.

- Propozim- Vendim për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale 114-0, 137-0, 191-0,188-0, 3551-1 dhe 1139-0 Zk. Jezerc.
- Propozim- vendim për destinimin e pjesës së ngastres kadastrale 614-0 Zk. Nekodim.
- Propozim-vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale 489-12, 489-11 Zk. Ferizaj.
- Propozim- vendim për dhënien në shfrytëzim të pjesës së ngastres kadastrale 1749-1 Zk. Ferizaj.
- Propozim- Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale 496-3, 499-0, 500-1, dhe 500-2 Zk. Ferizaj.
- Propozim- vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm të ngastres kadastrale 1749-6 Zk. Ferizaj.
- Propozim- vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale 690-1 me pjesët e ng.kad. 287-5, 286-5 dhe 314-4 Zk. Talinoc I Jerlive.
- Propozim- vendim për këmbim të ngastrave kadastrale 792-2 dhe 793-0 Zk. Talinoc I Muhaxhereve.
- Propozim- vendim për destinimin e ng.kad. 571-0 dhe pjesëve të ngastrave kadastrale 569-0 dhe 570-0 Zk. Ferizaj.
- Propozim- vendim për destinimin e pjesës së ng.kad. 542-0 Zk. Ferizaj.
- Propozim- vendim për revokimin e destinimit të parces 708-2 Zk. Ferizaj për ndertimin e objektit të grave dhe fëmijëve.
- Propozim- vendim për këmbimin e ng.kad. 707-2, 708-2, 707-1 me ng.kad. 1749-6 Zk. Ferizaj.
- Propozim- vendim për destinimin e ng.kad. 114-0 Zk. Fshati I Vjetër.
- Propozim- vendim për destinimin e ng.kad. 23-2 Zk. Rakaj.
- Propozim- vendim për destinimin e ng.kad. 527-0 Zk. Varosh.
- Propozim- vendim për rishqyrtim vendimit të ng.kad. 526-1 dhe 526-3 Zk. Muhoc.
- Propozim- vendim për rishqyrtimin dhe plotësimin e vendimit për ng.kad., 171-4, 171-5, 171-6, 169-1, 169-2, 169-3, 169-4, 169-6, 171-3, 171-4,171-5, 171-6, 173-12, 173-13, 173-4, 173-5, 173-12, 173-13, 174-1, 175-2, 175-1, 177-0, , 176-2, 149-1, 149-2, 149-3, 149-4, 148-3, 178-11, 178-12, 178-10, 09-0, 11-2, 12-9, 11-6,168-1, 167-9, 12-3, 167-1, 166-0 14-8 Zk. Zaskok.
- Propozim- vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pjesës së ng.kad. 2080-1 dhe 2080-2 Zk. Mirosalë.
- Propozim- vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm për pjesën e ng.kad. 910-1 Zk. Babush I Serbeve.
- Propozim- vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm për pjesën e ng.kad.455-0 dhe 552-1 Zk. Pleshinë

- Propozim- vendim per shpalljen e interest te pergjithshem per pjesen e ng.kad. 314-1, 314-2 dhe 314-3 Zk. Papaz.

- **Në lëmin e shpronësimeve:** bëjnë pjesë lëndet të cilat janë në Gjykatën Themelore në Ferizaj kundër Vendimeve Përfundimtare të Shpronësimit, respektivisht rritjes së shpërblimit për tokat e shpronësuara, lëndë të cilat janë për vlerësim në MF, kemi filluar përgatitjet e lëndëve për zhvillimin e procedurave administrativo - juridike për parcelat të cilat janë në Zk. Zaskok ne rrugër “Gjergj Fishta”, “Fatmir Ratkoceri” Muhoc, Pleshinë etj.

- **Deklarata për Falje** gjithsej 23 raste.

- Deklarat per fajle nga Menderez Gajtoni te ngastres kadastrale 1085-1 me sip.305m2 Zk. Ferizaj

- Deklarat per fajle nga Nazmi Muhaxheri, Elmi Muhaxheri dhe Ejup Ferati per ng.kad. 31-0 me sip.650 m², 32-0 me sip. 212 m², 33-0 me sip. 73 m², 51-2 me sip 469 m², 51-1 me sip.463 m², 125-2 me sip 239 m²dhe 210-0 me sip.197 m² Zk. Neredime e Eperme.

- Deklarat per fajle nga Bedri, Remzi, Hisni Sahiti per ng.kad. 955-5, me sip 730 m² Zk. Nekodim

- Deklarat per fajle nga Bedri Shahin, Nexhmedin Reka per ng.kad. 855-1 14 m², 885-2 me sip 24 m², 885-3 me sip 36 m² Zk. Talinoc I Jerlive.

- Deklarat per fajle nga Emrush Topalli per ng.kad. 1584-2 me sip. 61 m² dhe 3286-7 me sip. 476 m²

- Deklarat per fajle nga Atdhe Lohaj ng.kad. 3162-0 me sip. 16 m² Zk. Ferizaj.

- Deklarat per falje nga Shukri dhe Agim Sallahu per ng.kad. 758-0 me sip. 155 m², 760-0 me sip.395 m², 765-0 me sip. 188 m², 753-1 me sip. 201 m² Zk.Zllatar.

- Xhevrije Zeqiri, Mehmet Mehmeti dhe Xhemajl Aliu per ng.kad. 467-1 me sip. 657 m², 469-1 me sip. 320 m² Zk. Talinoc I Jerlive.

- Xhyzide Hetemi dhe Musli Murati per ng.kad. 1010-5 me sip.780 m² dhe ng.kad. 1214-2 me sip. 780 m² Zk. Prelez I Jerlive.

- Nebih, Ali, Hamdi Rexhepi dhe Genc Çollaku per ng.kad. 291-1, 295-7, 750-3 Zk. Muhoc me sip.116m², 94 m², 37 m².

- Enver, Sefa dhe Haki, Mehmet Ramadani ng.kad. 7

- Ferid Avdullahu ng.kad. 117-4 Zk. Fshati I Vjetër 14 m².

- Ali Ibrahim 758-10 Zk. Talinoc I Muhaxhereve sip 527 m².

- Fehmi Hajrullahu ng.kad. 907-13,794-17 Zk. Jezerc me sip. 970 m² dhe 1178 m².

- Sabri Grainca 480-1 Zk. Cernillë sip 898 m².

- Uran Statovci ng.kad. 240-0 Zk. Cërnillë sip. 265 m²

- Naim, Tahir, Bekim Beqiri dhe Sali Berisha ng.kad. 640-2 Zk. Nekodim me sip. 66 m².

- Lulzim Muharremi ng.kad. 3179-0 sip 355 m² Zk. Ferizaj.

- Besim Qerimi ng.kad. 2266-0 Zk. Ferizaj me sip. 63 m²

- Rexhep, Sula, Hetem Ibrahim Osmani ng.kad.3575-12 Zk. Jezerc me sip 703 m²

- Rexhep Sula, Hetem Osmani ng.kad.923-4 Zk. Jezerc me sip 612 m²

- Sahit Neziri ng.kad.182-1, me sip 93 m² 184-0 me sip. 100 m² dhe 190-0 me sip 254 m² Zk. Burrnik.

- Arian Salihu, Kreshnik Islami dhe Nexhat Tahiri ng.kad. 3153-0 sip 111 m²

- Gjatë periudhës një vjeçare Janar- Djeto 2019 ne Sektorin e Pronës vullnetarisht pronaret e paluajtshmerive ne zonen dhe rurale kanë falur prona tyre per rrugë me siperfaqe totale prej 14674 m² ose (01.46.47 ha)

Spektori i Pronës gjatë periudhës një vjetore Janar-Dhjetor (2019) ka kryer edhe keto punë:

- Përfaqsim në Gjykatën Themelore në Ferizaj në cilësin e përfaqësuesit juridik 32.

- Përgjigje ne padi, me padit e ushtruar në Gjykatë lidhur me shpronësime 7

- Punë në terren me komisionin per verifikimin dhe matjen e objektit te Shoqates se Pensionistëve dhe Invalideve te Punes ne ng.kad. 1749-6 Zk. Ferizaj 2

- Punë në terren me komisionin për Dhenjen në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme për ng.kad. 314-1, 314-2, 314-3 Zk. Papaz 2
- Punë në terren me komisionin për Dhenjen në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme për ng.kad. 707-1, 707-2 dhe 708-2 Zk. Ferizaj 2
- Punë në terren me komisionin për Dhenjen në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme për ng.kad. 793-0, 792-2 dhe 791-2 Talinoc I Muhaxhereve 2
- Pjesa të shpronësimeve 22
- Pjesa furnitoreve 43
- Kërkesa furnitoreve 47
- Pjesa e punetoreve me kontratë mbi vepër 27
- Formularë për furnitor sistem 30



REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2019

Burim Bajrami
Drejt看 i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë

Ferizaj, 2020

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në kuadër të aktivitetit të saj ka në përbërje katër njësi:

- Njësinë e Lavërtarisë,
- Njësinë e Blegtorisë,
- Njësinë e Zhvillimit Rural,
- Njësinë e Pylltarisë.

Të gjitha këto njësi kanë në kuadër të tyre staf të përgatitur profesional dhe aktivitetin e tyre e zhvillojnë konform rregullave dhe ligjeve të parapara në këtë sektor.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë gjatë periudhës raportuese në vazhdimësi ka zbatuar praktikat sektoriale sipas:

- Strategjive zhvillimore,
- Planit të punës së Drejtorisë të hartuar për vitin 2019,
- Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të Kosovës 2014 – 2020,
- Planit Zhvillimor Komunal,
- Vendimeve të Kuvendit të Komunës dhe sipas kërkesave të qytetarëve.

Aktivitetet e Drejtorisë gjatë kësaj periudhe janë fokusuar kryesisht në realizimin e subvencioneve dhe projekteve si dhe në shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesave në lëmi të ndryshme të fermerëve.

Gjatë vitit 2019 në fillim të vitit janë kryer:

- Përgatitja e Raportit të punës për vitin 2018,
- Kompletimi dhe sistemimi i të gjitha dokumenteve për projektet dhe subvencionet e realizuara për vitin 2018,
- Plani vjetor i shfrytëzimit të mjeteve të Drejtorisë së Bujqësisë për vitin 2019 sipas kërkesës së Zyrës së Prokurimit,
- Përgatitja e arsyeshmërisë së subvencioneve për në Kuvend të planifikuara për vitin 2019,
- **Monitorimi i projekteve dhe subvencioneve** –janë monitoruar shumica e projekteve dhe subvencioneve të realizuara nga viti paraprak dhe gjatë këtij viti.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë nga viti në vit po e shton buxhetin për zhvillimin e bujqësisë, njëherit vazhdimisht po përkrah fermerët me projekte shumë të arsyeshme që deri më tani asnjëherë nuk kanë pas përkrahje të tilla.

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë gjatë vitit 2019 ka zhvilluar këto aktivitete:

- **Furnizimi i fermerëve me serra dhe sistemin e ujitjes pikë-pikë**

Për shkak të interesimit të madh të fermerëve për serra familjare- 50 m², Drejtoria e Bujqësisë këtë vit 50% të buxhetit të planifikuar për serra e ka orientuar për serra familjare dhe 50% për ngritjen e serrave me sipërfaqe prej 300m².

Serra familjare janë ngritur 95 copë, ndërsa serra me sipërfaqe prej 300m² janë ngritur 10 copë. Projekti i ngritjes së serrave është realizuar me pjesëmarrje të fermerëve me 25%, ndërsa 75% e vlerës është subvencionuar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë. Në këtë subvencionim është përfshirë konstruksioni i serrës, folija, transporti, punët rreth vendosjes së serrës dhe sistemi i ujitjes.

- **Furnizimi i fermerëve kultivues të grurit me impute bujqësore- pleh artificial azotik**

Përfitues të këtij subvencionimi kanë qenë fermerët që kanë mbjellë grurë në vjeshtën e vitit 2018. Sasia e tërësishme e plehut ishte 140,000kg për një sipërfaqe prej 930 ha me nga 150kg/ha. Shpërndarja e plehut është bërë në mënyrë proporcionale bazuar në sipërfaqen që kishin të mbjellur fermerët e Komunës së Ferizajt.

- **Subvencionimi i fermerëve për ngritjen e pemishteve me arra**

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë edhe këtë vit ka vazhduar subvencionimin e fermerëve për ngritjen e pemishteve me arra. Subvencionimi ka qenë në sigurimin e fidaneve dhe të sistemit të ujitjes për pemishtet që do të ngriten. Me këtë subvencionim janë ngritur 11ha me pemishte të arrave, përfitues kanë qenë 22 fermerë me nga 0.50ha Këto pemishte janë monitoruar edhe pas ngritjes dhe gjendja e tyre është shumë e mirë. Realizimi i këtij subvencionimi është bërë pa pjesëmarrjen e fermerëve.

- **Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra me fidane të perimeve**

Është një projekt që në Drejtorinë e Bujqësisë është realizuar për herë të parë, është bërë subvencionimi i fidaneve të perimeve. Fermerët përfitues furnizimin me fidane të perimeve e kanë bërë vetë, ndërsa kompenzimin e pagesës e ka bërë Drejtoria e Bujqësisë, përfituesve u janë pranuar nga 4 fidane/m² me çmim prej 0.25€/ fidan. Përfitues kanë qenë 23 fermerë, me gjithsej 32,000 fidane të perimeve që kultivohen në sipërfaqe prej 8000m² serrë.

- **Përkrahja e fermerëve me mekanizim bujqësor**

Ky projekt është realizuar për herë të parë dhe është vlerësuar si shumë i arsyeshëm. Me realizimin e këtij projekti janë përkrahur 92 fermerë me nga një pajisje bujqësore varësisht nga veprimtaria e tyre.

Fermerët janë përkrahur me këto pajisje:

Nr.r.	Emërtimi i mallit	Njësia	Sasia
1	Plugj 755	copë	10
2	Kosa roto 165	copë	10
3	Freza 1.8 M	copë	12
4	Trinat 4 krahëshe	copë	10
5	Mbjellëse misrit pneumatike 4 rendëshe	copë	3
6	Mbjellëse gruri me 16 rende	copë	5
7	Spërkatëse 500 litra	copë	10
8	Pjatore me 24 disqe	copë	11
9	Shpërndarëse të plehut 350 litra	copë	10
10	Grabuja diellore	copë	11

- **Përkrahja e fermerëve me pajisje - sistem kundër breshërit**

Një projekt i tillë realizohet për herë të parë në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë, por njëherit Ferizaj është e vetmja komunë që realizon projektin për sistem kundërbreshërit. Me këtë projekt do të përfshihet sipërfaqja prej 4 ha përmishte me mollë. Të gjitha furnizimet nga operatori ekonomik tek fermerët janë kryer, për shkak të kushteve jo të përshtatshme – thatësisë, montimi i sistemit ende nuk është kryer, ashtu edhe është e paraparë me kontratë.

- **Projekti i subvencionimit të kamatave të fermerëve** ka vazhduar edhe në vitin 2019 ku është bërë pranimi i aplikacioneve të fermerëve, janë vizituar fermerët, janë realizuar kreditë e tyre, janë kryer pagesat e fermerëve dhe është bërë monitorimi i projekteve pas implementimit. Gjatë vitit 2019 me projektin e subvencionimit të kamatave janë përkrahur 12 fermerë.

- **Vaksinimi i fondit blegtoral** – Drejtoria e Bujqësisë ka realizuar projektin për vaksinimin gjedheve, deleve dhe dhive kundër sëmundjeve clostridiale në fermat komerciale dhe gjysëm komerciale. Janë vaksinuar 4200 krerë gjedhe dhe bagëti të imëta (dele dhe dhi) 13578 krerë. Arsyeja e realizimit të këtij projekti është bërë nga se ky vaksinim parandalon sëmundjet infektive duke bërë që humbjet ekonomike në fermat e fermerëve të jenë shumë më të ulëta, rritjes së kualitetit të prodhimit dhe shëndetit të mirë të kafshëve me këtë edhe të njeriut duke konsumuar prodhime të shëndosha të mishit dhe qumështit të këtyre kategorive të kafshëve të imëta.

- **Trajtimi i lopëve të qumështit kundër endoparazitëve** - Drejtoria e Bujqësisë e ka në procedurë projektin për trajtimin e lopëve të qumështit në fermat komerciale dhe gjysëm komerciale kundër endoparazitëve i cili do të implementohet së shpejti. Janë trajtuar 2000 krerë.

- **Repelimi i gjedheve** (lopëve të qumështit, mështjerrave dhe viçave) kundër sëmundjeve virale e parazitare nga insektet e ndryshme-Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ka realizuar projektin pepelimi i gjedheve (lopëve të qumështit, mështjerrave dhe viçave) në fermat komerciale dhe gjysëm komerciale të Komunës së Ferizajt. Kjo masë preventive nënkupton trajtimin e kafshëve përmes repelentëve adekuat me qëllim parandalimin e bartjes së sëmundjeve nga insektet në gjedhe si atyre virale e parazitare. Me repelim bëhet sidomos parandalimi i babeziosës si sëmundje parazitare mjaft problematike duke shkaktuar humbje të mëdha ekonomike tek fermerët sepse një numër i tyre përfundon me fatalitet. Janë repeluar 4175 krerë gjedhe.
- **Rregullimi dhe mirëmbajtja e thundrrave tek lopët qumështore**- Sëmundjet e thundrrave ndikojnë në shëndetin dhe prodhimtarinë blegtorale ku vjen deri tek rënia e prodhimtarisë e njëherit edhe tek humbjet ekonomike në ferma. Është bërë rregullimi i thundrrave tek 2000 krerë lopë qumështore.
- **Subvencionimi i fermerëve me koshere të bletëve**– Fermerët të cilët kanë mbi 30 zgjoje të bletëve do të subvencionohen me koshere dy katëshe të cilat janë të kombinuara dru dhe plastik. Realizimi i këtij subvencionimi është me pjesëmarrjen e fermerëve me 20%(5,200.00) dhe nga Drejtoria e Bujqësisë me 80% (26,000.00). Për këtë projekt janë duke vazhduar procedurat.
- **Furnizimi i fermerëve me lopë të racës simental** - Drejtoria e Bujqësisë në mbështetje të mbarështuesve të fondit blegtoral ka nënshkruar kontratën për subvencionimin e fermerëve me 55 krerë të lopëve të racës simental. Realizimi i këtij subvencionimi është me pjesëmarrjen e fermerëve me 25%, dhe nga Drejtoria e Bujqësisë me 75%. Janë shpërndarë 60 krerë të lopëve të racës simental tek 60 fermerë.
- **Mbarsimi artificial i lopëve qumështore dhe mështjerrave** - Që ferma të jetë rentabile, përveç ushqimit të mirë, patjetër që duhet të investohet në përzgjedhjen e drejtë të racës së kafshës me këtë mundësohet kontrolli i sëmundjeve infektive dhe trajtimi i problemit të fertilitetit të ulët. Me material gjenetik do të mbarësohen të gjitha lopët dhe mëshqerrat e komunës sonë. Ky projekt ka kohëzgjatje 24 muaj por deri më 31.12.2019 janë mbarsuar 831 i lopëve qumështore dhe mëshqerrave.
- **Vaksinimi i qenve me pronar** –Drejtoria e Bujqësisë ka bërë shërbimin për vaksinimin e 3000 qenve me pronar.

- **Bashkëpunimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë me donatorë
Gjatë vitit 2019 janë projekte me këta donatorë :**

I. Marrëveshja e nënshkruar me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim- TIKa për realizimin e projektit: “Furnizimi i fermerëve me motokultivatorë”. Ky projekt u realizua në bashkëfinancim të TIKa-së me 60% dhe Drejtoria e Bujqësisë me 40%. Me realizimin e këtij projekti kanë qenë përfitues 20 fermerë me nga një motokultivator, përfitues janë kryesisht fermerët kultivues të perimeve në serra.

II. Në mes Drejtorisë së Bujqësisë dhe IADK (Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës) edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimi, është nënshkruar marrëveshja për realizimin e këtyre projekteve:

1. Furnizimi i 5 fermerëve me nga një llaktofriz, makinë mjelëse, nga tre bidonë dhe ofrimi i këshillave dhe trajnimeve në lëminë e blegtorisë. Ky projekt është realizuar në bashkëfinancim mes IADK-së, Drejtorisë së Bujqësisë dhe fermerëve përfitues.

2. Ngritja e pikës për përgatitjen e ëmbëlsirave- është kompletuar me të gjitha pajisjet e nevojshme dhe ofrimi i këshillave dhe trajnimeve në lëminë përkatëse. Ky projekt është realizuar në bashkëfinancim mes IADK-së, Drejtorisë së Bujqësisë dhe përfitueses së këtij projekti.

III. Marrëveshja në mes të Drejtorisë së Bujqësisë dhe IKC-së: Implementimi i projektit trevjeçar (2018-2020) për zhvillimin e bujqësisë sipas marrëveshjes së nënshkruar më datën 02.03.2018. Në kuadër të kësaj marrëveshje përfshihen shumë aktivitete mirëpo gjatë vitit 2019 janë realizuar këto aktivitete:

1. Ngritja e 7.5ha pemishte me lajthia - në kuadër të këtij projekti është përfshirë sigurimi i fidaneve, sistemi i ujitjes pikë-pikë dhe ofrimi i këshillave profesionale rreth mbjelljes dhe kultivimit të lajthive. Kanë qenë 15 përfitues me nga 0.50ha sipërfaqe.

2. Organizimi i panairit të gjedhit në Komunën e Ferizajt – është organizuar në bashkëpunim dhe bashkëfinancim në mes të Drejtorisë së Bujqësisë, GLV” Bifurkacioni dhe IKC. Besojmë që në të ardhmen organizimi i Panairit të gjedhit në Komunën e Ferizajt do të bëhet tradicional.

IV. Marrëveshja në mes të USAID-it, Drejtorisë së Bujqësisë, fermerëve përfitues dhe Partnerëve Strategjik që ishin Kompania SHPK “Besiana-G”-Ferizaj dhe Kompania” Agrium Fruits” SHPK nga Ferizaj për realizimin e projektit: Ngritja e 12 ha pemishte me dredhëza industriale. Përfitues ishin 24 fermerë me nga 0.50ha. Me këtë projekt janë siguruar fidanet nga partnerët strategjikë dhe USAID-i, ndërsa sistemi i ujitjes pikë-pikë dhe folia e zezë është siguruar nga Drejtoria e Bujqësisë me 75% dhe nga fermerët përfitues me 25% të vlerës.

- **Aplikimi i fermerëve për subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural** - kryhet në zyrat e Drejtorisë së Bujqësisë. Kjo fazë zgjatë mbi dy muaj, është një punë shumë voluminoze dhe tërë stafi i Drejtorisë së Bujqësisë është i angazhuar në kryerjen e këtyre punëve:

- *Shpallja e njoftimeve për aplikim për subvencione,
- *Përcaktimi i termineve të fermerëve,
- *Kontrollimi dhe pranimi i dokumenteve,
- *Rexhistrimi në Rexhistrin e Fermës,
- *Dixhitalizimi i parcelave në ELPIS,
- *Aplikimi online për të gjitha subvencionet në EFR.

Gjatë vitit 2019 për subvencionet nga MBPZHR në Drejtorinë e Bujqësisë kanë aplikuar gjithsej 980 fermerë për këto subvencione: lopë 2221 krerë, dele 8668 krerë, dhi 310 krerë, pula 79650 copë, bletë 7847 zgjoje, grurë 2243 ha, misër 2090 ha, thekër 6 ha, molla 61 ha, mjedra 58 ha, kumbulla 15 ha, patate 40 ha, kunguj 152 ha, qepë 16 ha, shalqinj 3 ha, lakra 3.5 ha , aronija 4 ha, manaferra 2 ha, arra 34 ha, vishnje 2 ha, lajthia 21 ha, dredhëza 7 ha, fasule 21 ha , domate 1 ha, specia 2 ha, marulla 1ha.

- Subvencionimi i fermerëve për sasi dhe cilësi të qumështit nga MBPZHR që bëhet për çdo tre muaj, aplikimi me të gjitha procedurat është bërë në Drejtorinë e Bujqësisë, ku kriter është të kenë sasinë së paku 1500 l /për tre muaj.

Në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë janë bërë:

- Kemi bërë planifikimin e projekteve dhe subvencioneve që do të realizohen me buxhetin e vitit 2019- 2021,
- Pagesat për të gjitha subvencionet e realizuara,
- Pagesat për të gjitha kategoritë e shërbimeve dhe mallrave,
- Janë bërë raportet mujore dhe gjashtëmujore për faturat e papaguara,
- Pagesat e participimit të fermerëve gjatë realizimit të subvencioneve,
- Pagesat e kamatave për fermerët përfitues të subvencionimit të kamatave,
- Planet dhe raportet e mbjelljeve pranverore,
- Janë bërë përgatitjet për korrje-shirje,

- Jemi të kyçur në komisionin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,
- Janë pajisur fermerët me vërtetime si prodhues bujqësor për nevoja të tyre personale,
- Të gjitha kërkesat që i janë drejtuar kësaj drejtorie janë shqyrtuar dhe janë zgjedhur konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.
- Mbajtja e trajnimeve është një instrument i rëndësishëm për realizimin e politikave të zhvillimit të bujqësisë. Trajnimet me komunitetin e fermerëve janë bërë me forma të ndryshme komunikimi dhe me një sërë aktivitete. Janë mbajtur trajnime me fermerë në sektor të ndryshëm të bujqësisë me tema mbi: teknikat dhe teknologjitë për prodhimin bimor dhe blegtoral, inpute cilësore, menaxhimin e fermës, kooperimin e fermerëve, plane biznesi, mundësitë e kreditimit, marketingun e prodhimeve bujqësore, çmimet e tregjet, potencialet prodhuese, mundësitë e përpunimit, prognoze-sinjalizimin i sëmundjeve dhe dëmtuesve, sigurinë ushqimore, etj. Janë shpërndarë rreth 1000 broshura dhe fletëpalosje fermerëve për tema të ndryshme të përgatitura nga Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike. Misioni i këtij shërbimi është siguri dhe ofrimi i informacionit dhe njohurive teknike dhe ekonomike për rritjen e prodhimit dhe të ardhurave për kategoritë e ndryshme fermerësh.

- **Njësia e pylltarisë**

	Objektivi	Aktivitetet	Rezultatet
Njësia e Pylltarisë Ferizaj	1. Mbrojtja e Pyjeve	<i>Rojet e pyjeve kanë ngritur</i>	Fletëparaqitje Penale –123 lëndë me 420.23 m ³ në vlerë 57935.94 €
			Fletëparaqitje për Kundërvajtje- 357 lëndë me 576.83 m ³ në vlerë 77265.70 €.
			Gjithsejt fletëparaqitje: Fletëparaqitje-480 Vëllimi – 997.06 m ³ Vlera – 135201.64 €
		<i>Konfiskimi i masës drusore</i>	Dru zjarri- 257.70 m ³
			Dru teknik– 12.14 m ³
			Nga konfiskimi i masës drusore janë ngritur 91 fletëparaqitje për transport ilegal të druve.

Janë zhvilluar 110 kontrolla dhe monitorime të pyjeve publike në rrugët pyjore dhe jopyjore

Janë zhvilluar 45 aksione me polici në rrugët pyjore, në tregun e druve.

Në Njësinë Menagjuese “Neredime-Jezerc” te Bashkimi i Lumenjve, që nga 1 marsi nga rojet e pyjeve është kujdestaruar 24 në këtë pikë kontrolli: Kjo kontroll ka zgjatur 2 muaj.

Kemi bërë mbylljen e rrugës në Lumin e Madh gjegjësisht në vendin e quajtur “Quki i dardhës”.

Takimet e mbajtura-Janë mbajtur takime me stafin e pylltarisë, takime me Inspektorë të Pylltarsisë në nivel Qendror.Janë mbajtur 4 takime me organet e policisë të nivelit qendro si dhe rajonal e lokal.

Gjatë vitit 2019, në kuadër të planit operativ nga ana e policisë së Ferizajt janë ndërmarrë mbi 10 aksione në pyje të Ferizajt në parandalimin e prerësve ilegal. Gjatë këtyre aksioneve janë kapur në flagrancë dëmtues të pyjeve për të cilët policia ka ngritur kallëzime penale. Këto aksione janë ndërmarrë në rajonin e Pleshinës, në rajonin e Burrnikut, rajonin Lumi i Madh dhe Jezerci 1.

Nga këto aksione nga ana e policisë janë ngritur 14 kallëzime penale me vëllim 60.63 m³.

Potenconi nëse keni aktivitete në mbrojtjen e pyjeve nga zjarret dhe sëmundjet.-

Gjatë vitit 2019 janë shfaqur këto zjarre në pyje publike:

Në rajonin Greme-Gaçkë, në rajonin Pleshinë-Greme, në rajonin e Dremjakut si dhe në rajonin Neredime.

Këto zjarre kryesisht janë shfaqur gjatë muajit mars dhe muajit gusht e shtator.Sipas një përlllogaritje në terren nga zjarri janë përfshirë rreth 26.80 hektarë.Këto zjarre janë shfaqur kryesisht në pyje të ulëta në kulturën e dushqeve dhe kanë qenë zjarre sipërfaqësore.Në fikjen e zjarrit kanë marrë pjesë, zjarrfikësit e Ferizajt, punëtorët sezonal të APK-së të Komunës së Shtërpces dhe Ferizaj si dhe stafi i pylltarisë.

Seancat gjyqësore-

Në Gjykatën Themelore-Divizioni Penal, janë mbajtur 223 seanca ndaj dëmtuesve të pyjeve. Në këto seanca gjyqësore ka qenë përfaqësuesi ligjor i DBP.

		Pasqyra e aktgjykimeve dhe akvendimeve për periudhën Janar-Mars: Nga Gjykata Themelore në Ferizaj, Divizioni për Kundërvajtje gjatë vitit 2019 kemi pranuar: - 396 aktvendime. Prej tyre 272 aktvendime janë pozitive, 123 aktvendime janë të pezulluara si dhe një aktvendim është negativ. Nga Gjykata Themelore në Ferizaj-Divizioni Penal janë pranuar 158 aktgjykime. Prej tyre 114 aktgjykime janë pozitive dhe 44 janë të pezulluara.
	2. Masat Silvikulturore	<i>Aktivitetet në shfrytëzimin e pyjeve publike, damkimin, realizimin etj.</i> Në ngastrën 32 operatori ekonomikë NTP “Meti Comerc” sipas ankandit gjatë vitit 2019 ka realizuar këtë masë drusore: dru teknik-73.68 m³ dhe dru zjarri 93.0 m³. Në ngastrën 34 operatori ekonomikë NTP “Meti Comerc” sipas ankandit, gjatë vitit 2019 ka realizuar këtë masë drusore: dru teknik-404.52 m³ dhe dru zjarri 255.30 m³. Gjatë vitit 2019 shitje me pakicë për furnizim me dru zjarri për ekonomitë familjare janë dhënë 191.46 m³. Këto dru janë dhënë nga damkimi i trungjeve në ngastra të llojit ahu, nga damkimi i pishave të thata si dhe nga rrallimet paratregtare. Nga depoja e Pylltarisë përmes Ankandit Publik janë shitur: Dru teknik me vëllim prej 14.71 m³ në vlerë të 1028.10 €. Poashtu nga shitblerja e masës drusore (në këmbë) në ngastrat pyjore përmes ankandit janë inkasuar -8163.96 €. Nga shitblerja e masës drusore përmes prerjeve sanitare janë inkasuar 246.50 €. Këto pagesa sipas ligjeve në fuqi bëhen përmes bllokpagesave nga APK-ja. Në bazë të Vendimit nr.138/19 të Kuvendit Komunal, nga drutë e konfiskuara është bërë shpërndarja e druve të zjarrit për familjet skamnore. Me nga dy metra dru zjarri janë furnizuar 150 familje.

		<i>Aktivitetet në shfrytëzimin e pyjeve private-</i> Gjatë vitit 2019 nga pronarët e pyjeve private kemi pranuar 73 kërkesa. Nga këto kërkesa 53 kanë qenë kërkesa për pyje private, ndërsa 20 kanë qenë kërkesa të ndryshme (tokë bujqësore, kullosa etj). Këto kërkesa janë trajtuar nga Njësia Komunale e Pylltarisë dhe janë vulosur 227.34 m³ dru zjarri. Nga APK-ja janë damkosur 38 kërkesa me vëllim prej: dru teknik-154.11 m³ dhe dru zjarri-1346.19 m³. Nga sasia e gjithmarshme e damkosur nga APK-ja dhe Njësia Komunale janë lëshuar 337 fletërpërcjellëse me vëllim prej 860.87 m³. Nga shërbimet për pyje private janë bërë pagesa në vlerë prej 3258.36 €.Këto pagesa sipas ligjeve në fuqi bëhen përmes bllokpagesave nga APK-ja.
	3. Aktivitetet tjera	<i>Angazhimet në komisione të ndryshme-</i>Gjatë vitit 2019 nga ana e stafit të pylltarisë janë formuar këto komisione: Komision për pranim-dorëzimin e ngastrave pyjore. Komision për verifikim dhe vlerësim të pyjeve private. Komision për regjistrim të dëmeve pyjore në të gjitha rajonet e Njesisë Komunale në Ferizaj.



REPUBLIKA E KOSOVËS ● REPUBLIKA KOSOVA ● REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT ● OPŠTINA UROŠEVAC ● MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2019

Arben Halili

Drejt看 i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

Ferizaj, 2020

1. HYRJJE

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në kuadër të fushëveprimtarisë së saj ka sektorin e shërbimeve publike dhe sektorin e emergjencave.

Sektori i shërbimeve publike mbulon aktivitete që ndërlidhen me mirëmbajtjen e hapësirave publike si mirëmbajtja e rrugëve me asfalt, me zhavor, riparimin e trotuareve, pastaj mirëmbajtja e rrugëve me shenja të komunikacionit si ato horizontale dhe vertikale, mirëmbajtjen e hapësirave të gjelberuara si sheshet, parqet, drunjtë dekorativ, mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik si dhe zgjerimin e tij aty ku paraqiten nevojat sipas mundësive buxhetore, pastaj mbarëvajtjen e komunikacionit rrugor dhe atij të mallrave, mirëmbajtjen e infrastrukturës nëntokësore si rrjeti i kanalizimit atmosferik dhe atij fekal, rrjetin e ujësjellësit etj, çdo herë në koordinim edhe me ndërmarrjet publike për detyrat dhe obligimet që ato i kanë ndaj qytetarëve të përcaktuara me ligjet dhe udhëzimet administrative në fuqi.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë e tjera, Komuna në territorin e saj organizon mbrojtjen nga zjarri, kujdeset për zbatimin dhe përparimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore si vërshimet, rrëshqitjet e dheut apo erërat si dhe fatkeqësi tjera natyrore që mund të ndodhin në Komunën e Ferizajt.

Në të njejtën kohë, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë zhvillon aktivitete për shënimin e datave të rëndësishme mjedisore si dhe dekorimin e qytetit për festat e fundvitit dhe festave tjera zyrtare. Gjatë vitit 2019 janë pranuar 1416 kërkesa nga zyra pritëse të adresuara nga qytetarët për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, pas analizave të gjitha janë shpërndarë tek zyrtarët përkatës të drejtorisë të cilat pas verifikimeve në terren disa prej tyre janë miratuar disa janë refuzuar e disa janë në proces.

Kërkesa të pranuar	Kërkesa të miratuara	Kërkesa të refuzuara	Kërkesa në proces
1416	1214	199	3

2.SEKTORI I EMERGJENCAVE

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-027 për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, në të cilin përcaktohen dhe rregullohen detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore, stafi i sektorit të emergjencave është munduar që të përmbush këto obligime që dalin nga ligji duke kryer këto detyra në terren që lidhen me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve.

- Gjatë këtij viti kemi pranuar 64 kërkesa të natyrave të ndryshme, ku të gjitha janë shqyrtuar.
- Mbikëqyrja e kryerjes së punëve në pastrimin e rrugëve të qytetit dhe fshatrave gjatë sezonit dimëror dhe veror.
- Menaxhimi-shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore si reshjet e shiut, borës, erërave dhe rastet e zjarreve.
- Përcjellja e punëve në mbjelljen e 25.000.00 copë luleve verore dhe 320 copë vjeshtore si dhe 340 copë të drunjve dekorativ në hapësirat e gjelbëruara të qytetit. Është bërë krasitja e drunjve dekorativ në sheshin e qytetit në mënyrë profesionale. Janë shënuar edhe data me rëndësi mjedisore si Dita e Pranverës, Dita e Tokës dhe Dita e Mjedisit si dhe data tjera me rëndësi ekologjike dhe mjedisore.
- Përcjellja e punëve në eliminimin e 50 deponive ilegale me materiale te ngurta dhe urbane nga ana e kompanisë K.R.M, Pastërtia’’ dhe NPL, Ambienti’’
- Largimi i 12 (dymbëdhjetë) deponive ilegale në aksionin “Ta pastrojmë Kosovën”.
- Përcjellja e punëve në deminimin e terrenit në Parkun, LIRIA’’ nga ana FSK-së.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave, shqiptare në qytet dhe Talinoc i Jerlive.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave ortodokse-serbe në qytet dhe në fshatrat: Bablak, Varosh, Bibaj, Talinoc i Muhaxhërve dhe Softaj.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave katolike në qytet.
- Bibaj-Sojevë-Zllatar furnizim me ujë me anë të cisternës për disa nga banorët e këtyre fshatrave nga ana e njësisë së zjarrfikjes.
- Vendosja e 7 aparateve ultrasonike kundër shpendëve.
- Vendosja e 50 shportave për mbeturina në sheshin e qytetit dhe në disa fshatra etj.

- Organizimi dhe menaxhimi me sukses i ushtrimit simulativ” Shpata e Argjendtë”-2019 në bashkëpunim me Komandën Qendrore të KFORIT dhe Kampit Bonsteel për vërshimet.
- Pjesëmarrja në trajnime të organizuara nga AKK dhe GIZ-i Gjerman për menaxhimin e mbeturinave dhe ujës-jellësve.
- Mbajtja e punëtorive me AME-në për menaxhimin e fatkeqësive natyrore.
- Menaxhimi i aktiviteteve të ndërmarra nga qytetarët dhe Komuna për rastin e tërmetit në Shqipëri dhe strehimi i qytetarëve të ardhur nga Shqipëria.

2.1. Hapja dhe pastrimi i kanaleve ujore dhe shtretërve të lumenjve

Me qëllim mirëmbajtjen e shtretërve të lumenjve dhe kanaleve ujore për të eliminuar vërshimet gjatë reshjeve janë hapur 77.961.23m gjatësi të kanaleve dhe shtretër të lumenjeve si dhe janë vendosur 115 m gjatësi të gypave dhe janë eliminuar 55 m-3 të shkurreve dhe drunjve.

- Talinoc i Muhaxherëve-hapja dhe pastrimi i shtratit të lumit në gjatësi prej L=1760m.
- Ferizaj-Parku i Lirisë -hapja dhe pastrimi i kanalit në gjatësi prej L=532m.
- Prelez i Jerlive -hapja dhe pastrimi i kanaleve në gjatësi L=4085.66m.
- Prelez i Muhaxhereve- hapja dhe pastrimi i kanaleve në gjatësi L=2950m
- Koshare- hapja dhe pastrimi i shtratit të lumit dhe kanaleve ujore në gjatësi 3840m.
- Tërrn-hapja dhe pastrimi i kanaleve ujore deri te lumi, Sitnica” në gjatësi L=10826m.
- Ferizaj-Ura e Dudit- hapja dhe pastrimi i lumit ne gjatësi L=2610m.
- Ferizaj-Rr. Brahim Ademi-hapja dhe pastrimi i kanaleve ujore në gjatësi L=1750m.
- Pleshinë-hapja dhe pastrimi i kanaleve ujore në gjatësi L=631m.
- Nikadin-hapja dhe pastrimi i shtratit të lumit dhe kanaleve ujore në gjatësi L=4281.97m.
- Pojatë- hapja dhe pastrimi i kanaleve ujore në gjatësi L=3658m
- Rahovicë- hapja dhe pastrimi i kanaleve ujore në gjatësi L=3747m
- Mirash- hapja dhe pastrimi shtrati të lumit dhe kanaleve ujore në gjatësi L=3120m
- Kosinë- hapja dhe pastrimi shtrati të lumit dhe kanaleve ujore në gjatësi L=5365m
- Gaçkë- hapja dhe pastrimi shtrati të lumit dhe kanaleve ujore në gjatësi L=584m
- Greme- hapja dhe pastrimi shtratit të lumit dhe kanaleve ujore në gjatësi L=2178m

- Nerodime e ulët- hapja dhe pastrimi i shtratit të lumit dhe kanaleve ujore në gjatësi L=2920m
- Bablak- hapja dhe pastrimi shtratit të lumit dhe kanaleve ujore në gjatësi L=4675m
- Lubovc- hapja dhe pastrimi shtratit të lumit dhe kanaleve ujore në gjatësi L=5986m
- Cernill- hapja dhe pastrimi shtratit të lumit dhe kanaleve ujore në gjatësi L=2757m
- Papaz- hapja dhe pastrimi shtratit të lumit dhe kanaleve ujore në gjatësi L=3984.60m

2.2. Raste zjarri për të cilat qytetarët kanë bërë kërkesa për dalje në vendngjarje

Duhet potencuar se stafi i emergjencave në kuadër të Drejtorisë pas pranimit të kërkesave nga qytetarët për dalje në vendngjarje për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri ka verifikuar këto raste:

- Ferizaj rr.” Hasan Berisha”-rast zjarri në familjen e Muharrem Xhemajlit.
- Sojevë- rast zjarri në shtëpinë e Bekim Dragoshit.
- Ferizaj rr.” Indrit Cara”-rast zjarri në shtëpinë e Jeton Gjellës.
- Ferizaj-rast zjarri në familjen e Edon Ahmetit.
- Ferizaj- rast zjarri në familjen e Agim Dashit.
- Ferizaj-rast zjarri në biznesin familjar të Visar Hamdiut.
- Jezerc-rast zjarri në familjen e Qamil Ugzmajli.
- Dremjak- rast zjarri në familjen e Milaim Veselit
- Talinovc i Muhaxherëve- rast zjarri në familjen e Xhemajl Ramiqit.
- Zaskok-rast zjarri në familjen Mehmet Jasharit.
- Ferizaj- rast zjarri në biznesin e Alban Bytyqit.
- Intervenime ne largimin e akullnajave nga çatitë e banesave si dhe demolimet e objekteve nga rrëshqitja e borës.

2.3. Largimi i deponive ilegale dhe masat parandaluese-vendosja e rrethojave

Me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të pastërt si dhe largimin e mbeturinave nga hapësirat publike janë zhvilluar një numër i madh i aktiviteteve:

- Kompania KRM, Pastërtia'' dhe kompania NPL,,Ambienti'' ka eliminuar 50 deponi ilegale. Largimi i 12 (nëntë) deponive ilegale në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën".
- Gjithsej deponi të eliminuara 62 apo 1658 tonë mbeturina.
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve (pesë raste të demolimeve të kulmeve të shtëpive dhe objekteve përcjellëse, të shkaktuara nga era e fortë dhe reshjet atmosferike).
- Vazhdimisht kemi bërë përcjelljen e punëve të kompanive të kontraktuara për pastrimin e rrugëve nga bora-hedhjen e kripës dhe rërës, në të gjitha rrugët e qytetit dhe fshatrave.
- Gjithsejt: 62 deponi ilegale të eliminuara nga zona e qytetit dhe fshatrave. Duhet theksuar se Komuna e Ferizajt është vlerësuar për keto aktivitete nga MMPH-ja duke përfituar 600 kontinjer 120 litërsh të cilët janë shpërndarë nëpër familje të fshatrave dhe në qytet duke mundësuar kështu rritjen dhe zgjerimin e klientëve në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

3.SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Në kuadër të shërbimeve publike janë zhvilluar një numër i madh aktiviteteve të cilat drejtpërdrejt kanë prekur interesat e qytetarëve si në riparimin e kanalizimeve, ujesjellësve, mirëmbajtjen e rrugëve me zhavor, asfalt dhe mirëmbajtjen e trotuarëve.

Duke u nisur edhe nga kërkesat e qytetarëve dhe gjendjes në terren janë realizuar këto punë dhe aktivitete.

Gjatë vitit 2019 kemi pranuar 194 kërkesa të ndryshme kryesisht nga pjesët rurale dhe nga pjesa urbane të cilat kanë të bëjnë më së shumti me riparime të rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza, dhe kyçje të reja, si dhe meremetimin-mirëmbajtjen e rrugëve me zhavor.

Gjat vitit 2019 kemi kryer shumë raste aty ku ka patur mundësi për deblokime në bashkëpunim me Kompaninë KRU,, Bifurkacioni” kemi bërë deblokimin e rrjeteve, kurse pjesët ku ka qenë nevoja për ndërrimin e gypave, dhe kyçjet e reja i kemi kryer si në shënimet në vijim:

3.1.Riparimi i rrjetit të kanalizimit

Gjatë vitit 2018 kemi pranuar një numër të madh të kërkesave dhe ankesave që lidhen me rrjetin e kanalizimeve atmosferike dhe fekale, andaj pas verifikimit të tyre në terren dhe konstatimit se janë jashtë funksionit për të cilin janë të dedikuar kemi ndërmarr masa për të riparuar apo edhe instaluar në gjatësi të caktuara rrjet të kanalizimeve fekale dhe atmosferike në zonat urbane dhe rurale të Komunës.

Gjatësia e riparimeve dhe instalimeve të këtij rrjeti të kanalizimeve arrin 7187 metra gjatësi.

Gjatësia e riparimeve të rrjetit të ujesjellësit arrin 1285 metra gjatësi.

3.2. Riparimi i rrugëve me asfalt dhe zhavor

Gjithashtu për të përmirësuar infrastrukturën rrugore sektori i shërbimeve publike ka kryer një numër të madh të aktiviteteve duke u nisur nga gjendja në terren dhe kërkesat e qytetarëve. Pas daljes në terren dhe verifikimit të gjendjes nga zyrtarët e shërbimeve publike e duke u dhënë prioritet rasteve më emergjente si dhe duke patur parasysh kufizimet buxhetore janë riparuar mbi 7246 metra katrorë të rrugëve me asfalt, mbi 3614 metra katror të trotuareve si dhe 74802 metra katrorë të rrugëve me zhavor.

4. NJËSIA E TRAFIKUT DHE TRANSPORTI RRUGOR

Njësia e trafikut dhe transportit rrugor gjatë vitit 2019 ka pranuar gjithsej 992 kërkesa të natyrave të ndryshme si leje për taksi individuale, pengesa në rruge, bllokime të rrugëve, leje për transport të mallrave, kërkesa për shenja të trafikut etj.

Nga përshkrimi i detyrave zyrtare të cilat rrjedhin nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, zyrtari i lartë për komunikacion rrugor gjatë periudhës një vjeçare sipas planit të parashikuar, për këtë vit ka realizuar këto punë:

4.1.Transporti rrugor i udhëtarëve dhe mallrave

- Transporti i udhëtarëve me autobus dhe taksi është në një nivel të kënaqshëm, ku nga dyzet e pesë fshatra sa ka Komuna e Ferizajt, dyzet e tri prej këtyre fshatrave janë të përfshira në transportin publik dhe vazhdimisht inspektohet nga inspektori i transportit.
- Janë miratuar shtatëmbëdhjetë leje të reja për kryerjen e transportit publik të udhëtarëve taksi (taksi individual),
- Janë miratuar të gjitha kërkesat për vazhdim lejeve për kryerjen e transportit publik të udhëtarëve taksi të regjistruara në vitet paraprake,
- Janë revokuar pesëmbëdhjetë leje për kryerjen e transportit publik të udhëtarëve taksi,
- Janë miratuar njëzetë e nëntë pëlqime për lëvizje pa pengesa me automjete transportuese nëpër rrugët e qytetit,
- Janë miratuar dyqind e njëzetë e shtatë pëlqime për ndërprerje të përkohshme e trafikut apo vetëm të njërit shirit të qarkullimit në trafik, për arsye të kryerjes së punëve ndërtimore në objektet kolektive.
- Janë miratuar njëzet e dy pëlqime për ndalje e përkohshme me automjete transportuese - pikap, me qëllim të ngarkim-shkarkim të produkteve të konsumit të përgjithshëm nëpër lokale afariste,
- Së bashku me inspektorin e transportit kam kryer kontrole të rregullta në transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave si dhe kemi bërë vizita të shpeshta edhe në Stacionin e Autobusëve lidhur me mbarëvajtjen e transportit të udhëtarëve me autobus dhe pengesat që janë paraqitur nga disa taksitë brenda stacionit.

- Në bashkëpunim me Inspektorin e Trafikut dhe Policinë e Kosovës kemi mbajtur takime të vazhdueshme për mbarëvajtjen e qarkullimit në trafik dhe eliminimin e pengesave të cilat janë paraqitur nga operatorët e transportit me autobus dhe transportuesit e udhëtarëve me automjete taksi.

4.2. Trafiku rrugor

Në këtë pikë është paraparë rregullimi teknik i qarkullimit në trafik dhe ngritja e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, ku së bashku me njësinë e trafikut të policisë kemi analizuar disa rrugë të qytetit dhe kemi dhënë disa ndryshime konkrete të cilat janë realizuar me qëllim të krijimit të një ambienti më të sigurt dhe ngritja e këtyre shërbimeve në një shkallë më cilësore për qarkullimin e këmbësorëve, biçikletave dhe mjeteve motorike.

4.2.1. Mirëmbajtja e rrugëve me shenja të trafikut rrugor

Në bazë të planifikimeve për këtë vit, kemi realizuar këto punë në sinjalizimin e rrugëve me shenja ndriçuese, shenja horizontale dhe shenja vertikale.

4.2.2. Shenjat ndriçuese të trafikut:

- Në rrugën urbane “Brahim Ademi”, pikërisht në dy vendkalime të këmbësorëve janë vendosur panelet për ndriçimin e vendkalimit.
- Në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, pikërisht përballë shkollës fillore të mesme të ulët “Jeronim De Rada” është vendosur një panel për ndriçimin e vendkalimit të shënuar për këmbësorë.
- Në rrugën “Ahmet Kaçiku”, pikërisht përballë shkollës fillore të mesme të ulët “Gjon Serreçi” dhe përballë Stacionit Policor janë vendosur dy panele për ndriçimin e vendkalimit të shënuar për këmbësorë.

- Vendosja e këtyre paneleve ndriçuese për shënimin e vendkalimeve të këmbësore në këto rrugë janë bërë me qëllim të ngritjes së sigurisë në trafikun rrugor.

4.2.3. Shenjat horizontale të trafikut.

- Në rrugët urbane “12 Qershori”, “Ahmet Kaçiku”, “Brahim Ademi”, “Ramadan Rexhepi”, “Dëshmorët e Kombit”, “Besim Rexhepi”, “Tahir Sinani”, “Agim Matoshi”, “Sejdi Sejdiu”, “Zenel Hajdini”, “Enver Topalli”, “Reçakut”, “Rexhep Bislimi”, “Hysen Statovci” në fshatin Fshati i Vjetër dhe rrugën “Shaban Viça”, pikërisht segmenti Fshati Doganaj-Greme-Gaçkë-Bajnicë deri te kryqëzimi me rrugën rajonale për Brezovicë janë shënuar këto shënime horizontale në rrugë :
 - Vija e ndërprerë e ndarjes së shiritave të trafikut në gjatësi 12.229,44 [lm],
 - Vija e plotë e ndarjes së shiritave të trafikut në gjatësi 11.917,10 [lm],
 - Shënimi i vijës së parkingjeve 490 [lm],
 - Vija e stopit para vendkalimeve 34.0 [m²],
 - Shënimi i sipërfaqeve tjera për orientim 31.0 [m²],
 - Vendkalimet e shënuara të këmbësorëve 1060.80 [m²],
 - Kufizimi i shtegut të biçikletave me ngjyrë të kuqe në gjatësi 4050 [lm],
 - Shënimi i logove të biçikletës (10 copë),
 - Shënimi i dy vend-ndaljeve të autobusëve me ngjyrë të verdhë (2 copë),
 - Është shënuar vija e bardhë optike e paralajmërimit për zvogëlimin e shpejtësisë (shiritat vibrues) në gjatësi 245 [lm].
 - Punimi i shigjetave udhëzuese një drejtimesh (30 copë).
 - Punimi i shigjetave udhëzuese një drejtimesh (15 copë).

4.2.4. Shenjat vertikale të trafikut

- Rrugët në të cilat është intervenuar me shenja vertikale të trafikut:
 - Rruga urbane “Ahmet Kaçiku” me rrugët anësore dhe tre kryqëzimet me rreth-rrotullim.
 - Fshati Fshati i Vjetër – segmenti rrugor nga rruga nacionale (N2) deri te rruga nacionale (N25-3) dhe rrugët anësore brenda fshatit.
 - Rruga urbane “Brahim Ademi” me rrugët anësore dhe dy kryqëzimet me rreth-rrotullim.
 - Rruga urbane “Epopeja e Jezercit” me rrugët anësore.
 - Fshati Sojevë rruga kryesore me rrugët anësore.
 - Rruga urbane “Josip Rela”,
 - Rruga urbane “Hasan Prishtina”, “2 Korriku” dhe “Astrit Bytyçi” me rrugët anësore.
 - Rruga urbane “Ramadan Rexhepi”, “Dëshmoret e Kombit”, “Fatmir Ratkoceri” dhe afër shkollës “Ganimete Terbeshi”.
 - Fshati Gaçkë, Greme dhe Doganaj me rrugë anësore brenda fshatit.
 - Fshati Komogllavë, Rahovicë dhe Koshare me rrugë anësore brenda fshatit.
 - Rruga urbane “Zenel Hajdini”, “Besim Rexhepi” dhe “Rizah Matoshi”.
 - Rrugët urbane “Zenun Beqa”, “Lidhja Prizrenit”, “Arsim Zeqiri”, “Alishefik Spahiu”, “Fehmi Lladrovci” dhe “Gëzim Sahiti.
 - Rrugët urbane “Kemajl Hetemi”, “Gjon Serreçi”, “Azem Shkreli”, “Parku i Lirisë” dhe “Isa Boletini”.
 - Rrugën urbane “Hamzë Jashari”, “Dëshmorët e Kombit”, “Ëesli Clark”, “Shkëlzen Haradinaj”, “Tahir Sinani” dhe “12 Qershor”.
 - Në rrugën e fshatit Dremjak - Nerodime.
 - Në rrugën urbane “Reçaku”.
 - Në rrugën urbane “Besnik Osmani”.
 - Në rrugët urbane “Shën Nënë Tereza” dhe “Qamil Oamani”.
 - Në rrugën e fshatit Zaskok rruga kryesore me rrugët anësore.

- Sasia e shenjave vertikale të vendosura në rrugët e lartshënuara :
- Furnizimi dhe instalimi i 496 paneleve rrugore rrethore, trekëndore dhe katrore me dimensione Ø60, 3x900 dhe 600x600 [mm].
- Furnizimi dhe instalimi i 8 paneleve rrugore katërkëndëshe me dimensione 600x900 [mm].
- Furnizimi dhe instalimi i 55 paneleve rrugore katërkëndëshe udhëzuese me dimensione 1350x400 [mm].
- Furnizimi dhe instalimi i 12 paneleve katërkëndëshe për informata shtesë me dimensione 600x300 [mm].
- Furnizimi dhe montimi i 25 paneleve të emërtimeve të rrugëve.

4.3. Kamerate e sigurisë

- Komuna e Ferizajt, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë vazhdimisht bënë mbikëqyrjen dhe instalimin e kamerave të sigurisë për nevojat e Stacionit Policor në Ferizaj.
- Këtë vit kemi bërë vendosjen e dymbëdhjetë kamerave të reja të sigurisë, duke potencuar Stadiumin e Qytetit “Shaban Hashani” si dhe mirëmbajtjen e njëqind e tridhjetë e shtatë kamerave ekzistuese.

4.4. Punë tjera

- Pjesëmarrja në komisione brenda Komunës,
- Pjesëmarrja në trajnime dhe seminare të ndryshme të organizuara nga DEMOS, USAID, HELVETAS, GIZ, Asociacioni i Komunave etj.
- Vlen të veçohet hartimi i Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban i cili ka filluar të hartohet në vitin 2019 dhe pritet të përfundoj në Qershor të 2020. Ky projekt është mbështetur nga Asociacioni i Komunave kurse është duke u hartuar nga ekspertët nga Kolegji Tempulli në bashkëpunim me zyrtarët adekuat të Komunës së Ferizajt.

5.NJËSIA E NDRIÇIMIT PUBLIK

- Gjatë vitit 2019 ka vazhduar puna kontinuele në mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik ekzistues si dhe është punuar intensivisht në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit në rrugët dhe hapësirat ku nuk ka pasur ndriçim publik më parë duke u bazuar edhe në mundësië buxhetore.
- Gjatë vitit 2019 janë pranuar gjithsej 166 kërkesa për mirëmbajtje apo rrjet të ri.
- Gjatë vitit 2019 janë vendosur gjithsej 1640 trupa ndriçues LED (poça eficient) dhe atë 1467 cope 50v, 72 copë 30v, 72 copë 80v, 7 copë reflektorë 100v dhe 4 copë reflektor 400v në rrjetin ekzistues të shtyllave të KEDS-it si dhe në shtyllat e reja (metalike-398 copë dhe atyre të drurit-72 copë) të vendosura nga Komuna. Shprehur në vijë gjatësore gjatë vitit 2018 janë realizuar 115 km ndriçim publik. Ndriçimi publik si fushë me rëndësi e shërbimeve publike është bërë një infrastrukturë shumë e nevojshme për lëvizjen e lirë. Konform kësaj edhe kërkesat e qytetarëve për rregullimin e ndriçimit publik në hapësirat apo lokalitetet ku ata banojnë janë gjithnjë në rritje.
- Rrjeti i ndriçimit publik po vjen vazhdimisht duke u zgjeruar dhe deri më tani pjesa dërrmuese e rrugëve të qytetit dhe fshatrat e Komunës së Ferizajt janë të mbuluar me ndriçim publik dhe me këtë natyrisht është rritur edhe kostoja e mirëmbajtjes dhe shpenzimeve. Me qëllim të kursimit të energjisë elektrike këtë vit kemi bërë reduktimin e orarit të orëve me ndriçim duke e ndërprerë ndriçimin publik në orët pas mesnatës, në këto orë kur më së paku nevojitet ndriçimi, si masë eficiente apo kursyese në rrjetin e ndriçimit publik në Komunën e Ferizajt duke i vendosur sensorët për këtë funksion në çdo pikë matëse të rrjetit të ndriçimit publik në Komunën e Ferizajt.
- Përveç punës në mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik në fund të vitit 2019 kemi bërë dekorimin e qytetit me rastin e festave të fundvitit duke i vendosur dritat dekorative, bredhin e Vitit të Ri dhe elementet tjera dekorative në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, në sheshin para objektit komunal, në sheshin “Hyrë Emini”.
- Këtë vit kemi bërë disa risi dhe zbukurime paksa më ndryshe se viteve tjera në dekorimin e qytetit, të cilat me plot të drejtë mund të themi se i kanë dhënë një pamje shumë imponante dhe mbresëlënëse qytetit të Ferizajt dhe është listuar si qyteti i dytë me i zbukuruari për festat e fundvitit dhe për këtë treguesit më të mirë janë qytetarët e Komunës së Ferizajt të cilët kanë qenë

mjaft të kënaqur dhe të cilët më së miri e kanë përjetuar këtë zbukurim gjatë ditëve dhe mbrëmjeve të para të Vitit të Ri. Por gjithashtu edhe mediat si ato lokale dhe ato nacionale kanë dhënë vlerësime mjaft të mira për dekorimin e qytetit të Ferizajt, duke e veçuar Ferizajin si qytetin me dekorimin më të mirë dhe më atraktiv nga të gjitha Komunat e Kosovës.

6.. NJËSIA E SHËRBIMIT TË ZJARRËFIKJES DHE SHPËTIMIT

- Në vitin 2019 Shërbimi Zjarrfikjes dhe Shpëtimit ka pasur 773 dalje të ndara në kategori intervenimesh të cilat janë të paraqitura në pjesën e dytë të raportit përmes pjesës grafike të intervenimeve.
- Gjatë vitit 2019 Shërbimi i Zjarrfikjes dhe Shpëtimit pati intervenime nga më të ndryshmet, zjarret, aksidentet, largimin e objekteve të demoluara nga erërat si dhe intervenime tjera të natyrave të ndryshme si rezultat i fatkeqësive natyrore që ishin gjatë vitit 2019.
- Duhet potencuar se sfidë serioze që ka ndikuar drejtpërdejt në punën e këtij shërbimi ka qenë numri i pamjaftueshëm i zjarrfikësve profesional, mosplotësimi i kriterëve numerikisht për një shërbim me standarde të parapara me Ligjin Nr. 04/-L-049 dhe Rregullorja NR 16/2012 për numër të banorëve në Komunën tonë.
- Poashtu duhet përmendur edhe vonesat nga ana e AME-së si çështje prioritare në zhvillimin dhe avancimin e këtij shërbimi, aktivizimi i Qendrës së Alarmimit dhe Shpëtimit në rrugën “Enver Topalli”, ku objekti i ri ka përfunduar me vite por vetëm duhet plotësuar me inventarë shtesë, automjete dhe pranimin e punëtorve zjarrfikës sipas procedurave të AME-së dhe ligjeve në fuqi.
- Gjatë vitit 2019 janë bërë disa investime në furnizimin e këtij shërbimi si në mjete pune (shpinore, lopata zjarri dhe pompa të ujit). gjithashtu nga ana e AME-së ky shërbim është pajisur me rroba profesionale dhe nga Komuna janë pajisur të gjithë zjarrfikësit me rroba dhe veshmbathje për punë.
- Komuna do të ketë si prioritet zhvillimin e shërbimit të zjarrfikjes dhe shpëtimit si renovimi i objektit aktual, pajisja me mjete pune si dhe vendosja e hidrantëve të ujit me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për punë e cila do të ndikoj drejtpërdrejt në sigurinë e jetës dhe të mirave të shoqërisë dhe qytetarëve.

Tabela: Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenimeve tjera Janar-Dhjetor 2019

Muajt	Dalje	Objekte	Zjarre Malore	Zjarre Fushore	Aksidente Trafiku	Automjete	Pajisje elektrike	Alarme të rreme	Shërbime	Intervenime	Mbeturina	Boca Gazi	Objekte të tjera	Vërshime	Oxhaqe	Ushqim kafshëve	Gjendje Mobile	Eksplozive
JANAR	38	2	0	1	1	1	5	0	1	10	4	0	3	1	9	0	0	0
SHKURT	71	2	3	40	0	2	4	2	0	2	4	0	5	0	7	0	0	0
MARS	212	4	52	12 4	0	1	5	0	0	0	11	0	7	1	3	3	1	0
PRILL	51	6	15	5	0	0	6	2	1	3	7	0	1	0	5	0	0	0
MAJ	28	3	0	0	1	3	5	0	0	3	11	0	1	0	1	0	0	0
QERSHOR	27	1	0	2	1	6	2	0	1	11	2	1	0	0	0	0	0	0
KORRIK	37	3	0	5	0	4	1	2	0	5	12	0	3	0	0	2	0	0
GUSHT	85	1	5	40	3	3	1	0	2	11	12	0	6	0	0	1	0	0

SHTATOR	72	5	7	30	0	1	3	2	0	7	11	0	4	0	0	2	0	0
TETOR	66	1	1	35	4	1	3	0	2	4	11	0	3	0	0	1	0	0
NËNTOR	49	3	0	8	2	3	8	0	4	10	6	0	1	0	4	0	0	0
DHJETOR	37	5	0	0	2	0	12	0	0	8	7	0	0	0	3	0	0	0
TOTALI	773	36	83	29 0	14	25	55	8	11	74	98	1	34	2	32	9	1	0

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe intervenime tjera Janar-Dhjetor 2019

NJPZSH - FERIZAJ

Daljet e përgjithshme	Numri i zjarreve	Intervenime teknike.	Aksidente rrugore.	Vërshime	Shërbime	Boca gazi	Gjendje mobile
773	670	74	14	2	11	1	1

Struktura e zjarreve dhe klasifikimi i tyre gjatë intervenimeve të vitit 2019 nga NJPZSH - FERIZAJ

Zjarre në objekte	Zjarre në sipërfaqe të hapura	Zjarre në automjete	Zjarre në pajisje	Zjarre mbeturinash	Zjarre në oxhaqe	Zjarre në ushqime	Alarme te rrejtshme	Objek. tjera	Gjithsejt
36	373	25	55	98	32	9	8	34	670